

Jusuf BUXHOVI

LIBRI I BLLACËS

3

ETËR E BIJ

(Trilogji)

I

Në Byronë e të Zhdukurve, Vëllaznim Prishtina mezi do të depërtojë deri te nëpunësja e huaj, e cila priste përkthyesen vendore t'i ndihmonte për të vënë rend mbi shënimet që merrte nga ata që pareshtur hynin dhe që shumë prej tyre nuk ia dilnin të përballonin shqetësimin që u shfaqej me rastin e pyetjeve që u shtroheshin rreth të dhënave që lidheshin me identitetin e atyre që u mungonin.

Ndryshe nga pala paraprake, një mesoburri të thyer fare, i cili ishte shkrehur në lot kur kishte filluar të tregonte për të birin njëzetedyvjeçar që ia kishin marrë çastin që bëheshin gati të largoheshin nga Prishtina në drejtim të maleve të Koliqit dhe bashkë me shumë e shumë të tjerë, të lidhur i kishin futur në njërin nga automjetet e blinduara që rrinin skaj rrugës me tyta të drejtura në ta, Vëllaznimi ishte treguar fare i përmbajtur. Pa pasur nevojë për përkthyesen, e cila vazhdimisht ndërpritej nga ata që, edhe pasi largoheshin, ktheheshin me ndonjë letër tjetër, ose me ndonjë hollësi që u kujtohej më vonë, e që e merrnin si të rëndësishme, nëpunëses holandeze i ishte drejtuar anglisht, gjë që asaj ia kishte krijuar mundësinë që bisedën me të ta pranonte me një përkushtim edhe më të madh dhe, madje, pas atyre që fillimisht ishin futur në formularin e detyrueshëm, ta luste që, po të kishte kohë, në mbrëmje të pinin së bashku kafe në kafenenë aty përballë, meqë ashtu, si i kishte thënë ajo, i jepej mundësia që përmasat e asaj fatkeqësie t'i njihte, jo vetëm nga të dhënat dhe dokumentet, me të cilat err e terr ballafaqohej dhe shumë prej tyre, si të regjistruara, mund të mbeteshin vetëm një çështje statistike që u duheshin analizave të mëtutjeshme, por edhe nga bisedat e tjera të lira, ku rrëfimet nxirren nga detyrimi i atyre që u duheshin hulumtimeve të mëtejshme.

Por, para se të pinte atë kafënë e mbrëmjes dhe të bisedonte me holandezen e re që i takonte administratës ndërkombëtare, të vendosur në Kosovë sapo kishin hyrë trupat e NATO-s që, dhe si do të shihet, pa vonuar atyre ky takim do t'u kalojë në një miqësi të thellë që dikur do t'i bashkojë përfundimisht, Vëllaznim Prishtina në Byronë e të Zhdukurve do të japë të dhënat e domosdoshme që i duheshin plotësimi të formularit rreth personave të zhdukur gjatë luftës, ku do të deklarojë se fjala ishte për të atin, Bardhyl Prishtina, i lindur në Prishtinë në verën e vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë, magjistër i shkencave juridike, i cili viteve të fundit kishte ushtruar profesionin e avokatit të pavarur.

Në formular kishin pasuar edhe të dhëna të tjera, ndër të cilat binin në sy shënimet se Bardhyl Prishtina, si jurist i njohur, fillimisht kishte punuar këshilltar juridik në njërin nga sekretariatet e Qeverisë së Kosovës, ndërkohë që pas kryerjes së magistraturës në lëmin e të drejtës kushtetuese, ishte përfshirë në grupin e juristëve që kishin përgatitur amendamentet e njohura të Kushtetutës së vitit një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër, për t'u emëruar më vonë sekretar i Kryesisë së Kosovës, detyrë kjo, të cilën do ta ushtrojë për tre vjet me radhë

dhe nga e cila do të largohet pasi të jetë zgjedhur, së pari asistent, e pastaj edhe ligjërues i të drejtës kushtetuese në Fakultetin Juridik të Universitetit të Kosovës në Prishtinë. Nga shtatori i vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e deri në prag të luftës, pra për tetë vjet me radhë, në rrethanat e arsimit paralel, që ishte zhvilluar thuajse në kushte ilegale dhe me shumë vështirësi, kishte udhëhequr Katedrën e Fakultetit Juridik.

Ndër të dhënat e tjera, që plotësonin biografinë e babait, avokatit Bardhyl Prishtina, pas një hamendjeje të shkurtër, se mos ato nuk ishin gjithaq me rëndësi për ata që kërkoheshin, i biri kishte dhënë edhe shënimet që lidheshin me mandatin e tij si deputet i Kuvendit të Kosovës, nga periudha e vitit një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër e deri në vitin një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, ku ishte shënuar se karriera e deputetit kishte marrë fund më dy korrik të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, me shpalljen e Deklaratës kushtetuese të pavarësisë së Kosovës, me të cilën ishte shfrytëzuar e drejta legjitime e deklarimit që ia garantonte kushtetuta në fuqi si anëtare e barabartë e federatës, me çka do të krijohen edhe rrethanat formale për gjithë ato zhvillime që më vonë do të kulmojnë me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve dhe shkapitjen përfundimtare me Beogradin...

Këtu, Vëllaznim Prishtina kishte bërë një pushim të shkurtër, sikur të jepte të kuptohej se pikërisht aty përfundonte çdo gjë që mund të thuhej për të atin, si person i zhdukur, i cili kërkohet si shumë e shumë të tjerë.

Por, holandezja, e cila kishte përcjellë me vëmendje ato që ai kishte thënë deri atëherë dhe, ç'është e vërteta, një pjesë syresh as që ia kishte dalë ta shënonte, ngaqë gjuha e ngurtësuar e formularëve nuk mund t'i pranonte, sepse ishte hartuar për të dhëna të thjeshta dhe tejet të kufizuara, pra ajo e kishte përkujtuar se mungonin shënimet kryesore, ato që lidheshin me kohën dhe vendin e zhdukjes, të cilat duheshin për të hapur procedurën e kërkimit.

- Janë formalitete të domosdoshme që nuk mund t'u iket, ndonëse lidhen me shqetësime të mëdha...

Fjala „kërkim“ sikur e kishte trandur pa masë, ngaqë ia kishte përkujtuar humbjen dhe gjithë ato që lidheshin me të pakthyeshmën, po edhe më shumë se kaq, që më vonë do t'i kalojë në një përndjekje të vazhdueshme mendjeje, pikërisht pse ajo fjalë kishte shtrirë një pushtet të pakufishëm dhe ndoshta të përhershëm mbi ato që u kishin hyrë në mes si mospajtime dhe shqetësime të tjera, që asaj ndarjeje sikur ia kishin veshur përshtypjen e një humbjeje të hidhur, e cila, si e tillë, mund të mbetej përgjithmonë...

Por, meqë nevoja administrative e donte të thuhej edhe ajo që merrej si ndarje, që i kishte paraprirë zhdukjes bashkë me ato që nënkuptonte ajo dhe të ngjashme, pas një shtrëngimi që ia kishte pasqyruar fytyra e vrenjtur dhe mbase edhe gjithë qenia, me shumë vështirësi kishte nxjerrë nga goja ditën njëzet e tetë të marsit dhe kishte theksuar edhe orën gjashtë e shtatë minuta të mbrëmjes, me ç'rast ishte thënë se e gjitha kishte ndodhur në udhëkryqin, ku rruga magjistrale në drejtim të Shkupit, në të djathtë, në drejtim të maleve të Sharrit, shkonte për në Tetovë.

- Aty janë ndarë rrugët tona...

Vëllaznim Prishtina nuk kishte qenë i detyruar të tregonte më tutje se si ajo ndarje - edhe pse kishte qenë e dhunshme dhe ishte paraparë prej forcave ushtarake jugosllave dhe njësisive të tjera të shumta paramilitare, që kishin zënë atë udhëkryq dhe sikur të ndiqnin rregullat e zigzagut, ndanin automjetet, por edhe kalimtarët në drejtim të Shkupit dhe drejt Tetovës, ku të parët kishin përfunduar në atë që do të quhet kamp i Bllacës dhe aty do të përjetonin atë zhvlerësimin më të madh njerëzor që ishte parë ndonjëherë andejpari, ndërsa të dytët, të shpërndarë nëpër qendra të ndryshme të strehimit nëpër Maqedoni (Tetovë, Gostivar, Shkup e gjetiu), por edhe nëpër Shqipëri, që nga veriu e deri në jug, kishin fituar ndjenjën e rëndë të refugjatit në vend të vet - pra ajo ndarje, që atë ditë ishte bërë me një vrazhdësi të jashtëzakonshme, kishte ndodhur qëmoti, se kishte kaluar nëpër faza të ndryshme derisa të arrinte atë pikën kur ishte parë se midis tyre nuk ndodheshin vetëm dallimet midis etërve dhe

bijve, që ngrihen deri te dallimet e natyrshme të brezave, por kishin hyrë edhe ato moskuptimet e shumta, që ishin kthyer në mospajtime të hapura, për të cilat atëherë kishte menduar se nuk çonin vetëm rrugëve të ndryshme, por edhe në të kundërta madje dhe, pasi u kishte hyrë në mes ndarja e dhunshme, bashkë me ato që do të ngjajnë gjatë atyre shtatëdhjetë e gjashtë ditëve, sa kishte zgjatur ndërhyrja nga ajri, atë qëndrim, që dikur kishte menduar se është përfundimtar dhe i papajtueshëm fare, jo vetëm që do ta korrigjojë, porse edhe do të vlerësojë se kishte paraqitur atë hamendjen e përgjegjesisë së thellë ndaj sfidës së përgjithshme të ngjashme me atë me qenë ose mos me qenë nëpër të cilën ishte kaluar...

Megjithatë, ndërkoha që kishte shënuar heshtjen e ndjeshme, midis fjalëve për ndarjen e rrugëve të tyre tek ai udhëkryq, që edhe po të thuheshin nuk do të ishin në gjendje të shprehnin më shumë se një shqetësim të turbullt, që kthehet në ngulfatje dhe atyre që holandezes ia kishte thënë se pranonte ftesën që bisedën ta vazhdonin atë mbrëmje në kafenenë përballë ndërtesës së dikurshme të Shtëpisë së Armatës Jugosllave, ku ishin vendosur ndërkombëtarët, ishte plotësuar me përfitim të atyre që vetëtimthi i kishin kaluar nëpër mendje rreth çasteve të fundit që i kishin paraprirë atij udhëtimi, që vërtet kishte qenë i fundit dhe kishte mbetur përgjithmonë i fundit, jo vetëm pse nuk do të shiheshin më kurrë, por ngaqë aty ishte arritur kulmi i gjithë atyre që fillimisht ua kishin ndarë pikëpamjet, e më vonë edhe qëndrimet, sa të ndjeheshin edhe kundërshtarë, bile dhe më shumë se kaq që, po të mos ishte ajo ndërhyrje e dhunshme e paramilitarëve që t'i nxirrnin së andejmi dhe me kërcënimin e tytave pa u dhënë kohë më shumë se pesë minuta sa të mos kishin mundësi t'i mblidhnin të paktën plaçkat më të domosdoshme, t'i detyronin të merrnin rrugën në drejtim të Shkupit - me siguri se do të merrte kahun e ndonjë shkëputjeje më të papërcaktuar, që nuk do të përkonte fare me ato dallimet e rëndomta, të cilat një ditë pashmangshëm shfaqen kur mosha dhe pjekuria bëjnë të veten...

Dhe, ato çaste tejet të mundimshme, të cilat do t'i paraprijnë atij dëbimi të dhunshëm dhe asaj ndarjeje të përhershme fizike, që megjithatë nga ai çast do të kthehej në një afri të jashtëzakonshme, të cilën më vonë do ta quajë rigjetje të përhershme shpirtërore me anën e lidhjeve të çuditshme transcedente, kishin të bënin pikërisht me sjelljen në rrethanat e fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s ndaj forcave jugosllave në Kosovë dhe jashtë saj, kur pas shpërthimeve të para kishte filluar ajo hakmarrje e egër ndaj popullatës së pambrojtur fare, e cila kërcënohej me asgjësim të përgjithshëm, kështu që ndërhyrja sikur mund t'i shërbente për të arritur qëllimin kahtër të paraparë që të merrte një epilog të tillë.

I ati mbronte qëndrimin se meqë puna kishte shkuar deri aty, që pas gjithë asaj që kishte ndodhur, e që ai e quante deponim të madh civilizues që lidhej me përcaktimin e drejtë për pavarësinë, ndërkombëtarët t'i lanin hesapet me Beogradin, pa marrë parasysh ato që do t'i dilnin para, se meqë nga ana tjetër fjala ishte për një makineri ushtarake të përgatitur mirë që të çonte deri në fund projektet për spastrimet etnike me dhunë, e cila në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe kudo kishte dhënë dëshmitë më të tmerrshme të gjenocidit pa çarë kokën për ato që thuheshin për të – pra, meqë puna kishte ardhur deri tek ajo pika e synuar që Serbia të paguante njëfarë haraçi për atë që historikisht ishte shpërblyer, duhej bërë çmos që të ruhej popullata nga më e keqja dhe kjo të arrihej me largimin e përkohshëm dhe sa më të shpejtë në drejtim të Maqedonisë dhe të Shqipërisë, në mënyrë që edhe kundërvënja e armatosur nga brenda të ishte në gjendje të përqendrohej në veprimet e drejtpërdrejta luftarake, me të cilat ajo gjatë asaj ndërhyrjeje të ndërkombëtarëve do të fitonte trajtimin e partnerit në luftë dhe assesi ndryshe...

- Gjendemi para dilemës ndër më të mëdhatë me të cilën jemi ballafaquar ndonjëherë, andaj nuk guxojmë të bëjmë kurrfarë lëshimi apo gabimi, që mund të na kushtonte shtrenjtë..., i kishte thënë i ati gjithë shqetësim.

- Ne po e lëshojmë vendin sikur të ishim të huaj në të dhe mezi presim të ikim prej tij...Kështu, pushtuesve po u krijohet mundësia për të arritur qëllimin që ka herë e kanë synuar...

- Lufta e gjithanshme, e filluar qëmoti me Beogradin, tashmë gjendet në fazën përfundimtare dhe ajo, me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve, pashmangshëm merr epilogun, me të cilin u hapet udha kthesave të mëdha historike...

- Na duhet fitorja dhe jo kthesat, pa marrë parasysh se çfarë mund të quhen ato...

- Me rëndësi është që pushtimi serb njëherë e mirë të marrë fund në këtë vend...

- Kjo nuk është e njëjtë...

- Quaje si të duash, por pa këtë nuk arrihet qëllimi ynë...

- Vetëm fitorja jonë këtë e bën të mundshme...

- Hëpërhë mendjen e kam vetëm te humbja e Serbisë... Kjo do të paraqiste fitoren më të madhe...

- Unë mendoj për fitoren tonë, sepse vetëm ajo mban çelësin e të gjithave...

- Kush nuk do ta dëshironte këtë...?

- Ata që i frikësohen asaj...

Në të vërtetë, çështja e fitores, por edhe e humbjes që do t'i paraprinte asaj, atë ditë, por edhe më parë gjatë atyre viteve të dhunës së jashtëzakonshme nëpër të cilën ishte kaluar, fillimisht kishte paraqitur atë pikën e dallimeve, e më vonë edhe të mospajtimit, por edhe të kundërshtisë së hapur, ngaqë i ati e shihte si diçka që planit ushtarak i përcaktohej nga politika dhe rrjedha e saj, ku nuk përjashtoheshin ato që lidheshin me të mundshmen si të arritshme, që doemos kalon nëpër kandin e marrëveshjeve midis të mëdhenjve, që u duhen baraspeshimeve dhe atyre që shfaqen edhe si marrëveshje, por edhe kusurritje në dëm të të tjerëve dhe të tjera si këto që ai i shihte si pjesë të strategjisë dhe të gjeostrategjisë, ndërkohë që ai e shihte të kundërtën: që veprimi ushtarak, ku përfshihej lufta e armatosur me fitoren si qëllim të saj të fundit, t'ia përcaktonte kahet politikës dhe madje ta vinte para aktit të kryer, ngaqë ashtu, lojërave të ndryshme, që në këto hapësira gjithmonë kishin ruajtur përparësinë, ua ngushtonte hapësirën dhe ua merrte mundësinë e prapaskenave të mundshme me të cilat ajo shërbehej...

Këtë mendim, i cili sikur përjashtonte të tjerat, qofshin edhe ato që duhej të kiheshin parasysh, ai e veçonte nga ai duf i rëndomtë, me të cilin e kishte gojën plot e përplot gjatë bisedave në kafe "Syri", po edhe në ndeja të tjera, ambienti i të cilave jehonte nga kumbimi i vargjeve, recitimeve dhe fjalimeve të improvizuara plot e përplot emocione, veçmas kur shoqëroheshin me këngë dhe muzikë të protestës...

- Ka kaluar koha e politikës paqësore dhe e llafeve të saj me atë farë durimin poshtërues që nuk hiqet nga goja...

- Politikës nuk i kalon kurrë koha, edhe po të ketë fitore ushtarake...

- Lëre politikën ore, se na nxori shpirtin...

- Lufta është vazhdim i politikës me mjete të tjera...Ata që nuk e vërejnë këtë, ose për ndonjë arsye apo tjetër nuk dëshirojnë ta pranojnë, pashmangshëm kthehen në lodra të saj, madje edhe në viktima, por kur ta marrin vesh këtë, u bëhet vonë...

- Deri kur me këto matje-çmatje...?

- Ato janë të domosdoshme...

- T'i harrojmë njëherë se na zunë frymën...

- Nuk bën pa to, sepse mashtrohemi dhe dëshpërohemi pastaj...

Mbase biseda e tyre, edhe atë pasdite me shi të imët gjithë ftohtësi, do të merrte kahun e paraparë, pra, si rëndom atë të mospajtimit, që shpinte në grindje të pashmangshme, të cilat pastaj atij i shërbenin që dufin e tyre ta zbrazte nëpër vargjet e poezive që nuk i ndaheshin dhe në to gjente prehje shpirtërore për të gjitha - po të mos kishte trokitur dera e jashtme një herë dhe ajo trokitje pastaj shumë shpejt të kthehej në një përplasje dhe në fund të thyhej fare, kur

pa nxjerrë mirë kokën për të parë se çfarë po ndodhte, ishin tytat e armëve që u kishin dalë para bashkë me atë urdhrin gjithë çirrje që të largoheshin sa më parë prej andej.

Urdhri ishte përcjellë me kërcënime dhe fyerje të rënda. U ishin sharë nënat shqiptare. U ishte thënë se ç'u kishte sjellë ndërhyrja e NATO-s, që e kishin pritur dhe aq shumë kishin punuar për të gjetë atyre viteve të fundit dhe çmos tjetër. Ato ishin shoqëruar me atë refrenin e njohur të thyerjes së qafës në Shqipëri, meqë ai vend përgjithmonë do të mbetej Serbi, fjalë këto që çuditërisht kishin ndikuar që shpejt e shpejt t'u rikthehej ajo afria e brendshme, e strukur diku nga shpërfilljet dhe ato që u kishin hyrë në mes për vite të tëra të ndjeheshin një trup i vetëm, i cili shumë shpejt kishte vënë në veprim ata mekanizma të brendshëm mbrojtës, të ngjashëm me instinktin e pakontrolluar të frikës, që aty për aty, në rrethanat e një rreziku të madh, siç ishte ai, kishin qitur në pah vetëm mundësitë e ikjes, pa menduar fare për të tjerat...

Në atë ngarendje pas gjërave të domosdoshme (dokumente, të holla dhe cikërrima të tjera që nuk ngarkojnë), për herë të parë kishte hetuar kapërcimin nga njëra gjendje në tjetrën (nga ajo e fjalëve të zjarra, të shumtën si frymëzime të papërmbajtura poetike, të cilat pastaj i thurte nëpër vargje, tek ajo e sfidës së njëmendtë të kundërvënies, e cila nuk mund të ishte as mllef, as revoltë e as kurrëgjë tjetër, veçse pjesë e një të menduari shtruar, në përputhje me të mundshmen dhe me rregullat e saj), që nuk ia kishte marrë mendja se mund të ishte i tillë, gjë që ai ndryshim dhe shkallimi që ia kishte sjellë, edhe më tepër ishte nxitur kur kishin dalë në rrugë dhe aty i ishin bashkuar morisë së të përndjekurve, që vinin nga ana e Gjermisë dhe e Xhamisë së Llapit dhe gjithnjë në përputhje me kahun që ua caktonin forcat ushtarake dhe ato paramilitare që u shkonin pas dhe i përcillnin nga të dyja anët e rrugës, bashkoheshin te ndërtesa e Kuvendit të Kosovës për t'u drejtuar pastaj nëpër qendër dhe tutje drejt Lakrishtës për te stacioni i autobusëve.

Lumi i njerëzve, që të gjithë të trishtuar dhe të tmerruar (në bazë të ndonjë çante dhe gjësendeve të tjera, mund të thuhej se kishte edhe të atillë që tashmë ishin përgatitur për një gjë të tillë), krahas frikës se ashtu fillonte humbja e dhunshme e atdheut, poshtërimit e parë dhe më të madhin e kishte përjetuar kur, të përcjellë nga njësitë paramilitare dhe forca të tjera policore që kishin zënë pikat kryesore dhe i drejtonin rrugës së paraparë, kishin kaluar rrugës kryesore, nga Teatri deri te hoteli "Grand", nga të dyja anët ishin sharë, ishin pështyrë dhe madje ishin gjuajtur me gurë nga fqinjët e tyre të deridjeshëm, që fuqishëm çirreshin gjithë egërsi për Serbinë e madhe dhe fundin, si thoshin ata "të Shqipnisë së madhe" dhe të ngjashme, që përcillej me çirrjen e përbashkët:

"Kosova është Serbi dhe në Kosovë varroset NATO!..."

Si pjesë e asaj turme të pafuqishme dhe me mendimin se çfarë do të thoshte kur dhuna e papërmbajtur përnjëherë të kthen në një numër të thjeshtë brenda një mase të madhe, por të pavlerë fare, e dëgjueshme dhe me përulje të papërshtatshme lëviz andej nga i grahet, kishte bërë përpjekje që të atit të mos ia lëshonte krahun dhe sa më shumë që ia kishte shtrënguar, aq më shumë i ishte dukur se ashtu përçonte diçka të afërt, që i kishte munguar dhe druante se çfarëdo shpërndarjeje mund t'ia ndërpriste atë dhe me këtë ta bënte edhe të paqenë fare.

Pa çuar kokën nga sharjet, fyerjet dhe britmat e ashpra që u vinin nga të dyja anët e rrugës, me shikim të ndrydhur ishte munduar të përvidhte të atin, që mezi ecte, por kjo nuk i kishte shkuar ndoresh, sa nga druajtja se ashtu zinte ndonjërin nga ata që njihte, me të cilët ishte rritur dhe kjo do ta poshtëronte edhe më shumë, e sa nga frika se çfarëdo fërkimi me të do t'ia hapte çështjet e asaj që ai i fliste për rrethanat e ballafaqimit me forcën e egër dhe paaftësinë për kundërvënie, paraqet më shumë se dështim të madh njerëzor, një nënçmim dhe poshtërim të përhershëm...

Madje, nëpër atë shalakatje tejte të mundimshme drejt pikës së grumbullimit tek stacioni i autobusëve, kur ishte bërë pjesë e asaj mase të plogët, e cila dukej se zvarritej pa jetë, edhe shikimi më i butë i të atit do t'i vinte tepër i rëndë, më i rëndë se ajo gjendje neveritëse e brendshme nëpër të cilën kalonte pse nuk kishte qenë në gjendje ta parashikonte e as ta parafytyronte si të tillë, edhe pse ai vazhdimisht ia kishte tërhequr vërejtjen se më e keqe

se dhuna ishte gjendja që popullata e pambrojtur t'u nënshtrohej eksodeve kolektive dhe zhvlerësimeve të pashembullta, siç ishte ai në të cilin ishin përfshirë, pa qenë në gjendje që me çfarëdo mënyre t'i kundërviheshin.

- Ka lloj-lloj nënçmimesh, sa as nuk ta ha mendja se ç'plagë shpirti të përhershme shkaktojnë...

Por, kur kishin arritur në stacionin e autobusëve dhe aty për pak i kishin ndaluar që t'i lëshohej rruga një konvoji të gjatë ushtarak që vinte nga drejtimi i Mitrovicës dhe shkonte drejt Veternikut, në vend se t'ia përkujtonte ato që ia kishte përsëritur sa e sa herë kohëve të fundi, ai e kishte shikuar gjithë qetësi dhe ia kishte shtrënguar dorën sikur të dëshironte për me e trimnue për me u shpëtue atyre që mbesin plagë të përhershme shpirti, për të cilat e kishte paralajmëruar me kohë...

- Kalohet edhe kjo furtunë...Kalohet...Vetëm ata që do të kthehen, do të dinë për me e dashtë dhe me e ruejtë vatanin si duhet...

Ai kishte heshtur si i shkallmuar, ndërkohë që i ati, me të njëjtën qetësi, i kishte thënë se ai ishte fillimi i atij fundi, që e kishte pritur.

- Kjo luftë ka filluar qëmoti, edhe atëherë kur kemi menduar se po sillemi natyrshëm dhe, vetëm kështu mund t'i vijë fundi i pashmangshëm...

Kur përmendte luftën, Vëllaznimi e dinte se i ati e kishte fjalën për diçka më të madhe sesa konflikti me armë, që zhvillohej në fushëbeteja dhe, në rrethana të caktuara, nuk mund të paraqiste tjetër përpos vazhdim të politikës me mjete të tjera. Për të, ajo nisej nga hapësira jetësore, kur ajo mbrohej nëse nuk rrudhej dhe pashkëputshëm shkonte tutje-tëhu për t'u shtrirë deri tek gjendja shpirtërore dhe me gjerë, për të kaluar pastaj në kujtesë të përhershme, nga ushqehet genia dhe vetëdija e saj...

Gjatë kohës sa kishin qëndruar në stacionin e autobusëve, e edhe pasi i kishin hipur duke u grahur si bagëtisë në atë autobusin e madh me targa të Krlevës, ndër shumë e shumë sish që vinin nga veriu dhe me shpejtësi mbusheshin dhe niseshin në drejtim të Shkupit, i ati ia kishte përsëritur fjalët rreth çmendisë së humbësve, të dënuar për të, si dhe furtunës, e cila doemos kalohet me anën e durimit, të cilat i kishte shoqëruar me gjykimin se ata që do të kthehen, do të dinë me e dashtë dhe me e ruejtë atdheut si duhet...

Në rrethana të tjera, shprehjes *ruajtja e atdheut*, shpejt e shpejt do t'ia kundërvinte shprehjen *mbrojtja e vatanit*, siç kishte bërë shumë e shumë herë kohëve të fundit, kur edhe kishin dalë në pah pikëpamjet, por edhe qëndrimet e tyre të ndryshme dhe të kundërta gjatë asaj që kishte paraqitur jetë paralele dhe në mbijetesë e sipër pashmangshëm kishte hapur edhe dilemën se çfarë mund të arrihet po qe se e gjitha do të kthehej në një rreth të mbyllur a diçka të ngjashme?...

Por, përballë atij zhvlerësimi të tmerrshëm, në të cilin ishte përfshirë dhe kalonte, edhe pa dëshirë, vëmendja i përqendrohej vetëm te fjala *kthim*, që i vinte e shkëputur fare nga të tjerat, që pasonin rreth ruajtjes së atdheut, të cilat ia përsëriste dhe ia përsëriste pareshtur sikur të kishte për qëllim ta nxirrte nga ajo gjendje e rëndë, në të cilën kishte rënë dhe që e kishte nga dëshpërimi, ngase nuk ia kishte marrë mendja se do të ballafaqohej me diçka të tillë, aq më pak që ndaj saj të sillej ashtu pa më të voglën mundësi që disi t'i kundërvihej, së paku me anën e ndonjë shfrimi poetik, të ngjashëm me ato trandjet që e pushtonin gjatë recitimeve në kafe "Syri" a gjetiu gjatë atyre dehjeve të përbashkëta, ndonjëherë edhe tallanditëse, kur mendonte se është në gjendje t'u bënte ballë të gjithave, qoftë edhe dhunës më të egër, vetëm pse e kishte të aktivizuar ndjenjën e mospajtimit dhe të mllefrit, si diçka që është në gjendje të veprojë kur për këtë paraqitet nevoja...

Madje, një çast, kur kishin kaluar Ferizajn dhe nën urën që atë e lidhte me magjistralin e Shkupit, kishin vërejtur një mori njerëzish të rrethuar nga forca ushtarake në pritje të dëbimit për diku, sikur e kishte lëshuar forca fare dhe aty kishte hetuar atë shpërputhjen e madhe në vetvete, që i ati përherë ia kishte përkujtuar se duhej pasur parasysh, nëse, si i

thoshte, “mendohet të fluturohet pa krahë”, me të cilën ishte ballafaquar në çastin më të papërshtatshëm...

I ati kishte bërë përpjekje t’i ndihmonte disi duke i dhënë besim me fjalët rreth pranverës që do të vinte së shpejti, për beharin e Gërmisë dhe të tjerat, me të cilat si fëmijë frymëzohej për ato vjershat e para që shkruante dhe i pëlqenin aq shumë dhe në saje të tyre më vonë do t’i jepej me gjithë shpirt poezisë, ku me botimin e librit të parë dhe të dytit edhe do të bëjë emër në radhën e krijuesve të rinj, por që si duket as muzat më krenare që sjellin kryeneçësi dhe jo rrallë e frymëzonin t’i thoshte edhe ato fjalët rreth luftës si fjalë të fundit dhe të domosdoshme dhe të tjera si këto, me të cilat sikur më shumë ngushëllohej sesa trimërohej - nuk kishin qenë në gjendje t’ia krijonin përfytyrimin e një gjendjeje tjetër nga ajo e sharrimit të plotë drejt atij shkallmimi, që si duket do t’i kalojë paksa vetëm atëherë kur autobusi kishte ndaluar dhe i kishin zbritur aty ku rruga e Shkupit, në të djathtë, degëzohej në drejtim të Tetovës.

Aty kishte parë një turmë tjetër. Të rrethuar nga automjete ushtarake të vendosura në një trekëndësh, prisnin derisa vinin kamionët e mëdhenj ushtarakë me mushama të mbyllura, ku i hipnin dhe pa ndonjë rend, disa i drejtonin kah Shkupi e disa të tjerë në drejtim të Tetovës.

Ashtu kishte ndodhur edhe me ta. Policët me uniforma lufte i kishin ndarë në dy grupe, kush në të majtë e kush në të djathtë, pa çarë kokën për lidhjet familjare dhe madje as pse ashtu ndaheshin burrat prej grave, fëmijët prej nënave, ndarje këto që kur përcilleshin me lutje, ankime dhe rënkime që të mos ndodhte, atëherë përdorej forca e ashpër, përfshirë këtu edhe përdorimin e kondakëve të armëve dhe grushtimet e pamëshirshme dhe tepër poshtëruese, dhunë kjo që bëhej edhe më e rëndë kur shoqërohej me ato britmat për “Serbinë e madhe” dhe për vendosjen e saj të përhershme aty, që prej tyre quhej “djep i serbizmit...”

Përballja me një tmerr të tillë, sikur ia kishte hequr mundimin e mëparshëm të shkallmimit, por, nga ana tjetër, e kishte përballur me ndarjen nga i ati, kur atë e kishin drejtuar në anën e djathtë, ndërsa ai kishte mbetur në të majtën me ndjenjën e njeriut të vetmuar fare dhe pa praninë e atij që aty kishte kuptuar që kishte qenë një si dashuri prindërore e veçantë, ndër më të fuqishmet, ndër më të thellat, fuqinë e së cilës për herë të parë e kishte nxjerrë në pah pikërisht ajo që u kishte hyrë në mes si kundërshti, si ndarje dhe diçka tjetër, por që aty ishte parë se ajo nuk kishte qenë e tillë, ndjenjë kjo që i ishte shtuar edhe më tepër dhe e tillë do t’i mbetej edhe atëherë kur, bashkë me të tjerët, do të përplasej në kamionin që do të shkojë rrugës së Shkupit, që, si do të marrë vesh më vonë, kishte përfunduar në Bllacë ku, në saje të një njoftimi që e kishte nga njëri, i cili ngjashëm kishte kaluar nëpër atë kamp përqendrimi, me të ishte parë edhe atë mëngjesin e asaj dite të pestë të prillit, kur me ata autobusë të mëdhenj i kishin nxjerrë së andejmi dhe nuk dihej se ku kishte marrë fund rruga e tij, por, si do të shihet më vonë, ajo kishte qenë pa kthim...

Çastet e udhëtimit nga udhëkryqi që shpinte për në Tetovë e derisa i kishin zbritur para kalimit kufitar me Maqedoninë, një copë rrugë që në disa vargje e kishte përshkruar “vijë e hekurt nëpër shpirt, plagë e përhershme” dhe metafora të tjera të ngjashme që i lejohen poezisë, dhe aty, pasi edhe një herë i kishin hallakatur sikur të ishin lecka dhe bashkë me gjësendet e tjera ua kishin marrë edhe të gjitha dokumentet personale, të cilat i kishin hedhur në një shportë të madhe mbeturinash dhe ashtu i kishin kthyer në njerëz pa identitet fare - do t’i kalojë me ripërsëritjen e atyre që i ati ia thoshte rreth atij fillimit të fundit të asaj humbjeje, që theksonte se e kishte pritur të ishte i tillë, e që kthimi në atdhe do të paraqiste një sjellje tjetër ndaj tij, që ai të ruhej përgjithmonë, e që pak nga pak i kishin tingëlluar si vargje të shkëputura të një balade antike, të mbetura diku në një hapësirë të gjithmonshme, të ngjashme me atë bredhjen e përhershme në kërkim të Itakës, me të cilat më vonë do të fillojë edhe ato përpjekjet për krijimin e projektit letrar rreth “*Dardanisë si kujtesë poetike*”, me të cilën mendja ia thoshte se do t’u bashkohej pikëpamjeve të të atit rreth atyre që ai i thoshte për kujtesën historike si diçka që ushqen qenien, që nxjerr nga ato humbjet dhe rëniet, qofshin

edhe të mëdha, siç ishte ajo nëpër të cilën kalonin, por që krahas kësaj, mendonte se edhe do ta zhdëmtonte ndodhjen e Bllacës, para se ajo të kalojë në plagë të përhershme shpirti...

“Itakën nuk mund ta gjejnë ata që kthehen në numra të pavlerë...”

Kështu i kishte thënë vetes gjatë atyre njëqind e sa hapash që e kishin ndarë nga pika kufitare, së cilës i ishte afruar pak nga pak, si i ngrirë, më shumë në saje të asaj bartjeje të turmës, në të cilën ishte përfshirë, sesa të vullnetit të vet për të lëvizur. Sepse, në ato rrethana, po të kishte mundësi, me siguri se do të mbetej aty gjithë derisa t’i kalonte ai shkallim, që të mendonte kështu për të gjitha dhe më së shumti për humbjen e Itakës, por kjo nuk i ishte lejuar, ngaqë kishte arritur pikën më kritike, të cilën i ati ia përkujtonte, kur ndodh ajo shkundje kthjelluese e dhunshme nga ëndrrat, nga emocionet, nga paragjykimet dhe nga gjithë ato që sjellin shpërputhjet midis të mundshmes dhe të pamundshmes, midis të lejueshmes dhe të palejueshmes dhe, mbi të gjitha, midis të domosdoshmes, si të dobishme, që përcakton përmasat e mbijetesës pa u vënë në rrezik qenia e përgjithshme, ajo që paraqet atë trungun themelor të të qenët, që përcaktohet me kohën e gjatë të ndërtimit dhe të tjera të ngjashme, por që për t’u rrënuar nuk i duhet shumë...

Përshtypjen e sendit të pavlerë, të atij që nuk mund ta kërkojë Itakën, ngaqë e kishte humbur pa e merituar fare, e kishte pasur edhe pasi kishte kaluar kufirin dhe ishte gjendur në atë pjesën që shpinte për në Tetovë, së cilës, ndonëse kishte qenë natë dhe terri i thellë kishte vendosur pushtet ngado, nuk kishte qenë e mundur t’i fshiheshin përmasat e mëdha dhe të jashtëzakonshme të eksodit që kishte përfshirë mijëra e mijëra veta, familje të tëra, të cilat sikur zhvendoseshin nëpër një hapësirë përrallore të askundjes, ku do të mbeteshin përgjithmonë, jo pse kërkonin diçka që duhej ta gjenin, po pse kishin humbur kujtesën...

Mbase me përfytyrimin e Itakës dhe me mendimin për humbjen e saj do të mbetej edhe më tutje, po të mos ishin disa që e kishin zënë për krah dhe me shumë përzemërsi i kishin thënë se kishte nevojë për një pushim.

Ata, që ishin dy veta, e kishin marrë me vete dhe pasi e kishin hipur në një veturë, gjatë atij udhëtimi që nuk e dinte se a kishte qenë fare i shkurtër apo i gjatë, ndoshta dhe pjesë e atij që ishin nisur nga Prishtina e assesi të merrte fund, i kishin folur për një si fatkeqësi të madhe, që megjithatë kishin thënë se do të kalohej bashkërisht, se ajo bashkërisht, si thuhej prej tyre më shumë me ngjyrimin e një pikëllimi sesa të ndonjë shprese, që në ato rrethana as që do ta dëshironte dhe të ngjashme, nënkuptonte një si pritje që, siç kishte thënë ai që drejtonte makinën, ishte edhe e drejtë dhe e arsyeshme, ngaqë kishte shtuar se tashmë punët në dorë i kishte marrë i madhi, e që ky theksim i “të madhit” prej tij, i kishte tingëlluar ndryshe nga ato që ia thoshte i ati rreth NATO-s dhe perëndimorëve, të cilët udhëhiqnin atë ndërhyrje, që ia kishte përkujtuar më shumë pushtetin e forcave të panjohura sesa të fatit, të ngjashme me ato që kishin parapërcaktuar kthimin në Itakë, gjë që, i shtyrë nga përftimi i asaj përshtypjeje, sikur kishte përmendur edhe Trojën, edhe Ulin, edhe Agamemnonin dhe gjithë ato që ishin pjesë e epëve të mëdha antike, që kujtesa e shthurur dhe trysnia e njëfarë çrregullimi që i ishte shfaqur në të, pas pak ia kishte lidhur për gojë fjalët rreth Itakës dhe kerkimit të saj, që i kishte thënë sikur t’i thyhej diçka në gjuhë dhe atë ta nxirrte si një përplasje, me ç’rast atyre që e kishin marrë me vete dhe me aq shumë mirësjellje dhe përkujdesje e kishin shoqëruar deri te dhoma e asaj shtëpie në kodrinë, ku edhe e kishin vendosur dhe i kishin thënë se duhej të pushonte atë natë - ua kishte krijuar përshtypjen e të shkalluarit të përhershëm, çfarë kishte pasur bukur shumë gjatë atyre ditëve dhe me të cilët ishin përballur...

II

Me përshtypjen e kerkimit të Itakës, si një metaforë, e cila paraqiste më shumë se një bredhje të përhershme nëpër pjesët e shkapërderdhura të vetvetes, por edhe tek ato të shpirtit dhe të tjerat që më vonë me projektin për *Dardaninë si kujtesë e përhershme poetike* do t’ia bashkëngjisë kerkimit të babait të vet “*Dardania kujtesë historike dhe rrënjët e saj antike*”,

Vëllaznim Prishtina i ishte afruar kafenesë përballë ndërtesës së ndërkombëtarëve, gjithnjë me përshtypjen se edhe më tutje po i afrohej një pjese kaherë të ndaluar të qytetit, nga rridhte shqetësimi, frika dhe gjithë ato që kishin të bënin me dhunën, por edhe me luftën nëpër të cilën kishin kaluar. Këtë sëmbim e kishte hetuar sapo kishte hyrë në pjesën e epërme të rrugës kryesore, nga e cila, sa më shumë që i afrohej pjesës së hotel “Grandit”, vërente autobllinda të mëdha të trupave britanike dhe njësitë e tyre të armatosura tek përgjonin çdo kalimtar. Një copë herë mbeti ashtu i ngrirë në pjesën midis hotelit dhe shtëpisë së mallrave, që iu duk e shkretë, por që ajo qetësi e përzier me mbetjet e vapës së ditës që ngado kishte lënë një kundërmim të rëndë, sikur po i ngatërrohej dhunshëm me pjesët e pamjeve të parakalimi të asaj dite të katër të ndërhyrjes nga ajri të ndërkombëtarëve, kur njësitë paramilitare serbe i kishin nxjerrë nga shtëpia dhe bashkë me të tjerët i kishin detyruar të merrnin drejtimin e stacionit të autobusëve, për t’i nisur pas pak në drejtim të Shkupit...

Që t’i ikte këtij parafytyrimi trishtues, deshi të kthehej, ndoshta edhe do të kthehej po të mos kishte qenë lëvizja e një autobllinde që kishte ardhur nga drejtimi i teatrit e që atij i ishte dukur sikur të ishte nga ato të hershmet, e cila pastaj, nga pjesa e ndërtesës së “Elektroekonomisë” kishte marrë anën në të djathtë dhe kishte ndaluar pikërisht para asaj kafeneje të qetë, ku ata të dy kishin lënë takimin.

Holandezja e kishte vërejtur qysh nga çasti që kishte kaluar trotuarin dhe me nxitim i ishte afruar pjesës ku fillonte shtrirja e jashtme e kafenesë me ato tavolinat e shpërndara në të dy anët. Që ta bënte me dije se po e priste, ishte ngritur paksa dhe i kishte dhënë shenjë me dorë, gjë që ai, sikur befas të kishte lënë pas një pjesë të ankthit të madh, kishte ndjekur atë lëvizje sikur ta njihnte tashmë. Ajo ishte ngritur në këmbë dhe kur ia kishte liruarr karrigen përballë, gjithë përzemërsi i kishte thënë se quhej Helga Krojfi. Më tutje, ia kishte bërë me dije se ishte bijë e një juristi që ishte marrë me të drejtën ndërkombëtare dhe vinte nga një vend i vogël afër Roterdamit, ku edhe kishte mbaruar gjimnazin dhe pastaj në universitetin e atyshëm kishte studiuar arkeologjinë, ndërsa pas universitetit, për dy vjet me radhë kishte ndjekur studimet pasdiplomike në lëmin e trashëgimisë së Egjiptit të vjetër në Universitetin e Kajros, me ç’rast pjesën më të madhe e kishte kaluar në hapësirën e piramidave të luginës së Nilit.

- Madhështia e qytetërimeve të perënduara dhe të rrënuara më ka mrekulluar gjithherë... Aty ka diçka që duket se është gjithnjë e re dhe vazhdimësi, të cilën duhet ndjekur pareshtur për t’ia rikrijuar përfytyrimin por edhe ndërlidhjen me kohën shpirtërore...

Përmendjen e të atit si jurist i të drejtës ndërkombëtare e kishte marrë si shenjë të një afrie, e cila shumë shpejt do t’u kthehet në miqësi dhe lidhje të përhershme, ndërkohë që Egjipti dhe Kajroja ia kishte përkujtuar disa nga mumiet e vogla që familja i kishte trashëgim nga ai që i thoshin Gjyshi i Madh, i cili gjatë qëndrimit të tij të dytë atje në prag të shpalljes së pavarësisë kombëtare, i kishte marrë si dhuratë nga Mehmet Ali Pasha, me përkushtimin që edhe bota shqiptare, sapo të mëvetësohej, t’u kthehej rrënjëve të lashtësisë, nga edhe vinte.

Trashëgiminë e Gjyshit të Madh, të xhaxhait - njërit prej liderëve kryesorë të pavarësisë kombëtare, ministër i dy qeverive të përkohshme shqiptare (të Ismail Qemalit dhe të Turhan Pashës), kryeministër i qeverisë shqiptare që vetëm tri ditë kishte qëndruar në krye të saj dhe pastaj edhe udhëheqës i Komitetit të Mbrojtjes së Kosovës dhe deri ditën që do të vritet në Selanik, pasi të jetë dënuar dy herë me vdekje nga mbreti Zog dhe Beogradi, do të kundërshtojë Paqen e Versajës dhe marrëveshjet tjera me të cilat Kosova dhunshëm ndahej nga trualli etnik shqiptar - i ati e ruante me përkujdesje të madhe, jo vetëm pse ato kishin vlerë të veçantë dhe vinin nga një botë e lashtë që ishte themel i qytetërimit të përgjithshëm, por edhe pse ato vazhdimisht i lidhte me atë që ai e quante “pjesë e ngritjes kah majat e perandorive”, kur rastin e Mehmet Ali Pashës, por edhe të guvernatorëve e pashallarëve të tjerë të fuqishëm shqiptarë, që shumë prej tyre si sadriazemë për vite të tëra të udhëhiqnin Perandorinë Osmane drejt fitoreve të njëpasnjëshme, po edhe ta kthenin në një vend të kulturës dhe të qytetërimit të lartë në përputhje me zhvillimet e kohës, siç kishte ndodhur

paraprakisht edhe në kohën e Romës dhe të Bizantit, kur shumë prej tyre, si perandorë u kishin paraprirë kthesave të mëdha historike (Konstantini i Parë - me përqaftimin e krishterimit si religjion zyrtar i perandorisë, Justiniani - me kthimin e Romës në një model të qëndrueshëm të shtetit juridik, me ligje që do t'u bëjnë ballë të gjitha kohëve, deri edhe në ditët tona).

I kujtohej që, para se të fillonte lufta, mumiet bashkë me disa eksponate antike të gjetura në rrethinën e Prishtinës (portreti i perëndeshës dardane, idhulli i Ulpianës e të tjera, që thoshte se vinin nga koha e Dardanisë dhe mëvetësia e saj administrative dhe kulturore gjatë Romës, së cilës ai i kushtonte shumë rëndësi dhe, si do të shihet, jo rastësisht edhe ai projekti jetësor rreth kujtesës historike antike, të cilit nuk do t'i ndahet dhe do ta kthejë në një metaforë ekzistenciale, do të ndërlidhet me të) - i ati i kishte hequr nga vitrina e madhe ku i mbante dhe, pasi i kishte paluar me kujdes, kishte thënë se do t'i dërgonte në një vend të sigurt, ku do të ruhen. Kishte theksuar se ato dhurata tejet të çmueshme, bashkë me dokumentet e Gjyshit të Madh - që më vonë kishte marrë vesh se kishin qenë shumë e shumë sosh që flisnin për pjesëmarrjen në Revolucionin xhonturk, por edhe për ato që do t'u paraprinin lëvizjeve të pavarësisë kombëtare, siç ishte Marrëveshja e Taksinit për ngritjen e kryengritjes së madhe të viteve një mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë-dymbëdhjetë dhe të tjerat që lidhen me veprimtarinë e tij në qeverinë e parë të përkohshme të Vlorës dhe me pjesëmarrjen si ministër në qeverinë e Turhan Pashës gjatë kohës së qëndrimit të Princ Vidit në Shqipëri (tek i cili ai kishte varur shpresat si shumë dhe, nga ato që herë pas here i kishte hedhur në internet, qoftë si të shkëputura, takimit të parë me të në kështjellën e Noj Vidit në Gjermani, kur ia kishin dorëzuar kurorën e Skënderbeut do t'i kushtojë një vend të rëndësishëm sa të thotë se Princi gjerman, edhe pse nuk ia kishte dalë të ripërtërinte kurorën e mbretërisë shqiptare, ishte një hallkë e rëndësishme midis lashtësisë pellazge-gjermane si themel i qytetërimit perëndimor, që duhet të dalë në dritë dhe të ngjashme), pastaj të dhënat për veprimtarinë në Komitetin për Mbrojtjen e Kosovës dhe shumë detyrime të tjera që kishin të bënin me kohën me shumë e shumë kthesa dhe përpëlitje nëpër të cilën kishte kaluar bota shqiptare e shkapërderdhur dhe të tjera si këto - nuk ishin vetëm pasuri familjare, por më shumë se kaq, ngaqë ishin pjesë e asaj historie, që vazhdimisht ndiqej (luftohej) nga jashtë, por fatkeqësisht edhe nga brenda, me ç'rast nuk mungonin edhe përpjekjet që asaj t'i merreshin ato që i duheshin dikujt dhe t'i anashkaloheshin ato që pengonin, që ishin me rëndësi të madhe pikërisht pse aty ruheshin dëshmitë e atij identiteti që ai e quante perandorak dhe shtetformës, me rrënjë të thella që nga antika e deri në ditët tona, ku e djeshmja shihej si ardhmëri, që një ditë duhet të dalë në pah, po dhe shumë çështje të tjera që më vonë do ta përshkojnë trajtesën *"Dardania themel i kujtesës historike dhe rrënjët e saj antike"*, pjesë të së cilës vazhdimisht do t'i hedhë në internet dhe do t'i ndihmojnë rrumbullakimit të projektit poetik të *"Dardanisë si kujtesë poetike"*, me të cilin, përveç të tjerash, mendonte se me atë kujtesë shekullore dhe me fuqinë e saj të jashtëzakonshme do të zhdëmtohej Bllaca dhe nënçmimi i saj i tmerrshëm, nëpër të cilin ishte kaluar dhe që njëherë e përgjithmonë do të shprisheshin edhe hutitë, moskuptimet dhe bredhjet e tjera që ishin mbarsur me veprime të papërgjegjshme të përvetësimit të saj nga ata të cilët kishin bërë përpjekje për t'ia veshur meritat e vetëshpallura sikur çdo gjë të niste dhe të soste me ta...

Më vonë, gjatë atyre shtatëdhjetë e tetë ditëve të eksodit, të cilin në një vjershë e kishte quajtur *"refugjatë në vendin tim"* dhe atë e kishte kthyer në një refren që ndërhynte kudo, madje edhe në ato që ishin edhe gjëra të rëndomta dhe i tillë i kishte mbetur edhe pasi ishte kthyer - përfitim i parafytyrimit të mumieve të fshehura diku, bashkë me dokumentet e tjera nga Gjyshi i Madh, ku ishte edhe ai idhulli i Ulpianës me atë qëndrimin shprehës si prej qenieve që lidhin hyjnoren me njerëzoren si përbashkësi të përhershme - ia kishte krijuar përshtypjen se në atë kërkim-hulumtim të Itakës shpirtit mbetej pjesë e asaj bredhjeje të pandalshme, që mund të ishte e ngjashme me atë përkushtimin e të atit rreth kujtesës historike perandorake që lidhej me trashëgiminë dardane, por edhe me ato përpjekjet e gjata

shtetformuese gjatë shekujve me ato rëniet e shumta dhe ngritjet e vazhdueshme, të cilave duhej dhënë përgjigja poetike.

Sikur t'ia kuptonte mëdyshjet, që mund t'i ishin lidhur nga ajo paraqitje dhe futja e trashëgimisë së lashtësisë në të, holandezja kishte nxituar të bënte një kapërcim, duke e bartur atë te misioni i saj në Kosovë, i cili sapo kishte filluar dhe përcaktimi për të si një borxh që ndiente ndaj popujve të rrezikuar, të cilëve duhej t'u ndihmohej ta merrnin veten, duke thënë se i kishte paraprirë një trajnim tremujor në Qendrën Europiane në Den Hag, në kuadër të pjesës së donacionit për shoqërinë civile, linte për të kuptuar se ajo ishte e informuar mirë për të gjitha, përfshirë këtu edhe ato çështje që ajo i kishte përkushtim më të gjerë, e që lidheshin me kërkimin e gjurmëve materiale të antikës dhe gjurmëve të tjera shpirtërore nga lashtësia e përbashkët në atë hapësirë dhe shkonin tutje misionit, të cilit i ishte bashkuar që, si do të shihet, do t'i shërbejë vetëm si mbulesë për këto qëllime.

- Këtu është rrënuar gati gjithçka, prandaj kërkohet ndihmë për t'u rindërtuar - i kishte thënë ajo me atë përzemërsinë e fillimit, që pastaj, fjalën rindërtim ta plotësonte me një ndërtim, që tha se është i vjetër, themel qytetërimi dhe të ngjashme...

Vëllaznimi edhe më tutje e kishte shikuar sikur te fjalët e saj të kërkonte mbetjet e Itakës së humbur dhe të mjegullimit të saj, që i ishte bërë edhe më i madh dhe i kishte kaluar në përndjekje mendore çastin që me dhunë e kishin ndarë në atë udhëkryqin që rrugën e Shkupit e degëzonte për në Tetovë dhe të tjera si këto, ku për të zëntë fill ajo përpjekja e vazhdueshme e të kuptuarit e fatkeqësisë shqiptare dhe rrënjëve të saj, po që, pas pak, sikur të lirohej nga tisi i hutisë, ia kishte treguar ato që i takonin një njoftimi të tillë në ato rrethana, që ishte munduar t'i përmbledhonte me fjalinë "krijues i pafat, në kërkim të shpirtit të humbur..." Këto fjalë holandezes i kishin tingëlluar si pjesë e atij dëshpërimi të madh, të cilin e haste gjithnjë më shpesh gjatë gjithë kohës sa merrej me ato që i thuheshin për të zhdukurit dhe të tjerët, që ishin pjesë e asaj lufte dhe fatkeqësisë së saj të madhe, të cilat i dëgjonte me vëmendje, i shënonte në ata formularët e shumtë dhe pastaj, kur i bashkërendiste në dosje, ia përcillte departamentit të administratës, i cili merrej me hapjen e hetimeve dhe me çështje të tjera që lidheshin me personat e zhdukur.

-Të gjithë jemi paksa të pafat, veçmas kur bëhemi pjesë e fatkeqësive të përhershme, që përsëriten në vazhdimësi dhe në këtë përsëritje, me pasojat që sjellin, sikur bëjnë të ditur se janë të pashmangshme...

Me theksimin e përsëritjes së pashmangshme, sikur atë fatkeqësi dhe përmasat e saj të mëdha, që madje ishin shtrirë edhe deri te përpjekjet për kryerjen e gjenocideve të hapura, dëshironte t'i nxirrte nga rastësia dhe t'i vendoste përbrenda asaj që ishte pjesë e një loje tragjike që luhej në një skenë me aktorë të njëjtë, të cilët rolet shpesh i përsërisin pa qenë të vetëdijshëm se i shërbejnë të njëjtut teatër e të ngjashme, ky përkufizim ia kishte përkujtuar ato që i ati i kishte preokupim të përhershëm dhe i shihte si pjesë të asaj drame në vazhdimësi, të ngjashme me atë që luhej nga antika e tutje.

- Ndoshta është më mirë të flasim për aromën e blinit të tharë, - kishte thënë Vëllaznimi duke hedhur shikimin mbi kurorën e drunjve që u rrinin sipër kokës me degët e thyera nga predhat e armëve që u ishin përplasur gjatë ndërhyrjes ajrore.

- Pranvera e ardhshme do të sjellë degë të reja - ia kishte kthyer holandezja, duke dashur që bisedës t'ia parandalonte kështu kahun e padëshiruar, që mund ta merrte.

- Por, para se të vijë ajo kemi edhe një vjeshtë, kemi edhe një dimër, që kush e di sa i gjatë mund të jetë...?

- Me siguri se nuk do të jetë i përhershëm, e as polar - vazhdon të zbusë bisedën holandezja.

Nga druajtja se mund t'i jepej ndonjë melankolie, të ngjashme me ato që kohëve të fundit jo rrallë e përfshinin dhe ia shpërqendronin vëmendjen, me shpalosjen e kujtimeve: se ishte student i bodrumeve, se kishte bredhur nga njëra pjesë e errët e qytetit në tjetrën dhe ashtu kishte ndërruar edhe fakultetet, sikur të ishin lodra, por që e përhershme i kishte mbetur,

siç e kishte quajtur “çmendja e poezisë” dhe frymëzimi i saj që për fat bën që edhe gënjeshtër të shihet si e vërtetë, ndërsa e vërteta gënjeshtër dhe ashtu sikur ia kishte dalë të ushqejej, të mashtrohej dhe të vetëmashtrohej, bile shpesh edhe të trimërohej vrullshëm sa të mendonte se vetëm për vetëm mund ta bënte një luftë të madhe dhe madje ta fitonte siç i kishte ndodhur Davidit kundër Goliatit, me të cilën do t’i jepej dhe do t’u jepej fund dhunës dhe dhunave, pa marrë parasysh se çfarë ishin ato dhe andralla e fluturime të ngjashme, por që një ditë, pikërisht kur i kishin nxjerrë nga shtëpia dhe me dhunë i kishin deportuar në drejtim të Maqedonisë dhe të Shqipërisë, që të mos ktheheshin më dhe me këtë përfundimisht t’u rrëmbehej atdheu dhe bashkë me të edhe kujtesa dhe qenia dhe çdo gjë tjetër e saj - kishte kuptuar të vërtetën se në lëmshin e ngatërresave të mëdha ishte vetëm një numër i thjeshtë dhe i pavlerë fare, një hiç ndër ata të shumtë që, si duket, do t’i duhet kohë e kohë atë ndjenjë paksa ta zbusë, por pa e mundur dot dhe të tjera si këto - pra me këto fjalë jo gjithaq të natyrshme kishte bërë prezantimin që i duhej asaj bisede.

Holandezja e vëmendshme edhe më tutje kishte bërë përpjekje që takimit t’ia ruante përmasat e bisedës së rëndomtë, edhe pse që më parë e kishte pasur të qartë se këtë do ta kishte të vështirë, sepse, me ato që ia kishte thënë për poezinë dhe “çmendjen e saj”, për vrullin dhe ndjenjat që i shkojnë asaj, sikur ia kishte krijuar mundësinë për t’iu rrekur paksa më tërthorazi çështjeve që i interesonin, por njëherësh ia kishte hapur udhën asaj afrie të shpejtë që, si do të shihet më vonë, edhe do t’i shërbejë lidhjes dhe gjithë atyre që do t’i bashkojë, sa të ndjehen pjesë e një të menduari dhe të kërkuari dhe e të njëjtave vuajtje, të cilat pareshtur ua përplaste e djeshmja, që sikur ishte kthyer në një të sotme dhe të nesërme të përhershme jashtë ardhmërisë...

- Këtu nuk do të sillesh nëpër madhështinë e botës së Keopsit, por në atë të errësirës së përhershme të Hadit - i kishte thënë Vëllaznimi kur ajo ia kishte përkujtuar se kishte pasur një ditë tejet të mundimshme, me shumë kërkesa për ndriçimin e rasteve të të zhdukurve, me ç’rast kishte zënë ngoje numrin njëqind e njëzet e shtatë.

- Mund të ndodhë që shumë nga të zhdukurit të jenë pjesë e atyre ngatërresave të zhvendosjeve nëpër vende të ndryshme, të bëra me rrëmujë të madhe dhe, sapo të fitojnë mundësinë, paraqiten...?

Me këtë ndërhyrje holandezja kishte pasur parasysh kahun që biseda e tyre e parë të mos sharronte në ndonjë të papritur tjetër të përbashkët dhe këtë e kishte bërë me theksimin e një njoftimi të po asaj dite, se nga Turqia kishte ardhur një lajm se pesëdhjetë veta, kryesisht të rinj, që ishin paraqitur të zhdukur dhe dyshohej se mund të ishin masakruar diku në pjesën e Dukagjinit, si shumë e shumë të tjerë që ato ditë kishin rënë pre e njësive paramilitare dhe e etjes së tyre për gjak të freskët, pasi që kishin gjetur mundësinë të kalonin në Maqedoni nëpërmes Bllacës, ndodheshin në një qendër të pranimit dhe se pjesa më e madhe e tyre do të kthehej brenda muajit.

- Duket se ngatërresat më të mëdha i ka sjellë Bllaca dhe shfaqja e saj e papritur me atë shpronësimin e tmerrshëm nga identiteti, që kishte ndodhur pasi që paraprakisht, atyre që i kishin detyruar të futeshin aty, u ishin marrë që të gjitha dokumentet e identifikimit dhe gjësende të tjera personale...

Ajo sa nuk i kishte thënë se shpërndarja e refugjatëve nga Shkupi nëpër pjesë të ndryshme të botës, të shumtën nuk ishte bërë sipas emrave, por vetëm me anën e numrave, e kjo ishte bërë për arsyen e thjeshtë se shumë nga ata që ishin futur aty dhunshëm dhe në saje të atyre që kishin përjetuar, kishin shkalluar aq shumë saqë, me rastin e nxjerrjes shpejt e shpejt që ishte bërë atë mesnatën me shi të imët dhe me lagështi të madhe, që kishte ndarë ditën e gjashtë me atë të shtatë të prillit - nuk kishin qenë në gjendje të thoshin as emrat, madje as të nxirrnin ndonjë fjalë goje, kështu që organizatorëve u ishte dashur të përdornin disa shirita me numra, të cilët ua kishin lidhur për krahun e djathtë, që përkonte me atë informatën, të cilën BBC kishte përhapur në botë, se pas pesëdhjetë vjetësh, në kontinentin e vjetër sërish ishin paraqitur numrat e Aushvicit dhe të Mathauzenit.

Përmendja e Bllacës dhe theksimi i shfaqjes së saj si e papritur, sikur ia kishte rrotulluar mendjen. Krahës përfytyrimit që kishte në kokë nga ato që i kishin paraprirë asaj (thyerja e derës nga paramilitarët dhe urdhri që për një çerek ore të largoheshin, britmat dhe fyerjet gjatë rrugës, grumbullimi në stacionin e Prishtinës si kope si dhe largimi për në drejtim të Shkupit me ata autobusët e mëdhenj me targa të qyteteve të Serbisë derisa në atë udhëkryq i kishin ndarë dhe punë të tjera të parapara) - në mendje përnjëherë i kishin ndërhyrë edhe pjesëza të shkëputura të atyre që kishte dëgjuar gjatë qëndrimit në Tetovë, Strugë dhe Ohër, por edhe në Tiranë, nga disa të dëbuar që kishin kaluar nëpër të dhe qysh atëherë dukeshin si raste tipike të asaj fatkeqësie të madhe, që bënte të ditur se ai zhvlerësim i jashtëzakonshëm njerëzor, në të cilin ishin përfshirë me mijëra e mijëra veta, nuk mund të ishte tjetër pos pjesë e asaj që ishte paramenduar si thyerje e tmerrshme e shpirtit, që nuk do të jetë në gjendje të shërohet kurrën e kurrës dhe bindje të tjera të ngjashme, që më vonë duket se paksa do t'i zbuten, kur do t'i rreket atij projekti krijues, me të cilin Dardania shihej si pjesë e kujtesës poetike, që duhej t'i kundërvihej Bllacës si damkë e përhershme shpirtërore dhe fatkeqësive të tjera të ngjashme, që edhe më tutje nuk përjashtoheshin po qe se në mendje mbetej përvijimi i asaj skene dhe lojës së përhershme në të me aktorët e njëjtë, që mund t'i ndërronin vetëm rolet...

Që kjo nuk ishte çështje e lehtë, këtë e kishte kuptuar më së miri qysh nga takimi i rastësishëm në Tiranë me njërin nga shokët e fëmijërisë, kur ai, i shoqëruar nga dy veta që e mbanin për krahësh, në vend se ta përshëndeste, siç veprohej rëndom ato ditë me rastin e çdo takimi, ku shfaqej pikëllimi dhe njëfarë afrie e çuditshme, njëherësh - pa një pa dy kishte thënë se vinte nga ferri, ku kishte takuar djallin, që e kishte quajtur Mefisto, me të cilin, pas një bisede të lirshme, kishte lidhur një marrëveshje, së cilës do t'i përmbahej, pa marrë parasysh çmimin që do t'ia paguante...

- Marrëveshja është marrëveshje, apo jo...? Nganjëherë edhe djalli ndihmon, apo jo...? Është i pashmangshëm...I pashmangshëm... Djalli vendos për të gjitha...Për të gjitha, apo jo?...

Tjetër nuk kishte thënë, pos që shikimi i shthurur i kishte mbetur i varur në një pikë që mund të soste nga kodrinat e Dajtit, me ç'rast mund të merrej me mend se përfytyronte atë takimin e ardhshëm me Mefiston dhe, kush e di se çka tjetër...

Fjalët për marrëveshjen me Mefiston dhe ato që Gëte i kishte gdhendur me aq mjeshtëri tek "Fausti", të nxjerra aty dhe ashtu, befasi i kishin ardhur sikur të bënin të ditur për një marrëveshje të panjohur me të keqen, me kobin, që ishte arritur diku rreth një shpronësimi të përgjithshëm mendor dhe shpirtëror përmasash të jashtëzakonshme dhe që duhej të përmbushej gjithsesi, por që i duhej teatri dhe ajo skena e përhershme...

Madje, edhe ato që në ndarje e sipër i kishte dëgjuar prej njërit nga shoqëruesit, se e keqja më e madhe e gjithë asaj fatkeqësie ishte se të tillëve nuk mund t'u ndihmohet ta marrin veten, i kishin ardhur si pjesë e asaj marrëveshjeje që i duhej Bllaca dhe shfaqja e saj, që do t'i shërbejnë poezisë "*Takimi i ri me Mefiston*", si pjesë e atij projekti që më vonë Dardaninë do ta shohë si kujtesë poetike, që do ta nisë në Tiranë, do ta vazhdojë pastaj gjatë atyre bredhjeve nëpër Strugë, Ohër, Gostivar, Tetovë dhe Shkup, gjithandej ku ishin vendosur ato qendrat e përkohshme të strehimit të refugjatëve, për ta bartur edhe në Prishtinë dhe më tutje kur me holandezen, pas tre muajsh, do të largohen në atë që do ta quajnë "rrugë e përhershme në kërkim të botës së rrënuar, e cila kthen përfytyrimet e madhështisë së harruar, me të cilën njerëzimi mund të shpëtohet, por kjo ndodh kur preket fundi..."

Edhe rrëfimet e tjera të atyre që kishin kaluar nëpër Bllacë dhe herë pas here kishte pasur rastin t'i dëgjonte, përafërsisht kishin qenë pjesë e një shthurjeje të përgjithshme mendjeje, e një shkallimi të pandreqshëm shpirtëror, që kishte përfshirë të gjithë pa dallim, ku dikush i kishte folur si përçarë se i ngjante sikur fluturonte në qiell, por pa krahë - bile, bile këtë e bënte kur qielli ishte gjithë errësirë dhe ngjante në rrathë ferri të përhershëm; këtu dikush i kishte thënë se kishte humbur ngjyrat dhe çdo gjë e shihte sikur të kishte para një

perde të tejdukshme – dhe kjo ia pasqyronte një botë që ishte plot e përplot neveri; ku dikush i kishte thënë se gjithnjë e më shpesh gjuha e njerëzve i kthehej në atë të kafshëve - dhe kjo kushtëzonte kohë pas kohe një ulërimë; ku dikush kishte murmuritur gjithfarë gjërash të pakuptueshme, por kishte pasur edhe të atillë që i kishin folur vetëm në serbishte, pa qenë në gjendje që me ndonjë fjalë t’i përkujtojnë ato të gjuhës amtare, që ajo huti i ishte bërë edhe më e madhe kur kishte marrë vesh se kishte pasur edhe të tillë që, sapo kishin dalë prej andej, befasisht kishin murmuritur çmos në gjuhë të ndryshme, që nga anglishtja e deri te kinezishtja, madje, edhe pse ato nuk i kishin njohur më parë dhe thuhej se nuk kishin pasur ndonjë takim me vendet dhe popujt e tyre dhe shumë gjëra të tjera të asaj hallakatjeje, që më vonë në poezinë “*Gjuha e ngatërruar e Bllacës*” ishte munduar t’i shihte si pasojë të përpjekjeve të brendshme të kujtesës, për t’i bërë ballë fshirjes dhe shpëlarjes së mendjes edhe ashtu dhe në atë mënyrë me anën e asaj që, në njërin nga shkrimet e hershme të parapsikologjisë dhe të fenomeneve, shpjegohej si “pjesë e trurit dhe shpirtit të përbashkët kozmik” – masës së përbërë nga materia dhe fryma, që ndodhet diku në hapësirë dhe me ndërhyrjen e papritshme dëshmohet në raste të jashtëzakonshme, ku gjithsesi shqetësimi i Bllacës dhe gjithë ato që kishin ndodhur aty, hynin në të tilla...

Fillimisht, përjashtim nga ai shkallim që kishte ndeshur kur takonte të tillët, kishte paraqitur vetëm njëri, që e kishte takuar në Strugë, me të cilin kishte biseduar për dy orë në verandën e një restoranti të drunjte me shikim të qetë kah liqeni. Ai kishte trishtim, por jo edhe rrënim mendor dhe shpirtëror, siç e kishin shumë të tjerë. Por, biseda me të ia kishte përkujtuar shumë nga ato që kishte pasur me të atin në prag të luftës, me të cilat nuk ishte pajtuar dhe u kishin shërbyer edhe atyre që atëherë i kishte marrë për qëndrime të kundërta, që në një poezi të asokohshme, pra nga ato që në çaste ishin plot e përplot vrull dhe ai gjatë atyre recitimeve dehëse në kafe “Syri”, kur mendja i fluturonte kahmos, ndjehej edhe David që mund Goliatin, madje edhe katallan e ngjashëm - e kishte parafrazuar si pikëpamje midis *evolucionit* dhe *revolucionit*. Aty, metafora e *evolucionit* lidhej me të atin dhe të menduarit e tij shtetformues, që ai e kishte parashtruar në trajtesën “*Dardania, themel i kujtesës historike dhe rrënjët e saj antike*” - që më vonë, kur kishte humbur shpresën se do ta gjente fare dhe ishte pajtuar ta trajtonte si viktimitë të asaj lufte dhe me holandezen do të shkojë në Meksikë në kërkim të gjurmëve të qytetërimit të shkatërruar të Majave dhe Inkëve - do t’ia dërgojë nëpërmjet internetit bashkë me shumë e shumë ndërhyrje të tjera rreth kësaj çështjeje. Ndërsa *revolucionit* lidhej me pikëpamjet rreth luftës, si një mjet i domosdoshëm për arritjen e lirisë, formula e së cilës vlen që nga antika e tutje dhe të tjerat si këto, që në ato përfytyrime, me të cilat mendohej t’i bënte ballë dhunës që ushtrohej mbi të gjithë, kishte parë se janë vetëm pjesë e rebelimeve poetike dhe e asaj që e quante çmendje e arsyeshme dhe e dobishme madje, të cilën e kishte edhe nga ajo që merrej si kohë e bodrumeve dhe nënçmimi i saj, të cilën dikur, gjatë bredhjeve nëpër botë dhe ballafaqimit me sprovat të ngjashme të mbijetesës, nëpër të cilat kishin kaluar popuj të qytetërimeve të larta, por të zhdukura, pikërisht pse u kishte munguar të menduarit se mund të ballafaqohen me rrënuesit, me ata që ngritjen dhe ngjitjen në lartësi e shohin si ndëshkim, të cilit duhet për t’iu kundërvënë, dhe se ndaj tyre duhet marrë masa mbrojtëse, siç ishin Majat dhe Inkët - pra gjithë atë sprovë tejet të vështirë e kishte parë me të tjerë sy, sa ta quajë edhe “kohë e pjekurisë së veçantë”, “vetëdëshmi e jashtëzakonshme qytetëruese” dhe ndryshe-ndryshe...

- Bllacën edhe e kam pritur - i kishte thënë ai me një butësi të çuditshme sikur t’i fliste për diçka fare të rëndomtë.

Këtë parapërcaktim ai e kishte arsyetuar si diçka që i ishte dashur asaj faze të fundit të asaj lufte, si një sjellje dëshpëruese e atyre që kur e kishin pasur të qartë se nuk do t’ia dilnin t’i arrinin qëllimet që lidheshin me gjenocidin dhe spastrimin etnik me dhunë, kur kishin parë se më në fund shpërfytyroheshin keqas ato që deri më dje mund të ishin trimëruar, por që historia po merrte një kah tjetër që nuk do të mund të ndalej, atëherë dikujt i kishte rënë ndër mend për një nënçmim shpirtëror dhe zhvlerësim të tmerrshëm, që do t’u mbetej si damkë e

përhershme, me të cilën shumë prej tyre do t'u merrej e djeshmja dhe e nesërmja, pra do të dënoheshin përgjithmonë me ndjenjën e pandreqshme të shpërfilljes së tmerrshme si qenie njerëzore.

- Tekefundit, lufta kundër shpirtit, a nuk është lufta më e veçantë, që nuk është e thënë përherë të përfundojë në fushëbetejë, por të bartet në thellësi të qenies, që ta shpërqendrojë sa më shumë që të jetë e mundur, që pastaj të sharrohet në çrregullime të përhershme dhe në lajthitje të tjera...?

Më tutje, ai që kishte thënë se Bllacën e kishte pritur, se madje e kishte përfytyruar qëmoti të tillë dhe kishte pasur përshtypjen se do të futej nëpër të çastin që asaj lufte do t'i dihej fati, pra dështimi i vrasësve me anën e ndërhyrjes së ndërkombëtarëve (perëndimorëve), e cila fillimisht dukej se nuk kishte qëllime të qarta politike dhe qartësi të duhur ushtarake, (por kishte thënë se përkundër kësaj ajo një ditë ato do t'i nxjerrë dhe do t'i shtrojë në përputhje me atë që shihej si thyerje e kufirit të qytetërimeve dhe të ngjashme), që kishte shtuar se qysh kur e kishin nxjerrë nga shtëpia me dhunë dhe ia kishin dhënë ato pesëmbëdhjetë minutat që t'i merrte plaçkat dhe të çante për në Shqipëri, siç i ishte thënë me nënçmim nga ai që udhëhiqte dëbimin që do të kthehej në deportim përmasash biblike, e kishte ditur se do të kalonte nëpër një kamp të tillë të tmerrshëm zhvlerësimi, andaj atij që i kishte thënë se duhej të çante për në Shqipëri, i kishte thënë se nuk po shkonte në Shqipëri, por në Bllacë...

- Duket se përmendja e Bllacës e kishte zënë në befasi edhe atë që me siguri se mendonte që veprimet rreth deportimit, me të cilat ishte ngarkuar, çonin vetëm në Shqipëri dhe atje duhej të përfundonin përgjithmonë...

"As që më ha palla si do ta quash atë vend... Kryesore është se këndeje nuk shkel më këmba juaj..."

Pasi ia kishte thënë këto, ai që thoshte se Bllacën e kishte pritur, se ajo paraqiste atë fillimin e atij fundi të pashmangshëm, atë humbjen e domosdoshme, që një ditë do ta përjetonin ata për t'u ndarë nga ai mashtrimi historik në emër të gjoja misionarizmit, me të cilin ishin ushqyer e ua lejonte edhe të vrisnin - dhe kjo ia kishte përkujtuar fjalët që i ati ia kishte thënë kur, të ngrirë nga frika, po pritnin në atë udhëkryqin që kishte ndarë rrugën e Shkupit me atë të Tetovës dhe bashkë me to edhe fatet e tyre - kishte heshtur për pak dhe pastaj, me një ngjyrim tjetër të zërit, kishte thënë se ata që kanë kaluar nëpër Bllacë mund të kenë telashe me kthimin e shpirtit, e që, ndonëse nuk e kishte përdorur fjalën humbje, ajo nënkuptohej.

- Humbjet janë të vetmet mësimë që ndërgjegjësojnë...

Kur ishte larguar, pas kishte lënë jehonën e hamendjes së të priturve të papritura dhe të papriturave që duhej të ishin të pritura, fjalë këto që lidheshin me qëndrimin e të atit, e që çuditërisht, të thëna përafërsisht ashtu, por madje ndonjëherë edhe në tërësi të ngjashme edhe me ato që më vonë do t'i drejtohen me anën e internetit nga trajtesa "*Dardania themel i kujtesës historike dhe rrënjët e saj antike*", i kishte dëgjuar t'ia thoshin edhe disa, edhe pse ishin të paktë, që kishin kaluar nëpër Bllacë, por që kishin ruajtur drejtpeshimin, sa dikur të krijojë bindjen se gjatë atij qëndrimi prej katër ditësh në atë që ishte quajtur kamp bashkëkohor i përqendrimit, krahas atij nënçmimi të tmerrshëm dhe zhvlerësimi të pashembullt njerëzor që kishte ndodhur në çastet e fundit të atij shekulli dhe të mijëvjeçarit të dytë, që ishte paraparë të ishte i tillë dhe ishte bërë çmos të shkonte sa më thellë dhe të përfshinte pa përjashtim që të gjithë ata që kishin kaluar nëpër të, por edhe ata që nga jashtë i kishte tmerruar sa të ndjeheshin pjesë e asaj së keqeje dhe ta përjetojnë edhe më rëndë madje, nga shkaku i brejtjes së ndërgjegjes pse me asgjë nuk kishin mundur ta pengonin - pra në rrethana të tilla mund të kishte ndodhur edhe mrekullia e shfaqjes së atij të menduari mbishtresor, te disa si mekanizëm mbrojtjeje ndaj asaj së keqeje të pashembullt që kishte synuar rrënimin e shpirtit dhe të kujtesës, njëherësh, ose mund të kishte qenë pikërisht i ati ai që mund t'i kishte nxjerrë ato, siç i kishte thënë edhe gjatë atij udhëtimi nga Prishtina deri tek

ai udhëkryqi Shkup-Tetovë, ku dhunshëm u ishin ndarë rrugët përgjithmonë, që pastaj, ata që nuk kishin dëshiruar t'i nënshtroheshin atij nënçmimi (si duket kishin qenë të paktë) i kishin pranuar dhe, pasi aty i kishin ndërtuar dhe rindërtuar sa t'i ndjenin edhe si të vetat, bashkë me to ishin larguar prej andej, që pastaj t'i shpërndanin dhe kështu ajo e papritura ishte marrë si e pritur dhe i kishte shërbyer atij shpjegimi, që, në rrethanat e kohëve kalimtare dhe të vendosjes së gjendjeve të përkohshme me shumë e shumë të panjohura, ishte dukur ndër më të pranueshmet, me të cilin edhe ishte ngjizur mendimi se Bllaca nuk ishte e rastësishme, e as çështje e ndonjë ngatërrese, siç i kishte thënë edhe holandezja gjatë takimit të tyre të parë në atë kafenenë përballë ndërtesës së ish - armatës jugosllave, ku ishte vendosur administrata ndërkombëtare, por ishte një veprim kaherë i paramenduar dhe i qëllimshëm, që ndoshta mund të thuhet se në ato rrethana u ishte dashur njësoj të gjithëve, të cilët atë luftë e kishin parë edhe si pjesë të një qëllimi...

Por, duket se me kohë hamendjeve rreth mendimeve të të atit, që thuheshin prej disave që kishin kaluar nëpër Bllacë dhe përsëriteshin sikur të ishin të tyre dhe ashtu përhapeshin - do t'u shtohen edhe ato që si një vazhdimësi lidheshin me pikëpamjet e trajtesës *"Dardania themel i kujtesës historike dhe rrënjët e saj antike"*, të cilat pareshtur përhapeshin dhe gjenin studiues të rinj dhe gjithë ata që merreshin me studimin e së kaluarës, kur u ndërhyenin padiktueshëm në internet, nga dika, që mund të ishte ndonjë kod i veçantë, i fshehur dhe i panjohur, i cili ishte përgjegjës për shpërndarjen e atyre të dhënave çastin që shihej se ato mungonin, ose nuk përfilleshin sa duhet nga ngatërresa të tjera, që do të thotë se mund të ishte fjala për një mekanizëm të jashtëzakonshëm, përgjegjës për kujtesën dhe shpërndarjen e saj, i cili vepronte në përputhje me rregullat e veta...

Natyrish se, përmendja e Bllacës, si e papritur, nga ana e holandezes, gjithsesi i kishte sjellë nëpër kokë përfitime, të cilat i kishin marrë paksa kohë që t'i afrohej bisedës së paraparë me bashkëbiseduesen e sjellshme, siç e kërkonte rasti, por që ta shpëtonte nga ato që mund t'i prodhonin ngarkesat e të menduarit për Bllacën dhe mbetjet e saj, nga të cilat nuk do të lirohet kurrën e kurrës, kishte bërë përpjekje që të përqendrohej te zbutja e çështjes së zhdukjes dhe atë e kishte ilustruar me piramidën e Keopsit dhe me gjetjet, që për mijëra vjet kishin qenë të panjohura, por që kjo nuk ua kishte humbur rëndësinë fare. Përkundrazi, mosprania vetëm sa kishte shtuar kureshtjen për vlerat dhe madhësitinë e tyre...

- Nuk e pranoj zhdukjen, meqë ashtu pranohet humbja, që për mua nuk është as nuk mund të jetë... Madje, edhe kur ajo është e dukshme, e kthej në të kundërtën - që zhdukja të merret si dukje, si diçka që mbetet e përhershme...

Kur i kishte thënë këto dhe ajo dukje-zhdukje i ishte sjellë si qark metaforik që ndërlidhte diçka të pandashme, por të përsëritshme, sikur i kishte ngjarë që nuk po fliste ai, por ai tjetri në të, ai kryengritësi i papajtueshëm, që ishte përgjegjës për ato hallakatjet e mendjes dhe të tjerat që i takonin poezisë dhe atij të menduari të papërmbajtur, që çon në rebelime dhe shpërthime, të ngjashme me ato që gjatë kohës së dhunës së vazhdueshme, në pamundësi që t'i pasqyronte ndryshe a t'i zbrazte atje ku duhej, i shfaqeshin kur bisedonte me të atin, që pastaj u kishin shërbyer mospajtimeve, kundërshtimeve dhe atyre që mendonte se madje paraqisnin ndarje përfundimtare midis tyre, të cilat në atë udhëkryqin që atë e kishte dërguar për në Bllacë, ndërsa atë për në Tetovë dhe tutje andej sa pas pak të ndjehej "refugjat në vend të vet", jo vetëm që i ishin fashitur, por i kishin ardhur si pjesë të së përbashkëtës, të asaj që nuk ishte tjetër veçse pajtueshmëri e çuditshme nga brenda, e ngjashme me atë që do ta njohë më vonë në atë të menduar rreth Dardanisë si kujtesë historike dhe rrënjëve të saj antike, që herë pas here do t'i hidhen në internet dhe do t'ia krijojnë përshtypjen se i ati nuk ishte i zhdukur, por ishte kthyer në një dukuri të pavënëre dhe të përhershme, pikërisht në atë kodin e veçantë të të menduarit, që kishte mbetur të shpërndante pjesëza që i takonin një përhershmerie, të ngjashme me atë përsëritjen e së njëjtës, të cilat pastaj i kishte pranuar si pjesë të atij frymëzimi, me të cilin kujtesa historike plotësohej me atë kujtesën poetike dhe kështu kishte shpëtuar nga ajo që fillimisht, gjatë atij deportimi në drejtim të Shkupit dhe të

Tetovës, pas asaj ndarjeje kur ishte përballur me humbjen e dhunshme të atdheut, i ishte shfaqur si rënie, si shkallim i pashmangshëm...

Pa zënë ngoje Keopsin dhe gjithë ato që i takonin arkeologjisë, holandezja ia tumiri ato që kishte thënë, duke i pohuar se zhdukjen assesi nuk duhej pranuar, sepse ashtu mbyllet kapitulli i të përhershmes si ide lëvizëse në veprim, që e nënshtrohet vetëm ndryshimit...

Ndërhyrja e holandezes së kujdesshme sikur e kishte liruar nga mbetjet e atyre pjesëzave që i ishin lidhur për ato që kujtesën e ngarkonin me dhunë për ta bartur te parafytyrimi i të përhershmes si ide lëvizëse në veprim, si diçka që ushqen atë qarkun e të qenit dhe qenësinë dhe mbase do ta ndiqte atë përvijim - të cilit kohëve të fundit i jepej gjithnjë më shpesh për ta anashkaluar kështu trysninë e gjendjes kalimtare me shumë paqartësi dhe me më shumë të panjohura, por edhe me shumë të papritura që hapte - po të mos ishte kapërcimi i saj nga e përhershmeja tek e përkohshmeja, që e kishte lidhur me atë që e kishte quajtur “ngarendje marramendëse që të zhdëmtohet e djeshmja...”

- Mund të jetë fjala për zbrazëti kohore pa përqendrim...? - i kishte thënë ai me një qëndrim mëdyshas, me të cilin bashkëbisedueses dëshirohej t’i bëhej me dije se ai kishte vlerësime të paqarta rreth atyre që ndodhnin dhe, madje, as që denjonte t’i qartësonte, nga druajtja se ato do ta bartnin drejt një pellgu, që edhe po nuk u fute në të, ta krijon bindjen e rrëmbimit të përgjithshëm, të cilit nuk mund t’i bëhet ballë...

Holandezja e kishte pasur të qartë se theksimi i zbrazëtisë kohore mund të ishte një përgjigje e përgjithësuar që lidhej me rrethanat e pritjes, çfarë ishin ato nëpër të cilat kalohej, por asaj sikur i interesonte qëndrimi ndaj asaj që kishte ndodhur, jo vetëm si çështje e dëmeve të mëdha, që shkonin, nga humbjet në njerëz deri tek ato materiale (këtu kujtimi i viktimave të shumta dhe i të zhdukurve paraqitnin një kapitull të veçantë dhe tejet tragjik të kësaj fatkeqësie), por si ngarkesë shpirtërore që i shtresohet kujtesës, jo në drejtim të ndrydhjes së saj, që të kthehet pastaj në hakmarje, po në të kundërtën, që prej saj të nxirren mësimet historike, të ngjashme me ato të tragjeditive antike, kur humbjet, pa marrë parasysh çfarë kanë qenë, i kanë shërbyer një të menduari për ngritje dhe fitore të përhershme, ku gara është pjesë e madhështisë...

- Përfytyrimi i ardhmërisë me ngritjen e përhershme, kurdoherë është çështje e çështjeve...

Në vend se t’i përgjigjej, Vëllaznimi në një përkthim të atypëratyshëm të lirë në anglishte, që nuk do t’ia priste mendja se do të ishte aq i rrjedhshëm, ia kishte recituar ca vargje nga poezia “*Në kërkim të Itakës...*”

Ishin pikërisht ato vargje që i ishin lidhur për kokë atë ditën e fundit të marsit me shi të ndërhyrjes së NATO-s nga ajri, çastin që, i ndarë dhunshëm nga i ati dhe i zhveshur nga të gjitha, madje edhe nga dokumentet e identifikimit personal, që i ishin marrë nga forcat paramilitare serbe dhe i ishin hedhur me nënçmim në një shportë mbeturinash plot e përplot sosh, kishte kaluar atë pikën kufitare në afërsi të Tetovës dhe për herë të parë kishte fituar përshtypjen e trishtueshme të refugjatit në vend të vet, përshtypje që më vonë ishte munduar ta shihte edhe në dritën e asaj që paraqet përpjekje për vetënjohje, thellim dhe të tjera, që shkëpusin nga iluzionet e mbrojtjes me çdo kusht nga përkatësia e përbashkësisë, me të cilat ishte jetuar një kohë të gjatë si me një mburojë të jashtme dhe që ishte parë se nuk ishte në gjendje të luante rolin e parafytyruar...

Holandezja e sjellshme e kishte dëgjuar me vëmendje dhe për pak kohë ia kishte shtrënguar dorën. Prekja e beftë dhe ngrohtësia që kishte filluar ta pushtonte sikur e kishin shtyrë që vargjeve të nxjerra sipas mbamendjes t’ua shtonte edhe disa të tjera që i kishin ardhur aty për aty, por që kishte pasur përshtypjen se si të tilla, ngjyrimin të një humbjeje që merrej si antike, si e gjithëhershme madje, do t’ia kthejnë përçimin e një afrie të brendshme, e cila nuk kishte vonuar dhe ishte bartur dyanësisht drejt asaj që pas pak do t’u kalojë në lidhje të përhershme jetësore...

III

Të nesërmen, Vëllaznim Prishtina, siç pritej, nuk ishte paraqitur në Byronë e të Zhdukurve për ta plotësuar formularin e fundit, me të cilin lënda e të atit, avokatit Bardhyl Prishtina, përfundimisht duhej t'i kalonte departamentit ndërkombëtar të hulumtimit të të zhdukurve, që ngarkohej me kërkimin, por edhe për hapjen e hetimeve të mëtutjeshme rreth shkaktarëve të zhdukjes, që në rastin e dhënë, me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për deportim të dhunshëm të popullatës në drejtim të Bllacës ngarkonte forcat policore dhe ato paramilitare të Beogradit, që ishte ndërmarrë nga dita e fundit e marsit deri në ditën e katërt të prillit, që nga fillimi i ndërhyrjes ajrore të NATO-s ndaj trupave jugosllave në Kosovë dhe jashtë saj...

Kur kishte vendosur të mos kryente këtë formalitet - që për pasojë mund të kishte mos hapjen e hetimeve dhe kështu ndriçimi i fatit të të atit të mbetej çështje që duhej t'i lihej rastit, ose kohës që ajo ta kthente në kujtim të përhershëm, nëse nuk dëshmohej e kundërta (nuk përjashtoheshin as ato që quheshin mrekulli, të cilat shfaqeshin të mundshme edhe në rrethanat më tragjike dhe për to flitej gjithnjë më shpesh) - kishte pasur parasysh jo vetëm ftohtësinë e regjistrave dhe gjithë ato që njeriun sakaq e kthejnë në numër të thjeshtë fare, ngjashëm me atë që kishte ndodhur në Bllacë, ku pastaj ajo humbja si shkëputje e dhunshme bashkë me ato që i takojnë gjithë asaj tragjedie të madhe dhe të pandalshme disi zhdëmtohet me fjalën zhdukje, ose të zhdukur, që pastaj mospranimi lidhet me shpresën, e cila mund të jetë e ngjashme me atë kapjen për fije kashte dhe të tjera si këto - por për më tepër kishte pasur parasysh se me atë veprim sikur përjashtonte atë shkëputjen e vazhdimësisë së frymës së të qenit dhe të qenësisë, ngaqë edhe në rrethana të tilla duhej të mbetej e përhershme, pikërisht pse ato u takojnë çështjeve të shpirtit dhe preokupimeve të cilat lidhen me të menduarit si mbindërtim, me ç'rast ajo *me qenë* matet me krijimin dhe shpirtëroren në përgjithësi dhe jo me të tjerat që i takojnë të përkohshmes dhe të përditshmes si shfrytëzim, që, si do të shihet, do të ndikojnë që në përputhje me këtë qëndrim t'i rreket përpjekjes që preokupimin e të atit "*Dardania, themel i kujtesës historike dhe rrënjët e saj antike*", (pjesë të të cilit më vonë, të zgjeruara dhe të shtrua edhe ndryshe nga ç'i njihte nga dorëshkrimet e shumta, që thoshte se i takojnë "*Librit të shtetësisë*", në të cilin punonte edhe në rrethanat më të papërshtatshme, do të futen në internet) - ta baraspeshojë me krijimin letrar "*Dardania, kujtesë poetike*", që ndonjëherë do ta quajë edhe "*Libri i kujtesës*" dhe do ta shohë si të hapur pse në të, qoftë edhe pavetëdijshtë, futeshin edhe vargje dhe mendime të të tjerëve të mbetura nëpër kohë...

Por, duhet thënë se këtij vendimi - që më vonë do ta vlerësojë si më të rëndësishmin dhe më të dinjitetshmin e jetës, me çka ia kishte dalë që edhe bredhjet dhe mundimet, të cilave do t'u nënshtrohet gjatë kohës së luftës, por edhe të tjerat gjatë shoqërimit me holandezen Helga Krojff që do t'i ketë nëpër botë në kërkim të qytetërimeve të vjetra, të cilat përkonin me qytetërimin pellazgo-ilir dhe antik në përgjithësi, t'ia bashkëngjisë atij libri të kujtesës poetike, që ashtu t'u japë një vlerë të rëndësishme jetësore - do t'i paraprijë ajo shëtitje e vonë e natës, kur ai, pasi kishte përcjellë holandezen deri te hyrja e hotel "Grandit", pa pranuar ftesën që, po të kishte kohë mund të pinin diçka tjetër në pjesën e brendshme të restorantit, aty ku rëndom rrinin të huajt, ishte larguar sikur të ndiqej nga diçka e fshehtë, së cilës duhej t'ia kuptonte shqetësimin dhe t'ia jepte shpjegimin para se t'i kthehej në ngatërresë, siç i ndodhte me ato frymëzimet poetike që u shkonin vjershave me plot duf dhe shqetësime të pandalshme që ia bënin kokën lëmsh. Por, që shqetësimi të mos i shqiste në krakëllimë, por t'i kthehej në një vendim, kishte marrë rrugën kryesore dhe pas pak, thajse vetvetiu dhe nga një urdhër i brendshëm kishte ndaluar para sheshit të Teatrit, aty ku dikur gjendej njëra ndër kafenet më të preferuara të qendrës, por që edhe pas luftës, dukej se prapë kishte kthyer dashamirët e "ekspres-os" dhe të "makiat-os".

Tavolinat e mbushura jashtë dhe prania e madhe e atyre që lëviznin andejpari në ato orë të vona të mbrëmjes, ia zhvendosën të menduarit te takimi i fundit që kishte pasur me

Lindën, para se ajo t'ia bënte me dije se bashkë me prindërit, në kërkim të shpëtimit, përkohësisht do të largoheshin nga Kosova.

Fjalën përkohësisht e kishte shqiptuar më vështirësi, sikur të mundohej t'ia hiqte dyshimin dhe druajtjen se ajo e përkohshmja mund të kthehej në një të përhershme, humbje, që mund të paraqiste edhe ndarje...

Kur ia kishte thënë këto, sytë i kishte pasur të përbotur, ndërsa dora, që ia mbante, i dridhej.

Me këtë rast, Linda nuk kishte pasur nevojë t'ia përkujtonte se për familjen e saj, po edhe për shumë sosh të tjera të qytetit, largimet e tilla për në Turqi a gjetiu rëndom kishin përfunduar pa kthim, siç kishte ndodhur në fillim të viteve njëzet, pas rikthimit të ushtrisë serbe dhe në vitet pesëdhjetë, kur, pas vendosjes së të ashtuquajturit pushtet popullor, parullat e përdorura dendur për barazinë e shtresave punëtore dhe atyre katundare drejt një ardhmërie të lumtur për të gjithë, si iluzion shoqëror dhe ideologjik (më vonë do të dëshmohej se nuk do të japë provimin historik) - shovinizmi serbomadhi me metoda të ndryshme i shfrytëzonte pareshtur për të ushtruar një dhunë të veçantë ndaj shtresës qytetare dhe asaj intelektuale gjoja se ishte kundërshtarë e saj, me çka krijoheshin rrethanat për shpërngulje sa më të mëdha, që pastaj, nga zyrtarët e lartë arsyetoheshin "me të drejtën e pakicave" që t'i bashkoheshin shtetit amë dhe arsye të tjera perfide...

Ai kishte heshtur. Nga dritarja e mjegulluar e kafenesë së vogël kishin shikuar bashkërisht pjesën e shkretë të hapësirës përballë shtëpisë së dikurshme të mallrave, ndër më të bukurat dhe ndër më të furnizuarat e vendit, prej kohësh e kthyer në qendër të përkohshme të administratës policore-ushtarake, që me atë ftohtësi trishtuese ngjallte frikë...

Ajo kishte dashur t'i thoshte diçka që ta thyenin heshtjen, e cila i ngarkonte që të dy, por nuk kishte qenë në gjendje ta bënte nga shkaku se atë çast andejpari kishin kaluar dy nga autoblindat e policisë serbe, të cilat, pasi kishin bërë një gjysmë rrethi (sigurisht për të dhënë të kuptohet se me forcë mbikëqyrnin çdo gjë, madje dhe atë pikëllimin që zbrazej aty, ku dikur jeta kishte një gjallëri të veçantë), ishin vendosur, njëra para Teatrit, ndërsa tjetra në pjesën përballë shtëpisë së mallrave.

Gjithnjë në ndjekje të sjelljes së autoblindave dhe trishtimit që kishte mbërthyer atë pjesë që ishte shkretuar fare, pas një mundimi të madh ia kishte dalë të nxirrte disa fjalë, të përcjella me psherëtimë, me të cilat shprehej keqardhje për pranverën e trishtueshme të Prishtinës, që këtë herë mund të ishte edhe më e trishtueshme se të tjerat...

Madje, atij i kishte ngjarë se ajo, me ato përpëlitje të brendshme po mundohej ta nxirrte melodinë e ndrydhur të këngës "Kur pranvera vinte në Prishtinë", që gjithëherë përcillej me një ndjenjë pikëllimi, nga shkaku i vetëm se fjalët "kur flitnim për dashurinë", thuajse ishin zëvendësuar me "kur flitnim për lirinë...", por që aty tashmë mund të tingëllonin si: "kur flitnim për jetën, që ishte dhe sikur nuk kthehet më..."

- Pranvera e Prishtinës është e pandalshme... Sapo ka filluar t'i japë shenjat e para...

Fjalët, që do të duhej të vazhdonin dhe ashtu të mbillnin shpresë, tash, sikur ta tradhtonin, jo vetëm që nuk kishin nxjerrë vazhdimin për shenjat e para të jetës, po përkundrazi, i ishin këputur nga një pikëllim therës, që, si i tillë, bënte të ditur se pranvera që e kishin para, vërtet mund të ishte tjetër, ndër ato që mund të mbesin të shënuara përgjithmonë me peshën e prishjeve të pandreqshme dhe kobëve të përhershme...

Sikur t'ia kishte kuptuar atë ndjenjë, edhe Linda mundimshëm kishte pëshpëritur diçka rreth shenjave të pranverës së akullt dhe për gjelbërimin e ngrirë...

Ai kishte heshtur. Sepse, po të fliste, do t'ia përsëriste ato që ia kishte thënë ditë më parë, kur ajo ia kishte paralajmëruar vendimin e familjes që të largohej për në Turqi, ku kishin farefis, me ç'rast në pah kishin dalë edhe ato mospajtime, që kishte menduar se jo vetëm që lëndojnë dashurinë, por edhe hapin çështjet rreth qëndrimit ndaj atyre që largohen që ai e merrte si humbje të vullnetshme të atdheut, e cila, në rrethanat e paralajmërimit të ndërhyrjes ndërkombëtare, e cila pritej dita-ditës, ishte kthyer në një shqetësim të madh dhe të

përgjithshëm se si duhej vepruar, veçmas në mungesë të një qëndrimi të prerë dhe të përgjegjshëm, në një kohë kur kush shpallte kumtesa se duhej për të mbetur me çdo kusht (thuhej se qëndrimi në atdhe ishte një detyrë madhore patriotike, pa kursyer dhe fjalë të tjera të mëdha, pa dhënë kurrfarë sqarimesh se si duhej të bëhej kjo dhe kush duhej të merrte përsipër mbrojtjen e të pambrojturve dhe organizimin e jetës në rrethana të tilla tejet të vështira lufte), e kush fliste për largim të përkohshëm të fëmijëve, grave dhe të të moshuarve, por edhe për strehim diku afër (mendohej vetëm për Maqedoninë Perëndimore dhe për Shqipërinë), që po ashtu as për njërin e as për tjetrën thirrje askush nuk merrte kurrfarë përgjegjësie dhe, kështu, kur këtyre u shtoheshin edhe gjithfarë thashethemesh që vinin nga qendra të ndryshme dhe sekush i hidhte në qarkullim për interes të vet, atëherë në një përshtjellim të tillë të paparë, nuk mbetej tjetër përveç veprimi dëshpërues në krye të vet...

- Tash mund të ndodhë më e keqja, kishte folur Linda duke ia përkujtuar se kishin mbetur si rosat në mjegull, të lënë në mëshirën e xhelatëve, të cilëve ndërhyrja e NATO-s mund t'u shërbejë si shkas i mirë për çfarëdo masakrimi dhe për këtë fajin ta hidhnin gjetiu...

Këtë ia kishte thënë edhe atëherë kur ai fliste me shumë adhurim për njësitë e armatosura të kundërvënies dhe këtë e lidhte me atë, si thoshte, kthimin e dinjitetit të humbur, që më në fund, me emërtimin e përbashkët Ushtri Çlirimtare e Kosovës, kishin filluar të vepronin në pjesë të ndryshe të vendit, ani pse kjo kishte ndikuar që forcat serbe të kundërpërgjigjen me një hakmarrje të egër ndaj popullatës duarthatë, që pastaj detyrohej të lëshonte trojet e veta në kërkim të ndonjë mbrojtjeje, të shumtën si refugjatë, por që kjo për shumëkënd paraqiste shpresë se ky largim do të jetë i përkohshëm, ngaqë gjaku që kishte filluar të derdhej ishte ai që nuk lejonte prishjen e përhershme...

- Tash po afrohet fundi dhe vetëm fundi, andaj nuk duhet që, kur ai është fare pranë, të humbim përqendrimin, por të dëshmojmë se, krahas luftës, bashkërisht do ta fitojmë edhe ardhmërinë, i kishte folur ai, sikur të bisedonte me të atin, i cili po ashtu kishte mendimin se kur NATO-ja kishte marrë përsipër punën dhe që këtë ai e quante mrekulli të mrekullive, një dhuratë perëndie, që mund të ndodhë një herë në një mijë vjet - nuk duhej dhënë viktima të panevojshme, por duhej bërë çmos që popullata (veçmas fëmijët, gratë dhe personat e moshuar), të strehoheshin përkohësisht në Shqipëri dhe në Maqedoni, para se të bëheshin pre e forcave policore dhe paramiliare serbe, të cilat, sikur ai ujkua që do mjegull që të veprojnë sipas dëshirës, praninë e tyre sigurisht se e kanë paraparë ta shfrytëzojnë për qëllime ushtarake, qoftë për ta masakruar sipas dëshirës, qoftë duke e përdorur si peng për t'i shmangur bombardimet e objekteve strategjike nga ajri...

Ajo kishte rrudhur krahët në shenjë dyshimi. I kishte thënë se luftërat bëhen më të paparashikueshme çastin kur i afrohen fundit, e ndonjëherë edhe pas mbarimit të tyre, kur në shesh dalin gjithfarë prirjesh të turbullta të qëimit të hesapeve të ndryshme. Kishte shtuar se e kaluara jo fort e largët i kishte mësuar se të papriturat e kohëve kalimtare jo rrallë kishin qëlluar më shumë se armët dhe fatkeqësitë e luftërave nga shkaku se ato përhera ishin përcjellur me përmbysje të mëdha dhe të pashmangshme, që u kishin dhënë krah rrënimëve të pandreqshme...

Ato kishin qenë fjalët e fundit që i kishte kapur kur ishin ndarë dhe ai me atë tundimin e druajtjes nga kohët kalimtare dhe të papriturat e tyre që i kishte mbetur si i varur, nuk e kishte përqaftuar si rëndom dhe madje as nuk ia kishte kapur dorën, që një copë herë i kishte mbetur e shtrirë në pritje të përsëritjes, por gjithë tronditje të madhe, të përzier me ndjenjën e një humbjeje të paralajmëruar, me druajtjen se mund të ishte e përhershme, kishte marrë rrugicën që shpiente te posta kryesore, e ngarkuar së tepërmi me flamuj të mëdhenj serbë, të cilët herë, herë krijonin një të ri duke u bashkuar me ata të kishës ortodokse serbe që u rrinin fare pranë dhe prej andej kishte kaluar në pjesën tjetër të qytetit, ku fillonin ato rrugicat e mbushura me baltë dhe papastërti, që shkojnë deri te binarët e stacionit të hekurudhës në drejtim të Podujevës, që kohëve të fundit duhej shkretë.

Aty ishte ndalur dhe për herë të parë kishte hetuar një vetmi të jashtëzakonshme. Një vetmi shpirti të veçantë, të ngjashme me atë zbrazëtinë që mbetet e paplotësuar edhe atëherë kur vendin e saj mund ta zënë të tjerat...

Kjo ndjenjë sikur ia kishte paralajmëruar ndarjen e përhershme, që përnjëmend edhe kishte ndodhur. Sepse, ajo nuk ishte kthyer as pasi kishte marrë fund lufta dhe thirrja e vatanit me nxitim kishte përfshirë të madh e të vogël dhe i kishte vënë në një lëvizje drejt saj, që dukej sikur të ishte diçka biblike. Dhe, nuk do të kthehej as përkohësisht, siç ndodhte edhe me ata që ishin me mëdyshje se lojërat nuk kishin marrë fund dhe as ata që aq shpejt u ishin përshtatur rrethanave të reja në mërgim, por ndonjëherë vinin të çmalleshin po edhe të rregullonin çështjet e pronave dhe të tjerat që lidheshin me zhvendosjen. Dhe, nuk do të kthehej kurrë më edhe nga shkaku se dukej që kishin filluar të shfaqeshin ato të papriturat e kohëve kalimtare që ua kishte pasur frikën kur për to, para teatrit i kishte folur me shqetësim dhe ia kishte bërë me dije se mund të ndikonin që largimi i tyre të bëhej i përhershëm, që për fat të keq kishte pasur rastin të bindet edhe vetë se ishin të tilla, kur një ditë ishte gjendur para shtëpisë së saj dhe kishte parë një familje të vendosur në të, me ç'rast burri që kishte biseduar me të i kishte thënë se atë shtëpi e kishin në shfrytëzim nga Qeveria e Përkohshme, e cila, sipas tij, me të drejtë kishte vënë nën mbikëqyrje shtëpitë e braktitura të turqve, romëve dhe të tjerëve, që kishin bashkëpunuar me okupatorët dhe nuk kishin rrugë tjetër përveçse të iknin me ta...

Derisa largohej, ky banues i ri - që fliste me bindjen se atë shtëpi dhe pronën do ta kishte të përhershme, se madje këtë e kishte shpërblim për vuajtjet që kishte pësuar gjatë atyre viteve që thoshte se i ishte kundërvënë dhunës serbe me të gjitha mjetet dhe fjalë të ngjashme që ato ditë dëndur dhe me shumë zhurmë dëgjoheshin të thuheshin kudo dhe ngado, veçmas nga ata që kërkonin përfitime të shpetja dhe me çdo kusht - i kishte thënë se turkoshakët dhe kullakët, të cilët vazhdimisht kanë qenë lojalë ndaj secilit pushtet, ishte e udhës që një herë e mirë të paguanin për këtë...

- U ka ardhur fundi sahanlëpirëseve dhe atyre që ndryshojnë fytyrën si pasqyra para diellit...

Iu bë se ato fjalë që i erdhën si një tërmet tejet rrënues, që i kishte shpërthyer diku në brendi, tashmë mund ta kishin qëlluar dhe tronditur edhe Lindën dhe familjen e saj, por edhe të tjerët, që mund t'i kishin dëgjuar, qoftë edhe si thashetheme po edhe si të përfolura të qëllimshme që përhapeshin shpejt ngado, aq më parë kur u ishin shtuar edhe ato që ishin mësuar nga ajo Marrëveshja e Kumanovës, (sipas saj, armata jugosllave, në saje të një marrëveshjeje teknike me shumë të panjohura, nuk tërhiqej detyrimisht e as nga kapitullimi dhe as që i ndalohej kthimi i mundshëm dhe të ngjashme), e edhe ato që pastaj lidheshin me atë vendosjen e gjendjes së përkohshme me shumë e shumë paqartësi, ku kishin dalë në pah veprime krye në vete gjithfare, ndër më të çoroditurat dhe ndër më të paparashikuarat, që bëheshin „në emër të meritave të ndryshme“ nga profiterët dhe të papërgjegjshmit e shumtë, që sikur më kohë ishin përgatitur për ato veprime - pra, të gjitha këto mund ta kishin detyruar atë të ndërronte mendje dhe të mos kthehej më...

Kafeneja skaj Teatrit dhe numri i madh i atyre që edhe në ato orë të vona të natës mbushnin atë hapësirë, sikur po e yshtnin për pak kohë të ndalej, që ta ndërledhnin me atë pjesën, që mendonte se përgjithmonë ishte shkëputur dhe kishte shkuar pa kthim, por që ishte diçka e brendshme që këtë nuk dëshironte ta pranonte si të tillë, së paku gjatë atij përballimi.

Madje, një çast iu bë se midis atyre që aty ishin ulur dhe të tjerëve që rrinin pranë njëri - tjetrit dhe bisedonin fare qetas, po hetonte dhe po ndjente diçka të asaj fryme të përbashkët të takimeve me Lindën, që kishte mbetur dhe priste t'i afrohej...

Me përfitim të kësaj thirrjeje, që iu duk e afërt, po njëherësh edhe tejet e largët, sikur të vinte nga një botë tjetër, iu afrua kafenesë dhe te banaku që kishte vend, porositi atë kafënë e lehtë, bashkë me një ekspreso, të cilat një copë herë i shikoi, sikur të kishte pranë Lindën, kur të dy bashkë kalonin çaste të lumtura, ajo me atë kafënë e lehtë që e rrufiste shpjat,

gjithnjë duke ia ngulitur shikimin, ndërsa ai me atë ekspreso të fortë dhe pa sheqer fare, për të cilën ajo me shpoti i thoshte se pinte pelin...

Ndjenja e pelinit, që tashmë kishte filluar ta pushtonte dhe sikur ia gërryente zorrët, bëri që filxhanët t'i linte të paprekur dhe, pasi kishte lënë monedhën e metalit prej dy markash gjermane, e cila, sapo kishte prekur banakun, kishte nxjerrë një krismë të ftohtë dhe të thekshme, ishte larguar me shpejtësi, sikur ta ndiqte diçka që i sillte shqetësim të papërballueshëm.

Në të vërtetë, ishte përvijimi i shikimit të fundit të Lindës, gjithë pikëllim, ai që i kishte dalë përpara dhe nuk po i ndahej, sikur të dëshironte t'ia bënte me dije se kishte humbur një pjesë të veçantë, që vetëm pasi ishin ndarë ia kishte kuptuar rëndësinë, siç i kishte ndodhur edhe me të atin, në atë udhëkryqin e kobshëm, kur atë e kishin detyruar të hipte në atë kamionin në drejtim të Shkupit dhe kishte marrë vesh se kishte përfunduar në Bllacë, ndërsa ai kishte mbetur në anën tjetër, e cila do ta çojë në Tetovë dhe prej andej, ngado që ishte sjellë, ishte ngarkuar me atë ndjenjën e rëndë të refugjatit në vend të vet, që jo vetëm nuk i ishte hequr, por sikur i ishte shtuar edhe më shumë pas kthimit, sa të mendojë se ishte kthyer në një bredhës të përhershëm në kërkim të asaj që as shihet, as preket, por vetëm ndjehet dhe se përpjekjet që ta gjente, i kishin ndihmuar ta zhdëmtonte atë që në të vërtetë paraqiste humbje, e që si të tillë nuk dëshironte ta merrte e as ta pranonte, nga shkaku i vetëm se ashtu bëhej pjesë e atij zhvlerësimi dhe nënçmimi, të ngjashëm me atë që kishin ata që kishin përjetuar Bllacën dhe tmerret e saj...

Me ato përpëlitje në kokë, kishte bredhur edhe një copë herë në pjesën e vjetër të qytetit, që, në atë heshtje të orëve të vona të natës, i kishin kthyer copëza të përfytyrimeve të kohëve të paraluftës, kur andejpari mbizotëronte dhuna, frika dhe gjithë ajo që i takonte atij nënçmimi të përgjithshëm, me të cilin jetohej, që dikur ia kishte krijuar ndjenjën e një gjallimi të padinjitetshëm, nëpër të cilin kalohej, që, për ta mundur disi, atëbotë nuk i ndihmonin më as bredhjet poetike, as ëndrrat që u shkojnë frymëzimeve krijuese, siç ishin ato frustrimet e pandalshme në kafe "Syri", e aq më pak i ndihmonin fjalët e të atit rreth durimit dhe domosdosë që gjërat shkojnë aty ku duhet të shkojnë, ku ai, pas gjithë asaj që e quante dëshmi qytetëruese dhe shtetformuese (siç ishte jeta paralele, që nga shkollat, mjetet e informimit dhe deri te strukturat tagrambledhëse, madje edhe ato të rendit dhe të mbrojtjes dhe të tjera si këto, me të cilat prania e Serbisë ishte rrudhur deri në përmasat e pushtuesit të egër policor-ushtarak, me çka Beogradit dhe propagandës së tij i kishin humbur të gjitha atutë e mashtrimit që përdorte dhe përfundimisht do t'u kthehej mjeteve të luftës që t'i realizonte ato që i quante qëllime historike, siç ishin spastrimet etnike, pa përjashtuar këtu edhe krimet e rënda kundër njerëzimit që shkojnë deri në shkallën e gjenocidit të hapur, të cilit patjetër se do t'i shkaktohej edhe kndërvënia e armatosur dhe të tjerat që nënkuptonte lufta e drejtë për mbijetesë), një ditë kishte paraparë edhe atë ndërhyrjen ndërkombëtare, që më në fund edhe do të ndodhë, por që atij, përballë realitetit të padurueshëm, me atë që ishte kthyer në jetë bodrumesh dhe nënçmim të hapur nga pushtuesi, të cilit mendonte se ato veprime i shkonin për shtati dhe ndaj tyre nuk do të ndërmerre asgjë - i dukeshin të pabesueshme, ninulla, me të cilat kërkohet gjumi pa natë dhe ato që i takojnë asaj mbijetese dosido, me anën e atij mashtrimi që e shihte vetëm si të tillë, nga i cili një ditë duhej liruuar patjetër para se të krijohet vetëdija e robit të përhershëm, që atë e ka fat dhe assesi ndryshe...

- Ai që sillet nëpër biruca dhe mësohet me to, kur të gjendet jashtë tyre, nuk është në gjendje të përjetojë hapësirën dhe përmasat e saj, i kishte thënë të atit...

- Ndjenjën e robit nuk e heq hapësira, por përcaktimi shpirtëror i lirisë dhe fryma e saj kur kalon nëpër sprova që ajo të mbrohet, por edhe të zgjerohet në përputhje me parimet e saj...

Ai i kishte folur për diçka të paraparë, së cilës i duhej kohë dhe, mbi të gjitha, sjellje e mençur dhe jo njerëz të humbur, siç thoshte ai dhe të ngjashëm, që me të drejtë dhuna dhe

poshtërimet e saj ua kishin humbur durimin, por edhe shpresën se ajo ishte “në sosje e sipër, në vetëshpenzim të papërmbajtur, në vetëvrasje...”

Jehona e këtyre fjalëve i ishte ngjitur aty dhe tashmë, nga një zhvendosje e brendshme, po i vinte sikur t’i thuhej se lirinë nuk e përcaktonte forma, por përmbajtja dhe pjesëmarrja në të me përcaktimin e përhershëm të zgjerimit, jashtë së cilës ndodh ai zhvlerësimi tjetër, i përhershmi, ku nuk diti se si fjalët ”i zhdukur” dhe “zhdukja” i ndërhyjnë dhe kjo do të ndikojë që përfundimisht të heqë dorë nga procedura administrative, krejt në fund të kryerjes së formaliteteve në Byronë e të Zhdukurve, kur mund ta merrte edhe njoftimin zyrtar se për të atin kishte filluar procedura e kërkimit, që kishte vlerësuar se nuk do të thoshte tjetër përveçse pajtim me një humbje shpirtërore dhe më shumë se kaq, që, si do të shihet, fryma e saj do ta mbajë në atë gjendje kërkimi të përhershëm poetik, por edhe intelektual dhe njerëzor, në përgjithësi...

Ky vendim, jo vetëm që e kishte lehtësuar, por ia kishte krijuar ndjenën e një rigjetjeje, që më vonë do ta shohë si rimbushje dhe të ngjashme, me të cilën ishte hedhur në shtrat, sikur ta kishte pranë të atin, bashkë me ato që ia thoshte për ato sprovat e vazhdueshme të dëshmimit dhe të vetëdëshmimit, të cilat sikur i përfshiheshin në një mjegullim të lehtë dhe me atë përhitje edhe kishte fjetur, derisa kishte dëgjuar zilen e derës dhe cingërima e saj e kishte nxjerrë nga fashitja, e ngjashme me atë të zhytjes në askundje dhe e kishte bartur në shqetësimet që lidheshin me ato të kohës së fillimit të luftës, kur ajo lidhej me të papriturat dhe shfaqjen e tyre.

Por, këtë herë, për habi, ishte holandezja Helga Krojff, që ia bënte me dije se, meqë e kishte pritur gjatë gjithë ditës dhe ai nuk ishte shfaqur të kryenin ato formalitetet që i duheshin hapjes së procedurës së kërkimit të të atit dhe, edhe nga frika se mund t’i kishte ndodhur diçka, duke i thënë se kishte keqpërdorur afrinë që kishin nga biseda e kafesë së përbashkët në kafenenë e qytetit, sillte formularët për nënshkrim.

Ai edhe më tutje nëpër mendje sillte ato pjesë të atyre përfytyrimeve që e kishin bartur nga hotel “Grandi” te Teatri dhe pastaj nëpër atë pjesën e vjetër të qytetit, derisa kishte përfunduar në shtëpi, ku ishte futur sikur të hynte në një vend të huaj. Nga ajo trandje, fillimisht ndoshta nuk kishte qenë në gjendje të kapte as ato që holandezja ia kishte thënë rreth formularëve që duhej doemos atë ditë t’i nënshkruante, përpos që i kishte dhënë shenjë të hynte brenda dhe të ulej, derisa të kthjellohej pasi t’i ketë larë sytë.

Ajo ishte ulur në kanapën e dhomës së madhe të pritjes, përballë raftëve të mëdhenj të librave, tashmë gjysmë të boshatisur, ku rrinte edhe një portret i Gjyshit të Madh, i bërë pas vdekjes së tij nga një piktor i njohur, bashkëkohës i tij.

- Ky portret duket sikur një fotografi e ngjashme, që ndodhet në një arkiv të Hagës, e bërë nga një reporter italian në prag të atentatit në Selanik - foli holandezja gjithë kërshtëri.

Përmendja e fotografisë në arkiv dhe atentati në Selanik, seç e ngrinë Vëllaznimin dhe e lanë në gjysmë të rrugës për në banjë, ku duhej t’i lantë sytë.

Që t’ia bënte me dije se kishte edhe njohuri të tjera rreth atij që i thoshte Gjyshi i Madh, nisi t’i fliste për një intervistë që ai ia kishte dhënë gazetës së njohur të Vjenës “Die Presse”, diku në prag të Revolucionit xhonturk, ku krahas pikëpamjeve politike rreth atyre që ndodhnin në atë pjesë të botës dhe sillnin shqetësime të mëdha kudo, e kishte parë të udhës të fliste edhe për trashëgiminë antike në Dardani dhe rrënjët e saj në qytetet Ulpiana dhe Justiniana, që shtriheshin në rrafshnaltën e Kosovës dhe kishte shumë e shumë dëshmi të atij qytetërimi të lartë dhe thoshte se ishte koha që edhe për të të gjendej ndonjë Shlliman, me çka theksonte se ndoshta ashtu do të hiqeshin disa nga hamendjet e Trojës dhe të përkatësisë së saj gjeografike, por edhe kulturore, që edhe sot e gjithë ditën, me të drejtë mbesin të hapura. Madje, në atë intervistë ai kishte shtruar dilemën se Troja mund të kishte qenë pjesë e qytetërimit pellazg dhe, ato që merren si huti gjeografike, nuk paraqesin tjetër veçse përpjekjen që kjo çështje të anashkalohej nga frika se qendra e antikës mund të zhvendoset në një pjesë tjetër nga ajo e helenëve, ku është fiksuar...

- Mund të thuhet se njohuritë e tij arkeologjike nuk paraqesin vetëm dëshmi të mira rreth një qytetërimi dhe rrënjëve të tij në një hapësirë, siç është kjo, por ato sikur ruajnë edhe shqetësimin, që vjen nga dikah, se një ditë ai mund të dëshmohej si i tillë... Ndoshta, këtu duhet parë edhe shkakun e vërtetë të vrasjes?...

Fjalët e fundit, seç ia rrotulluan kokën, por edhe gjithë trupin. Sepse ato, si një tërmet që bie papritmas dhe ndryshon gjithçka përnjëherë, mund të zhvendosnin në përgjithësi një të menduar nga një anë në tjetrën, të paparashikueshme fare, me të cilën një kujtesë historike që edhe më tutje mbetej me hamendje të ndryshme - siç ishte ajo rreth njërit nga liderët më të rëndësishëm të lëvizjes kombëtare për pavarësinë, i cili do ta pësojë pse ndër të paktët do t'i mbetet besnik idealit të filluar dhe përkushtimit që pavarësia kombëtare të përfshinte gjithë hapësirën etnike shqiptare, pa lejuar që me asgjë ajo që paraqiste themel të saj të mbetej jashtë, sepse ashtu edhe krijesa torso e shtetit shqiptar mbetej pa aftësinë e duhur jetësore, një si marionetë në duart e huaja dhe të tjera vlerësime si këto (do të tregohen si të vërteta të hidhura për botën shqiptare, por njëherësh do të mbesin edhe shqetësime të hapura për të tjerat, mbi të cilat pastaj do të bëhen ato fesatet dhe mosmarrëveshjet që do të ushqejnë krizat dhe luftërat, siç ishte edhe kjo e fundit dhe të tjera si këto) – pra, sikur kjo kujtesë historike rrënohej pamëshirshëm në dobi të një çështjeje që për shumëkënd në dukje mund të ishte e dorës së dytë a të tretë, por, madje edhe zhvlerësim...

Ai sa nuk i tha se mund të ishte fjala për ndonjë ngatërresë apo huti, krejt një, që ishte përhapur nga ata që e kishin vrarë për ato që duhej të vritej, e që ishin çështje madhore, që mjerisht edhe më tutje kishin prodhuar pasoja dhe mund të vazhdonin të prodhonin edhe në të ardhmen nëse nuk merren parasysh si të tilla dhe të ngjashme, por ishte përmbajtur nga druajtja se mund të shkapërderdhej andej nga nuk e kishte ndër mend të kalonte...

Sikur t'ia hetonte hutinë, por edhe mospajtimin, me pohimin se ai megjithatë mbetej figurë e rëndësishme politike, ndër më komplekset e historisë më të re shqiptare, që i takonte kohës së shtetformimit dhe kishte vizione të qarta për përbashkësinë dhe ardhmërinë sipas koncepteve të qytetërimit perëndimor, që me siguri se me ato integrimet rreth hapësirave të përbashkëta në kuadër të një tërësie ekonomike dhe kulturore që do të përkujtonte përpjekjet e Karlit të Madh dhe më vonë edhe ato të Napoleonit dhe lëvizje të ngjashme, kishin qenë një hap para kohës - holandezja kishte nxituar që, pas asaj që kishte thënë rreth njohurive arkeologjike të botuara në gazetën vjeneze dhe ato madje t'i quajë edhe pjesë të kulturës së përgjithshme që posedonte një politikan me kredo intelektuale, që ishte ndër të pakët, gjithë përqendrimin ta kthente tek roli i liderit të rëndësishëm kombëtar, ku edhe ishte dhe duhej të mbetej, por që edhe me këtë rast, vrasjen e tij në Selanik kishte dëshiruar ta nxirrte nga hapësira e intrigave të brendshme ndërshtetërore dhe nga fatkeqësitë që kishte prodhuar lufta e ashpër për pushtet, e cila nuk kishte kursyer edhe njerëzit më të merituar të pavarësisë, për ta bartur tek ajo e kundërimeve dhe pikëpamjeve gjithëballkanike dhe europiane, si pjesë e qytetërimit perëndimor me përkatësi antike, të cilat i kishte ai dhe mund të dëshmohej, me të cilat do të përjashtohej luftra e qytetërimeve dhe kurdisjet tjera që andejpari prodhonin fatkeqësi të përhershme, veçmas në kurriz të shqiptarëve...

Por, Vëllaznimit edhe më tutje i sillleshin vërdallë nëpër kokë mbetjet e fjalëve që shkakun e vrasjes e shihnin tek ajo që pak më parë ishte thënë se ndoshta mund të lidhej me njohuritë rreth shqetësimit, që sjell dësmimi i rrënjëve të antikës në këtë hapësirë...

Në këtë përfitim i ndërhynte idhulli i Ulpianës, i ndërhynte edhe portreti i asaj që thuhej se ishte mbretëresha e Dardanisë, të cilat i ati i mbante në vitrinë dhe thoshte se i kishte trashëgim nga Gjyshi i Madh, që bashkë me të tjerat, në prag të luftës i kishte ruajtur diku me arsyetimin se ishin pjesë e rëndësishme e asaj kujtese të gjatë historike dhe të tjerat si këto, që në ato rrethana të dhunës së pandalshme, kur ishte vetëm hapësira e bodrumeve dhe horizonti i mbyllur, ajo që përcaktonte rrethin e madh dhe në dukje të mbyllur fare, sikur nuk ua kishte vënë veshin, ngaqë çfarëdo që thuhej për të ngjashmet, pa marrë parasysh seriozitetin që

kishin, përballë nënshtrimit dhe perdes së errët që kishin përpara, dukeshin çështje fare pa vlerë...

Megjithatë, holandezja Helga Krojf, sikur t'ia fliste i ati, por me një përqendrim edhe më të theksuar, kishte vazhduar të sillej rreth kundrimeve gjithëballkanike dhe europiane të atij që i thoshte Gjysh i Madh, ku zinte ngoje projektet për lidhjet me grekët, bullgarët dhe me të tjerë, të cilat i kishte quajtur dëshmi tejet bindëse të një rirreshtimi shoqëror dhe politik në përbërje të asaj që shfaqej si hapësirë e përkatësisë së qytetërimit perëndimor, i cili nuk rrudhej vetëm në çështjet e besimeve dhe në përhapjen e tyre në përputhje me pushtimin e hapësirës së fituar me anën e luftërave në emër të tyre, por bartej te rrënjët e antikës dhe te gjithë ajo lashtësi, e cila pas heqjes së dhunshme nga skena historike, që do t'ua vijë nga librat e shenjtë, sërish do të kthehet edhe në saje të atyre mendjeve që kanë parë se hapësira e lirisë shtrihet tutje kryqëzatave dhe përtej mendimeve të librit të mbyllur, për t'ua lidhur me filozofinë e vjetër, njohuritë e së cilës pastaj do t'ia hapin rrugën humanizmit dhe renesancës, por edhe iluminizmit dhe parlamentarizmit demokratik me shtetin sekular, që fillonte nga leksioni historik i Revolucionin Borgjez Francez...

- Ai njihte Volterin, Kantin, Hegelin, por njihte edhe themelet e filozofisë antike, që nga Platoni dhe Aristoteli, si dhe përvijimet e saj në realitetet shoqërore dhe ato politike, që mbesin modele të pakapërcyeshme...

Kur ia tha këto, holandezja e kujdesshme nga dosja nxori disa fletë të fotokopjuara nga një gazetë gjermane dhe ia la para. I tha se, të përkthyer për të enkas në anglishte, ishin pjesë e një interviste dhënë gazetës së Berlinit "Tagespost" pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, kur paqja e Versajës dhe marrëveshjet që do të dalin prej saj, krahas shumë çështjeve të zgjidhura sipas diktatit të fitimtarëve, me krijimin e Jugosllavisë, si një krijesë artificiale, në radhë të parë në dëm të shqiptarëve, por edhe të gjermanëve, hungarezëve dhe të tjerëve, që nuk i takonin familjes së sllavëve të jugut, pa marrë atë që në ato pjesë shfaqshin si etni të qendrueshme, do t'ua lënë të ndezur fitilin luftërave të ardhshme që do të arrijnë deri te kjo e fundit, me të cilën, ndonëse Versajës do t'ia jepet fund, megjithatë mbesin plagët e saj të mëdha, me çrregullime të përhershme, kapërcimit të të cilave u duhen vizione tejet largëpamëse dhe të guximshme, të cilave u duhet vizioni i qytetërimit perëndimor...

- Ka disa gjëra që duhen mbajtur parasysht me kujdes të veçantë, ngaqë përsëritja i bën edhe më tragjike...

Holandezja nuk kishte vazhduar të fliste më tutje për këtë, por, pasi ishte ngritur dhe e kishte bërë me dije se formaliteteve rreth hapjes së hetimeve për të atin si të zhdukur mund t'ua jepnin fund edhe të nesërmen, i kishte thënë që, po të kishte kohë, do të ishte mirë t'ia hidhte një sy intervistës së gazetës gjermane.

- Ka të ngjarë që edhe Kemal Atatürk, gjithë doktrinën e shtetit modern sekular turk dhe reformat, ndër më të mëdhatë e kohës, që edhe sot e gjithë ditën mbesin si njëri ndër modelet më të fuqishme të një transformimi të gjerë shoqëror të një rëndësie të madhe botërore, t'ia ketë mbështetur mbi këto mësim, për të cilat ai ka pasur njohuri të duhura nga koha kur bashkërisht janë gjendur në taborrin e atyre që kanë menduar se Perandoria Osmane mund të shpëtonte vetëm me anën e reformave të thella politike dhe shoqërore, sipas frymës perëndimore dhe në përputhje me to edhe kanë vepuar...

IV

Para se t'ia lëshonte sytë intervistës së botuar në gazetën gjermane, që Helga Krojf ia kishte bërë me dije se e kishte përkthyer enkas për të në gjuhën angleze, Vëllaznim Prishtinës sesi i shkoj mendja se rasti i të atit në atë luftë dhe i familjes së tyre në përgjithësi, me Gjyshin e Madh në qendër të vëmendjes, sikur shfaqej i veçantë dhe hapja e procedurës së zhdukjes, që ishte pritur, mund t'ia kishte dhënë shkas atij trajtimi që, si do të shihet më vonë, njohjes me holandezen do t'ia japë kahun e një afrie të shpjetë, e cila do të kalojë në lidhje të përhershme jetësore, por njëherësh do të ndikojë që vështrimin "*Dardania, themel i kujtesës historike dhe*

rrënjët e saj antike”, që e kishte nga i ati, ta baraspeshonte me projektin letrar “*Dardania si kujtesë poetike*”, së cilës, si lajtmotiv do t’i shërbejë poezia “*Në kërkim të Itakës*” që, si frymëzim ngushëllues i përhershëm, i ishte qepur çastin që atë ditën e katërt të bombardimeve nga ajri, forcat paramilitare serbe, pasi i kishin nxjerrë nga shtëpitë me dhunë, i kishin mbërthyer në drejtim të Maqedonisë dhe ai kishte përfunduar në atë rrugën që do ta shpiente në Tetovë dhe pastaj prej andej në Tiranë dhe gjetiu nëpër Shqipëri me atë ndjenjën e rëndë të refugjatit në vend të vet, ndërkohë që i ati, pasi kishte përejtuar Bllacën, kishte shkuar në një drejtim të panjohur që, me ato që më vonë herë pas here kishte filluar t’ia hidhte në internet, sa herë ndjente se projekti letrar rreth kujtesës poetike po i ngecte, ose druante t’i mbetej i shkapërderdhur, sikur dëshmonte se ishte kthyer në një frymë të përhershme që si kod i jashtëzakonshëm e përcillte këmba-këmbës dhe, si do të mësojë, ngjashëm do t’u ketë ndihmuar edhe të tjerëve, veçmas studiuesve të rinj që merreshin me lashtësinë e botës shqiptare dhe me rrethanat e ngritjes së saj që nga antika e tutje (gjithnjë me anën e porositve që ua dërgonte me anën e internetit nga ai kodi i panjohur, që shfaqej i vendosur diku vetëm për qëllime të tilla) - duke ua bërë me dije se çelësi i mbijetesës së saj të vështirë, me shumë e shumë vazalitete, larje-lyerje gjithfare para pushtuesve, që vinin herë nga njëra anë e herë nga tjetra dhe, të parën gjë që bënin, kërkonin ndryshimin e besimit bashkë me shkronjat dhe gjuhën – gjithnjë duhej kërkuar te përpjekjet që gjatë kohëve kalimtare të ruhet themeli i ngrehinës, mbi të cilin qëndrohej, pa u lënë hapësirë të papërgjegjshmëve dhe atyre që janë të gatshëm t’i ndërrojnë njëqind fytyra për një çanak të vogël dhe të ngjashme, pa çka që e gjithë kjo vazhdimisht duhej të paguhej me një çmim të lartë, pa të cilin nuk bënte...

Por, para se të ndodhë kjo lidhje e përhershme jetësore me holandezen Helga Krojff, që pas pak do t’i bartë rrugëve që çonin gjurmëve që ndiqnin qytetërime të vjetra, pjesërisht të zhdukura dhe të rrënuara, me çka do të përpiqen të dëshmojnë se ato kishin një nismë të përbashkët, që ka përcaktuar të gjitha zhvillimet, qofshin ata ndër më të fuqishmet dhe më të panjohurat, siç mund ta kishin të ngjashëm edhe fundin që mund t’u vijë nga dhuna e rrënuesve dhe çmendja e pushtuesve të pangopur kur gjejnë hapësirë dhe mundësi për veprime të tilla, që ua mundëson heshtja e të përgjegjshmëve apo anashkalimi i tyre dhe ndërhyrja e të papërgjegjshmëve por edhe kyçja e tyre e qëllimshme nga dikah, Vëllaznim Prishtina për herë të parë do të vrasë mendjen se e gjitha e asaj afrie dhe lidhjeje të përhershme jetësore, por edhe shpirtërore midis tyre, në ishte çështje rasti - pse ai kishte shkuar në atë zyrën ku paraqiteshin të zhdukurit që të regjistronte të atin, me ç’rast holandezja, pasi ta kishte lutur të takoheshin në kafenenë përballë ndërtesës ku ishte vendosur administrata ndërkombëtare dhe ai të ketë pranuar, midis tyre kishin shpërthyer ato shkëndijat e para të afrisë, që pastaj ajo kishte bërë çmos të shkonin sa më larg meqë tek ai kishte parë një djalosh që kishte shqetësime të ngjashme intelektuale, pra që me anën e muzave të bredhte në kërkim të diçkaje, që ishte e njëjtë me atë përcaktimin e saj për gjetjen e gjurmëve të kulturave të harrura nga lashtësia dhe të ngjashme... Apo, mund të thuhet se ajo që kishte lindur midis tyre, përnjëmend mund të ishte “prodhim i rrethanave”, po ashtu të veçanta, të cilave mund t’u ketë paraprirë një interesim paksa më i madh sapo t’i kishte parë të dhënat që i ishin dorëzuar prej tij, me të cilat ajo mund të kishte shkuar te zyra e Drejtorisë Ndërkombëtare që merrte përsipër hulumtimet e mëtejshme dhe, nga njëri prej atyre që kishte njohuri për të gjitha (kishte bukur shumë sish të përgatitur nëpër seminare paraprake rreth historisë dhe kulturës shqiptare) - aty për aty ishte pajisur me të dhënat për familjen Prishtina dhe rolin e saj në lëvizjen kombëtare dhe të tjera ngjarje që do t’i paraprijnë vrasjes së tij nga ai plumbi që do t’i vijë i porositur nga shumë anë dhe pastaj, nga të njëjtat burime, nuk e kishte pasur të vështirë të merrte shpejt e shpejt edhe ato njohuri rreth veprimtarisë së të atit, si avokat i njohur që, për vite të tëra, me të dhëna të ndryshme rreth shkeljeve të të drejtave njerëzore nga represioni serb dhe dhuna shtetërore që ushtrohej nga Beogradi, kishte ushqyer burime të ndryshme ndërkombëtare që merreshin me këto çështje, po ku kishte pasur mundësi të njihej edhe me ato që diheshin për veprimtarinë e tij si deputet: veç të tjerash ishte ndër ata

të shtatët që kishin refuzuar Kushtetutën e 23 marsit të vitit 1989, kur Kosovës i ishte marrë autonomia me gjak, e ku mund të ishin edhe ato të dhëna që diheshin rreth veprimtarisë së tij për themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, më 23 dhjetor të po atij viti, si dhe shumë angazhime të tjera që lidheshin me përgatitjen dhe shpalljen e Deklaratës së dy korrikut të vitit 1990, pastaj të Kushtetutës së Kaçanikut, të referendumit për pavarësinë një vit më vonë dhe punë të tjera që kishin të bënin me ndërtimin e sistemit paralel, të cilin ai bashkë me rrethin e mendimtarëve e kishte vlerësuar si të domosdoshëm, jo vetëm për ta mbajtur jetën jashtë strukturës së sistemit politik, shoqëror dhe ekonomik të Beogradit, por edhe për ta rrudhur praninë e Serbisë vetëm në përmasat e pushtuesit policor-ushtak, pra të okupatorit, me çka faktori ndërkombëtar një ditë sillej para aktit të kryer dhe të tjera si këto...

Këto të dhëna, sigurisht se mund të merreshin nga shërbimet që paraprakisht kishin qenë të njoftuara për ndërhyrjen e ndërkombëtarëve dhe përfshirjen e tyre në atë kohën e administrimit kalimtar të vendit dhe, në përputhje me këtë mision, është fare e natyrshme që të përgatiteshin me të dhëna të domosdoshme po natyrisht edhe me të tjera rreth figurave qendrore të lëvizjeve për pavarësinë, për ato që kishin ndodhur pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, si dhe për intelektualët e rëndësishëm dhe rolin e tyre në të gjitha zhvillimet, veçmas të atyre që ishin vënë në ballë të zhvillimeve të fundit, pa përjashtuar këtu edhe njohuritë rreth autoriteteve vendore dhe piramidës së tyre në të gjitha nivelet dhe të tjera si këto, por Vëllaznim Pishtinës i kishte bërë përshtypje përkushtimi aq i theksuar i holandezes Helga Krojfi, si dhe interesimi i Gjyshit të Madh rreth trashëgimisë materiale dhe asaj shpirtërore nga antika, kur ajo edhe rastin e vrasjes e kishte vënë në lidhje me atë, si kishte theksuar, mundësinë e gjetjes së çelësit që themelet e antikës mund t'i zhvendoste në një hapësirë tjetër nga ajo që tashmë njihet, pra, nga bota helene tek ajo pellazgo-ilire, me çka atë e vendoste në një lapidar tjetër, ndër më të lartësuarit dhe të nderuarit, me çka po ashtu nuk do të ishte e vështirë të shpjegoheshin edhe përmasat e dhunës së ushtruar shtetërore që shkonin deri në gjenocid të hapur ndaj një popullate me origjinë antike, së cilës duhej t'i fshiheshin gjurmët para se të dilte në dritë e vërteta e saj...

„Holandezja nuk është nëpunëse e rëndomtë. Dhe, as interesimi për Gjyshin e Madh nuk kishte qenë vetëm një takim i thjeshtë me njërin nga personalitetet e rëndësishme të lëvizjes kombëtare, rreth të cilit paraprakisht duhej të kishin disa njohuri nga koha e trajnimit në mision“ - do të mendojë Vëllaznim Prishtina, derisa ajo largohej me atë buzëqeshjen e ëmbël, pasi ia kishte lënë atë porosinë se formalitetet rreth paraqitjes së të atit ndër të zhdukurit mund t'i kryente edhe të nesërmen, meqë lënda ishte regjistruar dhe ajo tashmë kishte numrin e vet dhe shifrën bartëse, me anën e së cilës bëheshin hetimet e mëtejshme...

„Ajo dinte shumë më shumë që më parë dhe çështja e formaliteteve administrative të zhdukjes mund t'i kishte shërbyer si mbulesë atij takimi të rastit, i cili do të bëhej, qoftë edhe në rrethana të tjera...“

Kështu gjykoi kur mori në dorë fletët, ku ishte ai përkthimi anglisht i intervistës që sillte gazeta e Berlinit, sipas së cilës ajo i kishte thënë se fitohej bindja që edhe Kemal Atatürk shumë vlere të doktrinës së shtetit modern sekular turk, si një kundërpeshë të domosdoshme kundrejt Perandorisë Osmane dhe vendit të saj në atë pikë aq të ndjeshme të botës, mund t'i kishte mbështetur mbi këto mësimë, të cilat ai duhej t'i kishte njohur gjatë takimeve që ata kishin pasur kur ndodheshin në të njëjtën anë në përkrahje të Revolucionit xhonturk, hamendje kjo, të cilën më vonë do ta plotësojë edhe me një dorëshkrim të gjatë që ajo e kishte nxjerrë nga Arkivi Politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë në Bonn, ku ishin dy biseda që ambasadori i atëhershëm gjerman në Stamboll, me urdhrin e Berlinit kishte bërë me të në cilësinë e deputetit që drejtonte grupin parlamentar të reformave politike të perandorisë, me të cilat synohej që ajo t'i afrohej botës perëndimore në vend se të ndodhte e kundërta, siç do ta dëshironin Rusia dhe aleatët e saj në Ballkan.

Biseda e parë ishte bërë në prag të fillimit të kryengritjeve të viteve një mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë-dymbëdhjetë, ku ai kishte shprehur pikëpamjet pse pavarësia

kombëtare, nëse do të dështonin përpjekjet për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një tërësi autonome, do të duhej të shpallej në gusht të vitit një mijë e nëntëqind e dymbëdhejtë me ngritjen e flamurit kombëtar në Shkup, por që, si do të shihej më vonë, kjo nuk do të ndodhte ngaqë, përpos tij, të tjerët, që kishin qenë në atë takimin e Taksimit në një lagje të Stambollit dhe kishin marrë përsipër detyra të caktuara që kryengritja të ngrihej njësoj në të gjitha pjesët, për arsye të ndryshme, këtë jo vetëm që nuk e kishin bërë, por me veprime të ndryshme e kishin penguar, me çka mund të shpjegohen edhe ato dështimet e mëvonshme që botën shqiptare do ta hedhin në një vorbull të rrezikshme, ku do t'i kanoset edhe shpërbërja...

Ndërsa, biseda e dytë ishte bërë tetë vjet më vonë në një vend bregdetar italian, kur pas gjithë atyre dështimeve të njëpasnjëshme, me të cilat ishte ballafaquar gjatë përpjekjeve që të stabilizohej shteti shqiptar dhe qeverisja e tij, përpiquej ta mbante gjallë Komitetin për Mbrojtjen e Kosovës, së cilës detyrë, jo vetëm që nuk do t'ia dalë, por e gjitha do t'i kthehet në një mosmarrëveshje edhe me bashkëlufëtaret e orëve të para, kur në luftë e sipër për pushtet, edhe do t'i shkojë koka në një gjendje tejte të vështirë, që të mos thuhet të mjerë, kur nuk i kishte mbetur tjetër veç idealit, të cilit nuk do t'i ndahej kurrë, madje as atëherë kur dukej se çdo gjë kishte marrë fund zi e më zi...

Fjalët për doktrinën e shtetit modern sekular turk sikur i erdhën të ftohta dhe të largëta madje, sa t'i dukeshin njëloj me ato që ia thoshte i ati kur thoshte se Perandoria Osmane, por jo vetëm ajo, të shumtën ishte udhëhequr nga kryeministra dhe gjeneralë me prejardhje shqiptare, të cilët në shumë fusha kishin lënë vulën e zhvillimit dhe se ajo ngritje dhe ngjitje majave, fliste për hapësirën si mundësi të arritjeve, që janë në gjendje ta ofrojnë vetëm perandoritë dhe të ngjashme si këto, të cilat ishin parë si mundësi që duhej shfrytëzuar dhe ishin shfrytëzuar, e që atij, në rrethanat e dhunës nëpër të cilën kalonin dhe arsimimit të ngushtuar që merrej nëpër bodrumet e errëta, ku zhvillohej ajo që quhej jetë paralele, me të cilën thuhej se jepeshin ato dëshmitë e vetëmbrojtjes, të vetorganizimit dhe dëshmi të tjera që u duheshin provave shtetformuese, që ziheshin ngoje vend e pa vend dhe sikur ishin kthyer në një refren që u hynte në punë të gjithëve për diçka dhe të ngjashme - i vinin jo vetëm si të huaja, por edhe sikur ishin për ta nënçmuar, sikur ishin për ta bërë me dije atë rënien e tmerrshme, në të cilën ishin përfshirë dhe dukej se me ato që thuheshin për durimin dhe qëndrimin, e tërë gjendja ishte kthyer në një mashtrim që i ndihmonte gjithë atij mjerimi për t'u bërë i përhershëm.

- Po unë si të bëhem kryeministër, kur nuk mund të jem as hardhucë, i kishte thënë një ditë të atit gjithë dëshpërim, pa denjuar që të kërkonte udhëzime, me të cilat mund të dilej prej batakut në të cilin kishte sharruar në vend se ta mbërthente me përrallat e madhësisë së perënduar dhe me dokrra të tjera, me të cilat kishte gojën plot e përplot dhe kujt nuk i hynin në punë...

- Kohët e vështira dhe gjendjet e vështira nuk duhet ta përjashtojnë të menduarit për madhësinë dhe vlerat e saj...Përkundrazi, përballimi i tyre nënkupton sfidën e ngritjes dhe ngjitjes së përhershme drejt majave edhe atëherë kur kjo duket e pamundur...

Megjithatë, gjatë kohës sa i ati ndodhej në rrugë e sipër për në Bllacë, ndërsa ai, i strukur sikur të mos ishte, priste të merrte udhën që pas pak do ta shpiente në Tetovë, ndërsa pas saj shumë shpejt do ta hedhte në ecejakeve të mundimshme gjithandej, ku për shtatëdhjetë e sa ditë do ta ndjejë vetëm refugjat në vend të vet, për t'iu kthyer në një metaforë që do t'ia zërë frymën madje edhe pas kthimit - kishte hetuar se në atë gjendje tejte të rëndë mund të ishte vetëm një të menduar i ngritjes, qoftë si fluturim a çkado qoftë, që do t'i ndihmonte paksa ta përballonte atë rrënim që nuk kishte besuar ndonjëherë se mund të ishte i tillë...

Në një sharrim të tillë të pandalshëm, në të cilin ishte gjendur kur i kishin përplasur në kamionin ushtarak dhe, pas kërcënimeve gjithfare, të përcjella me fyerje dhe nënçmime të pashembullta - u kishin thënë se, më në fund, mund ta harronin përgjithmonë Kosovën dhe pamjen e saj, ngaqë ajo nga ai çast, falë ndërhyrjes së NATO-s dhe mashtrimeve të perëndimorëve që t'i fusnin në kurrthet e tyre, bëhej tokë e përhershme serbe, tokë e shenjë e

tyre, siç kishte qenë dhe do të jetë, në ç'mënyrë kishin besuar se do të shuajnë përfundimisht çdo shpresë për t'u kthyer, ngase, në rrethana të tilla, përballë atij zhvlerësimi të tmerrshëm këto fjalë kishin diçka fataliste në gjykimin e tyre - Vëllaznim Prishtina i ishte dhënë të menduarit të ngritjes dhe të lartësimit, jo ndryshe, por me anën e përfytyrimit të një fluturimi, që i kishte ardhur si një urdhër i brendshëm shpirti a diçka e ngjashme, me të cilën sikur i bëhej me dije se kthesat e mëdha ndodhin kur preket fundi, kur nuk mund të sharrohet më poshtë, por lypset provuar të kundërtën – ngjitjen përpjetë, me kusht që të hetohet, po edhe të kuptohet fuqia e brendshme e shpirtit, ajo e strukura në thellësi të pahetueshme që, si rrezatim hyjnor është në gjendje të shpërthejë furishëm atëherë kur nuk pritet...

- Kthesave epokale u duhet vetëm vetëdija për ndryshime epokale dhe përkushtimi ndaj tyre e jo frika e robit të përjetshëm...

Në atë intervistë ai vazhdonte të sqaronte se para një gjendjeje të ngjashme, e cila mund dhe duhet të vlerësohet si çështje të rrosh apo të mos rrosh, ndodhej edhe Perandoria Osmane, porse ndodhej edhe Perandoria e Habsburgëve dhe madje edhe rajhu gjerman, i cili, ndonëse për nga mosha i ri, me mbretëritë dhe principatat që për qindra vjet ishin bartëse të trashëgimisë së Perandorisë së shenjtë të Romës, po ashtu ka nevojë për atë lëvizjen drejt krijimit të bashkimit të brendshëm, pa të cilin nuk mund të ketë zhvillim...

- Perandoria Osmane ka më së shumti arsye që dridhjet rrënuese që e tërheqin mbrapa dhe kërcënojnë ta përmbysin në një greminë të përhershme, t'i kthejë në lëvizje çliruese drejt një piramide të re, me anën e së cilës gjithë ajo energji, e cila duket se ndjek kahun e shthurjes së pandalshme me prirje të rrezikshme, të mbikëqyret dhe të përdoret për ngritje, me çka ankthi i përplasjes dhe i humbjes prapësohet nga qëllimi i një ngjitjeje të pandalshme, i cili si qëllim mund ta ketë arritjen e perandorisë së më të mirës, jashtë kthetrave të librave të mbyllur dhe atyre që botës ia kanë vënë kufijtë e ndarjeve me anën e gjakut dhe të kryqëzatave të pandalshme, peng i të cilave kishte mbetur...

Më tutje, Vëllaznimi kishte lexuar se aty arsyetohej edhe ai koncepti i arritjes së perandorisë së më të mirës, si një pajtim i ri botëror, që mbështetet mbi njohuritë mendore dhe shpirtërore të antikës dhe të filozofisë së saj, ku garës së religjioneve dhe ndasive që dalin prej tyre, do t'ua zërë vendin gara e filozofisë dhe e artit të lirë, që paraqet themelet e një shoqërie të çliruar dhe demokratike, ku religjioni përjashtohet nga çështjet shtetërore dhe mbetet vetëm çështje e besimit personal për t'u ushtruar sipas dëshirës dhe privatisht, pikërisht siç e kishin parë edhe ata që do ta inspirojnë Revolucionin Borgjez Francez që, në saje të mësimave nga filozofët e hershëm, po edhe nga ata që do të ndërliken me antikën dhe vlerat e saj të përhershme, si Hegeli, Kanti dhe të tjerë, njëherë e përgjithmonë do t'ia hapin derën mendimit të lirë dhe të arsyeshëm, në ç'mënyrë njeriu kupton se nuk është objekt, por subjekt i pakapërcyeshëm, i cili duhet të jetë në qendër të vëmendjes të të gjithave...

Në fund të bisedës, Gjyshi i Madh bënte të ditur se vetëm Turqia europiane, mbi ngrehinat e antikës dhe të madhështisë së saj, gjurmët e së cilës edhe sot e gjithë ditën ruan ajo hapësirë, pra një vend i reformuar dhe me frymën e shtetit sekular, do të jetë në gjendje ta mbrojë qytetërimin botëror, e në veçanti atë perëndimor, nga keqpërdorimet që mund t'i bëhen nga idetë e luftës së qytetërimeve dhe të tjerat që i duhen ndarjes dhe ndarjeve, pa të cilat sikur nuk mund të jetohej...

Theksimi i Turqisë europiane, si qendër e qytetërimit të mirëfilltë perëndimor, me gjurmët shpirtërore të Trojës, si dhe ato të Romës dhe të Bizantit në të, (pa ato ngarkesat e gjata të mbisundimit të dinastive tartaro-mongole të selçukëve dhe të tjerëve, që i quante të huaja dhe asaj për shekuj ishin munduar t'ia thadronin despotizmin e botës së stepeve, por që kësaj nuk ia kishin dalë në saje të ndërhyrjes së atyre që e kishin drejtuar dhe kishin ruajtur frymën perëndimore), do të arsyetohet me antikën dhe trashëgiminë e saj, ku bota pellazge, me degëzimin iliro-helen, thuhet se është e vetmja që mundëson heqjen e kufirit të botës dhe atë të ndarjes që i është vënë dhe vazhdon të prodhojë fatkeqësi, ku çdo gjë do t'u nënshtrohet hapësirave dhe garës së madhe dhe të pandalshme për pushtimin e tyre me vlera të reja

gjithënjerezore dhe gjithëkohore, pikërisht ashtu siç ishin parë dhe përfytyruar nga filozofët e saj të mëdhenj gjithëkohorë dhe gjithënjerezorë, të cilët për më shumë se pesëmbëdhjetë shekuj ishin përjashtuar me dhunë nga kujtesa e njerëzimit, por për fat të mirë, prapë ishin kthyer aty ku e kishin vendin dhe ku duhej të mbeteshin përgjithmonë...

Shikuar nga kjo pikëpamje, kur do të pyetet si e shesh zgjidhjen e atyre që quhen “ulcera ballkanike”, të mbetura në atë pjesën e trupit që nuk është as perëndim e as lindje, por njëherësh një përzierje e pandashme perëndim-lindje, ai do të përgjigjet se edhe ai që quhet kufi i ndarjes së qytetërimeve dhe me të padrejtë shihet si i tillë, pikërisht në këto hapësira ka gjasat më të mira të tregohet i paqëndrueshëm dhe i përbalueshëm fare në saje të bashkëjetesës së të kundërtave dhe frymës së mirëkuptimit të ndërsjellë, që është çështje jetësore dhe assesi ndryshe, sepse mbështetet mbi atë që është trashëguar nga shpirti antik dhe ndriçimi i tij, i cili ka rrezatuar edhe atëherë kur ka qenë i nxitur për të kundërtën...

Nga ky këndvështrim ai do të shohë edhe rolin e botës shqiptare, që do ta quajë “pjesë të lashtësisë antike” dhe këtë do ta lidhë me besimin se vjen si trashëgimi e botës pellazge, nga do ta shohë atë degëzimin e njohur iliro-helen, ku shqiptarët dhe grekët kanë të drejtë të quhen vëllezër dhe se pranimi i kësaj vëllazërie paraqet parakushtin më të rëndësishëm që në këtë hapësirë - ku ka filluar kujtesa historike e njerëzimit dhe gjurmët e para të rendit shtetëror, bashkë me ato që i duhen jetësimit të tij - të rivendoset harmonia e dikurshme, e cila do t’u shërbejë lidhjeve të atilla midis popujve, me anën e të cilave do të flaken ngatërresat dhe luftërat shekullore...

- Ballkanasve u duhet hapësira e dikurshme e perandorisë së më të mirës, ku do të zhvillohet gara e ngritjes dhe e ngjitjes, e jo mbylljet me ato kufizime besimesh të ndryshme dhe me urdhra të tyre, që edhe sot e gjithë ditën nxisin ndasi dhe gjakderdhje të reja...

Këtë, madje, do ta arsyetojë duke pohuar se “ata shumë shpejt bëhen perandorë në rrethana perandorake dhe kthehen në vrasës të pashembullt kur u vihet rrethi i mbylljes...”

Kur pyetet, se cila ishte ajo hapësirë e perandorisë së më të mirës, e cila më shumë duket si sajim filozofik sesa realitet, ai do të thotë se ishte gjithë ajo që lidhet me rrënjët e qytetërimit pellazg, me degëzimin iliro-dardan, për të cilin, ndër të parët kishte luftuar Aleksandri i Madh dhe kishte treguar se është e mundshme, por që ai për të arritur këtë ishte mbështetur në mësimet e filozofëve, me të cilat ishte lidhur që nga fëmijëria...

- Hapësirat e pakufishme dhe lufta për jetësimin e tyre paraqesin themelet e perandorisë së më të mirës... Aty thyhen kufijtë e ndarjes dhe ngatërresat e librave të shenjtë, bashkë me fatkeqësitë e përhershme, që edhe krijuesin dhe të fshehtën e krijimit, bashkë me të drejtën e të menduarit për të, e shfrytëzojnë për qëllime të tilla...

Që ta arsyetojë këtë të vërtetë si diçka thellësisht jetësore, së cilës madje nuk ka mundur t’ia ndryshojë kahun as ajo që më vonë do të shfaqet si garë e librave të shenjtë për mbizotërim, ku nuk është kursyer as krijuesi që t’i vihet në shërbim njërit a tjetrit kryq, njërit a tjetrit libër, që ka përjashtuar tjetrin dhe këtë e ka bërë edhe me çmimin e madh dhe të përhershëm të gjakut që është derdhur - ai kishte sjellë shembullin e lidhjes së asnjënësve tek Ura e Shenjtë, e bërë në shekullin e katërt, pasi perandori i Bizantit Anastas ta ketë shpallur ndarjen administrative të perandorisë në dy pjesë, në atë të Lindjes me qendër Kostandinopojën dhe atë të Perëndimit me qendër Romën, me çka trashëgimia e sundimit, që u kishte lënë të bijve, njëkohësisht kishte paraqitur edhe fërkimet e para midis kishës së Lindjes dhe asaj të Perëndimit, e cila, nuk kishte vonuar dhe ishte kthyer në një ndarje të papajtueshme midis ritit ortodoks, në njërën anë dhe atij katolik, në anën tjetër, me çka lufta e përgjakshme për pushtet përherë kishte marrë bekimin e njërit a tjetrit kryq. Me këtë rast, thuhej se shpallja e lidhjes së asnjënësve tek Ura e Shenjtë kishte paraqitur përpjekjen e parë në historinë e përgjakshme të ndarjes së kishës për pajtim, që shekuj më vonë ajo do të përsëritet me ekumenizmin.

Krahas kësaj përpjekjeje për pajtim të brendshëm, që koha e kishte rikthyer në vendin e vet, por pas shumë e shumë luftërash dhe viktimash, zihet ngoje edhe çështja e

bashkëjetesës së besimeve në të njëjtën hapësirë, me ç’rast edhe Bibla e edhe Kurani kishin gjetur vend në të njëjtën familje, ku njëri vëlla kishte kthyer në kishë e tjetri në xhami, e njësoj kishte ndodhur edhe me kushërinj, me bashkësi vëllazërore, bile edhe me fiset. Pra, ndryshe nga vendet ku librat rëndom përjashtoheshin dhe mbi atë kundërshti ishte ndërtuar edhe kufiri i ndarjes bashkë me ato përçarjet që kishin çuar deri edhe te luftërat në emër të njërit a tjetrit besim, në atë hapësirë kjo nuk kishte ndodhur, por e gjitha ishte pranuar dhe parë nga pikëpamja që edhe fryma e librave të shenjtë dhe porositë e tyre të kuptoheshin si pjesë e asaj shumëllojshmërie të të shprehurit, që nuk mund të shpjegohet ndryshe përpos me mbetjet e vetëdijes antike dhe të atij ndriçimit të hapur hyjnor të besimit në krijimin si çështje e përgjithshme brendapërbrenda një tërësie të përbashkët dhe pa kufizime në ngritje, që ishte rast i veçantë, e që jo rrallë kjo dukuri ishte provuar të anashkalohej, të fshihej, madje edhe të anatemohej me gjoja prirjet gjenetike barbare, që, si të tilla, nuk është në gjendje t’i zbusë asnjë qytetërim...

- Aty ku nuk ka luftëra fetare nuk mund të ketë indoktrinim fetar e as frikë të përfshirjes në luftën e qytetërimeve...

I kujtohej se një bisedë të ngjashme kishte pasur edhe me të atin në prag të jubileut të gjashtëqindvjetorit të Luftës së Kosovës, që propaganda e Beogradit dhe kisha ortodokse serbe tashmë kishin filluar ta kthenin në një fushatë për indoktrinim të paparë deri atëherë, duke armatosur qytetarët e vet me urrejtje, shovinizëm dhe kinse luftën e imponuar, në ç’mënyrë masat e gjera ishin futur në një atmosferë lufte, që nuk do të vonojë dhe, me anën e kryengritjeve të armatosura të serbëve për territoret etnike në Knin dhe më vonë në Bosnjë dhe Hercegovinë, që drejtoheshin nga Beogradi dhe soldateska e saj tashmë e përgatitur për mësymje të tilla, do të fillojë ajo lufta për rrënimin e trashëgimisë së AVNOJ-it që, në përputhje me idenë e asaj që ishte paraparë si mbetje e Jugosllavisë (prej saj do të përjashtohej Sllovenia – madje kjo do të bëhej vullnetarisht si një koncesion për Perëndimin, rrugën e së cilës pastaj mund ta ndiqte edhe Kroacia e cunuar dhe jashtë linjës Vukovar-Karlobag-Benkoc), por me Bosnjën e Hercegovinën, Maqedoninë dhe Kosovën pa shqiptarë që, edhe po të detyrohej të mbante diçka prej tyre për ta dëshmuar gjoja “multietnicitetin”, atëherë do të ishin, të shumtën, njëqind mijë sish, “të zgjedhur”, kryesisht të paarsimuar nga zonat e thella malore që, si të stërkequr, shpejt do të deklaroheshin turq, myslimanë, goranë dhe çfarë t’u kërkohet, ose do të shpërnguleheshin në vende të ndryshme.

Ndërkohë që i ati i kishte folur me shqetësim se e gjithë ajo orgji që bëhej në Kosovë nuk ishte pjesë e kujtesës historike, e as e shënimit të një jubileu të përvetësuar njëanshëm nga serbët, porse ogur lufte, që ishte në rrugë e sipër për t’u bërë kërdua, ai natyrisht ishte munduar që atë ta shihte “pjesë të mbetjeve të ngarkesave religjioze-primitive”, me të cilat bota ortodokse ishte plot e përplot dhe sikur i kishin kaluar në rituale të brendshme që ta kthenin energjinë e humbur dhe atë që sjell frika nga “vdekja e bardhë”.

- Gazimestani është kthyer në një shesh senilësh të mjerë... A nuk është kjo për keqardhje...?

- Të tillët nuk kërkojnë fajin te vetvetja, por tek të tjerët... Ata janë shumë të rrezikshëm...

- Duken edhe më anakronikë me atë temjanin që përhapin dhe lutjet për shenjtërit, me të cilët vetëmashtrohen...

- Nuk është çështje e vetëmashtrimit, as e ngushëllimit, por e thirrjes për hakmarrje dhe për gjak, që bëhet në emër të shpirttrave mesjetarë...

- Sikur ngushëllohen me ta...?

- Nuk është punë ngushëllimi, por e thirrjes për luftë...

I ati ia kishte bërë me dije se ngjashëm ishte vepruar edhe në prag të fatkeqësive të tjera, siç kishin qenë ato të viteve një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë - shtatëdhjetë e tetë, kur dëbimit të popullatës shqiptare nga Kurshumlia dhe Prokupja i kishte paraprirë mesha e madhe e Krusheci, në të cilën ishte përhapur thirrja për gjoja kthimin e tokave të

shenjta mesjetare serbe në Kosovë, për t'u përsëritur njësoj edhe më vonë gjatë depërtimit të ushtrisë serbe në vjeshtën dhe dimrin e vitit një mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë – trembëdhjetë, kur forcat serbe dhe ato malazeze do të masakrojnë thuajse gjysmën e popullatës së Kosovës dhe të viseve të tjera të Maqedonisë, bile këtë do ta bënin me arsytimin se luftonin pushtuesit turq, që ua kishin marrë vendet e shenjta mesjetare dhe për shekuj të tërë ua kishin përdhosur keqas, ani pse kjo nuk ishte e vërtetë fare, kur dihej se ishin pikërisht serbët ata që, me ta humbur luftën e Kosovës, që e quanin të veten dhe kështu e përvetësonin një lidhje të krishterë ballkanike - ndër të parët kishin nxituar të përqafonin vasalitetin e Portës dhe nën flamurin e tyre të luftonin përpjekjet e të tjerëve kundër zgjerimit të tyre drejt qendrës së Europës së krishterë (siç ishin hungarezët, polakët dhe rumunët), pa ngurruar që kisha ortodokse t'ia dorëzonte autoqefalinë sulltanit dhe si shpërblim për këtë të marrë që të gjitha garancitë për të vepruar lirisht në hapësirën ku shtrihej dhe atje madje të ngarkohej edhe me vjeljen e taksave, një pjesë të të cilave e kishte shfrytëzuar për ngritjen e manastireve të reja...

Me këtë rast ia kishte përkujtuar edhe atë historinë e të motrës së Lazarit të vrrarë në fushë të Kosovës, Milicës, dhe të birit, Stefanit, kur, pasi i biri kishte pranuar humbjen dhe ishte kthyer në vazal të Portës, sipas zakoneve të vasalitetit, ia kishte dhuruar hallën, Milicën, sulltanit, të cilën ai e kishte dërguar në harem të vet, por që prej andej, në sajë të shkathtësisë dhe intrigave, ia kishte dalë t'i afrohej sulltanit dhe madje të bëhej njëra ndër gratë e tij, në ç'mënyrë do të marrë përsipër edhe drejtimin e çështjeve fetare në gjithë perandorinë, me ç'rast kisha ortodokse, jo vetëm që nuk ishte dëmtuar, siç dëgjohet të thuhet, por ajo kishte fituar pushtet, të cilin ajo e kishte shfrytëzuar për zgjerimin e mëtejshëm të ndikimit të pushtetit të kishës ortodokse dhe kjo ishte bërë në sajë të njësive të jeniçerëve, të rekrutuar nga vendet sllave, të cilët vazhdimisht ishin dërguar të luftonin në Europën Qendrore kundër vendeve katolike, gjë që kjo paraqet atë aleancën e pashpallur midis osmanëve dhe ortodoksëve kundër katolicizmit, e cila jo vetëm që kishte funksionuar, por në planin shoqëror dhe politik kishte paraqitur atë lidhjen e veçantë osmane-ortodokse kundër Perëndimit, që mbetet hallkë e rëndësishme e prapaskenave kundër qytetërimit europian, ani pse propaganda e Beogradit është munduar që Luftën e Kosovës dhe gjithë atë që ka ndodhur gjatë pesëqind vjetëve të shtrirjes së Perandorisë Osmane në Ballkan ta paraqesë si pjesë të misionit të krishterë...

Pasi e kishte bërë me dije se serbët gënjeshtren e konsiderojnë virtyt nacional, bile këtë nuk e fshehin fare, i ati i kishte thënë se mbi këtë parim edhe ishte përgatitur ajo ploja e gjakut që do të ushtrohet kundër shqiptarëve dhe boshnjakëve në emër të këtij misionarizmi, nga ana e armatës serbe, që kishte depërtuar në drejtim të tokave shqiptare. Mediave perëndimore, të cilat do të mund të ngrihnin zërin, që më parë u ishin përgatitur fotografi dëshmimi për kinse gjendjen e mjerë të popullatës serbe dhe të monumenteve të tyre fetare në Kosovë, ku ishin paraqitur kishat e rrënuara ortodokse, varret e përdhosura dhe gjithçka tjetër që konsiderohej e shenjtë për ta... Reporterët e luftës nuk kishin ngurruar të përhapnin gënjeshttrat e tilla, gjoja se edhe një pjesë e “arnautëve të besimit katolik”, por edhe mysliman të viseve veriore kishin përsëritur ushtrinë serbe si çlirimtare dhe madje, në disa raste, edhe i ishin bashkuar luftës së tyre...

Kur kishte depërtuar nga Shkupi për në Kaçanik dhe tutje për në Ferizaj, gjenerali famëkeq Janković, me një thirrje të shkruar në gjuhën shqipe, me shkronja cirilike, të shpërndarë si qarkore, u kishte bërë thirrje shqiptarëve që ushtrinë serbe ta prisnin si mike, që luftonte edhe për lirinë e tyre, që thoshte se do ta gëzojnë bashkë me të tjerët, që kishin vuajtur aq shumë nën thundrën e pushtuesit turk, ndërkohë që njësitë çetnike, në kalim e sipër, kishin masakruar pamëshirshëm këdo që kishin takuar...

- Peshkopët ortodoksë përherë e kanë gojën plot me fjalë për paqen e zotit, por ajo paqe, sipas tyre, nuk vlen për të tjerët. Përkundrazi, ajo nënkupton zhdukjen e atyre që “pengojnë paqen ortodokse serbe”, ose “shqetësojnë paqen ortodokse serbe”, andaj nuk

mbetet tjetër përpos që “për paqen ortodokse serbe dhe mbrojtjen e saj në përputhje me përmasat e shtrirjes, siç shihej prej tyre, të përdoren të gjitha mjetet...”

Vëllaznimit, i cili deri atëherë nuk ua kishte vënë gjithaq veshin atyre që mund të dëgjoheshin të fliteshin rreth tolerancës fetare tek shqiptarët dhe që, ajo që kishte lexuar në romanin “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit” mund të dëshmohej jo fort larg Prishtinës, në drejtim të malësisë së Vitisë, po edhe në rrethin e Gjakovës, ku buzë Drinit dhe Erenikut kishte katunde të tëra me familje që i besonin kishës po edhe xhamisë dhe të dyjave bashkë, siç ishin laramanët, që shfaqeshin edhe me emra dhe mbiemra të përzier dhe kjo merrej si diçka e natyrshme - megjithatë nuk i ishte mbushur mendja se Gazimestani paraqiste bekimin e fundit që asaj lufte i duhej nga peshkopët, politikanët, por edhe nga intelektualët serbë, të cilët kishin vërshtuar aty dhe bashkërisht kishin kënduar himnin “Bozhje pravde”, pikërisht atë, i cili, më vonë, në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë do të përcjellë ngado ato të kremte të fitoreve të përgjakura, me anën e të cilave ushtarakët dhe peshkopët serbë bashkërisht do të ruajnë betimin e spastrimeve etnike “të tokave serbe” nga të tjerët, që quheshin pushtues, ku nuk do të mungojnë edhe ato masakrat e tmerrshme (e Srebrenicës, Zhepës dhe shumë të tjera), që do të tmerrojnë botën me skena të atilla që ishin përjetuar gjatë Luftës së Dytë Botërore nëpër kampet e përqendrimit anembanë Europës.

Më vonë, kur ishte në atë rrugën për në Tetovë, që do ta shpinte tutje-tehu, ku do të ndjehej si refugjat në vend të vet, ndërsa i ati do të përfundojë në Bllacë dhe nga andej do t’i humbin gjurmët, por si do të shihet pak më vonë, do t’i mbesin të hapura ato porositë që do t’i hedhë në internet në formën e një kodi të hapur për të ushqyer me porosi dhe ndihmesa ata që do të merren me studimet e lashtësisë, pra, në atë bredhje prej shtatëdhjetë ditësh do të merret edhe me atë që i ati, gjatë po asaj bisede, kur në ekranin televiziv kishin parë tubimin e Gazimestanit, i kishte thënë rreth librave të shenjtë që shfrytëzohen për ngjalljen e urrejtjes, prapa së cilës pastaj vjen edhe ai që do të quhet libër i vrasjes, me të cilat libraritë serbe ishin plot e përplot, jo vetëm tash, por ngaherë, qysh kur kishte filluar ajo koha e krizës lindore dhe nga Rusia kishin marrë shënjën se duhej të luftonin me penë dhe me shpatë për “të vërtetën ortodokse në Ballkan dhe fuqinë e saj që bashkon sllavët e jugut”.

Kur i kishte folur rreth librit të vrasjes, kishte zënë ngoje programin nacional serb të Garashaninit, të shpallur në “Naçertanje” në gjysmën e shekullit nëntëmbëdhjetë, për të shkuar pastaj te memorandumet e akademikëve serbë, që nga ai i pari, i vitit një mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë, i hartuar nga Çubriloviqi, pastaj i dyti, i vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e katër, i rishkruar po nga i njëjti autor, që i ishte dorëzuar Titos, (ishte pranuar, meqë aty flitej për zhdukjen e gjermanëve të Banatit e hungarezët dhe për këtë duhej shfrytëzuar qëndrimin e tyre prej kuislingësh gjatë kohës së Rajhut të Tretë), po kishte zënë ngoje edhe atë të fundit, të vitit një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë, të iniciuar nga Qosiqi dhe elita intelektuale serbe nga Akademia Serbe e Shkencave dhe Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë nga “Francuska Shtatë”, që kishin marrë përsipër projektin rreth “rishpëtimit të popullit serb” nga rreziku që gjoja u vinte nga ajo që quhet “humbje e paqes në rrethanat e regjimit të Titos”, ku ai akuzohej se ka përdorur shqiptarët dhe natalitetin e tyre për t’i dobësuar serbët, e që pas vdekjes së tij duhet bërë çmos të korrigjoheshin padrejtësitë që i ishin bërë popullit serb dhe Serbisë si bartës të jugosllavizmit, pa të cilët nuk do të kishte as Jugosllavi e as aleancë të sllavëve të jugut, në saje të së cilës aleancë thuhej se ishin dëbuar pushtuesit osmanë nga Ballkani, me çka atyre u ishte rikthyer hapësira etnike e humbur prej pesëqind vjetësh, por që njëherësh kjo fitore duhej të merrej edhe si misionarizëm në dobi të rikthimit të krishterimit perëndimor në djepin e vet, kthim ky që vlerësohej i suksesshëm dhe i plotë vetëm me dëbimin e shqiptarëve “ardhacakë dhe të egjër” prej andej...

- Pa atë literaturë dhe ata libra plot mashtrime nuk do të ndodhte Gazimestani dhe të tjerat që u duhen orgjive të tilla të luftës - do t’i thotë i ati.

Vëllaznimi edhe më tutje nuk kishte dashur të besonte se aq shumë njerëz të tubuar në një vend të tillë mund të ishin të mashtruar dhe të gatshëm të vrisnin në emër të një mashtrimi

të tillë, siç i thoshte i ati. Vrasës mund të kishte midis tyre, si kudo tjetër, por që të gjithë të jenë vrasës, këtë nuk ia hante mendja...

- Një milion vrasës përballë një liturgjie...? Kjo është e pamundur... E pamundur...

Ndoshta, pse atëherë nuk ia priste mendja se diçka e tillë jo vetëm që nuk është e mundur, po as që mund të ndodhte në ato rrethana që edhe më tutje parullën shumëvjeçare të vëllazërim-bashkimit e shfrytëzonin si një mashtrim, nën rrogzin e të cilit, në emër të edukimit socialist dhe të përbashkësisë, ngjizej fryma e unitarizmit serb, që pak nga pak pushtonte çdo hapësirë dhe këtë e bënte duke u arsyetuar me kinse ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e federatës nga irredentizmi dhe secesionizmi, ku pas pesë-gjashtë vjetësh do të dalin në skenë edhe ato kërkesat për ndryshimet kushtetuese, me të cilat, në emër të kësaj barazie, Kosovës duhej t'i merrej autonomia që ia garantonte Kushtetuta e vitit një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër, me të cilën ajo praktikisht ishte barazuar në federatë me njësitë e tjera dhe kishte të drejtën e konsensusit, që një ditë do të mund të shfrytëzohej në përputhje me interesat më të gjëra të rirreshtimeve të mundshme në ato hapësira, por që edhe këto ndryshime thuhej se nuk preknin esencën e barazisë, përpos që atë e qartësonin në përbërje të asaj që quhej "Serbi e bashkuar dhe demokratike për të gjithë".

Por, diçka nga fuqia e librit të urrejtjes, që më vonë vret, dhe të librave që përnjëmend vrasin, rreth të cilit i fliste i ati, nuk do të vonojë dhe Vëllaznimi do të shohë pasi të ketë përfunduar ajo e kremtja luftënxitëse e Gazimestanit, kur pas marrjes së autonomisë me dhunë dhe gjakosjes që do të ndodhë nëpër rrugët e Prishtinës dhe të qyteteve të tjera të atyre që kishin protestuar kundër, do të fillojë ajo ndarja e parë dhe e përhershme në "miq dhe armiq", kur edhe puna, edhe shkollimi i mëtejshëm dhe thuajse çdo gjë tjetër do t'i nënshtrohet deklaramit të hapur me shkrim "për Serbinë unike", që për alternativë kishte përcaktimin për Kosovën e pavarur, në përputhje me atë deklarinim që më dy korrik do të bëhet nga deputetët e Parlamentit të Kosovës, por edhe me atë të shtatë shtatorit të Kushtetutës së Kaçanikut dhe të tjerat që do të pasojnë e që do të paraqesin kornizat e asaj që pastaj do të fillojë si jetë paralele, kur arsimi, që nga klasa e parë e deri tek universiteti do të zhvillohet nëpër shtëpitë private dhe në bodrume të errëta, pa kushte dhe përherë me peshën e represionit të aparatit policor-ushtarak...

Si edhe për të tjerët, edhe për Vëllaznimin, po atë vjeshtë, me regjistrimin në fakultetin e arkitekturës, do të fillojë "jeta paralele", të shumtën duke u sjellë nëpër bodrume, që do të vazhdojë për vite të tëra e rrudhur deri në zhvlerësim sa dikur t'ia krijojë ndjenjën e atij që dënimin nuk e kishte nga ai që ishte shkaktar i asaj gjendjeje, por nga ajo sjellja me të cilën me çdo kusht kërkohet durim dhe durimi në emër të diçkaje që gjithnjë më shumë sikur i mungonte arsytimi i duhur dhe ashtu, pak nga pak, i bëhej se kalonte në një vetëmashtrim, që edhe më i rëndë i vinte nga ato që i ati ia thoshte rreth atyre që ai i quante "dëshmi qytetëruese dhe shtetformuese", pa të cilat nuk mund të thyhen ato hipotekat e rënda që i ka ndërtuar Beogradi me propagandën e fuqishme të gënjeshtreve, e të tjera, që ndonjëherë i tingëllonin si dëshmi vetërobëruese dhe të ngjashme, po që do të marrin fund me atë bombën e parë, që natën e njëzet e katërt të atij marsi të ftohtë do të niset nga njëra prej bazave detare të NATO-s në Mesdhe dhe do të qëllojë caqet e armatës jugosllave në Kosovë dhe përreth saj deri në Beograd, me çka pas shtatëdhjetë e gjashtë ditësh të ndërhyrjes nga ajri, jeta paralele dhe ajo që me kohë do të marrë kahun e kundërvënies së armatosur, do t'ia lëshojë vendin kohës kalimtare, me shumë e shumë të panjohura dhe paqartësi të tjera...

Megjithatë, gjatë atyre bredhjeve shtatëdhjetëditësh nga Tetova deri në Tiranë dhe anasjelltas, gjithandej ku e kishte ndjerë veten refugjat në vend të vet, por edhe më vonë në Prishtinë, në kërkim të të atit, kur ishte ballafaquar me atë kohën jashtë jetës paralele dhe gjithë asaj që i kishte takuar, që mund të quhet edhe mentaliteti i bodrumeve dhe gjithçka që nuk i shkon normalitetit, për herë të parë kishte hetuar se edhe tek ai kishte zënë vend libri i urrejtjes, që mund të quhej edhe libër i luftës dhe, pse jo, edhe libër i vrasjes, kur është çështja

e mbrojtjes së dinjitetit dhe gjithë asaj që mund të quhet vetëmbrojtje e domosdoshme nga Bllaca dhe të tjerat, nëpër të cilat kishte kaluar...

Përshtypja e vrasësit do t'i sillej në kokë edhe më tutje dhe druante se ajo do t'i kthehej në përndjekje të përhershme mendjeje, me të cilën mund edhe të mos pajtohej, por prej mbërthimit të saj sikur nuk kishte shpëtim po të mos ua kishte lëshuar sytë edhe një herë letrave që ia kishte lënë holandezja, ku ishte ajo intervista e Gjyshit të Madh dhënë gazetës së Berlinit.

Aty, sytë ia zunë pjesën përmbyllëse, ku flitej për hapësirat dhe perandorët dhe për rrethin e mbylljes me vrasësit e pashmangshëm...

V

- Rrethi i mbylljes të vret, ose të kthen në vrasës...

Këto fjalë ia kishte thënë holandezes Helga Krojf kur kishin biseduar rreth intervistës së Gjyshit të Madh dhënë gazetës gjermane, ku bënte me dije se shpëtimin duhej kërkuar te vetëdija e arritjes së perandorisë së më të mirës, ndërkohë që ai kishte krijuar bindjen se në mungesë të përmbushjes së saj dhe për arsye që ishin tri mashtrimet që me çdo kusht duhej lënë pas, duhej ikur sa më larg dhe sa më parë, me çka ajo do të pajtohej se ato, nëpër të cilat ishte kaluar, paraqitnin diçka të rëndësishme, që kërkonin qetësi të plotë në mënyrë që riballafaqimi me vetveten dhe përpunimi i të gjithave të shkonte sa më thellë, por do të kërkojë të kalonte tremuajshi i marrëveshjes që kishte me ndërkombëtarët dhe pastaj atë kohën e nevojshme ta gjenin në kërkim të qytetërimeve të harruara dhe të rrënuara, që largimi, pa marrë parasysh sa do të zgjasë, të paraqiste njëfarë zhdëmtimi të atyre që nuk ktheheshin më...

Por, cilat ishin ato tri mashtrimet, që Vëllaznim Prishtinës do t'ia krijojnë bindjen se e kishin kthyer në një qenie që kujtonte se nuk kishte as të djeshme, as të sotme, porse nuk mund të kishte as të nesërme jashtë të kaluarës që paraqet ardhmëri, të cilën mund ta fitonte vetëm shpirtërisht, me anën e asaj kujtese poetike, me të cilën i krijohej baraspesha nismës së të atit rreth Dardanisë si kujtesë historike me rrënjët e thella në antikë, ku ai shihte pikënisjen e të gjithave...

Gjatë bisedës që kishte pasur me holandezen Helga Krojf në dhomën që ajo mbante në hotel "Grand", kur pas takimit të tretë me radhë (dy në kafenenë përballë ndërtesës së administratës së ndërkombëtarëve dhe njërit në orët e vona të natës në Gërmë, kur thuajse spontanisht kishin shkëmbyer të puthurat e para, me çka do të fillojë ajo lidhja e tyre e përhershme), ishte mundur që në pika të shkurtra t'i pikaste ato që i shihte si mashtrime, që i kishte quajtur jetësore dhe i kishin ndihmuar ta fitonte atë përshtypjen e refugjatit të përhershëm në vend të vet, jo vetëm gjatë kohës së ndërhyrjes së ndërkombëtarëve nga ajri, sa ndodhej në Tetovë, Gostivar, Strugë, po edhe në Tiranë e në vende të tjera të Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme, gjithandej ku shtriheshin ato qendrat e vendosjes së të shpërngulurve, por edhe kur bashkë me të tjerët që kishin vërshuar nga të gjitha anët, ishte kthyer në Prishtinë dhe kishte menduar se me vendosjen e asaj gjendjeje kalimtare fillonte një kapitull i ri jete, që duhej përshtatur, (kështu kishte ndodhur me shumicën, meqë ndryshimet e saj për shumëkënd kishin paraqitur një mundësi të madhe që t'i rikthehen jetës në forma të ndryshme, qofshin ato edhe me vështirësi), porse shumë shpejt kishte parë se kjo nuk do t'i shkojë ndoresh, ndonëse mund të thuhet se ajo kthesë kishte qenë ndër më të fortat, që mund të quhen historike dhe në përputhje me ato që i ati i shihte si të domosdoshme që ashtu përfundimisht mund t'i hapeshin udhët jetësimi të konceptit shtetformues, si një vazhdimësi e pandalshme qysh nga Lidhja e Prizrenit, Deklarata e dy korrikut e vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, Kuvendit të Kaçanikut pas tre muajsh, bashkë me ato që do t'i paraprijnë referendumit gjithëpopullor që do të mbahet një vit më vonë dhe me të do të mbyllet një periudhë e rëndësishme e atij

koncepti të pavarësisë, me kusht që e gjitha të përfundonte, së pari me shporrjen përfundimtare të Serbisë dhe të miteve të saj nga kjo hapësirë, e që nënkuptonte edhe përfundimin e sovranitetit të shtetit serb mbi këtë pjesë, të vendosur dhunshëm gjatë pushtimit ushtarak në vitin një mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë e tutje, që për dy herë ishte ndërprerë për pak kohë (pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore) dhe sërish ishte rivendosur me gjak në saje të fitores së të majtës në Shqipëri dhe Jugosllavi dhe përfitimit nga koniunktura ndërkombëtare që Beogradin e kishin ruajtur si faktor të rëndësishëm rajonal...

Pra, mashtrimi i parë, që do ta përcjellë si hije dhe nuk do t'i ndahet dot, ishte ai që lidhej me kohën e fëmijërisë dhe të rinisë, që quhej vëllazërim-bashkim dhe kapte njëzet vjet të jetës, që ishte dashur ta kishte vulën e asaj që quhej edukim në frymën e socializmit vetëqeverisës jugosllav, ani pse kjo e fundit përherë ishte munduar që disi të anashkalohej, ose të thuhej me gjysmë goje nga shkak se ngarkohej me parashikimet e asaj shkrirjeje të pashmangshme të nacionales tek ajo që shfaqej si mbinacionale dhe dukej se mund ta prekte edhe atë pjesë të identitetit që thuhej se shquante secilin komb dhe kombësi në përbërje të asaj që merrej si përbashkësi dhe theksohej se paraqiste pasuri të përgjithshme, që një poet i realizmit socialist i ditëve të para, (për fat të paktë me përcaktime të tilla që i ndihmonin të ruante trajtimin e volitshëm të shkrimtarit të sistemit), e kishte quajtur “kopsht me lule shumëgjyrëshe...”

Mashtrimi i dytë përfshinte kohën e jetës paralele nëpër bodrume, gjatë ushtrimit të asaj dhune të egër, me ato që thuhej se i duheshin atij vetëdëshmimi qytetërues dhe shtetformues dhe gjendjes që prania e Serbisë në Kosovë të rrudhej vetëm në përmasat e pushtuesit të thjeshtë, gjë kjo që do ta ndërkombëtarizonte gjithë çështjen dhe një ditë do ta sillte në agjendën e faktorit të vendosjes, që pastaj, me atë ndarje të ashpër dhe shpërputhje në taborë që ishin quajtur të papajtuësishëm dhe me qëndrime të ndryshme, ishte kthyer në një konflikt të hapur midis dy popujve, i cili ishte shtrirë deri atje, sa Beogradi, një ditë, atë luftën me hove të vogla - të filluar para shumë vjetësh dhe të paraparë për ta zbratur Kosovën heshtazi, kur kishte parë se nuk po i sillte frytet e parapara, por po i kthehej si bumerang - ta kthente në një fushatë të madhe të armatosur policore - ushtarake, që për qëllim kishte spastrimet përfundimtare etnike dhe gjenocidin ndaj popullatës së pambrojtur, kur, si shumë e shumë të tjerë, edhe ai përkohësisht e kishte humbur atdheun dhe mbase do ta humbte përgjithmonë po të mos ishte ndërhyrja e NATO-s nga ajri...

Mashtrimi i tretë kishte të bënte pikërisht me atë vendosjen e gjendjes kalimtare dhe me rrethanat e përkohshme, të cilave jo vetëm që nuk ia kishte dalë t'u përshtatej, por me ato që kishin sjellë, i kishin krijuar përshtypjen përfundimtare se, nëse mashtrimi i parë dhe i dyti e kishin bërë që të ndjehet njeri pa të kaluar, ky i fundit sikur e linte pa të tashme dhe pa të ardhshme fare, nga shkak i vetëm se qenia e tij nuk matej dhe nuk përcaktohej më nga ato ndryshime shoqërore dhe politike të jashtme, por nga qëndrimi vetjak ndaj të gjitha çështjeve, përfshirë këtu edhe ato që deri dje ishin parësore dhe që edhe ato kërkonin përshtatjen dhe sjelljen në një hapësirë që shfaqej e shkëputur...

Meqë kishte lindur në verën e vitit një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë dhe gjatë fëmijërisë kishte kaluar nëpër një mirëqenie të ndjeshme materiale familjare, por edhe nëpër atë shoqërore në përgjithësi, që pas ndryshimeve kushtetuese të viteve që do të pasojnë, shënonte ngritje të përgjithshme, fillimisht ato që ishin thënë në çerdhe të fëmijëve rreth vëllazërim-bashkimit, por edhe më vonë në shkollën “Hasan Prishtina”, që nga klasa e parë dhe deri tek e katërta e fillores, (aty për herë të parë kishte parë bustin e atij që në familje e quanin Gjyshi i Madh, me ç'rast mësuesja i kishte thënë se me të krenoheshin që të gjithë), i kishte marrë si pjesë të asaj përbashkësie, që nënkuptonte jetën e barabartë edhe me të tjerët, pra me serbët, malazeztë, po edhe me turqit dhe romët, por që e gjitha e kësaj nënkuptonte marrëveshjen e mirëkuptimit dhe të asaj që thuhej se duhej të paraqiste themelet e njohjes së ndërsjellë, që fillonte me mësimin e gjuhës serbokroate, që nga klasa e katërt e tutje, si lëndë e

detyrueshme, e që më vonë njësoj vlente edhe për mësimin e gjuhës shqipe nga serbët dhe të tjerët.

Natyrisht se nuk ishte vetëm shkolla ajo që me anën e plan-programeve mësimore dhe të mjeteve të tjera të saj mbëltonte atë që quhej vetëdije e vëllazërim-bashkimit, që megjithatë në komunikimin e ndërsjellë të përditshëm në rrugë dhe gjetiu, përherë gjuhës serbokroate ia ruante dominimin dhe rrallë ndodhte që serbi t'i drejtohej shqiptarit në gjuhën shqipe pse ai ishte shumicë, ose shqiptari ta përdorte këtë të drejtë në raport me të tjerët kur bashkëbiseduesit vërtet ndodheshin në shumicë (edhe pse me ligj gjuhët ishin të barabarta në komunikim edhe në përdorim zyrtar të tyre, siç ishin edhe simbolet kombëtare, ku krahas flamurit shtetëror dhe atij partiak vihej barabar edhe flamuri shqiptar), por ishte edhe komunikimi i përbashkët me të tjerët në hapësirat jugosllave (nëpër ato gjashtë republika dhe dy krahina të barabarta të federatës), ku ajo gjuhë dilte si parësore, pa marrë parasysh se në të gjitha institucionet e federatës, me përjashtim të armatës, (në parlament, në gjykata dhe forume të tjera, deri edhe piramidale të vendit) kudo garantohej dhe ushtrohej përkthimi i atypëratyshëm dhe secili mund ta përdorte gjuhën e vet, pa kurrfarë pengesash, gjë që njësoj vlente edhe për dokumentet zyrtare, të identitetit personal dhe formalitete të tjera administrative që ishin të shkruara në të gjitha gjuhët, ku edhe shqipja shfaqej e barabartë, ndërsa në Kosovë parësore mdje.

Përballë këtyre rrethanave, si fëmijë i qytetit, që mund të thuhej se kishte një standard jetësor të familjeve që quheshin elitë intelektuale dhe me shumë gjëra kishin filluar të barazoheshin me të ngjashmet në vend, (i ati jurist, sekretar i parë i Kryesisë së Kosovës dhe më vonë ligjërues në Fakultetin Juridik, ndërsa e ama mjeke e fëmijëve në Qendrën Mjekësore të qytetit), nuk kishte pasur kurrfarë arsyeje të dyshonte se prapa fasadës së vëllazërim-bashkimit, siç do të dëgjojë më vonë, kishte pasur edhe pakënaqësi dhe vlerësime të tjera madje, të cilat do të thuheshin haptazi në demonstratat e pranverës së vitit një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një, kur do të kërkohej statusi i republikës për Kosovën, me çka ajo do të barazohej me njësitë e tjera në federatë.

Madje, kur kishin filluar demonstratat e marsit, i kujtohej si nga dritarja e klasës, që shikonte në rrugë, kishte parë depërtimin e njërive të policisë që shkonin në drejtim të Shtëpisë së Studentëve, nga më vonë kishte dëgjuar edhe ato të shtënat e para, ndërsa arsimtari kujdestar, me njëfarë druajtje kishte thënë se po shprehej një kërkesë e drejtë që do të duhej të ishte paraqitur si kërkesë e ligjshme nëpër institucione, para se të dalë në rrugë dhe ndaj saj të përdoret forca policore...

Fjalët e arsimtarit kujdestar i kishin bërë përshtypje dhe i kishin mbetur në kokë, jo për tjetër, por vetëm për faktin se kishte thënë që nuk duhej të vinte puna për të ndërhyrë policia kundër demonstruesve, kur ajo kërkesë mund të zgjidhej në forumet më të larta të vendit. Ndërkohë që, sapo ishte kthyer në shtëpi dhe kishte takuar të amën, e cila gjithë brengosje i tregonte të atit se kishte pasur të plagosur, se në fillim u ishte dhënë ndihmë studentëve të plagosur, por më vonë kjo ishte penguar, ngaqë gjithë përkujdesja njëanshëm dhe "me arsyetime të paqarta sigurie" kishte kaluar në duart e ekipeve të tjera mjekësore që kishin ardhur nga Beogradi, bashkë me njësitë speciale, që kishin ushtruar dhunë brutale ndaj demonstruesve - të atin e kishte pyetur si me habi, se pse nuk ishte vepruar siç kishte thënë arsimtari...?

I kujtohej që i ati, i cili dukej i shkallmuar fare - ngaqë si ligjërues në fakultet gjatë gjithë kohës kishte qenë në atë pjesën ku ishte demonstruar dhe kishte bërë përpjekje që t'u ndihmohej studentëve t'i iknin disi dhunës brutale policore që ishte ushtruar ndaj tyre, çastin kur nga Beogradi ishin vënë në veprim njësitë speciale - e kishte marrë pranë dhe me duart që i dridheshin ia kishte ledhatuar flokët pa i thënë gjë dhe kjo kishte mjaftuar të hetonte diçka nga ajo që më vonë do ta kuptojë se ishte pikërisht një hallkë e hapur që kishte mbetur në vargjin e pabarazisë, e cila atë vëllazërim-bashkim që nga ajo ditë e kishte kthyer në një

mashttrim dhe që fundi i viteve tetëdhjetë, bashkë me ato zhvillimet që do t'u paraprijnë këtyre ngjarjeve, me ç'rast do të derdhet edhe gjak - këtë do ta dëshmojnë më së miri...

- Lufta për barazi është e gjatë dhe e mundimshme, por prej saj nuk duhet hequr dorë dot, sepse ajo kurdoherë mundëson ripushtimin e hapësirës së humbur jetësore dhe të asaj shtetërore.

Këto do t'i thotë i ati atë ditë, e këto do t'ia thotë edhe më vonë, kur do të fillojnë ato diferencimet e pandalshme ideore, që do t'ua hapin udhën diskriminimeve dhe burgimeve të shumta dhe do t'ia përsërisë vazhdimisht deri atë ditën e njëzet e tretë të marsit të vitit një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë, kur në Kuvendin e Kosovës do të votohej ajo kushtetuta e përgjakur, së cilës, ai bashkë me gjashtë deputetë do t'i thotë -jo, siç do t'i thotë jo ditë më parë edhe elita intelektuale e vendit me anën e Memorandumit 215, që kishte ngritur zërin nga të gjitha anët kundër atij ndryshimi të dhunshëm, duke e bartur deri tek institucionet më të larta ndërkombëtare; siç do t'i thonë jo me qindra e mijëra demonstrues nëpër rrugët e Prishtinës dhe të qyteteve të tjera të Kosovës, kur do t'u hidhen përpara tankeve të armatës jugosllave dhe prej plumbave të tyre do të vriten shumë e shumë të rinj - ndërkohë që po atë ditë kishte marrë vesh se një grup i revoltuar i serbëve vendas, që viteve të fundit ditë e natë kishin ngarendur qyteteve të Serbisë duke u qarë gjoja për diskreditimin që ua kishte sjellë Kushtetuta e shtatëdhjetë e katërshe, që më në fund e kishin rrënuar dhe Serbia për ta "ishte bërë një dhe e tërë" - e kishin sulmuar bustin e Gjyshit të Madh në oborrin e shkollës, emrin e të cilit e mbante dhe pasi e kishin rrënuar, ashtu të thyer e kishin hedhur pranë shportave të mbeturina, në kthesën e rrugës kryesore, në mënyrë që përdhosja të bëhej sa më publike dhe me të të paralajmërohej jo vetëm fundi i gjithë asaj që deri dje ishte shitur si fryt i barazisë dhe i vëllazërim-bashkimit, por edhe fillimi i një dhune të egër, që do të çojë deri tek ajo lufta e hapur, që për qëllim kishte spastrimin etnik dhe gjenocidin, i cili edhe do të ndodhte po të mos ishte ndërhyrja e ndërkombëtarëve, e cila me siguri nuk do të ndodhte po të mos ishin vitet e kundërvënies aktive, ndërsa më vonë edhe ngritja e saj në kundërvënie të armatosur ndaj dhunës së paparë...

Pak më vonë, kur do të fillojë largimi nga puna i gjithë atyre që nuk pranonin të nënshkruanin lojalitetin e pushtetit serb në Kosovë, me çka, në njërën anë do t'i vihen themelet apartheidit serb, si sjellje anakronike shtetërore dhe, në tjetrën anë, do t'i hapen udhët asaj që do të quhet jetë paralele, me institucione vendore që nga shkollat, përkujdesja shëndetësore, ndihma dhe solidariteti, e më vonë, me shpalljen e Deklaratës së dy korrikut, të Kushtetutës së Kaçanikut, referendumi për pavarësinë dhe pas zgjedhjeve të para të lira që, ndonëse zyrtarisht nuk ishin njohur, por kudo ishin nderuar dhe quajtur si dëshmi e rëndësishme civilizimi që i duheshin ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, kur do të formohej qeveria që do të kalojë në eksil, do të formohen edhe Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Punëve të Brendshme – i ati do të thotë se me këto vendime njëherë e përgjithmonë merрте fund koha e luftës për barazinë brendapërbrenda federatës jugosllave, që e kishin rrënuar serbët, pikërisht pse druanin, si thoshin ata, se do të pushtohej nga shqiptarët me anën e ekspansionit biologjik dhe gjithfarë parullash të tjera frikësuese që përhapnin - dhe fillonte koha e mundimshme e luftës për pavarësinë, e cila, sipas të atit, edhe më tutje duhej të bëhej nëpërmjet ruajtjes së institucioneve, pa marrë parasysh dobësitë dhe lëshimet që më vonë do të jenë të pranishme, ku thirrjet për durimin e pandalshëm, bashkë me ato premtimet se një ditë e gjitha do të shpaguhet si duhet, kishin filluar t'i tingëllonin si thirrje për nënshtrimin e pandalshëm, që mund të kthehej në një nënçmim të përhershëm dhe të tjera si këto, që do t'u shërbejnë dhe pikëpamjeve të kundërta dhe atyre kundërshtive të hapura me të atin, të cilat një ditë do të arrijnë deri aty sa të mos pajtoheshin, madje edhe të shiheshin në anë të kundërta, që po të mos ishte ai deportimi i ditës së tetë të ndërhyrjes nga ajri, kur forcat paramilitare i kishin nxjerrë me dhunë dhe i kishin drejtuar kah Shkupi, (i ati kishte përfundaur në Bllacë, ndërsa ai në Tetovë dhe tutje në Shqipëri), sigurisht se përgjithmonë do t'ia kthenin shpinën njëri-tjetrit si armiq...!

Natyrisht se ajo koha e luftës për pavarësinë, e cila kishte kaluar nëpër bodrume, fillimisht me atë kundërvënien paqësore - (më vonë kishin dalë në pah edhe opsione të tjera për kundërvënien aktive, e cila nënkuptonte edhe luftën e armatosur dhe të tjera, që i kishte marrë për të drejta dhe i kishte vlerësuar si vazhdim i politikës me mjete të tjera, pra me ato të luftës, me të cilat edhe ishte arsyetuar ajo ndërhyrja ndërkombëtare dhe të tjerat që do të sjellë ajo gjendja kalimtare me shumë paqartësi) - kishte paraqitur mashtrimin e dytë, jo pse kishte zgjatur pothuajse nëntë vjet, e as pse kishte qenë e thadruar me ato pakënaqësitë që kishin qenë gjithnjë më të mëdha dhe gjithnjë më të arsyeshme, nga mosveprimi me arsyetimin e durimit dhe ato të tjerat që thuheshin rreth jetës paralele - por pse ajo kishte lënë të ngulitur mentalitetin e bodrumeve, një gjendje trupi dhe shpirti, të ngjashme me atë të mbylljes nëpër rrrathë të shumtë, e cila, edhe kur ndodh të kapërcehet një ditë, atëherë kjo i ngjan një çrregullimi me pasoja, nga shkaku se mungon kriteri i vlerësimit të dallimit midis çlirimit dhe lirisë, midis të lejueshmes dhe të palejueshmes, midis të mundshmes dhe të pamundshmes dhe sjelljeve të tjera qytetëruese, aq të domosdoshme për një shoqëri që ta rikthejë drejtpeshimin e humbur shpirtëror dhe shoqëror që u nevojitet rifillimeve të vështira...

- Bodrumet, sikur paraqesin Gazimestanin tonë...?

- Mbase nuk kishte mundësi të tjera?

Me këto fjalë që do t'ia thotë holandezja Helga Krojf, kur ai do të bëjë atë pushimin e shkurtër, me të cilin sikur dëshironte edhe më tutje ta mbante të lidhur për shpjegimin e atyre që ai i quante mashtrime, që ajo më vonë do t'ia thotë se i merrte si përkufizime të caktuara kohore (kohë e vëllazërimit-bashkimit, kohë e vetëdëshmit me anën e jetës paralele dhe kohë e përkohshme kalimtare), që mund të përjashtoheshin, por assesi të shiheshin të shkëputura.

Dhe, pas shumë e shumë bisedimesh rreth tyre, sikur kishin arritur pajtimin që ato të quheshin *realitete*: ai i vëllazërimit-bashkimit, i jetës paralele dhe i kohës kalimtare.

Vëllaznimi ia kishte kthyer duke pohuar se as që kishte ndonjë dyshim rreth atij përcaktimi, i cili, sa më shumë që kalonte koha, i dukej gjithnjë më i drejtë dhe i domosdoshëm, që madje, në një pjesë të atij projektit poetik rreth Dardanisë si kujtesë poetike, që do t'ia mbetej preokupim i përhershëm dhe e kishte parë si një baraspeshë të projektit të të atit, ku prej tij Dardania shihej si themel i kujtesës historike me rrënjët në antikë, (bëhej përpjekje të zhvlerësohej Bllaca dhe ndodhja e saj), e kishte quajtur “kohë e pjekurisë shekullore”, por që ishin dilemat e (mos)përshtatjeve me realitetet, të cilat kishin nxjerrë në pah shpërputhje dhe shthurje tepër të ndryshme, të cilat atij ia kishin krijuar përshtypjen e qenies jashtë kohe dhe hapësire, sa të kërkojë që ta radhiste ndër të zhdukurit, që më vonë i kishte quajtur “shpirtërisht të dukshëm” dhe për të tillë ta merrte...

- Në kokën time janë ndërtuar vetëm pikëpamje të njëanshme, të cilat pengojnë çfarëdo përshtatjeje të dosidoshme... Më kot po mundohem për me i përballue...

Holandezja Helga Krojf ia kishte bërë me dije se ato ishin të natyrshme për rrethanat, nëpër të cilat kishte kaluar, por duhet shpresuar se me kalimin e kohës mund dhe duhet gjithsesi të përballohen...

- Ligjet e jetës mbështeten mbi ndryshimet e përhershme, e jo në të kundërtën e tyre...

Ajo sa s'i kishte thënë se ndryshimi është çështje e pashmangshme e dialektikës, që po nuk u përfill përfundon me rrënim, me zhdukje dhe me atë që paraqet vetëzhdukje, siç u ka ndodhur edhe dinozaurëve dhe qenieve të tjera që nuk kishin qenë në gjendje, ose që nuk kishin dashur t'u përshtateshin ndryshimeve të domosdoshme sapo ishin shfaqur rrethanat e reja.

Por, duket se ishin pikërisht ndryshimet e shpejta dhe jo të natyrshme që kishte qitur në pah koha kalimtare me ato prirjet shumë të çoroditura për pushtet dhe përfitime të shpejta dhe pa kurrfarë mbulese dhe shumë lakmi të tjera të shfrenuara që, as përafërsisht nuk përkonin me atë përfytyrimin e ardhmërisë, të projektuar gjatë viteve të dhunës, ato që Vëllaznim Prishtina nuk i pranonte dhe as që dëshironte të kishte të bënte me to, që do ta shtynjë të kërkonte të shpallej i *vetëzhdukur* dhe të largohej në një vend ku ndoshta

përgjithmonë mund të ndjehej i vetmuar dhe i harruar madje, por me ndjenjën e afrisë shpirtërore me diçka të madhërishme, që mund të paraqiste vetëm një iluzion, që do ta lironte nga neveria dhe vetëneveria...

Kur ia kishte thënë këto holandezes Helga Krojf, nuk kishte pasur parasysh vetëm mangësitë që realisht kishte sjellë botëkuptimi i mbylljes dhe kufizimet e mentalitetit të bodrumeve, kur bota ishte parë njëanshëm dhe tepër e ngushtë, ku mbijetesa me çdo kusht, në njërën anë, dhe ideali i arritjes së diçkahes, në anën tjetër, kishin krijuar ato parakushtet e para të atyre shpërputhjeve, që do të dalin në pah dhe që nuk mund të ishin pa ndikim në përcaktimet e mëvonshme, kur sekush do të gjendet në atë hapësirën e lirë të orientimit dhe do të sillet më shumë në përrputhje me instinktët, shpeshherë ndër më të ulëtat, sesa me arsyen dhe qëllimet e përbashkëta, por kishte pasur fjalën pikërisht për mashtrimin e ndryshimit, kur ai kthehet në virtyt të rremë, me anën e të cilit edhe përmbysja më e pashembullt provohet të arsyetohet me anën e rrënim, si mjet i të arriturave që sjellin kthesa të caktuara...

- Përfundimisht nuk i takoj kësaj bote në lëvizje të paparashikueshme - i kishte thënë Vëllaznim Prishtina holandezes Helga Krojf dhe kishte kërkuar prej saj që ta mbante pranë, me çfarëdo arsytimi të mundshëm (ciceron, dashnor dhe si të dojë) derisa ta nxirrte prej andej dhe ta linte diku, ku do të ndjehej i vetmuar dhe i huaj, por me preokupimin e përhershëm të atij projekti të kujtesës letrare, që i kishte lindur në kokë me poezinë “*Në kërkim të Itakës*”, kur në atë udhëkryqin e rrugës për në Tetovë, dhunshëm e kishin ndarë nga i ati, i cili kishte përfunduar në Bllacë dhe pas saj kishte tretur në një vend të panjohur, ndërkaq ai kishte vazhduar për në Tetovë, ndërsa më vonë kishte qëndruar edhe në Gostivar, Strugë e Tiranë dhe gjithandej ku shtriheshin ato qendrat e pranimit të refugjatëve, me çka i ishte krijuar ajo ndjenja e refugjatit në vend të vet, nga e cila nuk ishte ndarë as gjatë atyre ditëve sa kishte zgjatur ajo ndërhyrja ajrore e NATO-s dhe nuk e kishte hequr as më vonë kur ishte kthyer në Prishtinë, e nuk do t’i ndahet as kur do të largohet së andejmi dhe bashkë me Helgën, së pari do të shkojë në Meksikë në kërkim të gjurmëve të qytetërimeve të vjetra të rrënuara të Majave, e më vonë edhe në Andet e Amerikës së Jugut, gjurmëve madhështore të Inkëve...

VI

Por, para se të vetëshpallej *i zhdukur* dhe gjatë tridhjetë e gjashtë ditëve të ardhshme do të vendosej kundruall apartamentit të Helga Krojfit në hotel “Grand” (i pajisur me një leje qarkullimi me emrin Maks Bruner, shtetas izraelit, të cilën, në një zarf të mbyllur ia kishte lënë zvicerani Marko Pantini kur ishte larguar nga Prishtina për në Maqedoni bashkë me vëzhguesit e tjerë ndërkombëtarë, të cilin për disa ditë e kishte shoqëruar në prag të ndërhyrjes së NATO-s nga ajri dhe ia kishte bërë me dije se mund t’i duhej ndonjëherë që në rast rreziku të largohej nga Kosova), Vëllaznim Prishtina së pari do të ndërmarrë të gjitha masat që te një kushëri i afërt në Vushtrri, i cili ruante mbiemrin Berisha, të vendoste të gjitha ato që i takonin trashëgimisë familjare. Ishte biblioteka e pasur e të atit bashkë me disa dosje, ku kishte dokumente të ruajtura nga ai gjatë kohës sa kishte ushtruar detyrën e sekretarit të Kryesisë së Kosovës, por edhe të tjera që lidheshin me ato proceset e diferencimit, e ku mund të merrej me mend se kishte edhe dokumente që kishin të bënim me atë presionin e madh në prag të votimit në atë mbledhjen e 23 marsit të vitit 1989, kur vetë i shtati u kishte thënë jo ndryshimeve me dhunë të Kushtetutës së Kosovës, me të cilën asaj i merrej statusi i subjektit të barabartë në federatë.

Kushëritit ia kishte bërë me dije se meqë largohej në kërkim të të atit të zhdukur dhe ngaqë kjo mund të zgjasë kush e di sa, librat dhe dokumentet e tjera duheshin mbajtur në një fshehtësi të plotë, derisa prej të atit, ose prej tij, të merrte ndonjë letër me shkrim si të veprohej me to, me ç’rast i kishte thënë se strehë e tyre e fundit mund të ishte vetëm Instituti i Historisë i Kosovës me kusht që të pranoheshin me pesë dëshmitarë, shkencëtarë, me tituj të fituar gjatë viteve shtatëdhjetë në Universitetin e Kosovës në Prishtinë.

Pasi ta ketë bërë këtë - që do ta quajë hap tejet të rëndësishëm për ruajtjen e kujtesës historike dhe gjithë atyre që do t'i takojnë trajtesës së përhershme "*Dardania si themel i kujtesës historike dhe rrënjët e saj antike*", pjesë të së cilës herë pas here do t'i hidhen në internet, që, sikur të ishte fjala për një kod kujtese të jashtëzakonshme të ngritur në një vend të panjohur, ngjashëm do të adresohen edhe për disa historianë dhe studiues të historisë kombëtare dhe të lëvizjes shtetformuese, të cilët së voni kishin filluar t'i kushtojnë rëndësi të veçantë hulumtimit të dokumenteve që lidheshin me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ato të formimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës si bartëse e lëvizjes kombëtare, si dhe të referendumit për pavarësinë të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një - Vëllaznim Prishtina pesë ditët e tjera do t'i kalojë në kërkim të gjurmëve të asaj që e kishte quajtur *kohë e mashtrimit të vëllazërim-bashkimit* dhe të *kohës së mashtrimit të jetës paralele*, por që në atë kërkim, dashur a padashur, kishte ndërhyrë edhe diçka e atij *mashtrimit të kohës kalimtare*, që pas këmbënguljes së holandezes Helga Krojfi ishin marrë vesh t'i trajtonin, *jo si mashtrime*, por *si realitete jetësore* nëpër të cilat ishte kaluar dhe si të tilla ishin të papërsëritshme.

Sidoqoftë, Vëllaznim Prishtina, në kërkim të gjurmëve të atyre që i kishte parë si *mashtrime*, të cilat më vonë do t'i quajë edhe *realitete jetësore të papërsëritshme*, (këtë do ta bënte edhe pa këmbënguljen e holandezes), kishte takuar fare pak të asaj që i takonte vëllazërim-bashkimit, jo vetëm pse ai si realitet, me largimin e serbëve dhe të malazezve, por edhe të një pjese të pakicave të tjera (romë, goranë dhe boshnjakë) që ishin manipuluar nga regjimi okupues serb dhe pak a shumë, në forma të ndryshme, kishin marrë pjesë edhe në dhunën që ishte ushtruar mbi shqiptarët), as fizikisht nuk ekzistonte më, por edhe pse ishte përpjekja që me të të ndërpritej çfarëdo lidhjeje, me arsyetimin se çdo gjë që ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore "në emër të ndërtimit të një bote të re dhe të barabartë komuniste" - mund të ishte iluzion, shpresë, besim dhe çmos tjetër e atyre pesëdhjetë e sa vjetëve - kishte përfunduar me përpjekjen për gjenocid të tmerrshëm, të cilin e kishin ushtruar serbët.

Andaj, në rrethana të tilla të gjakderdhjes dhe të përjetimit të një eksodi të tmerrshëm me shumë e shumë plagë të hapura, që si të tilla mund të mbeteshin përgjithmonë, ajo nuk mund të shihej ndryshe veçse kujtesë e keqe, vrastare...

Madje, edhe ato që në njëfarë mënyre mund të kishin qenë të arritura të pamohueshme brendapërbrenda sistemit dhe fillimisht barteshin nga parullat socialiste dhe ideologjike për emancipim të masave dhe arsimim të tyre, siç ishte zhdukja e analfabetizmit, heqja e feroxshesë, përkujdesja shëndetësore, arsimimi i detyrueshëm fillor në gjuhën amtare (më vonë edhe ai në të gjitha nivelet e shkollimit, i cili në vitet e gjashtëdhjeta kishte kulmuar me hapjen e fakulteteve dhe të Universitetit të Kosovës në Prishtinë në gjuhën shqipe, pastaj të zhvillimit të gjithanshëm kulturor me krijimtarinë e pasur artistike, ku në fushën e letërsisë mund të veçohen disa vepra të rëndësishme që kishin pasuruar letërsinë kombëtare në përgjithësi, pa harruar këtu krijimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, punën shkencore - kërkimore, që do të marrë hov të dukshëm në sajë të institucioneve dhe të ekspeditave shkencore, të cilave u ishte hapur rruga me ndryshimet kushtetuese të viteve shtatëdhjetë, me të cilat do t'i krijohet bërthama e gjithë asaj që do të shihet edhe si pjesë e vetëdijes shtetformuese në vazhdim e sipër, që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndej, që më vonë do të gjejë pasqyrimin në atë lëvizjen për pavarësinë të fundviteve të tetëdhjeta dhe të atyre të nëntëdhjetë), pra, të gjitha këto, sikur i ishin nënshtruar këtij rishikimi dhe kishin fituar hipotekën e çështjeve "të diskutueshme", "të rishqyrtueshme" dhe "me dyshime", deri tek ato "të padëshirueshme", madje edhe "armiqësore", me të cilat duhej qëruar hesapet sa më shpejt. Por që kjo, nga frika e ndonjë përsëritjeje të së njëjtës, kur kohët mund të ktheheshin (siç kishte ndodhur pas Luftës së Parë Botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore, kur dhuna serbe ishte rikthyer edhe më e fuqishme), ose për ndonjë arsye tjetër (pa konsensusin intelektual dhe profesional rreth kritereve shkencore të vlerësimeve se çfarë duhet hedhur menjëherë dhe çfarë duhet trajtuar si trashëgimi pozitive dhe as pa pritur distancën kohore aq të domosdoshme që gjërat të shihen në kontekst më të gjerë historik), e gjitha i kishte gjasuar

një fushate që kishte vazhduar si hakmarrje e njëanshme për t'u fshirë edhe ajo që nuk mund të fshihet e as duhet të fshihet, por të merret pjesë e një ndërtimi të brendshëm, i cili nuk mund të zhdukët e as të harrohet edhe po të bëhet në emër të përcaktimit për pavarësinë, rreth të cilit tashmë ishte arritur ujdia e përgjithshme...

Kështu, pasqyrimin e parë të këtyre përvijimeve të brendshme, të cilat, si duket, dikudiku, ashtu si veprohej, kishin filluar të përkujtonin edhe kohën e diferencimeve të dikurshme famëkëqija, që drejtoheshin nga qendra të padukshme ideologjike, që më vonë do t'i quajë "frustrime të çoroditura të viktimave me metodat e dhunës, nëpër të cilat kishin kaluar" - Vëllaznim Prishtina e kishte parë në stendat e libërshitësve para hotelit "Grand", ku mungonte pothuajse pjesa më e madhe e botimeve të "Rilindjes" (madje edhe ato kompletet luksoze të klasikëve të letërsisë dhe të kulturës kombëtare, si Naimi, Samiu, Çabej, Çajupi, Fishta dhe të tjerë, që ishin botuar edhe para se kjo të bëhej në Tiranë) dhe vendin e tyre e zinin gjithfarë botimesh të botuesve që kishin mbirë si kërpudhat pas shiut dhe s'u diheshin emrat mirë, ku kishte libra pa kriter fare, që nga përkthimet shkel e shko dhe ku pranë njëri - tjetrit kishte libra të shenjtë dhe të kuzhinave kineze e, ç'nuk kishte: libra me vetëlavdërime, me vetëreklamime, me synime për t'u vetërehabilituar gjithkush dhe për gjithçka, me folklorizëm primitiv që kishin nisur të shkruheshin për çmos, që mund të thuhet se pasqyronte jo vetëm mungesë të shijes, porse edhe rrënim të saj dhe të vlerave të arritura, ngjashëm me ato spastrimet e revolucioneve të përcaktuara ideologjike, kur synohej të krijohesh një shije e keqe në çdo art...

Madje, kur si me kureshtje kishte pyetur njërin syresh, pse nuk kishte disa nga botimet e rëndësishme të "Rilindjes" dhe a mund të gjendeshin ato kund, kishte marrë një përgjigje që përkonte me frymën e librave që shiste:

"U ka ardhë funi paçavrave të Tites"...

Më tutje, Vëllaznim Prishtina nuk kishte pasur ndër mend të merrej me atë që e kishte parë si mashtrim të vëllazërim-bashkimit, me të cilin ishte rritur, e që holandezja Helga Krojfi ia kishte bërë me dije se, ndonëse fizikisht nuk ia shihte gjurmët (kjo lidhej me mospraninë e serbëve dhe të malazezve që ishin larguar me armatën jugosllave ngaqë një pjesë e tyre kishin qenë pjesë e represionit të saj), megjithatë, përfytyrimi i saj edhe për shumë kohë do t'i sillte nëpër kokë, siç do t'u ndodhë edhe të gjithë atyre që e kishin përjetuar atë dhe, gjithnjë sipas saj, nuk kishte asgjë të keqe nëse kujtimet për atë që është njerëzore do të ruheshin për t'u rishfaqur në rrethana të reja si miqësi a të ngjashme, siç do të ishte jonjerëzore, po që se prania e saj do të luftohej me hipokrizinë e fshehur të nostalgjisë për të, në përputhje me vështirësitë e gjendjes kalimtare, që janë të mundshme, që janë të arsyeshme madje, pikërisht pse në të nuk shfaqet ai çelësi magjik, me të cilin sakaq hapen të gjitha dyert dhe plotësohen që të gjitha dëshirat, përfytyrimet dhe iluzionet madje, ndërkohë që edhe plagët e mëdha të së kaluarës së afërt veprojnë fuqimisht drejt prishjes së imazhit të realitetit jashtë përmbushjes së parashikimeve...

Me përshtypjen e një përmbysjeje të madhe, që nuk do të mbetej pa pasoja edhe atëherë kur koha shumë gjëra mund t'i vendoste në vend të vet, kishte filluar t'i afrohej edhe asaj, nëpër të cilën kishte kaluar gjatë atyre dhjetë vjetëve të fundit, që, në njërin anë ishte përjetuar, por edhe parë si jetë paralele, me ato institucionet e domosdoshme, që të shumtën punonin me vështirësi tepër të mëdha dhe thuhej se i shërbenin jo vetëm mbajtjes së jetës në rrethanat e dhunës dhe të pushtimit të plotë policor-ushtarak serb, po edhe të atyre vlerave të domosdoshme shtetformuese, me të cilat prania e Serbisë rrudhej në pushtues të thjeshtë policor-ushtarak e me këtë i merrej çdo atu për çfarëdo posedimi të mëtejshëm të saj që mbështetet mbi sovranitetin shtetëror dhe të drejtën e mbrojtjes së saj nga lëvizjet separatiste, qoftë edhe me përdorimin e dhunës (siç arsyetohej në rastin e dhënë), dhe në tjetrën anë, e gjitha ajo që thuhej për lëvizjen paqësore me ato organizimet paralele dhe durimin si moto që përdorej edhe vend e pa vend dhe jo rrallë edhe keqpërdorej, ishte parë si një humbje kohe, si diçka që ia kishte vazhduar jetën dhunës së pushtetit serb dhe të ngjashme, që, si do të shihet,

me kalimin e kohës, kur do të piqen kushtet për lëvizje nga vendi, (pas marrëveshjeve të Dejtonit, kur soldateskës serbe do t'i jepej leksioni i parë nga NATO dhe armatat kroate dhe boshnjake), kjo e dyta do t'ia marrë anën të parës dhe, kundërvënia institucionale, me kundërvënien gjithnjë më të hapur dhunës serbe, do të fitojë edhe atë krahun aktiv, që ai nuk e kishte parë si shkëputje as rrugë tjetër nga ajo e filluara që prej vitesh, siç dëgjohej të thuhej më vonë dhe të ngjashme, kur me çdo kusht do të kërkoheshin ato ndasitë dhe shkëputjet jo të natyrshme, me ç'rast nuk do të ngurrohej që edhe një historie të tërë t'i shihej vetëm faqja e fundit, edhe ajo e rrudhur në disa rreshta të paqartë dhe të ngjashme, por e kishte parë si një zhvillim të natyrshëm, që do të shkojë edhe deri te përfshirja në atë luftën e domosdoshme, kur ajo do të marrë përmasat e spastrimeve etnike dhe të gjenocidit, të cilën, për ta parandaluar, do t'i duhej edhe ndërhyrja ndërkombëtare, që edhe do të ndodhë, pa marrë parasysh që do të bëhej me pretekst humanitar dhe që ai përkufizim më vonë do t'u kthehej në një barrë të rëndë shumë çështjeve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e saj përfundimtare.

Natyrisht se afrimi i kohës së mashtrimit të jetës paralele, ose i asaj që në atë projektin e mëvonshëm të kujtesës poetike do ta quajë "mentalitet të bodrumeve" dhe "jetë e katakombeve", po dhe ndryshe-ndryshe, që më vonë prej tij do të vlerësohet edhe si një sprovë tejet e rëndësishme e pjekurisë historike, pa të cilën asgjë nuk do të mund të lëvizte drejt kahut të duhur - nuk mund të kalonte pa shqetësimet që e kishin përcjellë atë dhe gjithë ato që do të shihen "si pikëpamje të ndryshme të natyrshme" për atë "ndarjen etër-bij", që ka të bëjë me moshën e pjekurisë me të cilën arrihet ai pavarësimi i domosdoshëm i fëmijës prej prindit, që paraqet shkëputjen e brezave, si proces të natyrshëm jetësor...

Por, ndarja etër-bij, gjatë asaj kohe, nuk kishte qenë as e natyrshme e as e thjeshtë, pos një shqetësim i përgjithshëm, nëpër të cilin kalohej dhe mbi të cilin ishte ngritur edhe ajo dilema e ngjashme me atë me qenë ose mos me qenë, ku përvijoheshin dy rrugë të ndryshme për të njëjtin qëllim. Në njërën anë pavarësia, ndërsa në tjetrën bashkimi kombëtar, si çështje e drejtë e secilit popull që atë ta sendërtojë me mjete qytetëruese edhe atëherë kur duhet të përballojë rrethana që e vështirësojnë a e pengojnë atë zhvillim, që më vonë do t'i shohë si "rrjedha të ujit që shkojnë në të njëjtin lumë dhe bashkohen në të"...

Këtë madje do ta ngrejë në metaforë që do ta përsërisë vazhdimisht, ku gjithnjë sipas atij përfytyrimi artistik, njëra (pavarësia) ndiqte vijën institucionale dhe në ato tundimet e hershme poetike e kishte parë si evolucion, ndërkaq tjetra (bashkimi kombëtar) parashihte arritjen e qëllimit pa përrjashtuar asnjë mjet, pra, përfshirë edhe luftën, nëse për këtë paraqitet nevoja, që e kishte parë si revolucion që i kishte pëlqyer dhe edhe do ta mbështesë, ngaqë kishte bindjen se vija shtetformuese nëpërmjet institucioneve paralele, që ishin krijuar dhe që i ati, i cili ishte përfshirë në atë projekt dhe nuk do t'i ndahej, i thoshte se ishin të domosdoshme për atë vetëdëshmimin që të evitohej lufta, e cila do të kishte pasoja shkatërruese në ato rrethana, kur Beogradi edhe më tutje kishte përkrahës në botë (siç ishte Rusia) dhe veçmas midis fqinjëve, të cilët e dinin se çështja e Kosovës patjetër se nxirrte edhe çështje të tjera të pazgjidhura të hapësirave etnike shqiptare në rajon. Andaj, këtë duhej pamundësuar qoftë edhe me lejinim që Serbia të përdorte edhe gjenocid që të mos hapej kutia e pandorës dhe të ngjashme. Pra, këto arsye time që dëgjonte err e terr, gjithnjë e më shumë ia krijonin ndjenjën e nënçmimit që përballë dhunës së ushtruar zhvlerësonte e zhvlerësonte pafundësisht. Ndërsa rruga e kundërvënies me të gjitha mjetet, përfshirë edhe luftën e armatosur, ia krijonte përfytyrimin e lëvizjes nga ajo gjendje dhe të çlirimit të dosidoshëm prej saj, qoftë edhe të përkohshëm mental. Ani pse një mendim i këtillë, kur fashitej, edhe e frikësonte, veçmas kur e dinte se ajo që po ndodhte në hapësirat e ish - Jugosllavisë nuk ishte çështje e thjeshtë, por duhej pranuar se ishte pjesë e atyre lëvizjeve të mëdha tektonike të natyrës strategjike dhe gjeostrategjike, që kishin dalë në syprinë pas rrënimit të murit të Berlinit dhe rënies së bipolaritetit blloksit, me ç'rast rirreshtimet e reja botërore me shumë të panjohura dhe befasi madje, nga ata që përherë kishin qenë pre e kusuritjeve të të mëdhenjve dhe të lojërave të tyre, kërkonin kujdes e maturi, sepse, si thoshte ai me të drejtë, të vegjlit, si

ishin ata, edhe gabimin më të vogël e paguajnë shtrenjtë, sa ndonjëherë të mos jenë në gjendje ta ndreqin fare...

Me bindjen se uji që nuk lëviz kthehet në batak dhe kjo nuk ishte vetëm bredhje poetike, me çka e kishte kokën plot dhe sa vinin e i ngatërroheshin në një lëmsh, së paku shpirtërisht, ishte përcaktuar për rrugën e kundërvënies, së cilës, ndonëse nuk i ishte bashkuar drejtpërdrejt si shumë të tjerë nga ato që i quante pjesë e “katakombeve të jetës paralele”, megjithatë, me anën e vargjeve që, të shumtën i recitonte në kafe “Syri” dhe disa prej tyre pastaj i shpërndante dorë më dorë, po edhe duke i botuar në fletushka të ndryshme që kishin filluar të qarkullonin dhe, jo rrallë, në vend se të përqendroheshin te shkaktari i asaj gjendjeje dhe kundërshtimi i projekteve për shfarosje, shpenzonin më shumë fjalë kundër jetës paralele dhe institucioneve të saj, duke i quajtur madje edhe “pjesë të tradhtisë së madhe historike”, kishte filluar të kthehej në një frymëzues të kundërvënies, sa edhe të quhej “rebel i nëntokës”...

Kjo nofkë i pëlqente dhe, kur çonte ndonjë gotë birrë më tepër se ç’duhej, atëherë asaj, si me shpoti ia shtonte edhe këtë: “poet kryengritës i llafosjes së bodrumeve”.

Megjithatë, ndjenja e “kryengritësit të bodrumeve” do t’i kthehet në realitetin e rëndë të refugjatit në vend të vet, do të fillojë atë ditën e tetë të ndërhyrjes nga ajri kur njësitë paramilitare do t’u trokasnin në derë dhe do t’u japin pak kohë t’i mbledhin plaçkat e dorës dhe të thyenin qafën për në Shqipëri, siç u kishin thënë gjithë nënçmim kur i kishin dërguar në stacionin e autobusëve dhe prej andej i kishin futur në autobusët e mëdhenj me targa të Krallëvës në drejtim të Shkupit, që në atë kthesën e Tetovës ishin ndarë përgjithmonë: i ati në drejtim të Bllacës, ndërsa ai për në Shqipëri. Ndjenja e realitetit të refugjatit në vend të vet nuk do t’i hiqej as gjatë atyre bredhjeve nëpër Shqipëri dhe Pollog të Maqedonisë, e nuk do t’i hiqet as kur do të kthehet në Prishtinë, e as kurrë më...

Sidoqoftë, edhe pse më vonë përkatësinë shpirtërore ndaj kundërvënies dhe mospajtimin me atë të jetës paralele me ato institucionet që me kohë kishin filluar të vegjetonin, që më së miri ishte pasqyruar me atë ndarjen me të atin dhe mësimet që nuk u hiqej dot, e kishte pajtuar me atë lëvizjen shtetformuese dhe madje e kishte quajtur “parakusht që i ishte dashur vazhdimi të politikës me mjete të tjera, pra me ato të kundërvënies së armatosur” – prapë se prapë, atë kohën që gjatë atyre pesë ditëve të ardhshme do ta shpenzojë në kërkim të mashtrimit të jetës paralele me arsimimin e bodrumeve dhe të realiteteve të saj, e kishte përqendruar më shumë në ato theksime të kundërvënies, të cilat kishin shkuar deri te lufta e armatosur, sesa në theksimet e kundërvënies paqësore, e cila sikur kishte mbetur nën hije dhe me hipotekat e diçkaje që duhej t’i dëshmohej fajësia në vend të meritave fillestare të një lëvizjeje të fuqishme me intelektualë të njohur në krye, pa të cilën nuk do të mund të kishte as kundërvënie aktive e as luftë të armatosur, siç do të ndodhë më vonë kur për të ishin krijuar rrethanat dhe të ngjashme.

Edhe pse kjo qasje do të ndryshojë sapo të fillojë vendosja e asaj kohës kalimtare dhe do të shihet se edhe më tutje ato që quheshin qëllime historike dhe jo rrallë ngatërroheshin me fjalë të mëdha pa mbulesë, ato mbeteshin të hapura dhe në kompetencë të mëtejshme të rindërtimeve të mundimshme institucionale, gjithnjë të mbikëqyrura nga faktori ndërkombëtar i vendosjes, që i kishte marrë në dorë të gjitha dhe ditë për ditë shtronte kushte, paraqiste kërkesa dhe shtynte afate, që edhe ashtu shfaqeshin të mjegulluara për nga përmbajtja.

Në kërkim të tyre, rruga pashmangshëm e kishte çuar te kafe “Syri”. Me të hyrë forcat ndërkombëtare e kishte ndërruar emrin në “Shqiponja”. Edhe përkundër kësaj, kjo kafe, edhe më tutje kishte mbetur pikëpjekje e atyre që gjatë dy-tre vjetëve të fundit hiqeshin “pararojë shpirtërore” e kundërvënies aktive me të gjitha mjetet (krijues të ndryshëm, të shumtën poetë mediokër, e ku defilonin edhe llafazanë e lavdidashës, që kishin zgjidhje të gatshme për çdo gjë). Ata që vetëshpallëshin edhe “pjesë e frymës revolucionare” dhe e gjithë asaj që thoshin se i takonte lëvizjes ilegale me emra të ndryshëm, që do të duhej të nënkuptonte njëfarë fshehtësie, çfarë, ç’është e vërteta, aty kishte fare pak, ku pinin dhe madje deheshin tapë,

recitonin dhe këndonin pa karar sa të frustruar fare i jepeshin një fantazie të shfrenuar për të shpikur lloj-lloj bëmesh heroizmi, trimash të rrallë, që, kur i shkëputnin nga legjendat e shumta dhe visheshin me ta në atë tymnajë të pistë, ishin në gjendje edhe t'i tureshin qiellit, të ndiznin botën, po që në orët e hershme të mëngjesit, pas vjelljeve dhe mbllaçitjeve, përfundonin duke dalë jashtë kokulur dhe heshtazi në atë realitet që ishte siç ishte...

Në atë kafene i kujtohet se kishte filluar edhe ato recitimet e vjershave që i kishte plot e përplot vrull revolucionar, që ia kishin dhënë namin “e poetit të kuq” dhe shërbenin për të ndezur emocione, që si duket më së shumti i kishin pëlqyer pronarit Lulzim Baliu, i cili fillimisht kishte qenë një ndër veprimtarët e dalluar të Lidhjes Demokratike të Kosovës nga radhët e atyre njëqind e njëzet e shtatë vetave që atë e kishin themeluar ditën e njëzet e tre dhjetorit të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë në lokalet e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, por që pas dy-tre vjetësh kishte hequr dorë nga aktivitetet e mëtutjeshme me arsyetimin se përkrahte vetëm atë lëvizje që do të shpinte në kundërvënien të armatosur. Në prag të ndërhyrjes së NATO-s, duket se u ishte bashkuar edhe njërive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që vepronin në pjesën e Llapit, por që pas luftës, pa zënë ngoje farë merita dhe lëvdata, siç kishte me bollëk kudo dhe në emër të tyre jo rrallë, krahas përmendoreve e përkujtimeve kërkoheshin edhe përfitime të pabesueshme, prapë ishte kthyer te kafeneja, së cilës ia kishte ndërruar emrin nga “Syri” në “Shqiponja”. Këtë madje e kishte arsyetuar “me përhapjen e shikimit nga ai i natyrshmi, siç ishte i syrit të njeriut, tek ai i lartësive, që ishte në gjendje ta bënte vetëm shqiponja si mbretëreshë e qiellit”, gjë që mund të thuhej se ai ndryshim emri pasqyronte edhe metaforën e kundërimit të gjendjeve të ndryshme nga ajo poshtë, deri më dje, në lart, ndryshim ky që ishte përcjellë edhe me zmadhimin e hapësirës për dy-tre herë, pajisjen me mobilie tejet luksoze dhe, mbi të gjitha, me ngritjen e shtëpisë mbi të, që deri dje kishte vetëm një kat dhe dukej tejet e vjetër, së cilës tashmë i ishin shtuar edhe të tjera, ku së shpejti parashihte hapjen e një hoteli dhe disa lokale të tjera për shërbime të natës...

Lulzim Baliu e kishte pritur me përzemërsi dhe pa një pa dy ia kishte treguar të gjitha ato që lidheshin me zgjerimin e biznesit, që thoshte se e gjitha e asaj ngjitjeje mund të arsyetohej me gjeturinë në angazhimin e mjeteve financiare që i kishte huazuar, por edhe me kursime familjare që vinin nga qëndrimi i gjatë i dy vëllezërve si punëtorë me leje të përhershme pune në Zvicër.

Kishte porositur raki rrushi dhe sallatë me turshi, si dikur, dhe i kishte thënë se, koha e paqes kërkonte edhe njeriun e paqes, atë që mendon për ardhmërinë, por që edhe më tutje ruante mallin për poezitë dhe vargjet që i kishte për gjak, të cilat aty do të jenë të mirëseardhura gjithnjë.

- Gjërat e shpirtit nuk harrohen...

Ashtu si kishte folur, veçmas kundrimi i matur përpara, i kishte lënë përshtypje të madhe holandezes Helga Krojfi, e cila kishte treguar kureshtje të dinte se si e shihte ardhmërinë e atyre që deri dje kishin jetuar nën të njëjtën çasti, por që lufta i kishte kthyer në armiq...

Pa një pa dy, Lulzim Baliu kishte thënë se lufta ishte luftë, paqja paqe... Prandaj, tash e tutje duhet për të menduar që secili të përpiket për ardhmërinë, që kishte thënë se duhej të ishte e barabartë dhe e qartë, që të mos prodhojë më ngatërresa...

- Ardhmërinë mund ta ndërtojnë vetëm të barabartët dhe të pavarurit...

Madje, edhe kur ajo e kishte pyetur se çfarë kuptonte me atë barazi dhe qartësinë që të mos prodhojë ngatërresa, ai edhe më tutje kishte vazhduar të shpjegonte se barazia si barazi nënkuptonte pavarësinë e secilit, bashkë me të drejtën e punës, të lëvizjes së lirë dhe të krijimtarisë shpirtërore, që paraqet bazën e çdo shoqërie të lirë dhe të qytetëruar, ku individit ruan dinjitetin, ndërkohë që shteti i ligjit me institucionet përkatëse merr përsipër ruajtjen dhe jetësimin e tyre.

- E rëndësishme është se nuk do të ketë kthim prapa...

Me gjuhë të ngjashme, që e kishte befasuar për të mirë, i kishin folur edhe disa nga ata që për vite të tëra kishin qenë pjesë e pandashme e kafenesë “Syri” e tash “Shqiponja” dhe të shumtën u bashkoheshin atyre shfrimeve poetike gjithë vrull për luftën dhe revolucionet që përhapeshin gjatë orëve të mbrëmjes nga krijuesit e atyshëm me duf të brendshëm, të shumtën të papërmbytur, të cilëve u takonte edhe ai.

Kështu, për biznesin e shekullit “në rrethanat e lirisë” i kishte folur edhe Din Mati, një student i përhershëm i arkitekturës, që kishte hapur një pompë të madhe të benzinës në të dalë të Prishtinës dhe ishte në udhë e sipër, si thoshte, të hapte edhe një tjetër në drejtim të kundërt dhe këtë do ta bënte në saje të një bashkëpunimi me një biznesmen të jashtëm, me të cilin kishte lidhje të hershme.

- Kohët e pasluftës janë kohët më të vrullshme, të cilat hapin të gjitha udhët, qofshin ato edhe ndër më të vështirat...

I pyetur nga holandezja Helga Krojfi, se mos ajo çështja e hapjes së të gjitha udhëve mund t’i shkojë për shtati pikërisht “shtresës së zhdërvjellët”, që, në lëvizje e sipër shmanget edhe ligjet dhe kështu ua hap rrugën gjithfarë veprimeve, që mund të marrin kah të papërmbytur, Din Mati kishte theksuar se “koha nuk pret”, ngaqë “ngecja kishte vazhduar si shumë” dhe “po të veprohej me ngathtësi dhe ngreh e mos këput, ka rrezik të humbet hapi me vrapim, që për pasojë do të kishte humbjen e besimit tek ardhmëria...”

- Uji që nuk ec nuk pihet...

Ngjashëm i kishte folur edhe Lul Lumjani, i cili i kishte thënë se kishte nisur një veprimtari për meremetimin e banesave të vjetra dhe të lëna, po që paraqiste njëfarë byroje që përkujdesej rreth pasurisë së patundshme dhe për regjistrimin e saj në përputhje me kërkesat e reja.

- Ka ardhur koha kur pa hezitim çdo gjë duhet lëvizur drejt qëllimeve të ardhmërisë...

Ashtu disi do t’i flasë edhe Metë Gashi, i cili kishte hapur një shtypshkronjë dhe krahas shtypjes së formularëve dhe materialeve të tjera administrative që u duheshin byrove, kishte nisur të bënte edhe fletore dhe synonte të botonte edhe libra, me ç’rast, si rrëshqitazi, kishte zënë ngoje edhe çështjen e disa librarive që i kishte nën mbikëqyrje. Si më shpoti i kishte thënë se së shpejti mund të llogariste që vjershat t’i botonte tek ai dhe kjo do ta nderonte.

- Duhet pasur parasysh ata që shpirtërisht kanë frymëzuar lëvizjen, e cila ngriti masat në luftë të pashmangshme...

Rreth borxhit, që, si kishte thënë, “krahu i luftës ia detyronte dhe për frymën revolucionare që kishte përhapur me poezi”, i kishte folur edhe Neki Rrema, dikur njëri ndër fjalamanët e papërmbytur, që kur koka i mbushej me birra, as profetin nuk e kursente me ato sharjet, të cilat të shumtën lidheshin “me tradhtinë” dhe “tradhtarët”, që i shihte kudo dhe thuajse te secili që ia dilte të merrte frymë, qoftë edhe me mundime.

Por, dukej se Neki, ndër të gjithë ata që për vite të tëra kishin qenë ndër më të zëshmit në kafe “Syri” dhe pikërisht pse e tepronte me ato përgjithësimet e dyshimit dhe të fajësisë, e që pothuajse merrej vetëm si shakaxhi i prapë, krahas një biznesi të mirë me një firmë të huaj që shiste pajisje elektronike të informatikës (në radhë të parë kompjuterë, por edhe teknike tjetër për fotokopjime, skanime, filma digjitalë dhe të tjera), ia kishte dalë të bëhej edhe njëri ndër liderët e dalluar të njërës nga partitë e rëndësishme, që, si do të shihet më vonë, ajo do të jetë një subjekt politik që do të marrë pjesë në bashkëqeverisjen që do të dalë pas zgjedhjeve të para, ku ai do të drejtojë resorin kryesor të departamentit të planifikimit dhe do të jetë njëri ndër ata që kishte punuar më së miri, me profesionalizëm, gjithnjë jashtë atyre kornizave të ngushta partiake, që të shumtën ishin përçarëse dhe me lloj-lloj prapaskenash, e kjo do t’ia krijojë namin e liderit të moderuar, që gëzonte përkrahje të përgjithshme ndër intelektualë, po edhe nga të tjerë, që, po të mos ishte largimi prej politikës (pas përfundimit të mandatit të parë të zgjedhjeve) dhe kthimi në biznes, me siguri se do të

ishite njëri nga ata që do të fitonte postin e ministrit në atë qeverisjen e përbashkët, të cilën ndërkombëtarët e favorizonin...

Sidoqoftë, takimi me Neki Rremën dhe ato dy bisedat që kishte pasur me të, i kishin lënë përshtypje të madhe, ngaqë, në njëfarë mënyre, i kishte kërkuar falje rreth veprimtarisë së të atit dhe gjeneratës së tij, që sa herë i kujtohen, e mbushin me turp.

- Ishte kohë lllomotitjesh pa karar, që niste dhe soste duke veshur kuturu fajësime, sikur nuk kishte tjetër përpos tradhtarë...Tash po shihet tamam se nuk shkohet në qiell pa shkallë dhe se ato shkallë, doemos shpijnë nëpër atë që është ndërtuar me mund të madh të të gjithë brezave, të cilët, për të arritur diçka, është dashur t'u përshtaten disi rrethanave të mbijetesës që kryesisht kanë qenë tejet të vështira...

Në ndarje Neki Rrema i kishte thënë se libri i kujtesës (këtë ia kishte theksuar me veçanti) ka dy mijë e sa faqe dhe jo vetëm një, që nga sekush shpëputet sipas dëshirës dhe pastaj lexohet gabimisht dhe kështu fitohet përshtypja se edhe ideali i lirisë dhe lufta për të dhe gjithë ai gjak i derdhur e sakrifica janë paraparë për përfitime dhe allishverishe...

Fjalët që dikur Neki Rrema, thuajse i dehur, ia kishte thënë se kishin qenë “gjithfarë lllomotitjesh pa karar” dhe i kërkonte falje për to, thuajse ia kishin marrë gjumin atë natë, por edhe netëve të tjera, duke ia kushtuar kërkimit të gjurmëve të atyre kohëve të mashtremeve të jetës paralele dhe të bodrumeve me gjithfarë andrallash në kokë, nëpër të cilën kishte kaluar, që më vonë do t'i quajë realitete jetësore ndër më të veçantat, sepse ato e kishin lidhur, jo vetëm me atë pendimin, që, si i kishte thënë ai, sa herë i kujtohet e mbushin me turp, por për më tepër rreth qëndrimit të *librit të kujtesës* prej dy mijë e sa faqesh dhe ato shpëputjet e fletës, që i bëheshin dhe thoshte se mund të lexohen mbrapsht, jashtë tërësisë...

Në të vërtetë, ato që ai ia kishte thënë rreth të atit, që nuk kishin qenë vetëm fyerje të rënda, që mund të bëhen kuturu, por në njëfarë mase ishin edhe pjesë e asaj bindjeje tejet fanatike të „qerthujve marksistë“, që çlirimin dhe bashkimin me Shqipërinë e fetishizonin deri në atë masë saqë çfarëdo përpjekje tjetër e ndërtimeve dhe mbindertimeve që diktojnë rrethanat jetësore, pa marrë parasysh nga kush bëhen dhe ç'peshë kanë, shikohen si tradhti e pafalshme, e cila duhet të ndëshkohet rëndë e më rëndë, bile me betimin se “armikun së pari duhet parë brenda vetes, e pastaj jashtë”, pra ato kishin pasur për shkas një intervistë dhënë radios “Europa e Lirë” pas përfundimit të marrëveshjeve të Dejtonit. I ati, në mënyrë mjaft kritike analizonte vendimet e Dejtonit si dhe gatishmërinë e Perëndimit që ta bëjë partner Millosheviqin, i cili ishte fajtori për njërën ndër gjakderdhjet më të mëdha në Europë pas Luftës së Dytë Botërore. Në këtë intervistë, im atë, gjithnjë duke analizuar vendimet e marrëveshjes së Dejtonit, bënte të ditur se projekti për Bosnjën e ndarë në tri njësi federative, përligjte në tërësi strategjinë serbe të spastrimeve etnike me dhunë dhe të gjenocidit, madje edhe i shpërblente për një veprim të tillë, me çka me arsye druhej se mos diçka e tillë mund të ndodhte edhe me fatin e Kosovës nëse kihet parasysh se ecuria e akteve të kryera me dhunë mund të luajë një rol të rëndësishëm në sofrën e vendosjes, ku rëndom problemet nuk zgjidhen me drejtësi, por sipas kutit të interesave të të mëdhenjve dhe pazareve të ndryshme, pa çarë kokën për telashet që u dalin atyre që mbesin pre e tyre...

Pikërisht çështja e interesave të të mëdhenjve dhe ecuria e zgjidhjeve të përkohshme me shumë të panjohura e kishin detyruar të atin të brengosej se pas Bosnjës, (Beogradi e shihte veten fitues dhe kishte arsye të ndjehej i tillë), mund të dyshohej se në njëfarë mënyre serbët ishin trimëruar të vepronin njësoj edhe me Kosovën, aq më parë kur dihej se marrëveshja me Bosnjën dhe Kroacinë dhe “humbja” e Kninit mund të paraqiste farë zhdëmtimi etnik, me ç'rast ishte fare e mundshme që Beogradi, ata që tashmë ishin larguar nga Knini dhe nga viset e tjera të kreaturës së ashtuquajtur Republikë e Kninit dhe gjendeshin në Serbi, që për katër vjet me radhë kishin torturuar gjithë Kroacinë sa të karikaturizonin edhe pavarësinë e saj jashtë territoreve më të rëndësishme që nuk i mbikëqyrte - do të mund t'i

vendoste në Kosovë, por para se ta bënte këtë, atyre duhej t'u krijohej hapësira, e cila mund të arrihej vetëm duke i larguar me dhunë shqiptarët nga trojet e tyre, e assesi ndryshe...

Duke pasur parasysh këtë skenar fare të mundshëm, që përnjëmend do të ishte ndër më fatalët, ai kishte deklaruar se do të ishte tragjedi e tmerrshme që hapësira e paraparë për kolonizimin eventual të Kosovës me serbë të Kninit dhe të viseve të tjera të humbura në Kroaci, të bëhej me anën e ndonjë "shkasi të kurdisur", me çfarë ajo luftë ishte plot e përplot, në një kohë kur çfarëdo kundërpërgjigje e organizuar e shqiptarëve ndaj dhunës serbe - Beogradi tashmë e kishte anatemuar si "terrorizëm fundamentalist ilsamist", do të mund të shfrytëzohej për një blic-krig, me të cilin do të arriheshin këto qëllime...

Andaj, kishte kërkuar syçelësi dhe me këtë rast kishte apeluar që vija institucionale, pra ajo e pushtetit paralel me të gjitha ato dobësi dhe mangësi që kishte, meqë sadopak mbikëqyrte gjendjen dhe ishte e vetmja që mbante përgjegjësinë për diçka, të merrte masat e duhura që grupet e ndryshme të kundërvënies, të cilat me të drejtë kishin filluar të vepronin dhe herë pas here sulmonin poste të caktuara të policisë serbe dhe të armatës jugosllave, të gjenin gjuhë të përbashkët me strukturat e ngjashme nga ato të pushtetit paralel dhe bashkërisht të merrnin përsipër të gjitha veprimet, me anën e të cilave, siç thoshte, „mishi të piquej, e helli të mos digjej”...

Me këtë rast ai kishte thënë se përgjegjësi historike mbanin të gjithë njësoj, pa marrë parasysh se në ç'anë gjendeshin, por të përgjegjshmit i ngarkonte shumëfish që të veprohej në përputhje me të...

- Si mund të bisedohet me pacifistët dhe qyqarët rreth luftës së përbashkët, kur ata nuk e duan dhe, jo vetëm që nuk e duan, po edhe e pengojnë me gjithfarë shpifjesh dhe me arsyetime të ndryshme fataliste, duke shpallur Serbinë si të pamposhtur, ndërkohë që në Kroaci dhe Bosnjë u dëshmua e kundërta - i kishte thënë Neki Rrema atë natë të ftohtë të dhjetorit në kafe "Syri".

Më tutje, gjithnjë me atë shqetësim kishte shtruar pyetjen, se a duhej gjithmonë të pritej dhe të pritej sa edhe të vdisej turpshëm me atë premtimin e durimit, që një ditë gjoja do të shpaguehet...?!

- Të gjithë po lëvizin, përpos nesh, që presim të na pikë diçka nga qielli dhe këtë e bëjmë duke mbjellë frikë dhe me gjithfarë dredhish, të cilat nuk kanë fund dhe ndrydhnin edhe mllefën që është në shpërthim e sipër - me një fjalë, duhet të nënshtrohemi...

Vëllaznimi kishte heshtur, jo vetëm pse nuk e kishte dëgjuar intervistën, por edhe pse qëndrimi i tij ndaj kundërvënies paqësore dhe asaj jetës paralele, ishte ndryshe nga i të atit, pra që ajo pas gjithë atyre viteve të durimit dhe të vetëdëshmive, që në fillim ishin të domosdoshme, më në fund, duhej t'i kthehej kundërvënies aktive, që mund të shkonte deri te lufta e armatosur, por që veprimet e tilla nuk ishte e thënë se duhej t'ia mbyllnin rrugën as asaj forme që shfaqej si organizim i pashmangshëm jetësor, me të cilin mbaheshin gjallë fushat kryesore: arsimi dhe shëndetësia, por edhe përkrahja e ndërsjellë me atë solidaritetin social, që paraqiste njërën ndër çështjet që kërkonte vëmendje të veçantë përballë çfarëdo rrethane.

- Yt atë, që i ka lënë gishtat në atë kuvendin e qyqarëve dhe të tradhtisë së Kosovës, duhet ta dijë se ata nuk i ka me për punë të tjera, përpos për ato xhingla-minglat e nënshtërimit, me të cilat nuk pran së ushqyeri frikakakët dhe dështakët, sot e gjithë ditën...

Fyerjet i kishte vazhduar me kërcënim të hapur:

- Luftëtarët e lirisë, që kanë filluar t'i marrin punët në dorë, nuk kanë nevojë për këshilla të tilla, e as për ombrellën e qyqarëve, të cilëve u bëhet me dije se ka ardhur koha ta mbyllin gojën para se t'u mbyllet...

Vëllaznimit, edhe pa sasinë e nevojshme të birrës, e cila ia nxirrte gjuhën, i ishte nxehur gjaku sa ta zinte për gushe.

I kishte thënë se në atë kuvendin e Prishtinës, ku autonomia ishte marrë me dhunë, nuk kishte pasur vetëm të nënshtëruar nga frika e dhunës, por kishte pasur edhe të atillë që kishin

vepruar si patriotë të devotshëm, siç ishin ata që me guxim të jashtëzakonshëm u kishin thënë -jo atyre që kërkonte Serbia me anën e tankeve, siç u kishin thënë -jo edhe ata mijëra e mijëra të rinj dhe të tjerë që kishin demonstruar nëpër rrugët e Prishtinës dhe të qyteteve të tjera të Kosovës dhe shumë prej tyre kishin marrë plumba...

Po ashtu, ia kishte bërë me dije se guximi i treguar në parlamentin e Kosovës, si dhe gjaku që atë ditë dhe shumë ditëve të tjera të ngjashme që ishte derdhur nëpër demonstrata dhe protesta gjithëkombëtare në Prishtinë dhe në vende të tjera të Kosovës, ishte çështje e një përcaktimi, me të cilën mbrohej një e arritur kushtetuese e një rëndësie të madhe, e fituar me mund të madh dhe ishte pjesë e lëvizjes shtetformuese, që kishte kaluar nëpër shumë e shumë peripeci, por që nuk ishte as e falur e as e gjetur, por pjesë e asaj lufte të gjatë dhe të drejtë, pa të cilën nuk do të arrihej aty ku ishin dhe nga e cila nuk duhej hequr dorë kurrën e kurrës, pa marrë parasysh ato që thuhën kuturu...

- Ah, lëvizjet shtetformuese dhe ato dokrrat e tyre mashtruese, me të cilat po na zihet fryma... Ne kemi nevojë për luftë çlirimtare dhe për bashkim kombëtar, me të cilin njëherë e mirë zgjidhim çështjen shqiptare si duhet dhe jo për broçkulla të paqes...

- Nuk është fjala për dokrra, por për sjellje të përgjegjshme historike në përputhje me rrethanat që shfaqen dhunshëm nga jashtë dhe ndaj tyre duhet vepruar me mençuri, ku çdo ndërtim i brendshëm duhet të paraqesë një hap tjetër drejt mëvetësisimit dhe jo rrezikimi i saj me axhamillëqe, që mbesin në fyt...Tekefundit, bashkimin kombëtar, edhe po qe se një ditë bëhet dhe, ç'është e vërteta, duhet të bëjmë çmos të arrihet, nuk duhet parë si shuarje të dhunshme të identiteteve të brendshme të krijuar në rrethana të ndryshme kulturore, shoqërore dhe politike, siç është shteti i Kosovës, i shpallur në përputhje me vullnetin e qytetarëve të saj, por si pjesë të një marrëveshjeje demokratike, ku do të ruhen këto veçori si pasuri e përbashkët...

- Qyqarët dhe tradhtarët e kanë humbur të drejtën të flasin për luftën dhe për ardhmërinë...

Me siguri se grindja me Neki Rremën atë natë do të arrinte pikën e ndezjes dhe do të mund të merrte fund me të keq, po të mos ishte Nuri Bani - një gazetar i ri dhe tejet i guximshëm që informonte për "Zërin e Amerikës", i cili, pasi kishte marrë pak nga ato që ishin thënë aty, ndërhynte me fjalë të buta dhe përherë të matura, se kishin nevojë për pajtim dhe jo për grindje dhe i kishte ulur në tavolinë, ku rëndom poetesha dhe këngëtarja e njohur Shpresa Kamberi me sharmin e saj ishte në gjendje të fashiste edhe grindjet më të mëdha.

- Kërkoni sherr...? Jua them unë se ku mund ta gjeni...

Kur kishte folur kështu, madje këtë e kishte theksuar me njëfarë nënçmimi që u bëhet mburracakëve, çfarë aty kishte me bollëk, kishte bërë me shenjë nga jashtë, pikërisht në pjesën përballë, ku rëndom rrinin autobлиндat e patrullave të policisë serbe dhe prej atje err e terr mbikëqyrnin udhëkryqin që lidhte pjesën nga Qendra e Studentëve me atë që shpinte nga rruga drejt Institutit Albanologjik për te semafori i qendrës...

- Doni të shkoni atje...?

Vëllaznimi nuk kishte folur, por ishte larguar si i thyer.

Kur kishte dalë jashtë, ajri i ftohtë i mbrëmjes së dhjetorit përnjëherë i kishte përjashtuar nga koka çdo gjë, përpos atyre që Neki Rrema i kishte thënë për të atin, sa t'i dukeshin të atilla që ishin për ta çuar në një askundje, në të cilën duhej të mbeste përgjithmonë i ngrirë.

Iu bë se në atë rrëshqitje në askundje me ngrirje, pranë e pranë po i shfaqej edhe Gjyshi i Madh bashkë me ata që kishin udhëhequr ato lëvizjet e përgjakshme për pavarësinë, të cilët mbanin nga një plumb, i cili në gjoks, si dekoratë, u rrinte me fjalën "tradhtar" dhe "tradhti"...

Atë natë, sikur kishte humbur busullën edhe më tepër nga përfytyrimi i Gjyshit të Madh dhe i bashkëluftëtarëve, të cilët i shfaqeshin të ngrirë në atë askundje të mjegulluar me ato fjalët për tradhtinë që u rrinte si dekoratë...

I dukej se Gjyshi i Madh po i fliste rreth një pështjellimi të pashoq, ku sekush ndërhynte pa ditur gjë dhe në atë lesheli e bardha shihej si e zezë, ndërsa e zeza e bardhë dhe çmos tjetër dhe, ç'është edhe më keq, ai i ankohej që më tepër se disfatat dhe humbjet e përjetuara, ngase ashtu si kishin shkuar punët edhe i kishte pritur - e kishin qëlluar ato ndërkëmbjet e brendshme, ku e drejta që të flitet ishte kthyer në të drejtë për fyerje dhe për sharje të ulëta, ku sekush që ishte sjellë në periferi a kudo qoftë, po edhe që mund të kishte qenë pjesë e ndonjë veprimtarie të çfarëdoshme dhe nuk kishte qenë në gjendje të shihte tjetër, pra të tillët, në ato rrethana të vendosjes së gjendjes kalimtare, me ato shpifje, me ato llomotitje e njollosje të të gjitha vlerave të krijuara me mund, sikur kishin marrë përsipër të bënë atë punën që u kishte mbetur në gjysmë armiqve, të cilët ishin në rrugë e sipër ta çonin deri në fund...

Një copë herë ishte sjellë pa ditur se ç'ishte ajo që do të mund t'ia kthente, së paku atë pjesën e rebelimit krijues, qoftë si duf ngushëllues a diçka të ngjashëm, që e zbrazte në ato vargje dhe pastaj i thoshte në kafe "Syri", po që dhe ia përsëriste vetes kur shembej në shtrat dhe ato i ngatërroheshin, sa në pamundësi që t'ua ndiqte rimën, shpesh i vinin si të vrazhda, që duhej flakur sa më parë...

Por, atë natë të ftohtë dimri, nga sharrimi përfundimtar në atë gjendjen e askundjes, që ngjashëm do ta hetojë më vonë, kur do të ndodhet në Tetovë dhe pastaj edhe në Shqipëri dhe nëpër ato bredhje në qendra të strehimit të të dëbuarve me dhunë, do të ndjehet si refugjat në vend të vet, e kishte shpëtuar Miranda Vala, që sapo e kishte takuar te Xhamia e Llapit, e cila, sikur t'ia kuptonte gulfën që e kishte mbërthyer dhe madje t'ia kishte dëgjuar edhe ato që ishin thënë prej Neki Rremës, e kishte zënë për krahu dhe ashtu heshtazi e kishte dërguar në atelie, që ndodhej në pjesën ku dikur ishte selia e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, e më vonë edhe vendstrehim i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe e të gjitha partive të tjera që kishin dalë pas saj dhe ndodheshin në krye të asaj lëvizjeje që kishte marrë përsipër atë që shfaqej si shtet paralel...

Aty kishte parë disa trupa nga allçia, të shumtën të mbetur përgjysmë si dhe disa modele të tjera të shtrira në letra të mëdha, që ia kishin krijuar përshtypjen e një bote të shkapërderdhur qëllimisht, që ashtu ruante shqetësimet e veta të brendshme, por edhe të jashtme.

- Kjo është bota ime e pakryer - i kishte thënë ajo dhe ia kishte bërë me dije se me gjasë përherë do të mbetej e tillë dhe këtë ia kishte arsyetuar me bindjen se sikur kishte parandjenjën se i takonte një gjenerate fatkeqe që do ta ndjekë mallkimi i thyerjeve të pandreqshme...

- Sikur jemi krijuar të mbesim as andej as këndeje... Askund...

Vëllaznimi edhe më tutje kishte përparë atë akullnajën, bashkë me ata që në atë ngrirje të asaj hapësire të askundjes ruanin plumbat dhe ato stolitë në gjoks si tradhtar. Iu duk se ca nga truporet nga allçia, sikur ishin pjesë e asaj ngrirjeje dhe, ndër më të shkallmuarit shihte Gjyshin e Madh me ato plagët vdekjeprurëse që i kishte marrë në atë sheshin e Selanikut nga plumbat e atij që i kishte thënë se vinte t'ia sillte një përsëritje për "meritat e mëdha" dhe, ndër ato merita që sillte, ishte dënimi me vdekje, i marrë nga shumë qendra njëherësh (Tirana-Beogradi), qofshin ato edhe të papajtueshme mes vete dhe në armiqësi të hapur me njëra-tjetrën, që ai e kishte zbatuar me gjakftohtësi të madhe dhe pastaj në atë mbrojtjen që e kishte dhënë para gjyqit grek, ishte arsyetuar se me atë veprim "kishte penguar një tradhti të madhe kombëtare"...!

- Këtu sillem si të dua dhe, ndonëse më shumë prish sesa ndreq, askush nuk më hidhërohet - i kishte thënë Miranda gjithë qetësi.

Vetëm pasi kishte zbrazur gotën e dytë të rakisë së rrushit, Vëllaznimi kishte filluar t'ia kuptonte fjalët që Miranda Vala ia thoshte rreth atyre prishjeve që i shkaktonin njëfarë ngushëllimi dhe kjo pastaj i kishte ngjarë sikur fjala ngushëllim i ishte kthyer në kënaqësi, po që tash këtë ia thoshte Neki Rrema me gojën e saj...

Ngatërrimi i ngushëllimit dhe i kënaqësisë sikur i kishte sjellë rëndim koke dhe pastaj njëfarë kllapie që e kishte plandosur dhe në atë gjendje të mjegulluar kishte mbetur deri të nesërmen në mesditë, kur e kishte zgjuar zhurma e madhe e një muzike me vegla frymore, e cila sikur lëvizte dhe zbrazej diku për t' u kthyer sërish edhe më e fuqishme në atë hapësirë të vogël.

Miranda Vala i kishte thënë se ishte parakalimi i romëve të Serbisë, të cilët atë ditë, për nder të fillimit të ndërtimit të kishës ortodokse serbe në qendrën universitare, për pak kohë kishin lënë sallën kryesore të qendrës tregtare “Boro e Ramizi”, ku mbahej festivali ballkanik i bandave muzikore të romëve me bori dhe ishin derdhur rrugëve kryesore, që asaj ngjarjeje t' i bënin jehonë të veçantë, ashtu siç kishte kërkuar edhe kryepeshkopi i kishës ortodokse, Pavle, i cili personalisht kishte bekuar themelet e kishës me fjalët se ajo ishte tempull i shenjtë i përhershëm serb në vendin, që prej tij ishte quajtur “djep i Serbisë...” dhe kishte kërkuar të rikthehej me të gjitha mjetet...

- Vërtet, ditë e mirë për vetëmburrje - i kishte thënë Miranda Vala.

VII

Miranda Valën, sikundër edhe poeteshën dhe këngëtareshen e talentuar Shpresa Kamberi, nuk ia kishte dalë t' i takonte, edhe pse kishte humbur dy ditë në kërkim të gjurmëve të tyre, siç nuk kishte takuar as disa të tjerë, që për vite kishin ëndërruar dhe kishin ushqyer gjithfarë iluzionesh bashkë me frikën, që mundoheshin ta përballonin me shprehjen e dufit të papërmbajtur...

Nga Kujtim Bardhi, një mik i ngushtë i Mirandës, me të cilin prej vitesh kishin jetuar bashkë dhe thuhej se kishin një marrëveshje fare të lirë, të ngjashme me atë që në disa vende hyjnë çiftet e pavarura, kishte kuptuar se gjatë luftës ishte sjellë diku në rrethinën e Prishtinës, por që pas përfundimit të saj, kur ishte kthyer dhe kishte dashur të fillonte punën, aty ku e kishte lënë, në atelie që e kishte nën mbikëqyrje nga skulptori i njohur profesor Gëzim Qafa - me shpresën se, si thoshte, “në liri do t' u jepte frymë gjithë atyre veprave që i kishte lënë të pakryera qëllimisht” dhe ishin në përputhje me bindjen që kishte se në rrethanat e robërisë edhe arti duhej ta paraqiste gjendjen e asaj frymëmarrjeje të rëndë, pra që asgjë të mos mbetej e kryer ngaqë ashtu i tradhetohej fryma, që mund t' i jepte alibi edhe dhunës dhe të ngjashme si këto - nuk u kishte besuar syve, kur në vend të ateliesë që nuk ishte, kishte parë një ekskavator të madh që zhvendoste dhe nga një anë në një tjetër dhe që me një punë të tillë sikur kishte zhdukur aty një pjesë të madhe të punimeve, ndërkohë që, edhe ato që kishin mbetur, ishin bartur në anën e stadiumit të qytetit, ku tashmë ishte krijuar një grumbull i madh mbeturinash gjithë fare, nga ato të luftës e deri tek të tjerat që ishin hedhur nga ata që pastronin shtëpitë pas kthimit.

Meqë fillimisht i kishte shkuar mendja se atelieja mund ta kishte pësuar nga ndonjë bombë nga qielli, e hedhur qëllimisht në atë pjesë ku gjendej komanda e forcave policore dhe ushtarake serbe dhe prej andej për vite të tëra ishte udhëhequr dhuna shtetërore por edhe lufta e tyre, Miranda kishte mbetur si e shtangur dhe, e para gjë që i kishte shkuar në mendje, ishte bindja se lufta, si çdo luftë që nuk kursen asgjë, ia kishte marrë një pjesë të krijimtarisë, siç ua kishte marrë të tjerëve gjërat më të shtrenjta e edhe jetën, andaj duhej menduar për anën tjetër, atë që lufta, me heqjen e vrasësve, kishte krijuar rrethanat për krijimtari të lirë dhe për jetë, gjë që ashtu duhej parë edhe realitetet e atyre ditëve, pa marrë parasysh dëmet dhe të papriturat. Por, pas pak kishte vërejtur se prishja e ateliesë dhe e objekteve të tjera përreth nuk ishte vepër e luftës, por e pasluftës, e atyre që pa mbaruar ajo mirë, kishin nxituar t' i shtrinin rrënjët kudo dhe ngado me anën e përvetësimeve të njëanshme dhe marifeteve të tjera, pa çarë kokën se ashtu rrënonin shumë vlera të shtrenjta dhe të pakthyeshme fare.

Me këtë përshtypje, e shfrenuar dhe me britma që të ndaleshin, se ashtu rrënonin krijimtarinë e saj dhe të të tjerëve, kishte vrapuar deri tek ata që me disa letra në duar matnin diçka dhe vazhdonin t' i vendosnin telat edhe më tutje nga ana e stadiumit dhe u ishte drejtuar,

po ata nuk ia kishin vënë veshin, duke u shtirë sikur nuk e vërenin fare, por vetëm pasi i kishte dalë përpara ekskavatorit dhe kishte rrezikuar ta merrte me vete, ai që e drejtonte kishte ndaluar dhe gjithë hidhërim i kishte thënë se nëse e kishte ndër mend të bënte vetëvrasje, atëherë të gjente ndonjë vend tjetër, e jo aty ku ai me punë fitonte bukën.

Ajo mezi kishte marrë veten dhe ia kishte bërë me dije se aty ishte një atelie shumë e rëndësishme dhe me vlera të mëdha që i takonte skulptorit të njohur profesor Qafa, që para se të vdiste, (para dy vjetësh), ia kishte lënë në mbikëqyrje të plotë, me kërkesën që derisa të vazhdonin ato rrethana, ta shfrytëzonte sikur ta kishte të veten dhe pastaj, siç i kishte thënë, kur të vinte ajo dita e madhe (kishte menduar për ditën e lirisë), t'ia kthente Akademisë së Arteve dhe se për këtë kishte gjithë dokumentacionin e duhur nga avokati i profesorit, që ishte kovertuar si duhej...

Ekskavatoristi as që kishte çarë kokën për ato që i thoshte Miranda për skulptorin e njohur dhe për veprat e çmueshme të tij, që qëllimisht ishin lënë aty të mos binin në sy dhe më vonë duhej t'i dorëzoheshin fondit të Galerisë së Arteve të Kosovës, sapo ajo të rihapej. Kishte vënë buzën në gaz dhe i kishte thënë se aty nuk kishte parë kurrfarë punimesh të hajrit, përpos ndonjë cingu që nuk i ha as oxhaku më grykës, se edhe po të shihte diçka të ngjashme, me siguri se do ta nxirrte prej andej pa një pa dy, ngaqë aty, në saje të një kontrate që kishte lidhur me punëdhënësin, të cilit ia kishte shqiptuar zëshëm emrin dhe mbiemrin, që t'ia bënte me dije se me kë kishte punë, ishte që të hapte themelet e hotelit "Liria", që parashihej të ishte njëri ndër më të mëdhenjtë në atë pjesë të qytetit, pa marrë parasysh se ajo hapësirë përherë njihej si "strehë" e krijuesve, me disa atelie, e në mesin e tyre ishte edhe ajo baraka e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, në të cilën shtatë-tetë vjetët e fundit ishin zhvilluar të gjitha aktivitetet e rëndësishme intelektuale dhe ato politike, që i ishin kundërvënë propagandës serbe, e ku ishte themeluar edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, e pastaj ishin mbajtur edhe ato takimet e para historike me kongresmenët dhe senatorët amerikanë dhe me përfaqësuesit e Parlamentit Europian, ku i ishte dhënë përkrahja lëvizjes intelektuale për barazi dhe demokraci dhe gjithë asaj që shumë shpejt do të kthehet në një lëvizje të madhe të rezistencës gjithëkombëtare kundër dhunës serbe.

- Unë bëj punën time dhe nuk çaj kokën për tjetër - i kishte thënë Mirandës, e cila edhe një herë atyre që mbanin ato letrat në duar dhe kryenin matjet, u ishte drejtuar për ndihmë, por ata as që ia kishin vënë veshin.

E vetmja gjë që i kishte mbetur Mirandës ishte përpjekja që disi t'i shpëtonte ato pjesët e thyera të disa punimeve në dru dhe një skulpturë të profesor Qafës, ndër ato të rëndësishmet, të cilat, sapo kishte bërë denoncimin ashtu si kërkohej në rastet e tilla, ia kishte lënë në mbikëqyrje oficerit të trupave angleze, që ato ditë kishin hyrë në Prishtinë dhe ai kishte treguar mirëkuptim për to, por që nuk kishte qenë në gjendje t'i ndihmonte as ta ndalonte që në vendin ku kishte atelienë të ndërpriteshin punimet e atij që ashtu krye në vete kishte ndër mend të ndërtonte restorant, e as të ndërmernte ndonjë hap tjetër që së paku juridikisht të mbrohej, ngaqë ata nuk kishin autorizime për veprime të tilla.

I kishte thënë se duhej pritur që këtë ta bënte administrata e UNMIK-ut, e cila ishte në vendosje e sipër dhe sigurisht se i duheshin kohë që të vendoste rregull aty ku së pari kishte filluar të prishej më së keqi, siç ishin uzurpimet e shumta të banesave, të shtëpive dhe të pronave të ndryshme, nga ato private e deri tek ato shoqërore nga ana e komandantëve të vetëshpallur dhe luftëtarëve të shpifur që u shfaqen si këpurdhat pas shiut bashkë me ndërtimet e egra, që, si shihet, do të vazhdojnë edhe atëherë kur formalisht ishin plotësuar kushtet për njëfarë rregulli, por kjo nuk kishte ndodhur, ngaqë ishin aktivizuar marifetet e reja me lejet e vjetra, pra ato të regjimit serb dhe të administratës së dhunshme, që ishin përdorur me mjeshtëri nga spekulantët e shumtë, të cilët me gjasë se edhe paraluftën, e edhe luftën, e kishin shfrytëzuar për hesape të tilla dhe shpejt e shpejt i kishin nxjerrë edhe pas luftës, me çka u ishte hapur udha atyre ngatërresave të shumta dhe të ndryshme, që, në vend se të hiqeshin, kishin vazhduar dhe të shumtën ishin shfrytëzuar nga përfitues të luftës dhe shtresa

të ngjashme, e cila kishte bërë çmos që ato rrethana të megjulluara të vazhdonin sa më gjatë...

Kujtim Bardhi i kishte thënë se atë natë me Mirandën kishin ndenjur ashtu të thyer deri në mëngjes në kafe “Shqiponja” (ish - “Syri”) dhe nuk ia kishte dalë ta kuptonte tamam se në ç’gjendje ndodhej ajo: a ishte buzë shkallmimit, që mund të merrte fund me ndonjë rënie të plotë apo ndodhej afër një çmendjeje, në pritje të atij shpërthimi, kur humbet busulla fare dhe çdo gjë është e mundshme...

Sidoqoftë, Kujtimi i kishte thënë se dikur në mëngjes ishin ndarë ashtu të heshtur, sikur të ktheheshin nga ndonjë varrosje, ku kishin lënë përgjithmonë diçka që i kishte lënë pa të sotme dhe pa të nesërme, qenie të zbrazura...

Me një përshtypje të tillë ajo kishte ndjekur drejtimin që çonte tek atelieja e rrënuar dhe gjithë ato që lidheshin me kujtimin e profesor Qafës dhe me veprën e tij, e cila, me atë sjellje të papërgjegjshme kishte përjetuar një përdhosje të tmerrshme, një rirrënim të pashembullt, kur kjo më së paku pritej. Ndërsa ai, pasi e kishte përcjellë largimin e saj derisa i kishte humbur në atë pjesën që pamjen ia mbulonte ndërtesa e Bibliotekës Universitare, kishte përshtypjen se nuk do të shiheshin më, meqë parandienin se përpara u ishte shfaqur Rubikoni, i cili pas pak u kishte hyrë në mes...

- Është vetëzhdukur dhe si të tillë duhet parë, pa marrë parasysh se a ka përfunduar në ndonjë çmendinë apo në ndonjë batac të përvetshëm - i kishte thënë Kujtim Bardhi gjithnjë me përshtypjen e njeriut të vetëzbrazur nga të gjitha, ndjenjë kjo që sa më shumë kalonte koha, i kthehej në njëfarë bindjeje se ndodhte ashtu ngaqë lufta e jashtme u ishte kthyer në luftë të brendshme, një lëmsh pa fije, ku mund të kishte vetëm humbje dhe dëshpërim të përhershëm, e asgjë tjetër...

Ç’është e vërteta, dëshpërimi i Miranda Valës, të cilën Kujtim Bardhi e kishte quajtur të vetëzhdukur, sikur lidhej me ato parakushtet shumë të volitshme për atë veprim, që atë e bënin fare të mundshëm në dritën e rrethanave të reja. Sepse, ajo që prej kohësh kishte lëvizur nëpër teh të shpatës, ku në njërin anë ishte përballur me konfliktin e pashmangshëm të brezave *etër-bij*, që tek ajo shfaqej si *nënë-bijë* dhe paraqitej më i veçantë, ngaqë ishte fëmijë i një martese të përzier: babai shqiptar (oficer i lartë i ish - armatës jugosllave, të shumtën me shërbim në Sarajevë, i cili në fillim të viteve tetëdhjetë ishte sjellë në Prishtinë dhe pas pak do ta pësojë në një aksident komunikacioni të pasqaruar fare, i cili kishte hapur dyshime se ishte një likuidim, çfarë nga shërbimi sekret serb u bëhej shumë oficerëve të informuar shqiptarë) dhe nëna e deklaruar boshnjake (një grua e pashme nga një familje e njohur e Sarajevës, që kishte origjinë nga Plava dhe kujtimi i saj nuk ishte fikur kurrë, por vazhdimisht ishte ushqyer me mallin për të). Në tjetrën anë, ishte ushtrimi i dhunës shtetërore serbe, që, jo pa qëllim, me atë që quhej pranim publik i lojalitetit të shtetit serb, kishte filluar t’i sfidonte së pari dhe më së tepërmi të ashtuquajturat familje me martesë të përzier, gjë që edhe së ëmës, që vetëm mbante barrën e përkujdesjes për familjen, punësimi i mëtejshëm në postë si inxhinierë i kushtëzohej me pranimin e shtetit serb, që duhej ta bënte me nënshkrimin e një deklarate, ndërkohë që prej andej përjashtoheshin të gjithë shqiptarët, që po s’e bënte, atëherë nuk i mbetej tjetër veç të merrte botën në sy si refugjate, pa ditur se çfarë do t’i sillte e nesërmja, ku të qartë e kishte vetëm mbijetesën dosido në një botë fare të panjohur dhe të huaj, ku do të kursehej prej përkatësisë etnike që kthehet në kob...

Natyrisht se pas bisedës që kishin pasur nënë e bijë për mundësinë që duke u larguar përkohësisht, mbase do të mund t’i shmangnin problemet që hëpërhë u dukeshin të papërballueshme, ishin përcaktuar për këtë të dytën, edhe pse kishin drujtur se me atë veprim sikur uleshin në një varkë pa rrema, drejtimin e së cilës e përcaktonin stuhitë, e jo ata që ishin në të.

Rruga e refugjatit për to nuk kishte qenë as e lehtë, as e thjeshtë, ngaqë kishte kaluar nëpër sprova të shumta të shërbimeve të fshehta klandestine që i organizonin, të cilët, përpos të holla të shumta, kishin kërkuar edhe durim të madh, veçmas kur duhej të kaloheshin ato

javët a muajt e qëndrimit ilegal në vende të caktuara (Poloni a Çeki), që shfaqeshin me gjithfarë peripecish të pabesueshme të shkaktuara nga klandestinë të shumtë, që emërues të përbashkët kishin zhvlerësimin e pashmangshëm njerëzor, aq sa nuk mund të merrej me mend.

Nënë e bijë, duket s në këtë fatkeqësi të rrugës jetësore, kishin pasur njëfarë fati, nëse mund të thuhej kështu, meqë në Poloni, njëri që merrte përsipër punët e kapërcimit të kufirit polako-gjerman, u kishte dalë i njohur dhe kishte ndikuar që të përshpejtohej koha e pritjes nga disa javë në disa ditë, e me këtë të kurseheshin edhe nga ato nënçmimet e shumta dhe vuajtjet që ishin pjesë e kësaj odiseje.

Miranda Vala, që atë aventurë e kishte bërë kur kishte qenë vetëm gjashtëmbëdhjetëvjeçare dhe në kokë kishte pasur përfytyrimin se ndoshta në Perëndim mund të gjendej ilaçi për të gjitha ato që në vendlindje shfaqeshin si vështirësi të pakalueshme, sidomos kur lidheshin me anatemën e martesave të përziera dhe të pasardhësve të tyre, mbi të cilat nga të gjitha anët rëndonte njëfarë dyshimi i çuditshëm, shpejt ishte dëshpëruar, jo vetëm në saje të trajtimit të refugjatit, që ia kishte krijuar bindjen e përkatësisë së një numri të thjeshtë dhe të pavlefshëm fare, ku mëshira shfaqet si mbrojtje e padinjitetshme, por edhe për shkak se ishte ndjenja se ai largim e kishte privuar nga diçka shpirtërore, e cila ishte në gjendje të vepronte vetëm në rrethanat e atjeshme, pa marrë parasysh ato që ndodhnin dhe të shumtën dëbonin ata që kishin mundësi këtë ta bënin.

Këtu zaten, kishin filluar ato fërkimet nënë-bijë edhe ashtu të thadruara me ngarkesat e deriatëhershme, që shumë shpejt ishin kthyer në mospajtime të hapura dhe kishin çuar edhe në ndarje, me ç'rast ajo pas gjashtë muajsh ishte kthyer në Kosovë, që, si kishte thënë sa e sa herë gjatë atyre dehjeve të netëve të gjata në kafe "Syri", "të rritej me sfida e sprova me gjeneratën e vet dhe të provonte fatin aty, pa marrë parasysh se me ç'sy do të shihej", ndërkohë që e ëma kishte mbetur atje, me bindje të plotë se ai ishte vendim i dhembshëm, por i vetmi i drejtë në ato rrethana, kur ajo kishte humbur edhe të djeshmen, por, mbi të gjitha, edhe të nesërmen dhe, meqë mund të merrej me mend se pa ndonjë vështirësi kishte fituar edhe statusin e të përndjekurve politikë, me këtë edhe lidhjet e tyre do të ndërpriten përgjithmonë, por që do t'u mbetej e hapur plaga dhe ajo hija që një ditë do t'i përpijë njësoj, sikur ta kishin mallkim të pashmangshëm...

E vetmuar, por me bindjen se ashtu rritej dhe ndërtonte diçka të veten në përputhje me dëshirën që të merrej me krijimtarinë, që i flinte përherë – pra, nga tërësia e masës (guri, druri e të tjerë) të ndërtonte lidhje të brendshme të qëndrueshme, që vetëm arti, me jetësimin e përherëshëm, që mund të shkojë deri tek e madhërishmja madje, mund t'i mbronte nga rrënimet e përditshme - Miranda Vala kishte filluar të studionte skulpturën në klasën e profesorit Gëzim Qafa, që ishte një skulptor i njohur, i cili edhe shtëpinë, bashkë me atelienë në të dalë të Prishtinës, ia kishte lënë në shfrytëzim të plotë Akademisë së Arteve dhe kështu, pas dëbimit të studentëve nga ndërtesa e Akademisë së Arteve, ia kishte dalë ta mbronte nga shuarja degën e skulpturës.

Gjatë kohës së bredhjeve të përditshme në drejtim të ateliesë së profesor Qafës në të dalë prej Prishtinës, kishte njohur Kujtim Bardhin, i cili asokohe, si mjek i përjashtuar nga Spitali i Prishtinës pse nuk kishte pranuar të nënshkruante lojalitetin ndaj regjimit okupues serb, si shumica e kolegëve, përpiquej që në disa katunde të mbikëqyrte shëndetin e atyre që kishin nevojë për ndihmën e tij, me ç'rast edhe udhëtonte çdo ditë pa ndonjë përtesë.

Ashtu si të tjerët që kishin gjithfarë idealesh, që sado binin ndesh me rrethanat e dhunës serbe, edhe Miranda e Kujtimi kishin gjetur prehje nën strehën e bodrumeve, me ç'rast njëra ndër pikëpjekjet e pashmangshme shpinte tek kafe "Syri" dhe atmosfera që krijohej aty.

Aty ishin njohur e ishin shoqëruar dhe, bashkë me të tjerët, një kohë të gjatë kishin përjetuar emocione, shpresa, dëshpërim, po që njëherësh, përballë gjendjeve krijuese, nëpër të cilat kishin kaluar, kishin pleksur me to përfytyrimet, me të cilat ishte bërë përpjekje që asaj

t'i ikej qoftë edhe me anën e atij dufi, i cili ishte zbrazur në forma të ndryshme, por që me kohë ishte kthyer në një prehje, me të cilën ishte frymëzuar edhe ajo revolta që i duhej asaj kundërvënie, me të cilën ai durim i pafundshëm, që fillimisht thuhej se ishte i domosdoshëm për atë vetëdëshmimin civilizues dhe shtetformues, kthehej në një lëvizje që, si do të shihet, do të shtrihet deri atje sa t'i kundërpërgjigjet dhunës me të gjitha mjetet e tjera, që më në fund do të përshkallëzojë me kundërvënien e armatosur, që ishte e pashmangshme.

Bisedat me duf me Mirandën, Vëllaznimit ia kishin krijuar përshtypjen se ajo e donte luftën, ngaqë mendonte se ashtu mund të parandalohej ajo që tashmë ishte kthyer në makineri vrastare (këtë përshtypje në njëfarë ankthi ia kishte krijuar masakra e Srebrenicës dhe të tjerat që kishin ndodhur në Bosnjë dhe mund të vazhdonin edhe në vende të tjera, të shpallura toka të shenjta serbe, pa marrë parasysh se për sy e faqe mbroreshin nga faktori ndërkombëtar, siç ishte OKB-ja me vëzhguesit dhe helmetëkaltrit e saj të pafuqishëm fare), por njëkohësisht kishte frikë të madhe prej saj, ngaqë thoshte se ajo rëndom, krahas thikave, me të cilat synohet shfarosja, sillte edhe shpronësime të tmerrshme, në radhë të parë shpirtërore, që të shumtën e herëve mbesin të pashërueshme...

Përfytyrimin e gjakut, bashkë me të papriturat e tjera që sjell ajo si plagë të pashërueshme, e kishte edhe nga ato që i kishte dëgjuar nga e ëma rreth tragjedisë së familjes së saj në Sarajevë, që ishte me prejardhje nga Plava dhe e fisit të Ali Pashë Gucisë, nga, pas disfatës që kishin pësuar forcat e Lidhjes Shqiptare nga osmanët, gjatë fushatës që ishte ndërmarrë nga Dervish Pasha dhe forcat e tij që ishin futur kudo, bashkë me shumë e shumë të tjerë kishte qenë e detyruar të largohej në drejtim të perëndimit dhe të kalonte në pjesët që i mbikëqyrte Vjena, me ç'rast u ishte dhënë strehim në Sarajevë dhe dukej se pak kishin marrë veten, por që edhe atje nuk kishin gjetur qetësinë e duhur, ngaqë pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, me hyrjen e forcave serbe në atë pjesë, nga falanga e tyre kishin filluar vrasjet e njëpasnjëshme, të cilat kishin goditur familjet e pasura, në veçanti familjet e ardhura nga pjesët lindore dhe nga veriu i Shqipërisë, mbi të cilat ushtrohej presion i vazhdueshëm për t'u shpërngulur në Turqi dhe që, ç'është e vërteta, një pjesë e tyre e mirë kishte marrë atë udhë. Ndër ata që me çdo kusht dëshironin të mbeteshin, ishte edhe gjyshi, i cili disi ia kishte dalë të mbronte familjen e vet, por që edhe asaj qëndrese, pas Luftës së Dytë Botërore i kishte ardhur fundi, kur gjyqi revolucionar i partizanëve, pasi ia kishte konfiskuar punëtorinë e duhanit, e kishte dënuar me varje, si kulak, ndërkohë që i biri dhe vajza, si të mitur, ishin dërguar në një kamp pune nga ato të shumta që i shërbenin atij që quhej "edukim socialist", ku ishin mbajtur për vite të tëra dhe, kur ishin kthyer që të gjallonin disi, ishin detyruar të punonin çmos, punë që i kishte thërrmuar, që megjithatë do të marrë fund përgjithmonë me atë masakrën e madhe që forcat serbe kishin bërë në Ilixhë në fillim të asaj lufte, kur kishin shpallur Republikën Serbe të spastruar nga boshnjakët dhe të tjerët...

Rasti i Shpresa Kamberit, poeteshës dhe këngëtares së talentuar, që paraqiste shembullin më tipik të gjeneratës fatkeqe të bodrumeve dhe të gjithë asaj që ishte pjesë e jetës paralele, duket se ishte edhe më tragjik se ai i skulptores Miranda Vala, të cilën Kujtim Bardhi e merrte për të zhdukur shpirtërisht dhe kjo ndërtonte atë metaforën, me të cilën mund të përmbledhej fati i një pjese të mirë të krijuesve, por edhe të të tjerëve, që dalja nga errësira e bodrumeve dhe e katakombeve, ku për vite të tëra ishin sjellë me gjithfarë përfytyrimesh dhe iluzionesh, në hapësirën e asaj që ishte quajtur realitet në rrethana të paqarta të gjendjes kalimtare, të shumtën i kishte dëshpëruar, jo vetëm pse nuk kishin qenë në gjendje të përballeshin me atë ndryshim, që në të vërtetë ishte kërkuar dhe mirëpritur, si kthesë e domosdoshme, e cila do t'ua hapte udhën të tjerave - por për më shumë, pse ata, në një gjendje të atillë, të ngjashme me peshkun pa ujë, jo rrallë ishin ballafaquar me nënçmime dhe zhvlerësime të paimagjinueshme nga ana e atyre që mendonin se, meqë në atë kohë të mbijetesës së rëndë gjatë ushtrimit të dhunës serbe shumë prej tyre dufin krijues, qoftë edhe të pakontrolluar mirë, e kishin vënë në shërbim të ngritjes së moralit dhe kishin qenë ndër ata që

në masë të madhe shpirtërisht e kishin frymëzuar kundërvënien, e cila do të kthehej në një rezistencë të armatosur, ishte e natyrshme të mendonin që ata edhe më tutje mund të përdoren dhe shpërdoren për nevoja ditore dhe, pse jo, po të jetë nevoja, të kthehen edhe në tellallë të thjeshtë...

Shpresa Kamberi si poeteshë dhe këngëtare e talentuar, mund të thuhet se me poezitë e saj, por për më tepër edhe me zërin e ëmbël, viteve të fundit, në një mënyrë të veçantë kishte ushqyer vetëdijen e kundërvënies, duke e bartur atë nga kundërvënia institucionale-paqësore tek ajo aktive, gjithnjë duke e parë të ndërlidhur dhe pjesë të së njëjtës, pa të cilat nuk mund të arrihej ajo që tashmë për secilin shfaqej qëllim madhor historik. Me vargjet meditative, që fillimisht i shoqëronte me meloditë, që i kompononte dhe i përcillte me kitarë (së voni nga një xhazist dhe saksafonist kishte krijuar edhe grupin ABC), ajo ishte munduar që gjithë atë përpjekje këmbëngulëse për mbijetesë, e cila zhvillohej nëpër bodrume dhe sipas saj nuk kishte alternativë, ta nxirrte nga nënçmimi i përditshëm që ia sillte dhuna dhe ta ngrite në një filozofi të kundërvënies, siç ishte në të vërtetë, e cila duhej të kishte qëllime dhe vizione, por, mbi të gjitha, ta ruante edhe ndjenjën e krenarisë dhe të sakrificës së përhershme për to, që, si do të shihet, nuk ishte punë e lehtë të bëhej nga shkak i vetëm se kohën e kishte kundërshtar kryesor...

Në kafe “Syri” paraqitja e Shpresa Kamberit pritej gjithnjë me interesim të jashtëzakonshëm, ngaqë ndër të gjithë krijuesit, ku kishte gjithfarë tuhafësh dhe tarafesh, që vetëm kur bëheshin xurxull ishin në gjendje të ngritin zërin dhe të liroheshin nga bezdia e çdoditshme, ia dilte që vargjet dhe melodinë t’i plekste me porosi të qarta, që ndjeheshin, pranoheshin dhe barteshin si diçka e veçantë, me frymëzim dhe kuptim...

Andaj, edhe ishte e arsyeshme që Shpresa Kamberi ishte kthyer në një ikonë, e cila vepronte njësoj edhe te studentët e revoltuar, që mezi prisnin t’u jepeshin atyre demonstratave dhe protestave, (si në shtator të nëntëdhjeteshtatës, me të cilat, pas tri-katër vjetësh “qetësie” do të kërkohej kthimi në ndërtesat e fakulteteve, me të cilat do të fillojë thyerja e asaj gjendjeje të status kuos, që kishte zgjatur që nga Marrëveshja e Dejtonit e tutje dhe vlerësohej se po vazhdoi, mund t’i shkonte për shtati regjimit të Beogradit, veçmas kur ishte kthyer në një faktor kyç implementues). Por, ajo vepronte edhe te pjesa tjetër e të rinjve dhe e intelektualëve të përfshirë nëpër institucionet paralele, që vepronin ditë e natë me përgjegjësi të madhe në përmbushjen e detyrave të marra, ani pse përballeshin me kërbacin e ashpër të dhunës serbe dhe po ashtu kishin filluar të mëdysheshin në mos e gjitha e asaj sjelljeje, pa veprime aktive dhe me parullën e durimit të përhershëm, mund të degjeneronte në një stërkeqje, nga e cila nuk do të dilte gjë prej gjëje, përpos pranimi të nënshtimit si vetëdije e caktuar, me të cilën mund të jetohej përherë...

Por, si edhe të gjithë të tjerët, që kishin lindur dhe jetuar në ato rrethana të paqëndrueshme, me plot e përplot dilema që zgjateshin dhe stërzgjateshin deri në pakufi dhe ku vetëm pasiguria ishte e sigurt, edhe Shpresa Kamberi kishte atë “thembrën e Akilit”, e cila mund të qëllohej nga ata që ia kishin frikën dhe kjo lidhej me të atin, i cili për vite të tëra kishte qenë funksionar i lartë në federatën jugosllave, i dërguar nga Kosova me anën e atij “çelësi” të kuadrove, ku kishte mbetur edhe pasi ishte bërë ajo shkëputja përfundimtare e çdo lidhjeje të Kosovës me federatën e mbikëqyrur nga Beogradi pas shpalljes së referendumit për pavarësinë, në shtator të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një.

Edhe pse thuhej se shkak i mbetjes kishte qenë një lidhje martesore me një hungareze nga Novi - Sadi, që e kishte pasur udhëheqëse të kabinetit, Shpresa Kamberi nuk e kishte marrë gjithaqë tragjike ndarjen nga i ati, sepse në familjen e saj ajo ndarje, në njëfarë mënyre, vepronte që prej vitesh dhe ishte e pashmangshme, por që shkuarja në Beograd si funksionar i federatës, e kishte kthyer në një fakt të kryer, ngaqë midis prindërve ishte lidhur një marrëveshje e brendshme e ndarjes, që, për hir të vajzës, nuk do të bëhej zyrtare, por ishte punë e përfunduar...

Duket se Shpresa Kamberi nuk ishte shqetësuar gjithaq nga ajo që kishte ndodhur midis prindërve, meqë vlerësonte se edhe dashuritë, edhe martesat dhe çfarëdo tjetër ishin çështje jetësore dhe si të tilla edhe mund të ndodhnin, po edhe të lëndonin njëkohësisht, veçmas kur përcilleshin me sprova të ndryshme të kohës, që nuk është e thënë se mund të përballohen gjithnjë si duhet. Andaj, nuk ishte e rastit pse ajo jo rrallë thoshte se lidhja për dashuritë e rreme, me arsyetime të ndryshme, është më e rëndë se pasojat e tyre.

Mbase, nga e gjithë kjo përvojë familjare, ajo kishte ruajtur druajtjen e lidhjeve të përhershme dhe atyre të qëndrueshme, të cilat i shihte si kurth, nga duhej për të ikur sa më shumë që të jetë e mundur, e që në njëfarë mënyre ua kishte përcaktuar edhe kahun sjelljeve tepër të lira, që ajo kultivonte edhe në ato rrethana, kur dukej se për pasojë kishin frikën dhe shqetësimin para ardhmërisë së pasigurt...

- Lidhjet më të qëndrueshme janë ato që e pranojnë të paqëndrueshmen si pjesë të të qëndrueshmes - i kishte thënë me një rast Vëllaznimit, kur ai i kishte folur për afrinë me Lindën, të cilën ai do të dëshironte ta kthente në diçka të përhershme, ngaqë ndjente nevojë për diçka të tillë...

Ngjashëm ishte shprehur edhe për martesën dhe të tjerat, që pak nga pak ia kishin krijuar imazhin e femrës që me çdo kusht kërkonte alternativën edhe në familje dhe kudo, jo si rrënim, por si ndryshim të domosdoshëm që do t'u përshtatej rrethanave të reja, atyre që, si thoshte, "kur bota shndërrohet në një katund të madh", kërkojnë qëndrime të tjera, të cilave nuk mund t'u shmangesh edhe po dëshirove...

Andaj, nuk ishte e rastit pse gjithnjë më shpesh quhej edhe poeteshë dhe këngëtare e "alternativave", me ç'rast në atë thes futej edhe ajo që ishte kthyer në përcaktim të jetës paralele, që paraqiste edhe atë thelbin e kundërvënies paqësore me institucionet përkatëse: që nga arsimimi, shëndetësia, përkujdesja sociale, informimi, të cilat kishin shkuar edhe deri te krijimi i qeverisë, që kishte dalë jashtë dhe të tjerat, me të cilat, më vonë ishte krijuar edhe ai mentaliteti i bodrumeve dhe ai pikëvështrim i mbyllur, nga mbërthimi i të cilit, shumë prej tyre nuk do të mund të lirohen as pas mbarimit të luftës e as ndonjëherë dhe kjo do t'u kthehej në një mangësi të madhe jete, sa edhe të ndjehen të vetëpërkujtuar prej saj...

Shpresa Kamberi, edhe pse nuk kishte pasur rastin të përjetonte rrethanat që të shpallej e vetëzhdukur, siç do t'i ndodhë Vëllaznim Prishtinës dhe shumë të tjerëve të gjeneratës së bodrumeve, tek ajo kjo thyerje do të shënohet më së ashpri dhe në mënyrën më tragjike. Sepse, siç kishte marrë vesh, të nesërmen kur kishte takuar Lulzim Bakiun - saksofonistin që gjatë viteve të fundit kishte qenë pjesë e pandashme e grupit muzikor ABC, që e udhëhiqte ajo - fillet e atij fundi tragjik do të niseshin me vrasjen e xhazistit Genc Duli, atë natën e njëmbëdhjetë qershorit, kur pas shpalljes së Marrëveshjes së Kumanovës, rusët, thuajse papritmas, nga bazat që kishin në Bosnjë të stacionuar në kuadër të trupave ndërkombëtare me mision të OKB-së, gjatë gjithë ditës kishin parakaluar nëpër Serbi dhe në orët e mbrëmjes kishin hyrë në Prishtinë, ku nga mijëra e mijëra serbë ishin pritur si çlirimtarë. Të trimëruar pa masë me atë ardhje të parë historike të rusëve në Kosovë rreth së cilës do të merret vesh se peshkopët që frymëzonin atë luftë u kishin folur gjatë orëve të përndezejeve shpirtërore me të cilat ushqeheshin gjithnjë e më shumë kohëve të fundit, të tërbuar fare, me gotat e vodkës në duar dhe me britma për Rusinë si mike e përjetshme e Serbisë dhe me parulla të ngjashme që ishin përhapur në të katër anët dhe kishin trishtuar të madh e të vogël, veçmas pse ato vinin kur besohej se kishte marrë fund më e keqja, serbët e dehur kishin filluar të futeshin nëpër disa lagje të Prishtinës dhe mizorisht të vritnin ata që takonin.

Ndër ta kishte qenë edhe xhazisti Genc Duli. Si duket, kishte qenë në rrugë e sipër te vendtakimi i tyre, në një shtëpi të vogël në pjesën e Velanisë, nga ishin marrë vesh të shfaqeshin çastin që trupat e NATO-s do të futeshin në Prishtinë dhe aty të organizonin koncertin e parë me moton: "Përsëritet lirisë..."

Lajmin për masakrimin e xhazistit Genc Duli, Shpresa Kamberi e kishte nga një mik, i cili raportonte për BBC-në. Diku nga gjysma e natës, ia kishte bërë me dije se rusët, pa marrë

parasysh se çfarë do të bënte masa e dehur serbe, do të silleshin ashtu deri në mëngjes, e pastaj, do të drejtoheshin për në aeroportin e Prishtinës, ku, sipas një marrëveshjeje midis amerikanëve dhe britanikëve, ata do të mbeteshin edhe për disa kohë, ndërkohë që nga mëngjesi i asaj dite do të fillonte depërtimi i trupave britanike nga pika e Kaçanikut në drejtim të Ferizajt, me ç'rast ardhja e tyre në Prishtinë pritej nga mesdita, kur edhe do të fillojë tërheqja e forcave jugosllave në drejtim të Serbisë, që do të zgjasë katër deri në gjashtë ditë...

Reporter i BBC-së e kishte këshilluar të kishte kujdes, sepse tërheqja e forcave jugosllave dhe hyrja e forcave të NATO-s mund të ishte koha më e rrezikshme, një si farë mjegulle dhe hallakame, ku mund të ndodhte çmos, madje edhe ato që në njëfarë mënyre dukeshin të pamundshme.

- Nuk është mirë të shkohet si qeni në rrush...

Por, Shpresa Kamberi, që kishte qenë shumë e pikëlluar për vrasjen e xhazistit Genc Duli, të cilit para një viti në luftimet me forcat jugosllave i ishte vrarë edhe i vëllai, student i filozofisë, i cili bashkë me disa shokë u ishte bashkuar njësive të para të UÇK-së në pjesën e Dukagjinit, me përkushtimin që në atë luftë ta thyenin kufirin e parë që i ishte vënë botës shqiptare qysh nga Konferenca e Ambasadorëve e tutje dhe, pa rënien e tij, siç thoshte shpesh në kafe "Syri", nuk mund të ketë kurrën e kurrës paqe andejpari, e as më gjerë – pra ajo nuk i kishte përfillur këshillat e reporterit të BBC-së dhe as udhëzimet e britanikëve, të shpallura me anën e radiove lokale, që qytetarët edhe më tutje të mbeteshin ku ishin, që gjatë afatit prej katër deri në gjashtë ditë të mos pengojë tërheqja e forcave jugosllave dhe hyrja e forcave të NATO-s.

Pa zbardhur mirë mëngjesi - bashkë me saksofonistin Lulzim Bakiu dhe reporterin e BBC-së, që u shkonte pas dhe si duket kishte xhiruar çdo hap dhe veprim të asaj dite ndër më të gjatat dhe ndër më të rëndësishmet - dhe deri në orët e vona të mbrëmjes, kur edhe do të kthehet në atë vendstrehimin në Velani, ku kishte qëndruar edhe gjatë luftës dhe aty të nesërmen do të gjendet e masakruar fare - kishte nxituar në drejtim të Teatrit, pa vërejtur as autobлиндat e fundit të forcave ruse si tërhiqeshin në drejtim të Fushë së Kosovës, e as ato të pararojës britanike me njësitë e njohura elite të përbëra nga "gurkë" nepalezë, që kishin filluar të zbarkonin para hotelit "Grand" dhe kujdesshëm po i afroheshin platesë së Teatrit, pikërisht pjesës ku deri para pak kohe grumbuj të tërbuar serbësh me ato klithmat dhe çirrjet ndër më të çmendurat që ishin dëgjuar prej tyre andejpari kishin kremtuar ardhjen e rusëve dhe në një gjendje të tillë të dehur, derisa i kishin pasur pranë, edhe kishin filluar të vrisnin dhe të prisnin lirisht nga të gjitha anët - pra, e përballur me atë zbrazëti të trishtueshme dhe me njolla të shumta gjaku në pjesët e skajshme, që kishin lënë rusët dhe kremtuesit e tyre, kishte filluar t'i binte kitarës, e përcjellë nga jehona e saksofonit...

Edhe pse fillimisht nuk kishte pasur kurrfarë përforsuesish me vete, (më vonë forcat britanike do t'ia sigurojnë pasi kishin parë se fjala ishte për një demonstrim të mahnitshëm, më shumë se kulturor), jehona e saksofonit dhe tingujt e kitarës sakaq kishin mbushur sheshin, i cili dukej që edhe më tutje ruante të shkëputura, si kërcënime të fshehura, pjesë të çirrjeve të masës serbe për rusët dhe ardhjen e tyre në Prishtinë, e cila ishte quajtur historike, ku ishte thënë se, në atë pikë të shenjtë lidhej ajo miqësia e përhershme ortodokse serbo -ruse, e cila do t'i japë shtytje të reja misionarizmit ortodoks në atë pjesë të rëndësishme të botës, pa marrë parasysh se si do të venin punët më vonë...

Jehona e muzikës funebër të funeralit të ushtarit të vrarë në fushëbetejë dhe përhapja e dhembjes krenare, që vinte nga plateja e Teatrit, kishin bërë që edhe njësitë pararojë britanike, që ecte në gjendje gatishmërie dhe përgjonte çdo skutë që deri pak më parë kishte qenë e mbushur me praninë e forcave ruse dhe të masës së harbuar serbe, për pak kohë të shpërqendrohej dhe të përshëndeste ushtarakisht dhe në shenjë nderimi të vazhdonte më tutje depërtimin e paraparë në drejtim të Kuvendit, aty ku rruga degëzohej për në Gërmirë dhe në drejtim të Llapit e të stacioni hekurudhor.

Saksofonisti Lulzim Bakiu kishte treguar se pas muzikës funebër të funeralit të ushtarit të vrarë, pra të asaj që në këto anë ishte përjetuar nga filmi “Ushtari Ivo Xhimo”, Shpresa Kamberi kishte filluar të recitonte disa nga vargjet që nuk i kishte rënë t’i dëgjonte më parë, një si baladë, ku i kujtohej se ajo që e quante qenie dardane si kujtesë historike dhe ngjashëm, lidhej me frymën e Revolucionit Francez dhe me Deklaratën e Kushtetutës amerikane...

Më vonë, vargjet kishte filluar t’i këndonte dhe ashtu t’i përsëriste dhe t’i përsëriste derisa dikur nga orët e vona të pasdites, kur nga britanikët kishte marrë një zërim tejet të fortë, që thuajse mbulonte gjithë hapësirën e qendrës së Prishtinës dhe shkonte tutje pjesëve të saj të skajshme, kishte parë se nga rrugicat anësore, ngadalë afroheshin qytetarë, të cilëve edhe më tutje fytyra ua pasqyronte frikën dhe mosbesimin nga paraqitja e papritur e forcave ruse, në një kohë kur priteshin perëndimorët dhe çirrje e masës serbe, e cila në atë gjendje dehjeje, kishte filluar të masakronte kë takonte andej nga futej dhe kështu dëshmonte frymën e paparashikueshme, si kërcënim të përhershëm, i cili kurdoherë duhet të mbahet parasysh...

Shpresa Kamberi dhe kënga e saj - që më vonë nga reporteri i BBC-së që kishte përcjellë gjithë atë paraqitje të jashtëzakonshme, kishte qartësuar se fjala ishte për një baladë të shkruar dhe të komponuar enkas për atë ditë dhe, theksimi për Dardaninë si kujtesë historike nga antika, që e lidhte me Revolucionin Francez, të cilin e kishte quajtur themel të qytetërimit perëndimor dhe me Kushtetutën amerikane, të cilën e kishte cilësuar kushtetutë të njerëzimit, testament të lirisë dhe ngjashëm - kishte bërë që ajo mbrëmje para platesë së Teatrit të Prishtinës dhe në përgjithësi në rrugën kryesore, e pagëzuar viteve të fundit “Nëna Tereze”, të fitonte një frymëmarrje tjetër nga ajo që e kishte një natë më parë, kur nga prania e forcave ruse masa e egërsuar serbe, në një gjendje tallandie kolektive, kërcënohej të lante hesapet përfundimisht me ata që kishte për cak zhdukjeje dhe këtë nuk e kishte fshehur fare as kur ishte gjendur përballë asaj përgjigjes ndërkombëtare që për këtë të pengohej edhe me anën e forcës, siç ishte ndërhyrja nga ajri...

Ajo edhe më tutje kishte recituar dhe kishte kënduar atë baladë për Dardaninë si kujtesë historike dhe djep qytetërimi me rrënjë antike, për Revolucionin Francez dhe Kushtetutën amerikane si vlera të përbashkëta të qytetërimit botëror dhe pak nga pak edhe të pranishmit që ishin gjithnjë më të shumtë, kishin filluar t’i bashkoheshin si ndonjë kor antik, kështu që në orët e vona të mbrëmjes i gjithë sheshi ishte mbushur me qytetarë, të cilët, të dehur nga entuziazmi dhe gëzimi, çliroheshin nga frika dhe tmerri, duke kënduar dhe bëheshin pjesë e asaj lëvizjeje, me të cilën i riktheheshin vetes, qenies së humbur nga gjithë ato që ishin përjetuar gjatë atyre viteve të dhunës së egër dhe mund të thuhej se fillonte rigjetja dhe rinjohja me qenien e vet, por nga një këndvështrim tjetër...

- Tash e tutje do të përpiqemi ta mësojmë lirinë dhe kjo nuk do të jetë e lehtë... kishin qenë fjalët e fundit në atë koncert maratonik “Përsëritje lirisë”, që shumëkush e kishte marrë, jo si këshillë, por si vërejtje.

Saksofonisti Lulzim Bakiu, që bashkë me reporterin e BBC-së e kishin shoqëruar deri në hyrje të Velanisë, ku ajo kishte pasur strehimin e përkohshëm dhe që aty ishin ndarë me kërkesën e saj, kishte përkujtuar se ajo kishte qenë gjithë mëdyshje dhe me përshtypjen e krijesës së lodhur si asnjëherë më parë...

- Na duhet një gjumë i gjatë, pa natë, që të shkundemi nga ëndrrat dhe nga gjithë ato që janë mbledhur në ne prej vitesh, që kur të zgjohemi, nëse kjo vërtet ndodh, të shohim se çfarë ka mbetur prej nesh...

Duket se atë gjumin e gjatë pa natë, që thoshte se u duhej për t’u shkundur nga ëndrrat për t’u parë se çfarë kishte mbetur prej secilit, nuk e kishte bërë fare. Sepse, siç ishte konstatuar nga mjekët britanikë që kishin bërë autopsinë dhe kishin marrë përsipër hulumtimin e gjithë rastit (edhe ky, si shumë e shumë të tjerë, edhe pas shumë vjetësh kishte mbetur i pandriçuar dhe me shumë komentime, sa të shihet edhe si njëri ndër atentatet e para politike që ishte bërë me marrëveshje të shumë faktorëve, të cilët edhe mund të mos ishin të një mendjeje, bile as në anë të njëjta, por që kjo nuk kishte rëndësi), ajo ishte vrarë nga

afërsia, me një plumb pistolette, që i ishte futur në kokë dhe në anën e poshtme i kishte dalë jashtë, por që ai nuk ishte gjetur, siç nuk ishte gjetur as gëzhoja e as ndonjë gjurmë, që, si duket, ishin fshirë me shumë kujdes dhe e gjitha asaj vrasjeje me të drejtë ia kishte dhënë trajtimin e një vrasjeje me paramendim dhe të paralajmëruar madje, të kryer me mjeshtëri të madhe nga ata që vrasjen e kanë profesion dhe, kur po ato ditë do të dalin në pah edhe ato që i kishin ndodhur Miranda Valës dhe disa të tjerëve nga i ashtuquajtimi gjallim i bodrumeve dhe i katakombeve, të cilët vite të tëra ishin munduar të vendosnin ura midis lëvizjes së kundërvënies paqësore me organizimin e jetës paralele dhe prirjeve të kundërvënies aktive që të dyja ishin kthyer në rezistencë të armatosur dhe t'i shihnin si një rrugë të të njëjtit qëllim dhe e kishin pësuar në mënyra të ndryshme tejet të dyshimta - atëherë fjalët dhe komentimet, jo vetëm që kishin qenë të arsyeshme, por ato sikur kishin filluar të përhapnin dyshimin se të mësuarit e lirisë - që nuk do të jetë e lehtë, siç e kishte thënë Shpresa Kamberi në fund të atij koncerti para Teatrit, me ato vrasje, por edhe me disa sjellje që janë të mundshme vetëm gjatë kohëve kalimtare me shumë e shumë paqartësi, po ku gishtat kryesorë dhe veprimet e tyre edhe më tutje duhej të mbeteshin fshehur - kishte filluar ta kërkonte tagrin e vet, madje atë më të rëndin...

Edhe reporteri i BBC-së, që i pari ia kishte dhënë njoftimin rreth vrasjes së xhazistit Genc Duli nga paramilitarët serbë, çastin që ata ishin trimëruar nga hyrja e forcave ruse natën e njëmbëdhjetë qershorit dhe me atë rast në Prishtinë ishte mbajtur njëra ndër orgjitë e para dhe më të mëdha serbo-ruse në këto anë - mendonte se koncerti i papritur para Teatrit dhe me moton "Përsëritje lirisë" dhe jehona e tij jo vetëm që ia kishte dalë ta mposhte atë bashkë me atë që ishte paraparë të prodhonte prania ruse aty, por njëherësh kishte bërë të ditur të kundërtën, gjë që e gjitha, sipas reporterit të BBC-së, mund të kishte qenë një shkas i fortë që asaj t'i kthehej në kob të pashmangshëm...

- Mbase ka prekur një pikë tejet të ndjeshme, atë të marrëveshjes së fshehtë të perëndimorëve me rusët rreth tërheqjes së pajisjeve të tyre strategjike ushtarake që i kishte pasur prej vitesh në atë pjesë, që po ashtu do të mund të zhdëmtuhej disi me praninë e tyre të veçantë në Prishtinë, që mund të thuhet se nga ndërkombëtarët kishte qenë e paraparë dhe, edhe forcave jugosllave, të cilat të nesërmen duhej të fillonin tërheqjen, ky veprim u kishte ndihmuar, që masës serbe, e cila duhej të tërhiqej me ta dhe dihej se pjesa dërrmuese e tyre nuk do të kishte kthim prapa, me atë dehje ruso-ortodokse në qendër të Prishtinës dhe me mashtrimin e saj, t'ia krijonin përshtypjen se ai largim ishte i përkohshëm, çështje dite, të shumtën dy-tri javë, derisa rusët dhe amerikanët të merreshin vesh për ndarjen e Kosovës në atë serbe (në përputhje me mitin e tyre për djepin serb) dhe në atë pjesën tjetër - për të gjithë, një si mishmash, që edhe më tutje duhej të mbetej njëfarë çifligu nën mbikëqyrjen e Beogradit dhe të tjera si këto...

Më tutje, reporteri i BBC-së ia kishte bërë me dije se koncerti i saj i papritur në Prishtinë, me ata mijëra e mijëra veta, të cilët sikur kishin dalë nga birucat ku ishin fshehur dhe ashtu befas kishin zbrazur frikën - kur tri-katër ditët e para, siç kërkohej nga ndërkombëtarët, duhej të shfrytëzoheshin, në njërën anë për tërheqjen e papenguar të forcave jugosllave dhe të popullsisë që u shkonte pas (të shumtën familje të ushtarakëve, të forcave policore dhe të administratës së dhunshme, por edhe të atyre që kishin qenë pjesë e aparatit të dhunës dhe i kishin ndihmuar që ai të kthehej në një formë të aparteidit) dhe në tjetrën anë, për përgatitjen e kushteve për vendosjen e administratës ndërkombëtare - pra, e gjitha kishte qitur në pah jo vetëm praninë e madhe të popullatës vendëse, e cila edhe në ato rrethana kishte mbijetuar dhe si e tillë dëshironte të përjetonte edhe disfatën e pushtuesve dhe të vrasësve të tyre, qoftë edhe simbolikisht, por mbi të gjitha, kishte dëshmuar atë përcaktimin civilizues me rrënjë të vjetra dhe me kujtesë historie, që duhej të ishte pikënisje e kthesave të tilla...

Reporter i BBC-së kishte dashur t'i nxirrte në pah edhe disa çështje të tjera që lidheshin me dyshimin se Shpresa Kamberi nuk ishte vrarë rastësisht atë natë, se ajo ishte një krim i matur dhe çmatur që më parë, ndërkohë që ishte pritur çasti më i përshtatshëm për të,

por që kishte thënë se nuk ishte koha për to. I kishte premtuar se edhe më tutje do të punonte në ndriçimin e këtij rasti dhe një ditë do t'ia hidhte në adresën e internetit ato që mund ta vërtetonin atë dyshimin fillestar që ajo ishte një vrasje me paramendim dhe e paralajmëruar madje që t'u shërbente si vërejtje të tillëve, gjë që edhe e kishte mbajtur fjalën, por vetëm kur përfundimisht ishte larguar nga Kosova për në Londër, ndërsa Vëllaznimi, bashkë me holandezen Helga Krojfi kishte marrë atë rrugën e largët, përtej Atlantikut, në kërkim të qytetërimeve të rrënuara dhe të harruara, siç ishin ai i Majave dhe Inkëve, që i kishte çuar së pari në Meksikë e më vonë edhe në vende të tjera të Amerikës Latine në lartësitë e Andeve, ku kishin mbetur për vite të tëra derisa përfundimisht do t'i ktheheshin Egjiptit dhe hulumtimit të piramidave të Nilit, si dhe mbetjeve të qytetërimit antik në Aleksandri, ku ai, në atë madhësi të lashtësisë, kishte gjetur frymëzimin për vazhdimin e projektit letrar për Dardaninë si kujtesë poetike, që duhej t'i paraqiste njëfarë baraspeshe preokupimit të të atit rreth Dardanisë si themel i kujtesës historike dhe rrënjëve të saj në antikë dhe aty ia kishte dalë të fuste edhe disa nga vargjet e baladës që Shpresa Kamberi i kishte kënduar atë ditën e dymbëdhjetë qershorit para Teatrit, që po atë mbrëmje i ishin kthyer në kob, por që jehona e tyre kishte mbetur si një thirrje e jashtëzakonshme për të kaluarën si ardhmëri, e cila prej saj shihej si një ndërlidhje midis kujtesës dardane, Revolucionit Francez dhe Kushtetutës amerikane, të cilat, në ato vargjet e poemës së madhe, me ato që i kishte theksuar rreth Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, rreth ndryshimeve kushtetuese të vitit një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër (të cilave u kishin paraprirë demonstratat e vitit një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë dhe ato të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një e tutje) dhe rreth lëvizjes së kundërvënies gjithëkombëtare të vitit një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë, të udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe forcat e tjera politike përreth, që së fundi kishte kulmuar me themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me luftën e saj heroike - pra, të gjitha këto ngjarje i kishte vënë në oltarin e shenjtë të lëvizjes gjithëkombëtare shtetformuese...

Sipas dëshmive që reporteri i BBC-së ia kishte dërguar me internet, vrasja me paramendim e Shpresa Kamberi shihej në katër variante dhe mund të thuhej se secili prej tyre ishte i mundshëm dhe i besueshëm në mungesë të qëndrimit zyrtar që nuk do të shfaqet kurrë dhe, sado që ato ndonjëherë përjashtonin njëri-tjetrin, të përbashkët kishin pajtimin e pashkruar se Shpresa Kamberi dhe të tillë të tjerë duhej ta pësonin pse me idetë e tyre nuk e kishin vendin në ato rrethana të vendosjes së gjendjeve kalimtare, por që nuk duhet ta kishin as më vonë e as ndonjëherë në kuadër të atyre kundërimeve kur e kaluara nuk shihej si ardhmëri, por si pjesë e meritave të shpifura, me të cilat ajo kthehej në një plaçkë të thjeshtë për t'u përdorur sipas nevojës nga shpërdoruesit dhe shkatërruesit e lirisë...

Prandaj, sipas variantit të parë, më të përhapurit dhe që çdo dyshim ishte e natyrshme të fillonte prej tij, del se Shpresa Kamberi ishte likuiduar që atë natë, sapo ishte kthyer nga koncerti, nga agjentë të shërbimit informativ jugosllav, që ishin të shumtë dhe vepronin intensivisht kudo dhe ngado, jo vetëm me ato lidhjet e vjetra që kishin dhe që ishte e natyrshme edhe më tutje t'i ruanin me përkushtim të madh, por për më tepër, mund të ishte kryer edhe nga ato "lidhjet e reja", të vendosura gjatë atyre viteve të jetës paralele, shërbime speciale nga Beogradi dhe Moska me detyra të veçanta që kishin përcjellë me vëmendje të madhe çdo gjë, aq më parë kur ata kishin pikasur më të përkushtueshmit, më të qëndrueshmit dhe më të paluhatshmit në qëndrimet madhore, në mënyrë që me kohë të parandaloheshin që të tillët të ktheheshin në ndërtues të lirisë dhe të pavarësisë në përputhje me konceptet e qytetërimit perëndimor...

Andaj, është e kuptueshme se pse, para se të tillëve t'u hiqej flama edhe në atë mënyrë, përhapeshin gjithfarë thashethemesh se gjoja ishin bashkëpunëtorë të Beogradit dhe të shërbimeve të ngjashme, se për këtë gjoja kishte të dhëna "tejet të besueshme" dhe të ngjashme, që nuk ishte e vështirë t'u lëshoheshin në çanak mediave të papërgjegjshme e të

manipuluara që, si shihet, nuk do të vonojë dhe në opinion, në emër të shtypit të lirë dhe të pavarur, ky farë karremi do të ahët shpejt e shpejt me një hapësirë të madhe që do t'ua sigurohej atyre që shiteshin si “zbulime sensacionale”, që thuhej se disi ishin deshifruar nga “kodet e dosjeve të fshehta të armikut”, që gjoja u kishin rënë në dorë. Me këso proçka tejet naive, që shiteshin me të madhe në ato rrethana krijohej atmosfera e linçit, me të cilën mundësohej që nga skena shoqërore dhe politike përjashtonte jo vetëm disa nga bartësit e përgjegjshëm të lëvizjes kombëtare, të merituarit për zhvillimet e deriatëhershme, por mbante larg edhe intelektualët me vizione civilizuese, që mund t'i shërbenin kohës së re. Dhe, në mungesë të tyre, u hapeshin dyert mediokriteteve të ngulshme dhe vasalëve të shumtë, që ishin në gjendje përlusishtë t'i shërbenin çfarëdo tarafi për një çmim tejet të ulët dhe për këtë “privilegj”, po ta kërkonte puna, ishin në gjendje ta ndërrojnë edhe lëkurën...

Pse ishte nxituar ashtu dhe, përkundër profesionalizmit me të cilin ishte kryer atentati, që fshihte gjurmët, të gjitha dyshimet i shpinte në drejtim të tyre, kjo mbase kishte të bënte së pari me vendosmërinë që të tregohej prania e shërbimeve jugosllave dhe ruse aty edhe pas largimit të forcave jugosllave, gjë që mund të paraqiste një faktor të presionit psikologjik të një rëndësie të madhe që do të mund të luante rol edhe atëherë kur dukej se ndikimi i faktorit sllav ishte në përfundim e sipër dhe, së dyti, të jepej të kuptohej se Beogradi dhe Moska edhe më tutje do t'i qërojnë hesapet me ata që në çfarëdo mënyre provojnë t'ua prishin terezinë, siç ishte ajo e pranisë ruse në Prishtinë dhe orgjia e përbashkët me serbët, e cila, edhe pse ishte më se e qartë se shfaqej si mashtrim i bërë në sajë të marrëveshjes me përfundimorët, nuk duhej të shpërrallohej aq shpejt, veçmas nga një këngëtare, e cila do të tolerohet nga britanikët dhe do të bëjë çmos që shpejt e shpejt të fshihet fryma e asaj që rusët dhe serbët bashkërisht kishin lënë aty dhe e kishin paraparë si përfytyrim trimëruar, që forcat jugosllave dhe serbët, që do t'ua shkonin pas drejt veriut, ta mbanin me vete dhe me të të ushqeheshin për një kohë të gjatë, ngjashëm me atë mitin, i cili përherë kishte qenë në gjendje të vinte në veprim edhe mashtrimet, siç kishin qenë ato që nxitën dhe nisën luftën...

Shpresa Kamberi me koncertin e saj dhe veçmas me atë baladën e jashtëzakonshme, ku Dardania, si kujtesë antike lidhej me Revolucionin Francez dhe me Kushtetutën amerikane, mund t'i kishte tmerruar serbët që deri para pak kohe kishin ruajtur histerinë ortodokse dhe bindjen e shtrirjes së saj të përfundimshme aty, si frymë që edhe pa ta do të jetë në gjendje t'ua ruajë kujtesën dhe gjithçka tjetër të tyre, me të cilën ishin ushqyer prej shekujsh edhe në rrethanat më të pavolitshme...

Të strukur nëpër ato banesat në qendër të qytetit, përballë asaj që ndodhte para Teatrit dhe në gjithë rrugën kryesore nga hotel “Grandi” deri tek udhëkryqi te ndërtesa e Kuvendit që ndante kalimet për në Gërmirë dhe Llap, që ata para pak kohe rrugën “Mareshali Tito” e kishin pagëzuar “Mbreti Lazar”, ndërkohë që shqiptarët prej vitesh e quanin “Nëna Tereze” (ky emërtim dhe çemërtim rrugësh dhe sheshesh të ndryshme paraqiste më shumë se një luftë të ashpër identitetesh të paqëndrueshme, që do të vazhdojë edhe më vonë dhe sikur kishte për qëllim që ashtu të demonstronte vazhdimësinë dhe paqartësinë e kohëve kalimtare), me të shpejt kishin harruar klithjet për rusët dhe temjanin e kryqit ortodoks që ua hidhnin përpara peshkopët e Graçanicës, ata të Deçanit dhe të kishave të tjera që kishin ardhur aty dhe atë pjekjen e parë ruse-serbe e kishin quajtur historike dhe e kishin bekuar si të tillë po që në vend të tyre sakaq u kishte dalë një pamje tjetër, një si fantazmë që u vinte nga ajo bota, që kishin menduar se përgjithmonë e kishin varrosur dhe për të nuk kishte kthim pas, përkundër ndërhyrjes shtatëdhjetegjashtëditësh të NATO-s nga ajri, e cila nga propaganda e tyre ishte marrë si sulm i dështuar, si diçka që më në fund kishte forcuar qenien ortodokse serbe dhe frymën e përbashkët ruse-serbe, që u ishte thënë se pas asaj që kishte ndodhur, ishte më e fuqishme se kurdoherë, se do të mbetej e tillë gjithmonë dhe, si dëshmi e kësaj fitoreje historike, u ishin shfaqur trupat ruse, që kishin hyrë në Prishtinë të parat, por që edhe para se të hynin, nga televizioni i Beogradit, por edhe nga kanale të tjera të huaja, si BBC, NTV, CNN dhe të tjera, që kishin përcjellë drejtpërdrejt lëvizjen e forcave ruse nga Bosnja mes për

mes Serbisë, ku ishin pritur dhe përshëndetur nga qindra mijëra kureshtarë dhe fanatikë të përбетuar të pansllavizmit ortodoks, që u kishin hedhur lule dhe në shumë udhëkryqe ishin bekuar nga priftërinjtë ortodoksë serbë - u ishte krijuar bindja e fitimtarëve të përjetshëm...

Krahas kësaj, nxitimi që Shpresa Kamberi të vritej aq shpejt dhe në atë mënyrë tejet mizore, mund të kishte të bënte edhe me miken e ngushtë, skulptoren Miranda Vala dhe lidhjet me të, që mendohej se mund të ishin shumë e shumë më të thella nga ç'shiheshin prej shoqërimit të tyre nëpër bodrumet e nëndheshme të Prishtinës, ku për vite të tëra kishin qenë vajzat më atraktive, që mendohej se ato lidhje në rrethanat e reja, mund të ishin shumë të rrezikshme për Beogradin dhe interesat e tij në atë pjesë, ngaqë ishte dyshuar se meqë i ati i Mirandës ishte ushtarak i lartë i armatës jugosllave, ndër oficerët e parë shqiptarë që kishte pasur njëfarë akses në aparatin e lartë të shërbimit informativ sekret ushtarak KOS, përkundër likuidimit që i ishte bërë në fillim të viteve nëntëdhjetë, kur ishte thënë se e kishte pësuar në një aksident komunikacioni, ai mund të kishte ditur shumë nga fshehtësitë e parapërgatitjes së luftës në hapësirat e ish - Jugosllavisë, por mbi të gjitha mund të kishte pasur edhe njohuri rreth atyre dosjeve që shërbimi informativ kishte përgatitur, ku ishin edhe shifrat e bashkëpunëtorëve të rëndësishëm të tij nga radhët e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit, të infiltruar prej kohësh në lëvizjen e kundërvënies paqësore, por edhe në atë të kundërvënies së armatosur, pra për ata persona "të heshtur", të cilët, të pahetuar dhe me gjithfarë maskash mund të shfaqeshin në çdo kohë dhe kudo me rolet e parapërgatitura (ndërkohë që opinionin dhe grupimet e ndryshme politike do të merreshin me bashkëpunëtorët e shpifur nga ato listat që u ishin hudhur qëllimisht terthorazi nga burime të ndryshme që të mbahej i hapur qerimi i brëndshëm i hesapeve), dhe meqë ishte dyshuar se përkundër vrasjes, ai këto të dhëna tejet të rëndësishme me kohë mund t'ia kishte lënë të bijës dhe e bija mund t'ia kishte treguar Shpresës, ndërsa ajo si vajzë që ishte me shumë lidhje të rëndësishme, do të mund t'i shpërndante më tutje sapo të binte në kontakt me trupat e NATO-s kur të hynin në Kosovë dhe dyshime e dyshime të ngjashme që nuk kishin fund – pra, që kjo të pamundësohej me kohë, ajo ishte likuiduar, siç mund të ishte likuiduar edhe Miranda Vala, e cila, ndonëse mikut të saj, Kujtim Bardhi, i kishte thënë se do të vetëzhdukej përgjithmonë, pas asaj që i kishte ndodhur Shpresa Kamberi, kishte pasur parandjenjen se në ato rrethana më të keqes nuk mund t'i shpëtohej, siç nuk i kishte shpëtuar as e ëma në Gjermani, që, si ishte marrë vesh jo shumë vonë pas mbarimit të luftës, edhe pse e kishte ndryshuar emrin dhe identitetin madje, kjo nuk i kishte ndihmuar t'ia ikte një plumbi të panjohur, që i kishte ardhur nga një afërsi, që njësoj i kishte kaluar nëpër trup pa iu gjetur as ai as gëzhoja dhe ishte vërtetuar se ishte i të njëjtit kalibër dhe i të njëjtit prodhim, pra nga arsenalin më i përkryer i armatimit të luftës speciale, që përdornin shërbimet më të njohura të botës...

Varianti i dytë lidhej me mundësinë që mund të ishte vrarë nga njëri nga shërbimet e vendeve perëndimore të hapësirës europiane, që, ndonëse kishin përkrahur ndërhyrjen ajrore të NATO-s ndaj trupave jugosllave në Kosovë dhe në pjesë të tjera të Serbisë, me të cilën ishte parandaluar gjenocidi ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare, megjithatë të Shpresa Kamberi dhe gjenerata e saj ishte parë si shembulli më tipik i ndikimit amerikan, i bartur tashmë si model i gatshëm nga intelektualët e rëndësishëm që kishin frymëzuar dhe udhëhequr lëvizjet demokratike qysh nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës e tutje, që edhe ishte shprehur me atë këndimin e asaj balade, ku Dardania, si kujtesë historike nga antika, e lidhur me Revolucionin Borgjez Francez dhe me Deklaratën e Kushtetutës amerikane si një model i përbashkët i civilizimit perëndimor, që duhej të ngadhënjente me atë që quhej vendosje e perandorisë së më të mirës, koncept ky filozofik, nga antika e tutje, që i shkon për shtati rendit të ri botëror dhe globalizmit, i cili udhëhiqej nga amerikanët si superfuqi e vetme botërore, që pas rënies së bipolaritetit bllokist dhe shpërbërjes së perandorisë së kuqe sovjetike, kishte rastin të kthehej në një perandori të më të mirës, po që se këtë do ta kërkonte.

Meqë europianët viteve të fundit kishin shfaqur gjithnjë më shumë frikë nga ky model shoqëror dhe ekonomik dhe në një farë mënyre doktrinën veriatlatnike të mbrojtjes dhe të sigurisë nuk e shihnin më si koncept që duhej t'i përcaktonte edhe raportet ekonomike dhe ato politike të bashkëpunimit të ndërsjellë, por që si alternativë të kërkohej përfshirja e Rusisë dhe e Kinës në të, atëherë ishte më se e qartë se një promovim aq emocional dhe aq përkushtues, siç ishte ai i shprehur nga Shpresa Kamberi, aty ku duhej të provohej rruga e re europiane dhe identiteti që quhej i ri, assesi nuk duhej lejuar, edhe pse fjala ishte për një ndërlidhje që mbështetet në atë që civilizimit perëndimor i është kthyer në emblemë.

Në këtë pikë, spekulimet se në këtë vrasje kishin dorë ato shërbime europiane që nuk ishin të interesuara që përcaktimi shpirtëror i shqiptarëve të ishte kryekreje proamerikan dhe vetëm amerikan deri në pikë të fundit, mbase kishin të bënin edhe me frikën se përrurimi i amerikanizmit në Kosovë në atë mënyrë, që nuk ishte i rastit, jo vetëm pse amerikanët gjatë gjithë kohës - pra nga fillimi i lëvizjes alternative në Kosovës, që kishte filluar me shenjat e para të shkatërrimit të ish - Jugosllavisë kur edhe në dhjetor të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë ishte themeluar Lidhja Demokratike e Kosovës, bartësja kryesore e atij zhvillimi historik tejet të fuqishëm, që me të shpejt kishte përfshirë thuajse gjithë botën shqiptare për ta shkëputur nga prangat e dhunës totalitare drejt një rirreshtimi të ri civilizues - fillimisht kishin qenë të vetmit që kishin trimëruar dhe mbështetur fuqimisht atë dhe veprimtarët që punonin në atë drejtim dhe u kishin dhënë garanci se, po i mbetën besnikë shprehjes së hapur demokratike dhe artikulimeve civilizuese që tashmë kishte përcaktimi i tyre nuk duhej të frikësoheshin për asgjë, por që kjo përkrahje si e singërtë kishte mbështetjen edhe në besimin amerikan ndaj mbrojtjes së çështjes kombëtare në çastet më kritike, kur ndodhej para dilemës të rrosh apo të mos rrosh, siç ishte ndërhyrja e presidentit amerikan Uilson me atë ultimatum që i ishte drejtuar Konferencës së Paqes, kur në mënyrë të prerë ishte kërkuar nga fuqitë europiane që Shqipëria të mbrohej si shtet i pavarur dhe me asgjë kjo të mos vihej në dyshim, siç hetohej nga prapaskenat që bëheshin midis Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë për ndarjen e saj përfundimtare në tri pjesë dhe me këtë të merrte fund gjithë ajo që nga kriza lindore e tutje do të shfaqej si çështje e hapur, që si e tillë ajo do të rithuhej edhe me atë paralajmërimin e kërcënimit të “vijës së kuqe” (që të mos sulmohej Kosova), që Uashingtoni ia kishte bërë Beogradit kur ishte filluar ajo lufta në Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë, dhe konfirmimin e plotë do ta gjejë me atë ndërhyrjen ajrore të NATO-s, e cila pa vendosmërinë dhe drejtimin e amerikanëve vështirë që ndonjëher do të ndodhte...

Andaj, edhe shfaqja e Shpresa Kamberit atë ditën kritike kur gjithë qytetin e kishte pushtuar frika e tmerrshme nga prania ruse bashkë me atë orgjinë e parë ortodokse në Prishtinë, që edhe pse e shkurtër, megjithatë mbetej një trishtim historik me peshën e fshehur të kërcënimit, ishte një kundërpërgjigje e shpejtë ndaj dëshpërimit që kishte filluar, se mos ajo ndërhyrje nuk ishte tjetër përpos pjesë e një loje, ku e gjitha do të mund të përfundonte me një kurdisje tjetër, me të cilën do të shkonte huq jo vetëm gjithë ai deponim civilizues që ishte bërë fillimisht me lëvizjen paqësore, por edhe zbrazja e asaj mbushjeje shekullore e kundërvënies, që ishte e natyrshme dhe e pritur, e që me të drejtë kishte shkuar deri te kundërpërgjigjja e armatosur ndaj soldateskës serbe dhe dhunës së saj nga ana e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?...

Shpresa Kamberi dhe koncerti i saj në qendër të Prishtinës, që nuk do të vonojë dhe do të kthehej në një festë të përgjithshme, kishte kthyer besimin te çlirimi, por njëherësh kishte bërë të ditur se ajo që kishte ndodhur paraqiste fillimin drejt arritjes së lirisë, që, sipas saj, projektohej në themelet e kujtesës historike, siç ishin ai i Dardanisë antike dhe në të arriturat qytetëruese gjithëkohore dhe gjithënjëzore, të cilave duhej përmbajtur dhe nuk duhej lejuar që këto përcaktime të ndikoheshin nga vështirësitë dhe pengesa të tjera që mund të sillnin gjendjet kalimtare dhe kapërcimet e tyre, ku mund të shfaqeshin edhe ato shpërfilljet dhe shpërdorimet që do të mund ta dëmtonin atë themel nëse do të ndodhte që, për ndonjë arsye a tjetër, hapësira që duhej ta mbanin të përgjegjshmit, t'u lejohej të papërgjegjshmëve...

Edhe varianti i tretë, që lidhej me mundësinë që Shpresa Kamberi mund të ishte vlarë nga brenda, pra me ato që mund të merreshin si larje hesapesh, ku fillimisht mund të dyshohej se e bija e kishte pësuar nga sjellja e të atit, si funksionar i lartë i federatës jugosllave, i dërguar nga Kosova, që ishte ndër të paktët që nuk i ishte përgjigjur thirrjes së strukturave të dala nga referendumi për pavarësinë i vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një, kur të gjithë ata që kishin kryer çfarëdo detyrash në federatë, republikë a gjetiu duhej të heqnin dorë nga funksionet dhe t'i vireshin në shërbim qeverisë së Kosovës, që ishte krijuar pas pak kohe dhe ndodhej në eksil, pa përjashtuar këtu edhe kuadrot në armatën jugosllave, të cilat gjithashtu duhej ta braktisnin atë menjëherë, thirrje kjo që vlente edhe për ushtarët që gjendeshin në shërbimin ushtarak dhe të tjerët jashtë vendit në çfarëdo shërbimi qofshin - kishte njëfarë mbulese, por nuk ishte gjithaq bindës, ngaqë çdokush e dinte se ajo lidhje familjare që moti ishte rrënuar, qysh në Prishtinë, kur e bija jetonte ndaras me të ëmën, ndërkohë që i ati kishte ndërprerë çfarëdo takimi me të bijën. Shkuarja në Beograd si funksionar i Kosovës në federatë, nuk kishte paraqitur tjetër përpos ndarjen përfundimtare, e cila e tillë ishte që moti. Madje, edhe vetë sjellja e të atit në federatë dhe mbetja atje edhe pas thirrjes, nuk kishte paraqitur ndonjë moment të veçantë, ngaqë ai ishte pensionuar dhe kishte vazhduar të rrinte si çdo qytetar tjetër, ndër ata qindra e mijëra shqiptarë që jetonin në qytete të ndryshme të Serbisë dhe edhe më tutje punonin dhe banonin atje në përputhje me përcaktimet e tyre jetësore.

Por, sipas reporterit të BBC-së, vrasja e Shpresa Kamberit nga brenda, mund të lidhej edhe me ato përvijimet e skenës politike që gjatë jetës paralele dhe atyre viteve të bodrumeve në mënyra të ndryshme dhe në anë të kundërta ishin mbushur përplot, me përplasjet mes tyre për të dalë në syprinë në rrethanat e vendosjes së asaj gjendjeje kalimtare, kur kishte filluar ajo lufta tjetër për pushtimin e hapësirës shoqërore dhe politike, që jo rrallë ishte bërë edhe me mjete të tjera, që kishin nxjerrë në pah edhe prirjet më të çoroditura.

Edhe këtu mund të thuhet se Shpresa Kamberi kishte paraqitur afrim dhe puqje në vend të ndarjes, pajtim në vend të kundërshtimit, por që në rrethana të tjera, ndryshe nga ato të kohës së bodrumeve dhe të jetës paralele me atë predikmin e durimit që dikur dukej i padurueshëm fare, e edhe të fillimit të lëvizjes së kundërvënies, që me shfaqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishin çuar edhe në kundërpërgjigje të armatosur ndaj dhunës serbe dhe soldateskës çastin që ishin shterur të gjitha ato që deri atëherë ishin në dispozicion - në të gjitha rastet ajo paraqitej si urë lidhëse midis tyre dhe njësoj frymëzonte veprimet, që i quante "rrugë që ndiqnin të njëjtin qëllim" dhe mësonte që të mos përjashtoheshin, e aq më pak bindjet e ndryshme intelektuale dhe ato shoqërore, që ishin të natyrshme për skenën e ardhshme pluraliste politike, të ktheheshin në armiqësi - pra, koha e re, siç do të shihej, jo vetëm që nuk kishte nevojë për të, që nuk e donte, por as që e duronte...

Në një plotësim që ia kishte dërguar me internet kur bashkë me holandezen Helga Krojff tashmë gjendej në Meksikë në kërkim të qytetërimeve të rrënuara dhe të harruara të Majave, reporteri i BBC-së, mik i mirë i Shpresa Kamberit, pas atyre që thoshte se i kishte hulumtuar, bënte të ditur se vrasja e Shpresa Kamberit mund të ishte vepër edhe e atyre, të cilët, gjatë kundërvënies paqësore atë e merrnin si ikonë të asaj lëvizjeje, por që njësoj mund të ishte edhe vepër e atyre që e merrnin për emblemë të frymës që ushqente kundërvënien e armatosur ndaj dhunës serbe, vargjet e së cilës, të shoqëruara me këngët e stilit të estradës, kishin ushqyer shpirtin e pashtuar deri në atë masë sa disa nga vullnetarët që u ishin bashkuar njësisë të UÇK-së (të shumtën studentë dhe intelektualë) dhe kishin rënë nëpër betejat që ishin zhvilluar gjatë verës dhe vjeshtës së nëntëdhjetetës dhe të nëntëdhjetenëntës, atë rrugë e kishin pikërisht nga kafe "Syri", ku ajo kishte kënduar dhe recituar ato vargjet e njohura për luftën, siç ishte "Balada e Prekazit", "Djelmoshat e Dukagjinit", e të tjera.

Ngjashëm mund të thuhet edhe për lëvizjen studentore dhe ato protestat e mëdha të vjeshtës së vitit nëntëdhjetë e shtatë, kur edhe në Prishtinë dhe në vende të tjera të Kosovës do të demonstrohej, me çka përfundimisht do të prishej ajo gjendja e status kuos që Beogradi

kishte filluar ta shfrytëzonte për të përhapur fjalë sikur në Kosovë gjoja çdo gjë ishte në rregull dhe jeta ecte kahut të natyrshëm, përveç “helmit terrorist” që kishte përfshirë një grusht “agjentësh të huaj”, të cilët përpiqeshin të sillnin shqetësime të panevojshme, por që me ta do të qërohen hesapet sapo për këtë të bindet si duhet edhe faktori ndërkombëtar dhe t’i shpallë “terroristë”...

Me siguri se edhe plotësimi që reporteri i BBC-së kishte dërguar me internet rreth mëdyshjeve që Shpresa Kamberi mund të ishte vrarë ngaqë, si thoshte, koha e re jo vetëm që nuk kishte nevojë për të, që nuk e donte më, po as që e duronte, do të mbetej paksa pezull pa atë arsyetimin se, pse koha e re, si thuhej prej tij, nuk mund ta duronte më?...

Ndonëse dukeshin spekulime, reporteri i BBC-së kishte shpjegime edhe për to. I arsyetonte me faktin se edhe njëra anë edhe tjetra (pra krahu i lëvizjes paqësore dhe ai i luftës, mendohej në pjesën më fanatike, që tashmë kishte filluar atë betejën e hapur politike, që jo rrallë bëhej edhe me gjithfarë prapaskenash të ulëta, të cilat gjenin pasqyrim edhe në shtypin vendor dhe aty ndezeshin deri në atë shkallë sa nuk përjashtoheshin as mundësitë e qërimit të hesapeve me të gjitha mjetet dhe prapësi të tjera si këto), mund të kishin pasur frikë nga përcaktimi i saj i mundshëm për karrierë politike, ngase, me fondin e saj intelektual që posedonte (kultura e gjerë, njohja e disa gjuhëve, talenti krijues i madh, lidhjet e mira me jashtë dhe mbi të gjitha, aftësia për të komunikuar me masën në mënyrë tejet të kulturuar dhe shumë cilësi të tjera), jo vetëm që i kishte brengosur, por edhe i kishte frikësuar se mos ata që kishin filluar të shtreshin si autoritete dhe të krekoseshin gjithandej, me të shpejt do t’i linte në hije...?

“ Që nga ditët e para, kur do të hynin trupat e NATO-s dhe kur i gjithë vendi ende ishte me mijëra e mijëra viktima që s’u diheshin varret dhe me mijëra e mijëra të zhdukur dhe me shumë e shumë të tjerë të katandisur nëpër rrugë të ndryshme të botës, kur ndodhej në atë ankthin e kërcënimit me djegie e shkretime, nëpër të cilin kishte kaluar, nga të gjitha anët ishin shfaqur prirje për pushtimin e dhunshëm të hapësirës shoqërore dhe politike, pa zgjedhur mjetet...

Për habi, kjo ngarendje kishte qitur në pah sjellje gjithfare, të cilat paralajmëronin se idealet dhe idealistët, jo vetëm që nuk vlenin më, por shpalleshin edhe të padëshiruar dhe madje të rrezikshëm...

Zëri i arsyes, i urtësisë dhe i thirrjeve që koha e re të shfrytëzohej për një perceptim të ardhmërisë së përbashkët në garën për më të mirën, jo vetëm që nuk dëgjohej, por as nuk vlente më...

Kështu, shumë nga intelektualët dhe ata që në një mënyrë apo tjetër kishin paraqitur atë sistemin e vlerave që kishte krijuar fundamentin e caktuar shoqëror - në pamundësi për t’i bërë ballë garës së pashembullt të vetëlavdëruesve, të vetadhuruesve, të të vetëquajturve patriotë, duke u vetëvlerësuar, por edhe një fodullëku, me ç’gjë mbushej çdo skutë e ambientit të turbullt, ku hapësirën kryesore e zinin diskriminimet e njohura që merreshin të gatshme nga shërbime të ndryshme informative, të interesuara që, duke përhapur intriga të kurdisura, të eliminoreshin të merituarit dhe të diturit - ishin anashkaluar, por edhe mënjanuar me arsyetime të ndryshme: gjoja i takonin një kohe tjetër, që thuhej se kishte perënduar, ose ishin lënë në harresë fare, që ashtu të përballeshin me mbijetesë të pamëshirshme...”

Reporterit i BBC-së theksonte se në këto rrethana të rrëtimeve të mëdha intelektuale dhe shpirtërore, të cilat ishin kthyer në moto të përbashkët të asaj ngarendjeje për të përfituar sa më shumë nga ajo që shfaqej si hapësirë e kohës kalimtare, autoritetet, çfarëdo qofshin ato, paraqitnin pengesë të madhe, andaj ai thoshte se kishte frikë që edhe nëse Shpresa Kamberi nuk do të merrej me kurrfarë profilimesh politike, si krijuese e lirë dhe tejet e talentuar, që me siguri se kohën e re, si dhe zhvillimet e ardhshme do t’i shfrytëzonte për ngritje të shpejtë - do të paraqiste një autoritet me ndikim të madh dhe ai do të mund të përdorej në dobi të njëres a tjetres anë, që njëherësh për dikënd do të thoshte ndihmesë, e për të tjerët humbje, veçmas kur kihej parasysh se ajo, me qëndrimin e saj të paanshëm, por edhe me kredibilitetin e lëvizjes

paqësore dhe të kundërvënies së hapur deri te lufta e armatosur që ajo e shihte vazhdim të lëvizjes së përgjithshme dhe assesit diçka të ndarë nga ai zhvillim historik, një ditë gjithsesi mund t'ua "nxirrte telashe" liderëve të vetëshpallur zhurmëshumë, përfituesve të shumtë që nuk kishin reshtur së ndërruari ngjyrën dhe anët për t'ua rreshtuar në përputhje me interesat e ngushta dhe gjithë atyre, të cilët do të bënin përpjekje që të spekulonin me meritat e së kaluarës (qoftë ajo kundërvënie paqësore apo si pjesëmarrje në luftë) dhe të përfitonin prej tyre, siç kishte ndodhur më vonë dhe shumëçka e skenës politike ishte përshkuar nga përvijime të tilla që pastaj kishin vazhduar edhe në fusha të tjera, e që për pasojë kishin pasur, në njërën anë largimin e të merituarve, përfshirë këtu edhe themeluesit e lëvizjes, ndërsa afrimin e lakejve të dëgjueshëm dhe të përshtatshëm, të shumtën mediokër, edhe në aparatin përcjellës të sistemit të kaluar, që me të shpejt kishin hetuar anën se ku duhej të hidheshin dhe, në tjetrën anë, anashkalimin apo edhe harrimin e patriotëve të njëmendtë, që ishin futur, ose i ishin bashkuar luftës me përkushtimin që t'i shërbenin lirisë, qoftë edhe me gjak, e jo të përfitonin prej saj poste e pasuri të pamërituar dhe krejt atë sakrificë të madhe ta kthenin në pronësi...

Varianti i fundit rreth vrasjes së Shpresa Kamberit, edhe pse ishte fund e krye çështje supozimesh ndër më të hapurat, që kalonte ato që përnjëmend mund të kishin mbulesë, megjithatë nuk mund të përjashtohet.

Fjala, pra, ishte për dyshimin se kishte prirje feministe dhe kjo mbështetej jo vetëm në miqësinë e parëndomtë me Miranda Valën dhe të disa vajzave të tjera, të gjitha të pamartuara, që dallonin me ato lidhjet e lira dhe fare të paqëndrueshme me partnerë të ndryshëm, por edhe pse ajo angazhohej për një jetë të lirë në familje, ku mund të thuhej se nuk përfilllej gjithaq institucioni i martesës dhe në vend të saj shfaqeshin marrëveshjet e lira, të ngjashme me ato të bashkësive të pavarura, tashmë të njohura në Perëndim, ku edhe jeta bashkëshortore, e edhe fëmijët "rregulloheshin edhe ndryshe" dhe me atë "ndryshe" nënkuptohej edhe përparësia që i takonte gjeneratës së re që ndërton të ardhmen, pa qenë e detyruar të mbetet, si thuhej prej saj, peng i paragjykimëve...

Reporterit i BBC-së, që kishte pasur rastin të ketë shumë e shumë takime me Shpresa Kamberin dhe mbase për pak kohë me disa të tjerë të jetojë në një si bashkësi alternative dhe kjo ishte treguar e frytshme veçmas gjatë atyre viteve të jetës së bodrumeve, ku frika dhe nevoja e mbijetesës me çdo kusht kishte thyer shumëçka nga ato që merreshin si sjellje të natyrshme, kishte bërë me dije se ajo përnjëmend kishte parafytyrime pak më të lira për familjen e së ardhmes dhe mund të pritej që në kohën e pasluftës të angazhohej për të.

Kjo prirje, që prej saj ishte theksuar aq herë edhe gjatë atyre bisedave që nuk kishin fund në kafe "Syri" dhe gjetiu dhe kishte thënë se në të ardhmen e afërme (këtu kishte pasur mendjen tek ato që do të vinin pas kapërcimit të asaj gjendjeje të dhunës, nëpër të cilën kalohej, kur thoshte se do të shfaqej një kohë e pashmangshme kalimtare me sfidat e saj të shumta dhe ajo duhej shfrytëzuar edhe për kundërime të reja), mund t'i kishte brengosur ata që ia kishin pasur frikën atij zhvillimi, që, siç kishte theksuar reporterit i BBC-së, e gjitha mund të shpjegohej edhe me atë prirjen e kundërt dhe përpjekjet që ajo e para t'ua dilte para fanatikëve religjiozë dhe të tjerëve që tashmë, në emër të rikthimit të lirive fetare, kishin filluar të paralajmëronin ndalimin e abortit, ndalimin e shkurorëzimeve, e deri tek ato që haptas lidheshin me kërkesën që femra të mbante fërxhenë dhe që brenda e jashtë të sillej në përputhje me normat që parashihte edukimi islamik, e pse jo, edhe sheriatu...!

"Koha e pasluftës do të jetë edhe kohë e luftës për t'ua liru nga mbërthimi i atyre ngarkesave të shumta të thadruara në brendi, që dhuna dhe ushtrimi i saj i ka bërë edhe më të mbyllura dhe më të paparashikueshme... Sigurisht se kjo nuk do të jetë punë e lehtë, ngaqë në atë hapësirën e re do të shfaqen gjithfarë pikëpamjesh dhe tharmesh, që do të përpiqen të përfitojnë sa më shumë dhe këtë ta bëjnë edhe në emër të shpëtimit dhe të shpëtimit nga ato që mund të shfaqen si mësim të shenjtë dhe çmos tjetër..."

VIII

Me bindjen se, si i shpallur i vetëzhdukur kishte anashkaluar gjithë ato që i duheshin ndërlihdjes së të sotmes me të nesërmen e paqartë me gjithë ato përshtatje, ku përjashtohet e djeshmja, të cilave nuk e kishte më ndër mend t'u nënshtrohej, por kishte fituar atë qetësinë që i duhej projektit letrar, ku Dardania shihej si kujtesë poetike, me të cilën ai, përpos që duhej t'i bashkohej konceptit të të atit rreth Dardanisë si kujtesë historike me rrënjët në lashtësinë antike, si një vazhdimësi, të cilën duhet për ta pasur preokupim të përhershëm, sidomos në ato kohët e paqarta me ato gjendjet kalimtare, njëherësh dëshironte të zhdëmtonte humbjen dhe humbjet e pakthyeshme, e edhe ta zhdukte disi damkën e Bllacës dhe të ngjashmet - Vëllaznim Prishtina me identitetin e atij që quhej Maks Bruner, kishte bërë përpjekje t'i plotësonte sa më mirë ato tridhjetë e gjashtë ditët, që i kishin mbetur, derisa me holandezen Helga Krojff të largohej, së pari në Meksikë, në kërkim të gjurmëve të qytetërimit të braktisur dhe të rrënuar të Majëve dhe pastaj edhe të Inkëve në pjesën e Andeve të Amerikës Latine, që pas disa vjetësh bredhjeje dhe hulumtimesh përfundimisht të ktheheshin në Egjipt, pranë piramidave dhe gjurmëve të antikës në Aleksandri. Me Helgën ishin pajtuar se me ato që do t'i shkruanin dhe do t'i botonin gjatë atij hulumtimi të përhershëm, të mbeteshin peng të asaj pjese të preokupimit gjithënjëzësor dhe gjithëkohor që lidhej me kërkimin, po edhe me përjetimin që i takonte pushtetit të perandorisë së më të mirës, që, ndonëse ndaj saj koha dhe njerëzit ishin sjellë aq pamëshirshëm, me mbetjet e rrënuara dhe të dëmtuara të ruajtura vetvetiu bënin me dije për madhësitë, së cilës gjithsesi duhet për t'iu kthyer një ditë dhe kjo do të ndodhë kur do të prekej ai fundi, pra do të arrihet ajo gjendja e zhvlerësimit më të madh të vlerave, ku rinjohja e saj dhe rrethanat që e kishin krijuar atë, do të paraqesë atë vlerën e vërtetë, që mund t'i ndihmojë ringritjes, e cila në të vërtetë është rilindje...

- Mbase, kundrimi i realitetit me sy të tjerë ndihmon që të shihen më mirë disa gjëra, që mbyllja e gjatë ua ngatërron përfytyrimet deri aty sa edhe t'i shformojë fare - i kishte thënë Helga Krojff, kur e kishte parë me ato syze të trasha dhe të errëta, që i vareshin mbi hundë, me mjekrën rrumbullake dhe rrobat komode, me të cilat duhej ta linte përshtypjen e reporterit të huaj, që në rrethanat e lëvizjes së kundërvënies paqësore dhe të asaj që kishte qenë pjesë e jetës paralele, hetonte rrënjët e kryeneçësisë dhe të shpërthimit të saj deri te kundërvënia e armatosur ndaj dhunës serbe, kur ajo kërcënonte me spastrime etnike dhe gjenocid të hapur dhe ishte në rrugë e sipër që këtë ta bënte po të mos ishte ndërhyrja e NATO-s, që, ndonëse e vonuar, megjithatë ia kishte dalë ta ndërpriste.

Me një fjalë, nën ombrellën e reporterit të huaj, që gjoja ishte izraelit dhe kishte bindje thellësisht paqësore, por që kjo "thellësisht" nuk përjashtonte përdorimin e mjeteve të tjera, që shkonin edhe deri tek ato të dhunës, kur kjo ishte më së e domosdoshme, kishte për qëllim që të merrte vesh se mos e gjithë ajo që ishte shpallur lëvizje e kundërvënies paqësore - me pushtetin paralel dhe të tjerat që i takonin gjithë asaj me të cilën ishte përballur Beogradi për vite të tëra dhe, sikur ndaj asaj sjelljeje të qytetëruar të atyre që synonte t'i zhdukte me hipotekën se nuk ishin të qytetëruar, se madje as që mund të qytetëroheshin ndonjëherë dhe si të tillë paraqitnin rrezik për qytetërimin perëndimor dhe të ngjashme si këto që i kishte përhapur më shumë se njëqind e sa vjet, nuk kishte pasur përgjigje tjetër veç dhunës së shfrenuar - ishte vetëm një përpjekje dëshpëruese e atij që nuk ka nga t'ia mbajë, ku zgjedhja e rolit të viktimës paraqet shpëtimin e vetëm nga rreziku i shfarosjes, në një kohë kur askush nuk ia shtrin dorë, apo bëhej fjalë për një filozofi të caktuar politike, e paparë deri atëherë andejpari, që me anën e durimit dhe të "durimit" të blihet ajo koha e domosdoshme e pritjes derisa për këtë të krijoheshin rrethanat e përshtatshme dhe të përfitohet prej tyre (siç flitej për luftën e gjatë në Kroaci dhe Bosnjë), ku armata serbe (jugosllave), si e ngjuar duhej të pësonte disfatat e para dhe të ngjashme, siç kishte ndodhur në të vërtetë në verën e vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë, që pastaj të ndërmerreshin hapa për kundërvënies aktive, që do të mund të shkonin edhe deri te një kryengritje e armatosur që do të bëhej me kujdes,

por pa e vënë në ndonjë rrezik të papërballueshëm qenien e përgjithshme të popullatës së rrezikuar shumëfish, që e gjitha pastaj të provokonte edhe ndërhyrjen e NATO-s, qoftë që të arsyetohet me shkaqe humanitare, siç kishte ndodhur, por që sekush e dinte se fjala ishte për diçka më të thellë, për një tronditje të madhe, me të cilën viheshin në sprovë ca nga levat, mbi të cilat për shumë e shumë kohë kishte qëndruar rendi botëror si i paprekshëm, ndër të cilat ishin ato që mbronin sovranitetin shtetëror dhe të drejtën që në emër të tij të përdorej edhe dhuna më e shfrenuar që mund të shkonte deri në shfarosje...

Pa dëshiruar që me çkadoqoftë të ndërlikohej tek ato që i kishte dëgjuar për vite të tëra rreth përcaktimit shtetformues dhe të tjerave që merreshin si të domosdoshme dhe rëndom lidheshin me ato, si thuhej, vetëdëshmitë qytetëruese që duheshin dhënë në ato rrethana të thyerjeve të mëdha strategjike dhe gjeostrategjike, nëpër të cilat kalonte bota dhe ku shpërbërja e Jugosllavisë si krijesë e përkohshme, e cila vazhdimisht synohej për t'u dominuar nga hegjemonizmi serbomadhi në dëm të të tjerëve, shihej si një rast i mirë për rirreshtime të reja, që bota e shkapërderdhur shqiptare duhej t'i shfrytëzonte për rilidhje, por që ato lëvizje duhej të ishin të vëmendshme dhe në përputhje me interesat e perëndimorëve dhe veprime të tjera të ngjashme që kishin preokupuar thujt secilin shqyrtim dhe secilën bisedë kudo dhe ngado, me të cilat, sa më shumë që kishte kaluar koha, gjithnjë më pak ishte pajtuar, pikërisht pse kishte fituar përshtypjen se durimi i tillë sillte tek nënçmimi dhe vetëdija e robit të përherëshëm, që kërkon mëshirë nga vrasësi dhe të ngjashme - dhe njëherësh, pa u ndërlidhur me atë dufin dhe emocionet e jetës së bodrumeve, kur në kafe "Syri" dhe në shtypin ilegal kishte publikuar ato vargjet për shpirtin rebel dhe intelektual, por edhe domosdonë që, duke u hedhur në luftë t'i jepej fund atij poshtërimit të përditshëm nëpër të cilin kalohej, (për çka do t'ia japin edhe epitelin e "poetit të kuq" dhe për çështje të ngjashme, që më vonë do t'i shikojë me sy të tjerë kur do të gjendet në Tetovë dhe pastaj në Tiranë dhe gjetiu me ndjenjën e rëndë të refugjatit në vend të vet) – pra, si Maks Bruneri kishte përjashtuar emocionet, frikën dhe gjithë ato shqetësime që kishin qenë të natyrshme për atë që përballohet me ato realitete dhe në vend të tyre kishte futur kureshtjen ndaj arsyes dhe gjithë ato që i duheshin një gjykimi esëll, i cili, në rrethanat e reja mund të pasqyrohej më së miri pikërisht nga ata që kishin kaluar nëpër ato dilema dhe shumicës prej tyre edhe më tutje u silleshin nëpër kokë si turbullime dhe paqartësi...

Kjo, zaten, i kishte ndihmuar që në nisje t'i përjashtonte, ose t'ua mbyllte udhën atyre që mund të shfaqeshin si shpërthime për dhe kundër çështjes që merrte në shqyrtim, me të cilat andejpari ishte i preokupuar sekush dhe sikur nuk mund t'u ikej dot, duke ua lëshuar vendin vetëm vlerësimeve të qeta dhe mundësisht nga këndvështrimi i asaj që kishte kaluar, ani pse mungonte ajo shkëputja e duhur kohore për diçka të tillë, e domosdoshme për çfarëdo qëndrimesh sado pak të forta.

Por, duket se pikërisht çështja e vlerësimeve të qeta, që kërkonte, kishte qenë më e vështira të arrihej, sepse edhe atëherë kur flitej për kundërvënien paqësore, si diçka me të cilën lidhej një lëvizje e tërë, që ishte mbështetur fuqimisht nga pjesa dërmuese dhe askush nuk mund ta mohonte të dhënë se thujt i madh e i vogël me vullnet ishin anëtarësuar në Lidhjen Demokratike të Kosovës, sapo ajo ishte themeluar – dhe, me ato veprime me të shpejt ishte shformuar Lidhja e Komunistëve, ajo që mbante monopolin partiak dhe shtetëror dhe ishte në rrënim e sipër - jo vetëm pse Serbia kishte filluar ta përdorte fuqinë e saj për qëllime hegjemoniste, me të cilat do të hyhet në atë luftën nga e cila Jugosllavia do të shpërbëhet, por edhe pse me atë përcaktim bëhej e ditur rruga drejt pavarësisë dhe lirisë jashtë tutelës ideologjike dhe gjithë atyre që rrënimi i Murit të Berlinit dhe pak më vonë edhe rënia e luftës së ftohtë i kishte hedhur në shportën e historisë - e edhe kur flitej për kundërvënien aktive që në dy-tre vjetët e fundit, me aksione të ndryshme kundër forcave policore dhe ushtarake serbe, ishte shfaqur gjithnjë më shpesh derisa me daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishte shkuar te rezistenca e armatosur, jo rrallë shfaqeshin ato njëanshmëritë dhe pikëpamjet e ndryshme, me anën e të cilave mund të fitohej përshtypja se mund të ishte fjala për rrugë

dhe veprime të kundërta, madje, që përjashtoheshin, pa u pranuar se shpinin tek i njëjti qëllim, por edhe kur tentohej të bëhej kjo, mbretëronte frika në mos shkaktohej ndonjë prishje e panevojshme?...

Kjo prerje që nuk mund të ishte e natyrshme ngaqë do të përkonte me atë të sjelljes së trupit pa kokë a të kokës pa trup, me gjasë se shfaqej si më e theksuara dhe forcohej tej mase nga ata që i kishin takuar edhe njëres edhe tjetres, pra që fillimisht me antëarësimin në Lidhjen Demokratike të Kosovës që nga ditët e para kishin qenë pjesë e rëndësishme e lëvizjes institucionale, por që më vonë, pse nuk ishin pajtuar me durimin dhe vetëm durimin që ishte gjithnjë më nënçmues dhe sikur krijonte përshtypjen se dhuna serbe dhe aparati i saj janë çështje fati dhe jo e një sjelljeje pushtuesi që duhet të ndryshohet me anën e kundërvënies, ose për ndonjë arsye tjetër, i ishin bashkuar kundërvënies aktive, që rëndom vepronte në ilegalitet dhe të shumtën shfrytëzonte resurset e panjohura të gueriljes, që, si e tillë, në një sfond gri të brendshëm të ngjarjeve e kishte pasur të vështirë të lirohej nga veli i thashethemeve, madje dhe të dyshimeve se mund të ishte fjala për lojëra të ndryshme, ku çdokush për qëllime të caktuara mund t'i fuste gishtat dhe të ndërhynte për qëllime të caktuara, me të cilat veprimet e tilla gjithmonë përcillen dhe mbështillen, derisa në atë ditën e njëzet e tetë nëntorit të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë, në një varrim të madh në Drenicë, një treshe e saj me maska, do të shfaqet për ta bërë të ditur atë që quhej Ushtri Çlirimtare e Kosovës, e cila, ndonëse fillimisht nga disa funksionarë amerikanë që merreshin me problematikën e ish - Jugosllavisë, ishte shpallur si organizatë terroriste, me çka kishte të ngjarë që Beogradit i ishte dhënë drita e gjelbër për të larë hesapet me popullatën shqiptare dhe me kundërvënien e saj (ndodhi kjo jo shumë kohë më vonë me masakrën e Prekazit në Drenicë dhe gjetiu), ky kualifikim do të ndryshojë kur të shihej se çfarë fshihej prapa qëllimeve të soldateskës serbe (jugosllave) dhe nuk do të vonojë e drejtuesit të guerilës shqiptare, në ato që do të quhen bisedime të Rambujesë do të njihen si forcë reale dhe do t'i prijnë delegacionit të përbashkët të Kosovës, miratim ky që do të vërtetohet me faktin që ata në njëfarë mënyre, ndonëse jo zyrtarisht, ishin pranuar edhe si partner lufte gjatë asaj ndërhyrjes shtatëdhjetë e gjashtë ditësh nga ajri ndaj forcave jugosllave, me çka edhe një herë do të dëshmohej ajo që sa e sa herë ishte provuar, se në rrethana të tilla, pra të shembjeve të mëdha, asnjë politikë pa vazhdimin me mjetet e tjera, siç ishte lufta dhe përdorimi i saj, nuk mund të arrinte qëllimet e parashtruara, por që aty e veçanta e kësaj sjelljeje sikur vazhdonte të ushqente dilemën e mbetur rreth politikës pa luftë dhe luftës pa politikë...!

Por, duket se përqendrimi fillestar te hulumtimi i kësaj çështjeje dhe kundërthëniet që shfaqeshin edhe kur kërkoheshin përcaktimet që do të mund të çonin për të parë meritat te "njëri a tjetri krah", kishte qitur në pah një dilemë tjetër tejet të madhe, atë që lidhej me shijen e lirisë dhe kuptimin e saj, jo vetëm pse në ato rrethana ajo ngatërrohej me çlirimin, por edhe pse me veprimet e pakontrolluara dhe tejet të papërgjegjshme, që nuk ishin më vetëm dukuri të aty këtu, siç ishin uzurpimet, qerimet e hesapeve për motive të ndryshme e me mjete dhe metoda tejet të ndyta, ku uniforma e luftës, edhe ajo më e përgjakura, nga sekush mund të përdorej dhe keqpërdorej në mënyra të ndryshme, që nuk ishin në përputhje as me qëllimet e luftës e as me të paqes, kishin filluar t'i nxirrnin në shesh ato dyshimet se mos e gjitha ishte një përmbysje e madhe që do të mund të shkonte deri atje sa koha kalimtare, me ato të panjohurat e veta të shumta, të kthehej në një liri kaosi, ku e sigurt do të ishte vetëm pasiguria dhe e qartë vetëm paqartësia, çështje kjo që pastaj krijonte edhe atë hamendjen tjetër, që shtrohej gjithnjë më zëshëm: në të vërtetë, çfarë u arrit me sakrificën e durimit të pashoq dhe të gjakut të dhënë...!?

Kur shprehej ky dyshim dhe mosbesim, atëherë sikur fitohej përshtypja se kjo mund t'i shërbente si shkas shfaqjes së dëshpërimit si qëndrim, që ndonjëherë shoqërohej edhe me emocione të thella, të cilat, krahas pakënaqësisë me ato që pasqyroheshin, dilte në pah shqetësimi rreth ardhmërisë së përjashtuar fare nga lufta e tmerrshme për gllabërimin e të sotmes me ato përpjekjet grykëse për përfitime me anën e keqpërdorimeve dhe lakmi të tjera

që nuk njihnin kufi dhe që kishin shpërthyer në të gjitha anët si një epidemi që nuk kishte frenim dhe thuajse kishte filluar t'u vinte hipoteka të rënda edhe atyre çështjeve madhore që lidheshin me synimet e idealet e asaj lëvizjeje dhe lufte të drejtë...

- Sot po përjetohet shkrimi më i madh kundër të nesërme, i cili po pasqyrohet me përvetësimin e njëanshëm të të sotmes, si meritë e vetëshpallur dhe çmos tjetër, me të cilën jo vetëm që rrënohet e djeshmja, pa të cilën nuk bën, porse luftohet edhe e ardhmja...

Kështu i kishte thënë gjithë shqetësim një absolvent i psikologji-sociologjisë së një universiteti gjerman, me njohuri të gjera për historinë dhe diplomacinë, fëmijë emigranti, i lindur dhe i rritur atje, por që nuk i kishte ndërprerë lidhjet shpirtërore me atdheun, i cili, si vullnetar i ishte bashkuar luftës së drejtë dhe pohonte se ndjehej krenar për të, sepse ashtu e kishte kthyer dinjitetin e humbur dhe kurdoherë do ta bënte sërish, por që vlerësonte se atë që shihnte me sy nuk ishte asgjë tjetër veçse një përmbysje e madhe, ku dihej se çfarë duhej të rrënohej dhe çfarë duhej të përvetësohej njëanshëm, por nuk duhej të dihej se çfarë duhej të ndërtohej dhe si, sidomos nga mendja dhe forca e asaj, me të cilën ishte arritur deri aty...

- Nuk do të kisha dëshiruar të shihja atë shkretëtirë të kuqe, të ngjashme me atë që e kishte përjetuar Isak Babeli dhe të tjerë të tillë, të cilët kishin qenë viktimë të iluzioneve të barazisë me çdo kusht dhe të fuqisë së masës si të mbikëqyrur për arritjen e qëllimeve historike, që, si po shihet, nuk ka paraqitur tjetër përpos një mashtrim tejet të madh me pasoja të paparashikuara...

Studenti i psikologji-sociologjisë gjithë shqetësim dhe pasiguri të thellë ia kishte bërë me dije se së shpejti do të kthehej prej nga kishte ardhur tejet i dëshpëruar dhe me përshtypjen se nuk e kishte larë borxhin ndaj atdheut, që e kishte përfytyruar, jo vetëm duke u futur në luftë, ku kishte llogaritur për të lënë edhe jetën, por, si thoshte, edhe me luftën për ardhmërinë, që do të bëhej më pas dhe do të paraqiste një preokupim të përhershëm, që do të lidhej me mundin e të gjithë brezave dhe me përpjekjet e tyre për liri dhe pavarësi...

- Liria është ideal, e jo përfitim vetjak pa zgjedhur mjetet...

Ngjashëm si studenti i psikologji-sociologjisë kishte menduar edhe një vullnetar tjetër i ardhur nga komuniteti shqiptar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, familja e të cilit kishte qenë ndër të parat që kishte ushqyer me donacione të shumta lobin shqiptaro-amerikan, i cili kishte merita të mëdha për ngritjen e çështje së Kosovës dhe të krizës së saj deri në nivelet më të larta të interesimit të politikës amerikane, në Kongres dhe Senat, ku kishte marrë një përkrahje të gjerë, si në planin diplomatik, edhe në atë politik, nga ajo ishte ndërkombëtarizuar ashtu si duhej, me çka ishin krijuar edhe rrethanat për ndërhyrjen e përfundimtare ndaj forcave jugosllave në Kosovë dhe në vetë Serbinë.

I pyetur, në mos i gjithë ky dëshpërim paraqiste njëfarë lirimi të pambikëqyrur, në njërën anë, nga ajo gjendja e durimit pa qartësi, ku nga represioni i gjatë ishte ndrydhur çdo gjë, madje edhe dinjiteti dhe, në anën tjetër, nga frustrimet e atyre që me dëshirë kishin luftuar dhe kishin sakrifikuar edhe jetën, po që pas luftës kishin parë se shumë nga idealet e tyre kishin qenë të kota pasi ishin ndeshur me një realitet të papritur ku pikërisht disa nga "çlirimtarët" do ta konsiderojnë atë plaçkë lufte - ai kishte mendimin se gjendja e pasluftës rëndom shfaqet me paqartësi të shumta, ngaqë në to projektohen gjithfarë dëshirash dhe synimesh që nuk kanë të bëjë me çështjet që lidhen me të, porse përvijimet e tilla me siguri se i kishte forcuar gjendja e paqartë kalimtare dhe megjulla e saj, që diku kishte sjellë dëshpërim dhe zhgënjim të thellë, e diku kishte vënë në veprim gjithë atë energji negative e cila pret rastet e tilla për t'u vu në veprim, që po vazhdoi, do të shkojë deri në shpërthim, me çka do të njolloseshin të gjitha ato përpjekje qytetëruese, të pasqyruara edhe në rrethanat më të vështira, me të cilat ishte ndryshuar për të mirë opinioni botëror ndaj një populli shumë herë të viktimizuar gjatë historisë në emër të koniunkturave të paqëndrueshme dhe lojërave të tyre.

Pra, shkakun e një shqetësimi të tillë së pari e kishte parë te përcaktimi që ajo luftë të merrte fund pa përgjigjen e merituar ushtarake, që do t'i jepej agresorit, siç ishte kapitullimi, i cili do të nënkuptonte edhe ndëshkimin për ato që kishte bërë dhe me këtë asaj krize t'i jepej

epilogu i merituar, me çka do të krijoheshin parakushtet për heqjen e të gjitha dyshimeve ndaj ardhmërisë, ku do të përfshihej edhe ai pajtimi historik i të dy popujve dhe të tjera marrëveshje...

Në vend të kësaj, shqiptaro-amerikani thoshte se ishte lidhur një marrëveshje midis gjeneralëve të NATO-s dhe Armatës Jugosllave për tërheqjen (pa pjesëmarrjen e luftëtarëve shqiptarë), e cila, ndonëse teknike, linte të hapur çështjen e prapaskenave të mundshme, frikën e të cilave sikur e bënte edhe më të pranishme vendosja e gjendjes kalimtare me atë bashkëqeverisjen e përkohshme që te shumëkush hapte dilemën se mos e gjitha ishte një paralojë e ndonjë loje tjetër me shumë e shumë të panjohura, proces ky i kurditur, për të cilin kishte thënë se në ato hapësira, për fat të keq, ishte i pranishëm që nga koha e krizës lindore e tutje, me ç'rast kishte zënë ngoje edhe vendimet e Kongresit të Berlinit rreth Bosnjës dhe Hercegovinës, pazaret me trojet etnike shqiptare me shtetet sllave atëbotë (Serbia e Mali i Zi) dhe me Greqinë, që ishin bërë në dëm të popujve që kishin paraqitur themelet e qytetërimit perëndimor, që nga antika e tutje, por që më vonë, pa të drejtë, nga shkaqe të mbijetesës, po edhe nga shkaqe që lidheshin me sjelljen e tyre në hapësirat perandorake që të arriheshin majat e qeverisjes së saj, ishin ngarkuar me hipotekën e kundërshtarit të këtij qytetërimi dhe kjo ishte bërë në sajë të propagandës së kishës ortodokse serbe dhe asaj greke e ruse, se gjoja fjala është për “mbetje të paqarta të popujve lindorë endacakë, me prire patologjike rrënuese”, që, si të tillë, mund të paraqesin rrezik për hapësirën europiane dhe që me këtë gogol atyre u ishin lënë dyert të hapura, në emër të misionarizmit perëndimor që u ishte ngarkuar, shqiptarët dhe boshnjakët t'i përjashtonin me dhunë nga hapësira e tyre jetësore dhe etnike, ku nuk kishin munguar as gjenocidet e bëra haptazi, siç kishte ndodhur edhe në atë luftën e fundit dhe me këtë sikur ishte bërë me dije se nën rrogos edhe më tutje mund të kurdisej diçka e ngjashme dhe çmos tjetër, që me të drejtë ushqen ndjenjën e dyshimit...

- Çelësin e së keqes duhet parë te vendosja e gjendjes kalimtare dhe te mjegullimi i saj, meqë ajo me të drejtë shqetëson të përgjegjshmit, të cilët kërkojnë një të ardhme të qartë dhe të sigurt, ndërsa trimëron të papërgjegjshmit dhe të ngjashmit me ta, që pa zgjedhur mjetet dhe me çdo kusht dëshirojnë ta gëlltisnin të sotmen, pa çarë kokën për të nesërmen dhe për qëllimet e saj...

Pyetjes, në mos me hedhjen e fajit te dikush tjetër jashtë nesh, dëshironte t'u jepte njëfarë mbulese veprimeve që edhe vetë i shihte tejet të shëmtuara dhe nuk kishin të bënin me asgjë që do të përkonte me qëllimet, as të kundërvënies paqësore e as të idealeve të luftës që për to kishin dhënë jetën qindra e mijëra atdhedashës, në ç'mënyrë edhe u dëshmuar - pa hequr dorë nga ato që i kritikonte dhe do të vazhdonte t'i kritikonte në mënyrën më të ashpër, edhe më tutje kishte fajësuar përcaktimin për vendosjen e gjendjes kalimtare, qoftë si të përkohshme, ngaqë, siç kishte theksuar, në njërin anë ishte lënë manash vizioni i ardhmërisë, si preokupim i drejtë që i takon secilit që atë e sheh në përputhje me vazhdimësinë e vlerave të arritura të të gjitha gjeneratave dhe, në anën tjetër, e sotmja ishte dënuar me paqëndrueshmëri, gjë që ndaj saj ishte sjellë pa përgjegjësi dhe shkel e shko, ku nuk mund të ketë vend për parime, por vetëm për përvetësime që mbjellin dyshimin se ajo i duhej dikujt që aty të kishte lojtarë të përdorshëm, të cilët kryejnë detyra të caktuara, edhe pse jo rrallë, pas “një përdorimi ditor” të tyre përjashtohen dhunshëm nga lojërat dhe ajo skena e madhe dhe e përhershme...

- Shenjat se kërkohen lojtarë të përshtatshëm, me të cilët mund të luhen ato lojërat e përhershme, janë dukur që moti, kur janë bërë përpjekje për t'u shmangur të përgjegjshmit dhe bërthama intelektuale me qëndrime kritike...

Në të vërtetë, kur vullnetari nga lobi shqiptaro-amerikan i kishte thënë kështu dhe këtë e kishte vënë në lidhje me sjelljen e faktorit ndërkombëtar, që kishte marrë përsipër atë që quhej vetëdëshmim që duhej të bëhej nën mbikëqyrje nga jashtë, me vetautorizime të tilla të hapura që shkojnë edhe deri te nënçmimi i vendorëve, ia kishte përkujtuar ato që i ati ia thoshte se, pse ishte gabim i madh që në emër të kundërvënies aktive dhe të luftës, që dihej se

një ditë doemos do t'i vijë radha, të anashkaloheshin a të rrënoheshin institucionet vendore, që kishin qenë themel i asaj që ishte ndërtuar si lëvizje paralele, me të cilën ishte marrë përsipër përkujdesja për funksionimin e levave kryesore të jetës, që nga organizimi i arsimit në të gjitha nivelet, shëndetësia, përkujdesja sociale e deri tek organet e tjera që u duhen atyre mekanizmave, ku ai kishte theksuar veçanërisht çështjen e mbrojtjes dhe të sigurisë, si pjesë e mbikëqyrjes institucionale, që kishte thënë se i takonte edhe organizimi i kundërvënies aktive deri te lufta, kur për këtë do të merrej qëndrimi gjithnjë në përputhje me faktorin përkatës ndërkombëtar...

Madje, kur ai i kishte thënë se pas marrëveshjeve të Dejtonit Kosova ishte në radhë, nga presidenti kishte kërkuar të sillej në përputhje me Kushtetutën e Kaçanikut dhe detyrimet që dalin prej saj, që, si komandant i forcave të armatosura, të vihej në krye të organizimit të lëvizjes së kundërvënies së armatosur dhe me këtë të hiqte atë mjegullën e panevojshme që ishte krijuar rreth rrugëve të ndryshme deri te pavarësia, por që shpinin tek i njëjti qëllim (kundërvënia paqësore dhe kundërvënia e armatosur), si paralele që ishte e natyrshme që dikur edhe ta pengonin njëra-tjetrën dhe me këtë edhe gjithë çështjen, siç kishte ndodhur në të vërtetë kur u ishin hapur udhë edhe keqkuptimeve të panevojshme, me të cilat pa ndonjë arsye ishte përçarë lëvizja dhe me këtë u kishin dhënë mundësi të vepronin atyre që kishin dashur ta shihnin atë në pozita të ndryshme dhe kishin punuar që ajo të merrte edhe kahun e kundërt, madje, ndërsa pasojat kishin filluar të vërehen në rrethanat e reja, kur ishin shfaqur edhe pozicionimet shpërputhëse “me krahun e luftës”, ose “me krahun e pacifistëve”, që u kishin shërbyer atyre përçarjeve mbi të cilat pastaj ishin ngritur ndasitë që u ishin dashur platformave të caktuara shoqërore dhe partiake, e që ishin bartur ashpërsisht edhe në skenën politike...

Kjo ia kishte kujtuar atë intervistën që i ati ia kishte dhënë radios “Europa e Lirë”, pas marrëveshjeve të Dejtonit, kur ai kishte kërkuar që më në fund të mendohej për kundërvënie të hapur, që do të duhej të ishte nën mbikëqyrjen institucionale dhe e udhëhequr nga profesionistë (ushtarakë të shumtë që prej kohësh i ishin vënë në dispozicion qeverisë në ekzil dhe ministrive të saj përkatëse, por edhe ata që prej kohësh, si oficerë të ish - armatës jugosllave luftonin në Kroaci dhe Bosnjë kundër trupave pushtuese serbe), e që për këtë deklaratë të guximshme, që, si do të merret vesh, nuk ishte përkrahur as nga presidenca e as nga qeveria në ekzil, nga Neki Rrema ai ishte quajtur tradhtar, ngaqë, si kishte thënë, “kërkonte t'i fuste gishtat që i kishte lënë në atë deklaratën e Kuvendit të Kosovës të njëzet e tre marsit të vitit një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë edhe aty ku nuk i takonte”, ani pse kjo nuk përkonte me të vërtetën, ngaqë i ati vetë i shtati haptas u kishte thënë - jo ndryshimeve dhe kishte votuar kundër dhe pastaj kishte qenë ndër ata që ishte angazhuar për shpalljen e Deklaratës së dy korrikut, të Deklaratës për pavarësinë dhe për miratimin e Kushtetutës së Kaçanikut, me çka lëvizjes i ishin krijuar të gjitha institucionet për kundërvënie paqësore, por edhe për pjesëmarrje aktive me anën e pushtetit paralel, ndërkohë që më vonë ai kishte kërkuar që e gjitha të shkallëzonte në kundërvënie aktive dhe të armatosur, por në përputhje me zhvillimet dhe në bashkërenditje me amerikanët...

Mendimet e të atit për të kaluar nga kundërvënia institucionale-paqësore - ku kishte vepruar për vite të tëra dhe me të ishin dhënë dëshmitë dhe provat e domosdoshme qytetëruese që bota i kishte çmuar dhe i kishte vlerësuar – në kundërvënie aktive, e cila parashihte edhe luftën e drejtë për liri dhe pavarësi, por që kjo të bëhej në bashkëveprim me amerikanët (këtë e theksonte veçanërisht, sepse vetëm ata ishin në gjendje t'ia ruanin frymën dhe interesat çështjes), sikur kishin filluar t'i ndërhyenin jo vetëm nga ajo biseda e gjatë që kishte pasur me studentin e dëshpëruar të psikologji-sociologjisë, por edhe me vullnetarin nga komuniteti shqiptaro-amerikan nga Nju - Jorku, me të cilin, edhe pasi të jetë kthyer në vendlindje, do të mbajë lidhje me anën e internetit dhe kishte pasur bindjen se ai kodi i panjohur i të atit e kishte gjetur edhe atë, duke ia hedhur ca nga pjesët e trajtesës rreth Dardanisë si kujtesë historike me rrënjët e thella në antikë, të cilat, si shihej, të cituara prej tij

edhe ishin përvetësuar, por ato i bëhej se i takonte edhe nëpër ato bisedat e shumta që kishte pasur me ata që kishin trajtuar atë që për pikënisje kishte shijen e lirisë, që, si dilte, pasqyronte mungesën e saj, nga shkaku se të shumtën ajo shihej e ngjashme me shpërthimin e lirisë së kaosit...

- Ende po më ndjek im atë. Por, tash me anën e porosive që ua bën të tjerëve nga dika dhe ato, nga goja e tyre, sikur më përplasen si qortim?...

Holandezes Helga Krojff, e cila pareshtur mendohej për ta bindur që ditët e fundit të qëndrimit në Prishtinë t'i shfrytëzonte për shqyrtimin dhe vlerësimin e çështjeve, me anën e të cilave i thoshte se duhej të përpunonte, por edhe të përballonte kapërcimet e tri kohëve (vëllazërim-bashkimin, jetën paralele dhe kalimtare, që ai i merrte si mashtrime, nëpër të cilat ishte kaluar dhe e kishin bërë pjesë të asaj askundjeje), ia kishte kthyer se ato që i hetonte si njëfarë përndjekjeje e frymës së të atit, nuk ishin as qortime e asgjë tjetër, përpos pjesë e opinioneve të shkapërderdhura që dëshmonin se përcaktimi nëpër të cilin ishte kaluar (ai i kundërvënies aktive me atë pushtetin paralel dhe ai i kundërvënies së hapur që kishte shkuar deri te lufta e armatosur), kishte qenë pjesë e një qëndrimi të përbashkët drejt të njëjtit qëllim, por meqë gjendja kalimtare dhe vendosja e saj e kishte lënë të hapur dhe diku-diku edhe e kishte mjegulluar fare, e kishte kthyer në një shqetësim të drejtë rreth së ardhmes, si një preokupim i përgjithshëm që do të mund të vihej në lojë dhe për këtë faji sërish t'u kthehej atyre që më së paku mund të ngarkohen me të, ndërkohë që shkaktarët edhe më tutje të vazhdojnë avazin e vjetër: krizave të kurdisura prej tyre t'ua tërheqin fijet për hesapet e veta dhe ashtu t'i zvarrisin në përputhje me synimet e tilla...

Ngjashëm me ato që ia kishte thënë Helga, i kishte folur edhe një shitëse e limonadave pranë një banaku të lëvizshëm që e kishte vendosur përballë "Grandit", një ish-reportere e njohur e Radiotelevizionit të Prishtinës, e cila, si shumë e shumë të tjerë priste të përfshihej në atë që ishte shpallur Radiotelevizion i Kosovës dhe thuhej se do të ishte televizion i pavarur, por që dyshonte se do të gjente vend aty nga shkaku se, gjykuar sipas parapërgatitjeve që zhvilloheshin, si thoshte nga "një qendër e panjohur", aty do të kishte vend për këdo, por jo për profesionistë në fushën e informimit, të cilët mund të ishin kritikë ndaj parashikimeve të tilla...

- Me gjasë, prapë kemi mbetur në karremin e lojërave që mund të zgjasin e të zgjasin dhe me këtë të qesin në pah edhe një (mos)durim tjetër, që prapë mund të na përplasit me ato shturjet nga brenda, që tashmë i kemi hak nga ajo nëpër të cilën kemi kaluar...

Ish reporterja e televizionit, që shiste limonada dhe thoshte se nuk mund të ankohej për fitimet që merrte, kishte bindjen se e gjithë ajo paqartësi që shfaqej dhe mund të merrte përmasa edhe më të mëdha dhe më të paparashikuara, ishte shprehje e atyre trysnive që nga jashtë i kishin ardhur lëvizjes së kundërvënies (asaj me sistem paralel dhe aktives, që kishte shkuar deri te rezistenca e armatosur), që ajo të mbetej as mish as peshk, pra as lëvizje institucionale, që do të ndiqte atë përcaktim deri në fund, e as të kthehej në kundërvënie të hapur, që do të merrte përmasat e një lufte të armatosur, me të gjitha rreziqet që sillte...

- Është kërkuar diçka e asaj pjese dhe diçka e pjesës tjetër, por jo si tërësi... Është kërkuar gjysmëqëndrimi, gjysmëpërpjekja, por njëherësh është kërkuar dëgjueshmëria e plotë, pa të drejtën që të kërkohej më shumë... Natyrisht se kjo sjellje ka nënkuptuar lojëra dhe lojtarë të përshtatshëm, që u kanë shkuar situatave të caktuara, e që po kjo vlen edhe tash dhe do të vlejë gjithmonë...

Reporterja kishte vazhduar të shpjegonte se mbetja në atë gjendje as mish as peshk, si dhe pamundësia që edhe pas luftës të thuhet diçka më shumë nga ajo që lejohet andej ku duhet, duket se ua kishte hapur udhën zbrazjeve nga brenda dhe përplasjeve të forta, që në vend të kthjellimit dhe të pranimit të realiteteve në përputhje me të mundshmen, kërkohej faji, kërkohej fajtorët dhe kërkohej fajësitë madje, edhe pse është ditur fort mirë çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet, edhe pse është ditur se çka mund të kërkohej dhe çfarë nuk mund të kërkohej, qoftë kur është kërkuar durimi i paskajshëm që është shfrytëzuar paskajshëm që

konfliktet e armatosura në hapësirat e ish - Jugosllavisë të mbahen të mbikëqyrura, qoftë kur është kërkuar që kundërvënia po ashtu e mbikëqyrtur të shfrytëzohet për trysni të caktuara, por që ajo të mos kalonte kufijtë që i ishin paraparë, pra të mos kthehej në një luftë të përgjithshme çlirimtare, sepse atë nuk do ta lejonin as përkrahësit, e as kundërshtarët dhe askush, meqë ajo rrëronte çdo gjë që andejpari ishte vendosur keq që prej njëqind e sa vjetësh...

Në përputhje me këto qëndrime të njohura, që dikush shtiret sikur nuk i ka ditur dhe me dredhi përpiqet të ngreh andej a kënde, reporterja kishte theksuar se faktori shqiptar ishte instrumentalizuar skajshmërisht dhe kjo duhet të pranohet me sinjeritet të madh si çështje që ka të bëjë me sjelljen përballë limiteve tejet të mëdha dhe mbikëqyrjes së përhershme nga të gjitha anët...

- Duhet pranuar se edhe koha e ashtuquajtur e durimit, me aq shumë e shumë sakrifica dhe nënçmime, e edhe koha e kundërvënies së armatosur, që është mbikëqyrtur nga jashtë, në radhë të parë nga amerikanët dhe nga NATO-ja, por që nuk kanë munguar as gishtat e shërbimeve të huaja në të, që kanë synuar ta çorientojnë nga brenda, ka pasur plot mentorë dhe pak, ose shumë pak hapësirë për lëvizje në përputhje me ato që janë dëshiruar a deklaruar...

Ajo kishte përkujtuar se gjithë këtë mentoromani e dëshmon edhe teatri në kështjellën e Rambujesë, regjia e vajtje-ardhjeve të ndryshme në Beograd dhe e të gjitha atyre parapërgatitjeve që i kishin paraprirë asaj që ishte quajtur shatel-diplomaci...

- Andaj, edhe krekosjet e sotme rreth meritave çfarëdo qofshin, janë vetëm pjesë e atij teatri që duhet të vendoset midis nesh, për t'u krijuar përshtypja e një loje të re me ato që mund të merren si të panjohura të njohura...

Por, kundruall asaj pakënaqësie që shprehej ngado dhe dyshimeve që ishin të pranishme edhe tek ajo shtresë qytetarësh që mund të thuhej se ishin të matur dhe parashikonin edhe një kohë tjetër të pritjes, që do të sfidonte durim dhe durim dhe të ngjashme, nga një luftëtar i ditëve të para, pra i atyre veprimeve luftarake që ishin bërë në pranverën dhe verën e vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë në Dukagjin dhe kishin shkuar deri te kufiri shqiptaro-shqiptar, me çka edhe ishte prekur njëra ndër pikat më të ndjeshme të asaj lufte - kishte pasur rastin të merrte një opinion tejet optimist që, po të mos ishte fakti se edhe kur përpiqej të aktronte reporterin e huaj dhe të panjohur, të cilit nga brenda edhe më tutje i rrihte ai tiktaku i qenies së strukur, me siguri se do t'i bashkohej, që së paku përkohësisht të përballonte atë ndjenjën e atij që ka parë se nuk mund t'u përshtatet më rrethanave të kapërcimit nga njëra gjendje në tjetrën, që i kishte quajtur mashtrime dhe kishin ndikuar të merrte atë vendim për t'u shpallur i vetëzhdukur...

- Kjo që ka ndodhur është kthesë e jashtëzakonshme, që deri më dje thuajse askush nuk ka mundur ta marrë me mend...

Luftëtari kishte thënë se ishin të bashkuar dhe ky fakt nuk mund të mohohet... Këtë bindje e kishte formuluar me parulla të zëshme:

- Nuk e kemi më sipër pushtuesin shekullor!
- U hoq me ndihmën e NATO-s!
- Tash jemi bashkë...!
- Nuk e kemi më kufirin që na ka ndarë mbi një shekull...!
- U hoq kufiri shqiptaro-shqiptar...!
- U hoq ajo vijë e hekurt që na ka përvëlur shpirtin...!
- Kjo është fitore historike...!
- Fitore...!
- Kush s'e sheh këtë, nuk ka sy...

Ai kishte folur për një fitore madhështore, për një fitore qiellore madje, që thoshte se ishte aq e madhe sa të ishte dhuratë perëndie, për të cilën duhej për t'u lutur i madh e i vogël...

- Qenia jonë është bashkuar...!
- Bashkimi është i përhershëm dhe i pathyeshëm...!
- Nuk ka kthim prapa...!
- Nuk ka...!
- Edhe po të përmbysët bota, lumi i bashkuar nuk ndahet më...!
- Nuk ndahet...!
- Jemi një...!
- Jemi një dhe do të mbesim të tillë...!"

Luftëtari kishte folur si i dehur, por ajo kishte qenë një dehje e vërtetë shpirtërore, të cilën ia pasqyronte jo vetëm qëndrimi i jashtëm, i syve gjithë shkëlqim, por edhe ai i brendshmi, që i rridhte si lumë i pandalshëm...

Edhe pse thoshte se i kishte humbur thujtë të gjitha (gruan me dy fëmijë, të vëllanë dhe pjesën më të madhe të farefisit), se kishte mbetur fillikat, me atë pikëllim të madh në shpirt për më të dashurit, megjithatë ndjente aq thellë kënaqësinë e lirisë dhe të bashkimit, si e theksonte, me të cilën do të ushqehet gjithnjë derisa t'u bashkohej më të dashurve, që ishin masakruar në Ponoshec, kur armata jugosllave kishte filluar atë vrasjen masive që do ta vazhdojë me krimet që do t'i bëjë në Morinë, në Smolicë, Meje dhe në katundet përreth, me të cilën parashihej që pjesa e Rekës së Keqe, që nga Ereniku e deri te Bjeshkët e Nemuna, përfundimisht të zhvishej nga qenia shqiptare dhe fryma e saj...

- Mon Haxhia është njeriu më i lumtur në botë...!
- Mos e harroni Mon Haxhinë...!
- Kujtoni kur të dëshpëroheni...!
- Kujtoni Mon Haxhinë ...!
- Kujtini...!

Mon Haxhia përnjëmend kishte qenë i lumtur. Por, shprehja e lumturisë me një afsh të tillë, më shumë fliste për një gjendje shpirtërore të rëndë të atij që gjithë atë humbje të madhe dëshironte ta kthente në një ngushëllim, sesa t'i nënshtrohej dhe ta kthente në ankim dhe vaj, siç ndodhte në shumë raste dhe kishte vazhduar edhe për shumë kohë, që të tillët të shfrytëzoheshin si viktimat të rastësishme të një dhune, në vend se të ngriheshin në pedestal, ku e kishin vendin...

Më vonë, kur ishte larguar nga Kosova dhe në vendin e Majëve në Meksikë ishte mrekulluar me atë qytetërim të lartë, kishte vetëm përfytyrimin e Mon Haxhisë, me ato që ia thoshte se ishte njeriu më i lumtur në botë, që ia kishte dalë t'i përballonte gjithë ato fatkeqësi që thoshte se duhej t'i linte diku të mbyllura në një kuti, në mënyrë që ndonjëherë mbase t'u kthehej që, nga një shpëputje kohore t'i rishqyrtonte në mos vallë disa gjëra duken ndryshe, edhe pse kishte bindjen se kjo nuk do të ndikonte për ta ndryshuar qëndrimin se ishin vetëm lidhjet e veçanta shpirtërore ato që ia ushqenin qenien dhe e bashkonin me botën që i takonte, së cilës, nga ajo largësi, me anën e të menduarit rreth kujtesës historike që shfaqte një projekt të përhershëm krijues, do t'ia lante borxhin, me ç'rast do të zhdëmtoheshin të gjitha ato humbje të njëpasnjëshme, veçanërisht Bllaca dhe nënçmimi i tmerrshëm nëpër të cilin ishte kaluar...

Në atë poemë epiko-lirike të përhershme, Mon Haxhia dhe ato që kishte thënë, ishte paraparë të zinin një vend tejet të rëndësishëm, të feniksit të përjetshëm, që, sikur të vinte nga bëmat e heronjve të epikës popullore të lashtësisë, shfaqej dhe rishfaqej pas çdo fatkeqësie që me qëndrueshmërinë e rrallë t'i ushqente pasardhësit që ta vazhdonin ku kishin mbetur dhe kështu ajo mbijetesë tragjike të kthehej në një mbrojtje të përhershme madhështore, në një krenari, frymëzimin e së cilës edhe më të fuqishëm e kishte bërë ajo ndërhyrja e të atit në internet nga ai kodi i veçantë, i cili, me ato që shpërndante rreth Dardanisë si kujtesë historike

me rrënjët e thella në antikë, ia bënte me dije se sikur edhe ai ishte kthyer në një feniks shpirtëror dhe i tillë do të mbetej përgjithmonë, pa marrë parasysh rrethanat, ngaqë, si i thoshte, libri i kujtesës është i hapur dhe nuk lejonte lexim të njëanshëm e as me shkëputje...

Kur ajo brohoritje “Mon Haxhia është njeriu më i lumtur në botë!”, të cilën e kishte dëgjuar në qendër të Prishtinës të thuhej me aq besim dhe thellësi shpirtërore, ishte në rrugë e sipër që të fitonte peshën e një metafore që do të shfaqej si moto e asaj pjese të poemës, nga ajo dërgesa në internet, që e dinte se i vinte nga kodi i veçantë i të atit, i cili pareshtur shpërndante pjesë të kujtesës - do të mësojë se Mon Haxhia, që në Prishtinë kishte brohoritur se ishte njeriu më i lumtur i botës, përkundër humbjes së madhe - ngjashëm kishte folur edhe në Vlorë, në atë vjeshtën e vitit një mijë e nëntëqind e njëzet, kur si vullnetar u ishte bashkuar forcave të qeverisë së Sulejman Delvinës, por atë herë si një fantazmë e jashtëzakonshme, ngaqë dihej se ai bashkë me shumë e shumë kosovarë që për vite të tëra si të përndjekur nga Kosova nga pushtuesit serbë ishin dërgur nëpër kënetat e Lushnjës, u ishin bashkuar atyre që kishin sulmuar italianët që mbanin Vlorën dhe atë e kishin shpallur hapësirë, të cilën ata e parashihnin pjesë të perandorisë së re të Romës, së cilës sërish do t’i kthehen pas njëzet vjetësh, kur do ta aneksojnë gjithë Shqipërinë...

Edhe ai Mon Haxhia, i Vlorës, që ishte vrarë ndër të parët, kur te Pasha Limani kapërcenin istikamet e forcave italiane, me bindjen se me atë sakrificë mund t’i ndihmonte Shqipërisë të bëhej Shqipëri dhe me këtë edhe t’i ndihmonte kthimit të vatanit të humbur prej vitesh nga pushtuesit serbë, që kishin masakruar kë kishin takuar atje, por si fantazmë - kishte folur ato fjalët për lumturinë e madhe dhe këtë e kishte bërë me një përkushtim të jashtëzakonshëm, që nuk ishte dëgjuar ndonjëherë andejpari...

Më vonë, një kohë të gjatë kishte menduar e menduar rreth asaj lumturisë së veçantë shpirtërore, që shfaqet në rastet më tragjike, të ngjashme me atë që kishte përfshirë Mon Haxhinë dhe të tillët që ishin të paktë dhe që nuk mund të ishte as ngushëllim as dëmshpërblim vetëmashtues për një humbje aq të madhe, por si ndjenjë e madhërishtme, e ngjashme me atë gjendjen e nirvanës, që është e mundur të përjetohet vetëm pasi të jenë hequr ndrydhjet e përshtatjeve dhe ato që krijojnë rrethanat e tilla, nëpër të cilat kishte kaluar dhe mund të thuhej se ato mashtime (vëllazërim-bashkimi, jeta paralele nëpër bodrume dhe koha kalimtare, që pas ndërhyrjes së Helgës fjalën “mashtim” e kishte zëvendësuar me “realitet i pakapërcyeshëm”), sikur e pamundësonin fare, nga shkaku se shumëpërkatesia krijonte atë ngatërresën shpërqendruese të shkapërdedhjes nga njëra kohë në tjetrën, që shfaqeshin jo vetëm të papajtueshme, por nga njëri kapërcim tek tjetri, kundërshtoheshin dhe përjashtoheshin madje ashpërsisht, siç i kishte ndodhur atij dhe gjeneratës së tij, e cila edhe kur ndodhte të përcaktohej, këtë e bënte jo nga bindja, por nga domosdoja e nevojës, pra, një ripërshtatje që i dukej si rimashtim tjetër që nuk kishte fund...

- Mon Haxhia kishte fituar atë lumturi ngaqë nuk i kishte takuar kurnjërës kohë... Mund të kishte qenë vetëm pjesë e asaj kujtese, që ishte shpërndarë si frymë e asaj qenie të mbetur te fillet e saj... Ai nuk mund të ishte njeri ngaqë të tillët ishin të paqëndrueshëm nga përcaktimi i shkatërrimit...

Kështu i kishte thënë holandezes Helga Krojft ditën që ishin larguar nga Prishtina dhe, identitetin Maks Bruner, që i kishte shërbyer të bënte atë mashtim, e kishte marrë si diçka që i shkonte asaj sjelljeje që ishte e vetmja që e kishte shpëtuar të mos mbetej peng i përshtatjeve të tjera, që ishin të pashmangshme dhe gjithë atyre nëpër të cilat duhej të përfshihej e të vepronte me shtirje poshtëruese...

Pikërisht aty për herë të parë kishte pasur përshtypjen se ishte barazuar me të atin e zhdukur, që megjithatë i vepronte ai kodi i veçantë, i cili ndërhynte me ato pjesëzat e kujtesës, që i shpërndante nëpër adresa të ndryshme...

Mendja ia priste se njësoj ishte barazuar edhe me Gjyshin e Madh, të vrarë rrugëve të botës nga ai plumbi që e kishte nga ata të cilët thoshin se e paskëshin dënuar si tradhtar në emër të mbrojtjes së atdheut...

Dhe, më në fund, kishte hetuar se ashtu ishte barazuar edhe me Mon Haxhinë...
Veçse, ky barazim tash kishte paraqitur të kundërtën e tyre...

IX

Gjatë fluturimit disaorësh, derisa ndodheshin mbi Atlantik dhe kur kishte përshtypjen e një qenie të zbrazur fare nga mungesa e peshës, e dënuar të mbetej përherë në atë hapësirë e askundjes, të paraparë për të vetëzhdukurit, ishte holandezja Helga Krojfi ajo që me një butësi të veçantë, që ngjante në ngushëllim, i thoshte se Vëllaznim Prishtinën do ta gjenin dhe do ta kthenin aty ku e ka vendin, po që atij i ngjante se po i fliste për një tjetër njeri, që duhej ta kërkonin bashkërisht dhe ta kthenin po ashtu bashkërisht aty ku e kishte vendin...

Çështjen e atij kthimi – i cili do të duhej të paraqiste ri gjetjen e vetvetes, holandezja ia kishte thënë edhe atëherë pasi ai të kishte marrë atë vendimin që me vetëdëshirë të shpallej i vetëzhdukur, që, ndonëse ajo ishte munduar ta shihte si shprehje dëshpërimi, hidhërimi, revolte dhe çmos që mund t'i lidhet atij që nuk mund t'u përshtatet rrethanave të reja, (pas daljes nga hapësira e katakombeve të krijuara gjatë asaj që ishte quajtur jetë paralele me atë vetëmbyllje dhe të tjera që i ishin dashur asaj që shfaqej si lëvizje e kundërvënies paqësore, e cila më vonë do të merrte edhe kahun e kundërvënies aktive që do të shkojë deri te lufta e hapur) - ai as që i kishte besuar, bile as që kishte dashur t'i besonte, nga bindja se kishte kaluar nëpër ato mashtrime të njëpasnjëshme (vëllazërim-bashkimi, jeta paralele dhe së fundi koha kalimtare, që, në sajë të ndërhyrjes së saj, fjalën “mashttrim” e kishte zëvendësuar me “realitet”), të cilat e kishin ndarë në pjesë të papajtueshme dhe së voni sikur ishin kthyer edhe kundër njëra-tjetrës...

Ai kishte heshtur i ngrysur, sikur edhe më tutje t'i nënshtrohej asaj shembjeje të brendshme, të ngjashme me atë që për herë të parë e kishte hetuar ditën e katërt të ndërhyrjes së perëndimorëve nga ajri, kur njësitë paramilitare serbe u kishin hyrë brenda me dhunë dhe me ato sharje e fyerje të rënda e të ulëta u kishin dhënë shumë pak kohë t'i mblidhnin plaçkat dhe, siç u kishin thënë, ta thyenin qafën në Shqipëri a kudo tjetër, larg tokës serbe që ishte dhe do të mbetej tokë e shenjtë serbe..

Sigurisht që edhe më tutje do të kishte heshtur, duke u ndërlidhur me atë shembje, që i shfaqej sikur nuk kishte përfunduar dhe do të vazhdonte e vazhdonte, po të mos i kishte folur për Itakën dhe gjetjen e saj, kur i kishte thënë se ishte një bredhje në kërkim të diçkahes që është, por duhet riparë ndryshe, madje me sy të tjerë, që të hetohet deri në rivlerësim dhe që mund t'i duhet kohë dhe durim mbase më i fortë nga ai që i është dashur dhunës së pashembullt, nëpër të cilën kishin kaluar, ndërkohë që ai, sikur për pak kohë të ishte shpikëputur nga ajo ngrysjë, kishte thënë se krijimtaria nuk ishte realitet dhe mirë që ishte kështu, ngaqë do të mbeteshin edhe pa fuqinë e asaj, që e kishte theksuar si tjetër gjendje shpirtërore, e cila i takon të përhershmes, me anën e së cilës së paku mund të zhdëmtoheshin ato që humbin përgjithmonë...

Kur ia kishte thënë këto fjalë kishte pasur mendjen te gjërat e përkohshme, që kthehen në trysni të përhershme dhe vetëm shpikëputja prej tyre, çfarëdo qoftë, mund ta pengojë këtë mashttrim...

Që jeta ishte një realitet i vrazhdë, i paparashikueshëm dhe herë-herë i pamëshirshëm fare, që as fantazia më e shfrenuar krijuese nuk mund ta përshkruajë, këtë ai do ta kuptojë më së miri aty, ku rruga në drejtim të Shkupit kthente në drejtim të Tetovës dhe me atë dhunën që i kishin ndarë: të atin në atë drejtimin, i cili e kishte çuar në Bllacë, ndërsa atë në një drejtim tjetër, që e kishte tretur në Pollog të Maqedonisë dhe tutje në Tiranë, me ç'rast kishte fituar atë ndjenjë e rëndë të refugjatit në vend të vet, nga e cila nuk kishte mundur të lirohej kurrë, as atëherë kur ishte kthyer në Prishtinë, e as ndonjëherë tjetër.

Megjithatë, çastin që kishte mbetur vetëm dhe, sikur të përshkohej nga një zbrazje e jashtëzakonshme nga gjithë ajo që paraqet ndërtim të brendshëm dhe vendin e tij e zë një si

rimbushje me zhvlerësim dhe hiçësi neveritëse madje, në mendje i ishin kapur ato vargjet për Itakën e humbur, me të cilat sikur kishte fituar përshtypjen se kishte krahë që mund ta bartnin tutje-tëhu në një hapësirë të paanshme, andaj kishte qenë i vetëdijshëm se shpëtimin duhej kërkuar vetëm tek ato bredhjet e padukshme shpirtërore në kërkim të një rindërtimi të së humburës, që mund të ishte i përhershëm, një si fillim pa fund, ose fund pa fillim, krejt një, ku do të sillej vërdallë, por që më vonë kishte parë se e gjithë ajo që i ishte dukur pa cak, në të vërtetë kishte qenë pjesë e atij përcaktimi që me anën e krijimtarisë - siç ishte projekti për kujtesën poetike, një poemë e madhe me shumë e shumë pjesë dhe mijëra e mijëra vargje, të gjitha me gjashtëmbëdhjetë rrokje, që do të ishte e ngjashme me preokupimin e të atit rreth Dardanisë si kujtesë historike - jo vetëm t'i zhdëmtonte ato humbjet që ia kishte sjellë realiteti, por me të të fshinte edhe atë damkën e rëndë të Bllacës dhe të tjerat, nëpër të cilat kishte kaluar gjatë atij nënçmimi tepër të rëndë...

Natyrisht se të menduarit e pavarur krijues, të cilit i duhej edhe ajo që parafytyrohej si hapësirë e përhershme e lëvizjes, ku do të kishte vend për ngritje dhe ngjitje të vazhdueshme drejt lartësive, me ato arritjet e jashtëzakonshme, të cilat janë të mundshme vetëm në rrethana të tilla dhe assesi ndryshe - sikur padashur i ishte ndërlidhur me ato që shpesh i bisedonte me të atin rreth hapësirave perandorake, si mundësi të jashtëzakonshme gjithënjëzore dhe gjithëkohore, të cilat edhe ai i lidhte gjithashtu me ato të arriturat e majave, me ç'rast thoshte se mund të bëhesh perandor, ndërkohë që mbyllja sillte sharrim në një rreth të përhershëm, ku humb edhe dallimi midis vrasësit dhe të vrarit, kundërime këto që, kur krahasoheshin me realitetin nëpër të cilin kalonin, menjëherë u shërbenin atyre mospajtimeve rreth përcaktimit se çfarë përgjigjeje duhej dhënë dhunës dhe atyre që ndërmerreshin haptas për rrënimin e qenies së tyre jetësore dhe etnike, kur ai i fliste për kundërvënien paqësore me atë që quhej pushtet paralel dhe ngulmonte se ishte e domosdoshme për ato dëshmitë qytetëruese dhe shtetformuese dhe të ngjashme, që i përsëriste e përsëriste pareshtur, sikur të ishin pjesë të një ndryshkjeje të brendshme që kishte kaluar në prishje të pandreqshme, ndërsa ai, si provë të domosdoshme të asaj qytetëruese dhe vetëdijes së qenieve që e duan lirinë dhe pavarësinë, zinte ngoje nevojën e kundërvënies së hapur, që duhej të shkonte edhe deri te kundërpërgjigjja me armë dhe me të gjitha mjetet e tjera që nënkupton çlirimi nga dhuna e tillë dhe të ngjashme, që më vonë kishte kuptuar se ai duf dhe ai shpërthim i brendshëm kishin qenë më shumë pjesë e një mendimi krijues drejt asaj pavarësie shpirtërore që paraqet atë parakushtin kryesor, me të cilin i iket kurthit që varësitë e jashtme të kthehen në të brendshme...

Në të vërtetë, atë çështjen e rrezikut të kurthit që varësitë e jashtme të kthehen në të brendshme, të përhershme, që ishte dashur të kalonte në mbikëqyrje të mendimit krijues dhe kjo të lidhej me atë projektin për Dardaninë si kujtesë poetike, që do ta baraspeshonte me atë të ngjashmin të kujtesës historike, me të cilin merrej i ati dhe pjesët e të cilit i shpërndante në internet në adresa të ndryshme, çastin që kishin arritur në Meksikë dhe pas dy ditësh udhëtimi të mundimshëm nëpër pjesë thuajse të pashkelura të maleve me drunj dhe lastarë që ngjanin në merimanga, u ishin afruar mbetjeve të qytetërimeve të Majëve – pra, në njërën nga ato shkalloret e larta, të ngjashme me piramidat, sikur e kishte kthyer në hapësirën e një teatri me atë skenën e madhe, ku luheshin ato dramat e përhershme me aktorë të njëjtë, që ndryshonin rolet, por që për habi, në atë lartësi, ku horizonti i gjasonte një vije të mbetur në një pikë që mund të ishte një si prekje e paarritshme, kishte hetuar sikur hapësira e atij kundrimi dhe frymimi i ajrit të ashpër, çuditërisht ia kishin krijuar përshtypjen se nuk ishte ai i vetëshpalluri i vetëzhdukur, që kishte ikur në një skaj tjetër të botës për të gjetur ngushëllim tek qytetërimet e braktisura, të harruara dhe të rrënuara, madhështia e të cilave edhe më tutje mahnit, por hetonte sikur ishte Gjyshi i Madh, në pritje të atij plumbi që po e shihte dhe jo vetëm që nuk po i frikësohej, po përpiquej ta trimëronte vrasësin që ta shkreppte sa më parë dhe ashtu të kryente detyrën që kishte marrë përsipër, e që me aq nuk mbaronte e tëra, ngaqë duhej të fillonte diçka tjetër, ajo që lidhej me atë të vërtetën dhe me dëshmitë e saj, të cilat në atë si

shkallore të atij që i përfytyrohej si teatër i përhershëm, duhej t'i riktheheshin skenës që të mbeteshin pjesë e lojës së teatrit...

Përshtypja se ndodhej para vrasësit, që duhej të trimërohej ta bënte atë pa hamendje, sesi i futi të dridhura dhe e ligështoi madje, sa të ulej në një rrasë guri, pikërisht aty ku fillonte ajo pika e pandalshme e horizontit, që duhej si e kapshme dhe e largët njëherësh, një si vijë, që pak nga pak hapte atë hapësirën e bardhë, ku shënohet ajo shuarja e përhershme, që mund të merrej me mend se shfaqej e pakthyeshme dhe e pashpjegueshme, fshehtësi që ndodhet midis vdekjes e jetës, ose jetës dhe vdekjes, krejt një...

Holandezja Helga Krojf, kur ia kishte vërejtur mundimin, kishte nisur t'i fliste se si përmasat e jashtëzakonshme të hapësirës dhe ajri i rrallë në atë majë, me të drejtë nxjerrin në pah shqetësimin e të shqetësueshmes, që përballohet duke iu dhënë plotësisht asaj ndjenje, me çka pastaj edhe krijohet mundësia për të pasur qetësi shpirtërore, e cila sakaq kthehet në një meditim fare të lirë, që është i mundshëm vetëm aty dhe në rrethana të tilla...

- Është një vetëprekje magjike, që i duhet të menduarit të lirë, por edhe sjelljes së lirë, në përputhje me atë vetëmbushjen e pavarur të rikthimit...

Nuk kishte dashur t'i thoshte se tek ai po ndodhte e kundërta, e as me ia ba me dije se për pak kohë kishte pasur përshtypjen se ishte një si përfitim i çuditshëm që e kishte bërë të ndjehej si Gjyshi i Madh, i cili gjendej para atij që mundohej për me e vra, por që i dridhej dora dhe ai duhej për me e trimnue për me e shkrepë plumbin sa më parë dhe që ajo shkrepje njëherësh do ta ballafaqonte me mundimin e përgjegjësisë së bartjes së atyre të pathënave që duhej të thuheshin patjetër, qoftë edhe prej tij, ngaqë ishin pjesë e kujtesës shpirtërore, që nuk ishte vetëm e tij, por e të gjithëve, e që vrasësit, përveçse me atë veprim i binte barra e bartjes së tyre deri te zbrazja, aty ku ato fillonin të hapeshin që të shpëtoheshin nga dhuna e harresës, njëherësh viktimës i ndihmonte për me e përballue gjendjen e mjerueshme të atij shpenzimi me vetveten, për me kalue tek ajo që quhet kthim te kujtesa e përhershme dhe të ngjashme...

Në një përpëlitje të tillë sikur i ngjante ta dëgjonte të ankohej që e kishin rraskapitur e shkallmuar rrugët e botës dhe ngarendjet poshtëruese nëpër to, prandaj priste që në një mënyrë të tillë të merrte fund nënçmimi i pafund...

Holandezja Helga Krojf edhe më tutje kishte folur për hapësirën dhe sfidën e saj kur njeriu gjendet në ato maja që i kishte theksuar si të përhershme për nga madhështia, e cila hetohet me anën e një përqendrimi të veçantë, të ndërlidhjes me të, që paraqet një qasje shpirtërore ndër më të pavarurat dhe të ngjashme, ndërkohë që ai, i tulatur pranë saj, me ato që edhe më tutje nëpër kokë i përvijoheshin si mbetje të asaj ankese që t'i jepej fund sa më parë nënçmimit me atë shkrepjen që duhej të bëhej, kishte heshtur sikur t'i nënshtrohej një vetëzbrazjeje tjetër, pa qenë në gjendje për me ditë se a ishte ajo vetëm për me iu përshtatë lartësisë dhe ajrit të rrallë apo diçka që ndoshta kishte të bënte me një rimbushje po ashtu të veçantë, së cilës doemos duhej t'i nënshtrohej gjatë atij rrugëtimi drejt fundit të parapërcaktuar, që e kishte fat a fatkeqësi, krejt një, e që paralajmërimin e kishte hetuar nga ajo përshtypje që për pak kohë e kishte bërë të ndjehej si Gjyshi i Madh kur gjendej para atij që provonte për me e vra, por që i dridhej dora, prandaj ai duhej për me e trimnue për me e shkrepë atë plumb e ta qëllonte dhe nuk kishte si t'i ikte?...

Përballë një gjendjeje të tillë, kur do të ishte e natyrshme të hetonte edhe ankthe, drithërima dhe trazime, megjithatë kishte ruajtur qetësinë, bile edhe atëherë kur ndjehej sikur të ishte Gjyshi i Madh para vrasjes dhe vrasësit, kishte hetuar një si vetëmbushje me diçka që duhej të kthehej në vetëshpalim dhe pastaj të bartej, por si e përpunuar shpirtërisht...

Kështu, nga vetëmbushja e jashtëzakonshme, e cila tashmë e kishte përshkuar të tërin dhe ia kishte krijuar ndjenjën se ishte vetë Gjyshi i Madh, para atij që duhej ta vriste, por që atë disa drithërima disi e pengonin ta zbrazte atë plumb të fundit, ai, duke ia thënë ato me të cilat duhej të ngarkohej në mënyrë që të barteshin, doemos se do ta trimëronte për ta kryer vrasjen...

Natyrisht që vrasjes dhe atyre që duhej të nxirreshin në atë mënyrë, që vrasësi pra të mos ndjehej vrasës, por pjesë e një shërbese të caktuar, për të cilin pastaj do të zhdëmtohej me atë të vërtetën që do të përhapej - i duhej edhe skena, i duhej edhe hapësira e teatrit, i duhej edhe loja dhe i duheshin edhe aktorët, të cilët udhëzoheshin nga regjisori i padukshëm, po i duheshin edhe spektatorët, që nuk ishte e thënë ta përjetonin tragjedinë si tragjedi, por ta merrnin ashtu siç dëshironin ata...

Në ndjekje të asaj që tashmë e hetonte, ishte ngritur dhe, pak nga pak, i ishte afruar pjesës së mesme të shkallës, ku kishte zënë vend pranë oltarit dhe aty kishte filluar të fliste ato që vrasësi duhej për me i ndëgjue, pa marrë parasysh se a do t'i bënte për to apo jo, sepse, duke i dëgjuar, ato edhe përhapeshin njëherësh dhe sapo të përhapeshin, qoftë edhe pavetëdije mbaheshin mend, për t'u shtresuar pastaj në kujtesë, duke u bërë kështu pjesë e atij mbindërtimi të rëndësishëm të saj...

- Nuk ke pse të frikësohesh, - fliste sikur t'i drejtohej atij që duhej ta kryente atë shkrepje, me të cilën ishte ngarkuar.

Pak më vonë, gjithnjë me përshtypjen se kishte përpara atë që mëdyshej, kishte thënë:

- Këtë po e pres që moti...

- Më në fund, gjendemi ballaballas dhe nuk kemi si t'i bishtnojmë njëri-tjetrit...

- Më në fund, kemi arritur majën, atë pikën më të lartë, që i duhet një akti të tillë...

- Nuk e sheh këtë...?

- S'ke pse të frikësohesh...

- Çasti i duhur është i pashmangshëm...

- Erdhi çasti...

- Erdhi...

- Er-dhi...

- ...dhiiiiij...

Ai tjetri, që e kishte përfytyruar si vrasës, edhe më tutje kishte shfaqur shenja të frikës dhe sikur kishte kërkuar të gjente shkas të ikte.

- Është arritur pika nga nuk ka kthim prapa as ikje...

- Maja...

- Maja – majë...?

- Maje...

- Pika...

- Pikë...

Ai tjetri, të cilin e kishte përfytyruar si vrasës, jo vetëm që kishte shfaqur shenja të frikës, por sikur matej t'ia linte para revolen dhe t'i kërkonte falje...

- Këtë nuk guxon për me e ba...

- Sepse, e ban dikush tjetër...

- E ban vetë arma, që është përgatitur për këtë...

- E ban...

- Shkrepja është e pashmangshme...

- E pashmangshme...

- Shkrepja...

- Shkrepe...

- Shkrepe...!

Ai tjetri, që e kishte përfytyruar si vrasës, që kishte shfaqur shenja frike dhe po bëhej gati për me e lanë revolen dhe t'i kërkonte falje, kishte mbetur si i ngrirë.

- Nuk ke nevojë të shqetësohesh fare, kryeje detyrën, sepse dikush patjetër duhet për me e krye...

- Detyra është detyrë...

- Apo jo...?

- Detyra...?

- Detyra-detyrë...
- Duhet kryer...
- Duhet...
- Detyra...
- Detyra-detyrim...
- Detyrim...!

Ai tjetri, të cilin e kishte përfytyruar si vrasës dhe që kishte shfaqur shenja frike dhe po bëhej gati për me e lanë dhe me kërkue falje madje, edhe pse kishte mbetur i shtangur, sikur kishte pritur edhe më tutje të trimërohej për me vra ...

- Para se me e shkrepë plumbin, e për këtë nuk duhet të shqetësohesh fare dhe as të ngarkohesh me ndjenjë faji, aq më pak të krimit, (është fjala për një punë që gjithsesi duhet të kryhet, pa marrë parasysh se prej kujt), duhesh për me i ndëgjue ato që kanë me t'u thanë, sepse ato që do të thuheshin dhe dëgjohen, edhe nëse nuk ua vë veshin (kjo nuk është kurrfarë mospërfilljeje), sapo nxirren bëhen pjesë e një dëshmie, e cila vetvetiu gjen rrugën që të përhapet dhe ashtu për me shkue ku duhet...

Ai tjetri, të cilin e përfytyronte si vrasës, sikur po e merrte veten.

- Pra, vetëm duhet për me ndëgjue...

- Mbase, kjo nuk të duket e vështirë, ngaqë paraqet një si plotësim dëshire që i lejohet të vrarit...?

- Jij i qetë dhe dëgjo...!

- Pastaj, edhe shkrepja ka me qenë fare e natyrshme...

- Fare e natyrshme...

- E natyrshme...

- Pse jo...

- Zbatim detyre...

Ai tjetri, që e kishte përfytyruar si vrasës, që kishte shfaqur shenja frike dhe bëhej gati të linte revolen e të kërkonte falje dhe t'ia mbathte, por që edhe më tutje kishte mbetur i ngrirë dhe ato që i ishin thënë i kishte marrë si trimërim për atë shkrepje, kishte dhënë shenjë se ishte i gatshëm për me i ndëgjue ato që do të thuheshin...

Po, ato që do të thuheshin ishin fjalë që ishin thënë rreth mallkimit të Taksimit, që e kishte zënë dhe i kishte zënë që të gjithë ata që nuk i ishin përmbajtur betimit të asaj marrëveshjeje që ishte lidhur aty...

Një copë herë kishte mbetur me fjalët ngoje për mallkimin e Taksimit, të cilat i kishin futur të dridhura dhe pak nga pak e kishin liru nga ndjenja se ishte Gjyshi i Madh, pikërisht para se ta qëllonte ai plumbi vdekjeprurës i atij që e kishte përcjellë dhe më në fund e kishte gjetur, po që kishte pasur frikë për me e qëllue, por ishte trimëruar për me e ba sa më parë, meqë ashtu kryente një detyrë që duhej ta kryente medoemos, pa të cilën do të mbeteshin të pathëna ato që duhej të thuheshin, ndërkohë që edhe ai lirohej prej asaj rraskapitjeje duke bredhur rrugëve të botës në pritje të plumbit kaheerë të paralajmëruar, që pashmangshëm duhej për me u zbrazë një ditë.

Po çfarë kishte qenë mallkimi i Taksimit që e kishte zënë dhe i kishte zënë që të gjithë ata që nuk i ishin përmbajtur betimit të marrëveshjes, por edhe të tjerët...?

Në atë hapësirë, të ngjashme me atë skenën e teatrit të madh, ku kishte përfytyruar dramën e përhershme me ato lojërat që luheshin me aktorë të njëjtë po që u ndryshonin vetëm rolet, nuk kishte qenë në gjendje për me ditë se për çfarë ishte fjala dhe kjo sikur e kishte mbushur me shqetësimin se mund të përfshihej në punë që nuk i dinte, që mund ta mundonin dhe t'ia krijonin përshtypjen e atij që ishte plot e përplot zbrazëti, që mund t'i kishte nga koha e bodrumeve dhe nga ato mësimet shkel e shko e që përhapeshin, por edhe nga të tjerat që lidheshin me ato mësimet gjysmake, ku thuhej diçka, jo deri në fund, po edhe kur thuhej, shumëçka mbetej pa u thënë, që mund të jetë tepër e rëndësishme, po që shpalimi i saj duhet

t'i takojë harresës nga frika se me të hapen çështje të tjera dhe çmos, të cilat nuk u shkojnë gjendjeve kalimtare.

Me siguri se këto hamendje do ta ngarkonin edhe më tutje, sa të ndjehej pjesë e një loje të paqartë dhe të ngjashme, sikur të mos ndodhte që po atë ditë në internet të haste përgjigjen nga ajo ndërhyrja që i kishte ardhur nga adresa "Bllaca" me shifrën "28-03-99", që paraqiste ditën e fundit të marsit, ose të katërtën e bombardimeve nga ajri, në të cilën ishin deportuar me dhunë në drejtim të Shkupit, e që mund ta merrte me mend se ishte nga i ati, me çka mund t'i bëhej me dije se nuk ishte i zhdukur, siç mendonte kur në udhëkryqin e rrugës Shkup - Tetovë i kishin ndarë dhunshëm dhe pasi do të ketë kaluar nëpër Bllacë, si shumë e shumë të tjerëve do t'i humbin të gjitha gjurmët. Njëherësh, me atë që hidhte në internet, që në të ardhmen do të vepronte si me farë kodi të veçantë shpirtëror nga një pikë e padukshme, po ashtu i ishte bërë me dije se i tëri i ishte dhënë trajtesës "*Dardania si kujtesë historike me rrënjë të thella në antikë*", shenjë kjo tepër inkurajuese, e cila i kishte shërbyer që edhe ai ngjashëm t'i hynte një pune të njëjtë (një kujtesë poetike), me mijëra vargje me gjashtëmbëdhjetë rrokje dhe me rimë të hapur, të shtrira në nëntëdhjetë e nëntë poema asnjëherë të kryera, me çka ishte marrë gjatë gjithë jetës dhe këtë e kishte bërë qëllimisht me arsyetimin "se ato kërkonin një jetë të tërë" dhe vetëm fundi paraqiste atë fjalën e fundit, por kjo nuk e kishte penguar që shumë prej tyre, edhe si të shkëputura, herë pas here t'i hidhte në internet në faqen e webit që e kishte quajtur "*I vetëzhdukuri*" dhe kishte pasur shumë e shumë vizitorë kur në të kishte paraqitur pjesë të poemave "*Mallkimi i Taksimit*" dhe "*Vera e gjatë e Shkupit*", që ishin përcjellë edhe me vlerësime dhe letra të ndryshme, të cilat më vonë, krahas përpjekjeve që t'i fuste në poemë dhe t'i ndërlidhte me porosinë e saj, siç u kishte ndodhur krijimeve popullore që ishin bartur nga brezi në brez, shumë prej tyre i kishte futur në një dosje të veçantë, të cilën e kishte quajtur "*Në kërkim të perandorisë së më të mirës*", që pak nga pak ishte kthyer në një libër të hapur, tejet të veçantë, ku kishin gjetur vend thuajse të gjitha ato letra me opinione të ndryshme tejet kritike, jo vetëm për çështje që lidheshin me ato që gjenin vend në atë preokupimin letrar që Dardaninë e trajtonte si kujtesë poetike, por edhe të tjera që kishin të bënin me atë që shihej "*si përvetësim i realitetit që të ndikohet kujtesa*", herë si "*shkatërrim i realitetit që të ndryshohet kujtesa*", e herë edhe si "*ngjyrim i realitetit që të rrënohet kujtesa*" dhe ndryshe-ndryshe, e kjo do të ndikojë që pasi të kthehet në Egjipt faqen e webit në internet ta ndryshojë nga "*I vetëzhdukuri*", që e kishte pasur për vite të tëra, në "*Vetëdukja*", me ç'rast holandezja Helga Krojff do të bindet se Vëllaznim Prishtina, pa marrë parasysh se në ç'cep të botës gjendej dhe pa marrë parasysh si e arsyeton atë largim, në të vërtetë ai gjithnjë kishte qenë në lëkurën e vet dhe vetëm ashtu e kurrësi ndryshe ishte sjellë brenda saj, prej nga sikur ishin shkrirë kufijtë midis hapësirës, por edhe kohës, sa çdo gjë të dukej se kthehej në një përsëritje të së njëjtës...

Por, para se të ndodhte kjo, duhet thënë se shkrimi rreth mallkimit të Taksimit, që i ishte hedhur në internet nga ai kodi i hapur i të atit me ato që i takonin kujtesës së përhershme e që ishte pjesë e vetëdijes - fillonte me shpjegimin se ç'ishte në të vërtetë Taksimi dhe pse ishte ngritur ai deri te mallkimi që i kishte zënë të gjithë ata që nuk i ishin përmbajtur marrëveshjes së arritur aty, por edhe të tjerët që ishin sjellë sikur ajo të mos ishte, ose pse nuk kishin pasur guximin ta kthenin atë në një shqyrtim të hapur...

Në këtë shpjegim thuhej se Taksimi ishte një vend i vogël në pjesën perëndimore të Stambollit, pra në atë hapësirën europiane, ku kishte gjelbërim të përhershëm dhe aromë të këndshme trëndafilash. Theksohej se aty, jo rastësisht ishte mbajtur një takim i disa liderëve të lëvizjes kombëtare për pavarësinë (përmendeshin Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Esad Toptani, Bedri Pejani dhe Sylejman Beu, si dhe ndonjë tjetër), që shumë prej tyre nga bashkëmendimtarët që ishin me përcaktimin që shpërbërja e Perandorisë Osmane të mos e gjente Shqipërinë pa u bërë Shqipëri dhe për këtë të bënin çmos, kur kjo nuk do të arrihej, në përpjekje dëshpëruese që disi ta zhdëmtonin atë, duke mos u kursyer edhe nga gjithfarë lojërash të huaja, do të kthehen në kundërshtarë, madje edhe në armiq, që do të punojnë për

t'ia hequr kokën njëri-tjetrit, por që shumë prej tyre do të vriteshin rrugëve të botës, të shkallmuar fare...

- Vrasja ime dhe vrasja jonë (pa marrë parasysh se do t'i duhen edhe njëzet e dy vjet që të merite epilogan e vet) filloi në Taksim, atë ditë të butë të janarit, kur erërat e forta të lindjes bartnin anije të shumta nëpër ngushticën e Bosforit sikur të ishin lodra fëmijësh, ndërkohë që ne dhamë betimin për atë kryengritjen e përgjithshme që duhej të fillonte me syrin e pranverës në të katër vilajetet (Kosovë, Shkodër, Manastir dhe Janinë) dhe me të të arrihej ajo që do të paraqiste themelet e shtetit të përbashkët shqiptar, pikërisht aty ku ai para dy mijë e sa vjetësh, te qytetërimi pellazg-ilir kishte rrënjët e veta në antikë...

- Nëse nuk ia dalim që kryengritjen ta nisim përnjëherë në katër vilajetet, atëherë kemi me ia hangër kokën asaj, thamë njëzëri në atë takim, kur u betuam se do t'u përmbahemi marrëveshjeve.

Por, ç'ndodhi?..

Ndodhi që vetëm Kosova të përfshihej nga flaka e kryengritjes dhe në atë flakë e sipër të digjej, ngaqë kishte mbetur vetëm dhe në vend të betimit për mëvetësi, me dilemën e hapur: “për” apo “kundër” sulltanit por nën ombrellën perandorake.

Megjithatë, flaka e Kosovës tronditi Perandorinë sa t'i kthehej në kob, çastin kur Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, të frikësuar nga bashkimi i vilajeteve shqiptare që pashmangshëm do të përfundonte me një shtet të fuqishëm, do t'i shpallin luftë Perandorisë Osmane dhe trupat e tyre shumë shpejt do të futen në trojet shqiptare...

Më tutje, ndërhyrjes së parë në internet - që ishte i sigurt se e kishte nga i ati dhe ai kodi i veçantë i kujtesës që vepronte nga dika thuajse pahetueshëm, por që në pjesën e dytë, pra kur shfaqej rrëfyesi, barteshin qëndrimet e Gjyshit të Madh rreth asaj ngjarjeje - i bashkëngjitej edhe shënimi shtesë “*Pse në Shkup nuk u shpall mëvetësia kombëtare*” dhe për këtë, nga ai që merr përsipër detyrën e *kujtesës*, kryekreje fajësoheshin nënshkruesit e marrëveshjes së Taksimit, me çka thuhej se u binte barra për tragjedinë e Kosovës, e edhe për fatkeqësinë gjithëkombëtare shqiptare, e cila do të kthehet në një plagë të madhe, që do të mbetet e hapur dhe do të kullojë gjak të freskët dhe pa të cilën as ndodhja e Bllacës nuk do të ishte e mundur e as ato të tjerat që do t'i paraprijnë, çfarë kishte shumë e shumë...

- Ka një fajësim dhe vetëfajësim të çuditshëm, për të cilin bëhet fjalë për herë të parë, me çka sikur hapen dilema të tjera që mund të kthehen edhe në plagë - do t'i thotë holandezes Helga Krojff pasi ta ketë lexuar për të satën herë atë që i ishte hedhur në internet dhe e dinte se ishte nga i ati, pasi ai t'i ketë marrë në shqyrtim të gjitha ato shkrime dhe shënime që i kishte lënë Gjyshi i Madh, ku prej tij ruheshin me kujdes bashkë me ato të fshehtat e tyre, të cilat një ditë duhej të dilnin në pah.

- Nuk është fajësim, por shpalosje e një të vërtete që është shmangur nga frika se mund të prodhonte përçarje... Duket se tash ka ardhur koha për të...

Holandezja Helga Krojff i kishte folur me qëllimin që të kishte parasysh se gatishmëria për t'u marrë me to dhe hapja e çështjeve që merreshin si të paprekshme, pashmangshëm do të ndodhë, pa marrë parasysh tronditjet që mund të shfaqen që, si do të shihet, me ato që më vonë do të gjejnë vend në dosjen e hapur “Në kërkim të perandorisë së më të mirës”, në vorbullën e kthesave të ashpra, të cilave do t'u nënshtrohet, do të paraqesin njërën ndër sfidat më të mëdha të rigjetjes së vetvetes...

Rreth kësaj kthese, që patjetër do të shfaqej, holandezja e kishte paralajmëruar në Prishtinë, kur ia kishte dhënë atë intervistën e botuar në gazetën e Vjenës, në të cilën shpreheshin opinionet rreth çështjes shqiptare në rajon, që prej tij quhej edhe “ulcerë ballkanike”, si dhe për rirreshtime të reja në hapësirat e saj pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, që do të ishin në përputhje me ato ndërlidhje që do të mundësonin një vazhdim të përbashkët civilizues, në vend të krijimit të rrethanave të tjera për përplasje të reja mbi baza të

përçarjeve fetare, siç kishte ndodhur kur ishte lejuar që Moska të hidhte projektin për shtetet e pavarura sllave nën ombrellën e ortodoksisë...

Më tutje e kishte bërë me dije se çështja e shpalljes së pavarësisë kombëtare në gusht të një mijë e nëntëqind e dymbëdhjetëshes në Shkup dhe mallkimi i asaj që me të drejtë quhej mospërmbushje e betimit të marrëveshjes së Taksimit, nuk ishte vetëm pjesë e tragjedisë shqiptare, që ata do t'i zërë shpejt, fill pasi të fillojnë luftërat ballkanike dhe Perandoria Osmane të humbë pjesën më të ndjeshme, mbi të cilën kishte qëndruar gjithë ngritja dhe fuqia e saj shekullore, por është edhe çështje e ngatërresave të tjera ballkanike dhe europiane që krizën lindore do ta bartin në qendër të përvijimeve të mëvonshme strategjike dhe gjeostrategjike që do t'i prijnë Luftës së Parë Botërore e më vonë edhe të Dytës, si dhe zhvillimeve të tjera, gjithë deri tek ajo ndërhyrja e NATO-s, bombat e së cilës, nga njëzet e katër marsi e deri më dhjetë qershor, do t'i japin fund asaj që mund të merret si mallkim i Taksimit...

- Shpallja e pavarësisë kombëtare në Shkup do ta pengonte tragjedinë shqiptare dhe atë ballkanike, madje do ta pengonte edhe Versajën dhe të tjera tragjedi që do të shestohen në Jaltë...

Ai, edhe më tutje nuk kishte qenë në gjendje të lirohej nga mbërthimi i hutisë, në të cilën ishte përfshirë nga ato që kishte lexuar në atë shqyrtimin që i ishte dërguar me internet rreth çështjes *"Pse në Shkup nuk ishte shpallur pavarësia kombëtare"*, ku thuhej se fajin kryesor për këtë e mbanin ata që nuk i ishin përmbytur betimit të marrëveshjeve të Taksimit, por edhe përçarjet në radhët e udhëheqjes kryengritëse që, në vend se të merreshin me këtë akt madhor si pasojë e asaj fuqie gjithëkombëtare që ishte pasqyruar me një shpërthim aq të madh që kishte tronditur themelet e Perandorisë, sikur t'i ishin frikësuar përdorimit të saj për atë qëllim, prapë i ishin kthyer shpëtimit të sulltanit dhe hijes së tij, me shpresën se jashtë atyre që quheshin axhamillëqe të xhonturqve, në atë fronin e vjetër, do ta ruante ngrehinën e kalbur perandorake dhe me këtë edhe gllabërimin e hapësirës së tyre, e cila ishte në shpërbërje e sipër që, si do të shihet më vonë, sapo të ulen armët dhe luftëtarët e dëshpëruar shqiptarë të largoheshin nga Shkupi, nuk do të vonojë dhe vendet e tyre, por tash me një luftë të re, do t'i zënë ushtritë serbe dhe malazeze, kur edhe do të ushtrojnë njërën ndër masakrat më të mëdha mbi popullatën e pambrojtur dhe njëherësh do ta bëjnë pikë e pesë gjithë hapësirën etnike shqiptare, me synimin përfundimtar për ta fshirë plotësisht nga harta e ardhshme europiane...

- Këto, sikur nuk m'i ha koka - i kishte thënë holandezes Helga Krojf, kur ajo edhe më tutje ishte munduar t'ia shpjegonte shumë nga ato që i dukeshin të pakapshme.

- Jemi mësuar që atë lëvizje ta shohim ndryshe, si diçka të shenjtë...

- Do të mësohesh me të papriturat e pritshme...

- Sikur më vijnë si një lëmsh i madh që më zë frymën...

- Këtij lëmshi një ditë duhet t'i gjendet filli...

- Nuk ma ha mendja se mund të lëvizën kornizat historike... Këtij tërmeti askush nuk mund t'i bëj ballë...

- Nuk ka përmendore të përjetshme... Përpyekjet që të mbahen të tilla janë mashtrime që një ditë dalin në shesh. Vetëm krijimtaria, kur me gjuhën e vet i fut në letërsi, muzikë, në pikturë dhe në skulpturë, ua jep përjetësinë...

- Ah, lëri përmendoret se po më trazohet midja prej tyre...

- Ato janë të pashmangshme. Njerëzimi sikur i ka fat, por edhe fatkeqësi, edhe kur i ndërton po edhe kur i rrënon...

Në të vërtetë, habia e Taksimit dhe ato që i ishin shfaqur çastin kur për herë të parë ishte ngjitur në atë shkallën e mbetjeve të qytetërimit të Majëve në atë pjesën e Puerto - Bravos, ku ajo pika e horizontit duket si largësi e afërt, por e pakapshme - pak nga pak i kishin kaluar në njëfarë prove të rimbushjes a të asaj që holandezja Helga Krojf ia kishte përkujtuar se i takonte kthimit nga vetvetja, por edhe rigjetjes së Vëllaznim Prishtinës, të vetëshpallur të zhdukur diku në Prishtinë nga dëshpërimi i prapësive që ishin parë dhe

përjetuar me rastin e ballafaqimit me atë kohën kalimtare dhe paqartësitë e shumta që ishin shfaqur kur hapësira i ishte pushtuar nga ata që kishin nxituar të silleshin sikur ajo të ishte e përhershme, një gjendje jashtë rregullave, por që me ato që sikur i vinin nga dika paraqiste frymën e Gjyshit të Madh që e ndiqte pareshtur si hije sa ta pushtonte dhe ai ndjente se ishte po ai para atij plumbi, të cilin e priste që e priste dhe bënte çmos për me e trimëruar atë që duhej për me e shkrepë, për mos me u hamendë, e as me u ligështue, por për me e ba me bindjen se me atë veprim i jepte fund një nënçmimi të rëndë dhe njëherësh krijonte mundësinë që ajo e vërtetë të bartej në atë kutinë e mbyllur të hamendjeve të mëdha, të cilave koha një ditë do t'ua hapë kapakun, kur për të të krijohen rrethanat e duhura...

Kështu, një ditë, këtë ndjekje që e mbushte vazhdimisht me frymën e Gjyshit të Madh, sa të ndjehej pikërisht si ai para shkrepjes së atij plumbi vdekjeprurës dhe kësaj as që ia kishte frikën fare, por do ta merrte si ndihmesë që ta nxirrte nga zhvlerësimi, nëpër të cilin kishte kaluar - ia kishte besuar edhe Helgës, së cilës i kishte thënë se po bënte përpjekje që disi edhe më shumë t'ia hapte hyrjet duke u hequr si Maks Bruner, të atij reporterit izraelit, i cili kishte marrë aq shumë e shumë opinione në Kosovë rreth fakteve që paraqiteshin si shkaqe të kundërvënies aktive, në rrethanat e asaj që shfaqej kundërvënie paqësore me atë vendosjen e pushtetit paralel të vetëdëshmimit dhe të ngjashme, me të cilat regjimi i Beogradit ishte rrudhur në pushtues të dhunshëm, veprim ky që më vonë, me shfaqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte ngritur në shkallën e kundërvënies së armatosur, me të cilën pastaj i ishin hapur dyert edhe ndërhyrjes së NATO-s kundër forcave policore-ushtarake të Beogradit në Kosovë, kur ajo kishte filluar të merrte përmasat e spastrimeve etnike me anën e gjenocidit të hapur ndaj popullatës së pambrojtur...

- Një ditë, ai plumb ka me u shkrepë, por mbase shkon kot, ngaqë të vetëzhdukurit nuk qëllohen dot, siç nuk qëllohet hija...

Helga Krojfi për herë të parë kishte heshtur, sikur të ishte zënë ngushtë nga ato që kishte dëgjuar t'i thuheshin për hijen që nuk qëllohet. Siç do të pranojë më vonë, kur do të kthehen në Egjipt pranë piramidave dhe në afërsi të rrënojave të qytetit të Aleksandrisë do t'ia shkruajë atë parathënien për veprën "*Në kërkim të perandorisë së më të mirës...*", të cilën do ta botojë në gjuhën angleze dhe do ta trajtojë si opinion të hapur rreth thyerjeve me kthesa të mëdha historike, që kishin mbetur pa kundërpërgjigje, si thoshte, "të mendjes dhe të shpirtit" - nga frika se mund të përfshihej nga shenja të depresionit, të ngjashme me ato që kishin ndikuar të vetëshpallej i zhdukur dhe nga rrënimi i mëtejshëm të mbrohej me atë maskën e përkohshme sikur të ishte Maks Bruner - e kishte bërë me dije se vetëm duke u marrë me projektin për Dardaninë si kujtesë poetike mund të ishte ai ilaçi që do t'i ndihmonte të mos ndjehej as i zhdukur e as hije, por një krijesë që me anën e hulumtimit të pareshtur përballonte ato që ia kishin krijuar përshtypjen e tri mashtrimeve, nëpër të cilat kishte kaluar (vëllazërim-bashkimi, jeta paralele nëpër bodrume dhe gjendja kalimtare), të cilat më vonë, kur me anën e internetit do të marrë shumë e shumë letra, shumë e shumë opinione, ndër më të ndryshmet, që ishin plot pakënaqësi dhe dëshpërim, por ndonjëherë edhe me kundërime optimiste se secila përmbysje lë pas rrënojat e veta që duhen përballuar dhe të ngjashme, do t'i marrë si pjesë të pashmangshme të asaj mbijetese me përshtatje, me të cilat historia e qytetërimit ishte plot e përplot dhe, sa herë që ajo sjellje ishte dashur të arsyetohej, ishte parë në përputhje me teorinë e evolucionit të Darvinit, të bartur në planin shoqëror...

Në të vërtetë, fakti që i ishte qasur kujtesës me ato që i kishte parë si pjesë të së djeshmes në të sotmen e nesërme dhe anasjelltas, që mund të merreshin edhe si ngatërime që sillnin ato realitete të papajtueshme dhe thyerjet e tyre, nëpër të cilat ishte kaluar (vëllazërim-bashkimi, jeta paralele nëpër bodrume dhe më pas gjendja kalimtare me shumë e shumë paqartësi dhe të papritura të pritshme) - i kishte ndihmuar që, në atë pjesë të botës, në Meksikë, përballë rrënojave të njërit ndër qytetërimet më të zhvilluara të botës, siç ishte ai i popullit të lashtë të Majëve në Puerto - Bravo, i cili thajse në mënyrë të pashpjegueshme ishte braktisur prej tyre në kohën kur ishte arritur pika më e lartë e asaj madhështie, por që

edhe në atë gjendje të mbetur prej qindra vjetësh, megjithatë kishte ruajtur frymën e përhershme dhe madhësinë, t'i shohë në frymën e së përheshmes dhe kjo ndjenjë i kishte sjellë ngushëllim, prehje po edhe shqetësim njëherësh, ngaqë ishte fryma e Gjyshit të Madh në prag të shkrepjes së atij plumbi, që kërkonte ta gjente sa më parë dhe, me të, si thoshte, t'i merrnin fund ato nënçmime të rënda, nëpër të cilat kalonte që prej vitesh...

Ai, sa s'i thoshte se kërkonte atë mburojën që mund t'ia jepte vetëm kujtesa, e cila kalon nëpër mendje dhe shpirt...

Kështu, në përputhje me përcaktimin që mendja dhe shpirti të ngrehnin mburojat që i duheshin kujtesës (më vonë do të pranojë se holandezja Helga Krojfi i kishte ndihmuar së tepërmi t'i kthente në një preokupim të përhershëm), kishin qenë edhe ato që ajo ia kishte theksuar si "përpunime historike" të domosdoshme, që krijimtaria duhet t'ua heqë atë velin e mjegullimit, siç ndodh që edhe gjatë gjendjeve kalimtare të dalin në pah gjithë ato mangësi dhe zbrazëti të pashprehura që ua zënë vendin vlerave, ku vend të veçantë kishin zënë poemat "*Mallkimi i Taksimit*" dhe "*Vera e gjatë e Shkupit*", të cilat i kishte thurur si me një frymë dhe kishte pasur bindjen se ruanin gjithë ecurinë e të vërtetës së shkrimeve që i ishin dërguar në adresën e internetit, por që shpejt kishte parë se ajo rrjedhje sikur kishte qenë paksa më e veçantë, ngaqë shumë nga ato vargje i derdheshin "nga dika" të gatshme dhe si ndihmesë a ndërhyrje që nuk mund të ishte tjetër përpos nga ajo që e ndjente si frymë të Gjyshit të Madh, të cilën e kishte hetuar aty, sa të fitonte përshtypjen se ishte qenia e tij që ia kishte plotësuar, jo vetëm atë hapësirën e zbrazur që i ishte shfaqur me rastin e vendimit për t'u shpallur i vetëzhdukur dhe si i tillë të merrte botën në sy – dhe, përballë qytetërimeve të mëdha të rrënuara, siç ishte ai i Majëve dhe i Inkëve, më vonë ai i Egjiptit me piramidat dhe Aleksandrinë e Aleksandrit të Madh që vinte nga bota pellazge, të gjente ngushëllim të përhershëm për atë rrënimin e brendshëm që e kishte përjetuar – por, edhe i kishte ndihmuar që asaj humbjeje t'ia jepte një kuptim të veçantë hulumtimi të përhershëm, që më vonë do t'i kthehet në atë që holandezja Helga Krojfi e kishte quajtur vetëgjetje...

Çuditërisht, hedhja në internet e një pjese të poemës "*Mallkimi i Taksimit*" me ato vargjet gjashtëmbëdhjetë rrokjesh, edhe pa ata emrat që kishin nënshkruar atë marrëveshje, me të cilën Shqipëria duhej të bëhej Shqipëri, por që e gjitha kishte mbetur në gjysmë të rrugës, ishte pranuar sikur të ishte fjala për "*Betimin e Taksimit*", një si zotim i shenjtë, që ndonjëherë do të çohet në vend, dhe se ajo bërja e Shqipërisë Shqipëri, që duhej të fillonte nga Kosova dhe përgjakja e saj e tmerrshme, nuk do të thoshte fund, siç ishte dukur me shpalljen e pavarësisë në Vlorë katër muaj pas parakalimit shqiptar në Shkup, kur Kosova dhe pjesët më të fuqishme të trungut shqiptar, si hakmarrje ndaj atij demonstrimi madhështor, do të pushtoheshin nga ushtritë serbe e malazeze dhe do të silleshin buzë zhdukjes, por do të paraqiste atë fillimin e asaj përpjekjeje të gjatë dhe tejet të mundimshme, që me pendë e luftë të arrihej ajo që ishte e pashmangshme, ku edhe ajo ndërhyrja nga ajri e ndërkombëtare e njëzet e katër marsit ishte parë si pjesë e atij betimi, që marrëveshja e Taksimit të çohet deri në fund...

- Herë-herë, sikur hetoj se në mua po shpërthen fryma e Shpresa Kamberit dhe baladat e saj, që mbushnin me jetë errësirën e bodrumeve të Prishtinës - do t'i thotë Helgës kur do ta rimarrë nëpër dorë tekstin e poemës "*Mallkimi i Taksimit*" dhe do të shohë se në vend të fajësisë dhe vetëfajësimit pse nuk ishte çuar në vend ajo marrëveshja për ngritjen në luftë të katër vilajeteve dhe pse e gjithë barra i kishte rënë Kosovës, e cila i ishte përmbajtur betimit të kryengritjes dhe për këtë ishte djegur e pjekur tmerrësisht dhe ankime të ngjashme, që mund të shkonin deri edhe te rishqyrtimet kritike, që edhe ai ua kishte pasur drojën ngaqë rrënoheshin edhe disa nga kornizat historike që merreshin si të paprekshme dhe madje të shenjta - ajo shfaqej si "*Betimi i Taksimit*", një si pasqyrim tjetër nga ai që i ishte hedhur në internet nga ai sqarimi që e dinte se i vinte nga i ati, por edhe ndryshe nga ato që i vinin nga Gjyshi i Madh, frymën e të cilit e ndjente përballë asaj shkrepjeje që assesi t'i vinte ngaqë

dorasit i dridhej dora dhe ai kërkonte ta trimëronte për ta bërë sa më parë, që të lirohej njëherë e mirë nga barra e nënçmimit, nëpër të cilin kalonte...

Kështu, në vend të atij që druante për me e ba atë shkrepje, me të cilën duhej për me u dhanë fund vuajtjeve të gjata dhe nënçmimit që kishte kaluar ai që ishte luftëtar i orëve të para të pavarësisë, shfaqej një tjetër, me një libër në dorë, që lexonte dhe lexonte diçka nga lashtësia dhe përkujtonte se ishte një betim i lashtë, që ishte dhënë para lumit Arion, kur Kadmi kishte mundur përbindëshin që kishte mbyllur burimet e ujit dhe atyre që i kishte krijuar nga dhëmbët e tij, u kishte thënë se nga ai çast krijimi i takonin botës pellazge, me të cilën fillonte edhe mbretëria tokësore e njerëzve, për të cilën duhej të luftonin gjithmonë për ta shtrirë dhe zgjeruar. Më vonë, bijtë e tij, ndër të parët Dardani dhe pastaj Iliri, kishin filluar ta jetësonin këtë porosi...

“*Betimi i Taksimit*”, nga “*Mallkimi i Taksimit*”, siç e kishte shkruar dhe ishte i bindur se këtë e kishte bërë në frymën e atyre që i ishin hedhur në internet, ku i bëhej me dije se ç’ishte në të vërtetë ajo marrëveshje, nga ato që lexoheshin në atë libër, ishte kthyer në “*Betimi i lashtësisë*”, që herë-herë tingëllonte edhe si “*Betimi pellazg*”, por edhe “*Betimi i Dardanit*” dhe së fundi “*Betimi i mendësisë*”, që ishte në gjendje t’i bënte vetëm poetesha dhe këngëtarja më e talentuar, Shpresa Kamberi, me atë përkushtimin e jashtëzakonshëm, e cila edhe situatat më të rënda i shihte të përballueshme...

Ngjashëm do t’i flasë edhe për ato që u kishin ndodhur vargjeve që do të gjenden në atë “*Vera e gjatë e Shkupit*”, kur ngjarjet e asaj vere - që do ta tronditin Perandorinë Osmane dhe do t’i paraprijnë tragjedisë shqiptare, e cila do të shfaqej në fillim të asaj vjeshte dhe dimri me shpërthimin e luftërave ballkanike - do të ngatërrohen me një verë tjetër, me atë të vitit një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë, në të cilën po ashtu bëhet fjalë për një luftë dhe një kryengritje të madhe, e cila ishte quajtur “përplasje e ashpër e dy botëve”, ku kryq dhe hënë e yll, në anë të ndryshme, që i ndante një lumë i rrëmbyeshëm midis malesh të ashpra, kishin luftuar për jetë a vdekje, por që në atë betejë sikur kishte ndodhur një ngatërrim i çuditshëm i këtyre simboleve, kur edhe në njërin anë (të kryqit, që e udhëhiqte gjenerali i Vjenës), e edhe në tjetrën (të gjysmëhënës, që e udhëhiqte padishahu), kishte shqiptarë, pra në të dyja anët kundërshtarë vëllezër të një gjaku, kush nën komandën e peshkopit Pjetër Bogdani, e kush nën komandën e Mehmet pashë Qypriut, të gjithë të vilajetit të Kosovës, të një gjaku dhe gjuhe, luftonin kundër njëri-tjetrit, por që në pushimet e betejave, skaj lumit do të këndonjë bashkërisht të njëjtat këngë dhe do t’u bien të njëjtëve fyej...

- Nuk e di se kush merr pjesë më shumë tek unë: Gjyshi i Madh apo Shpresa Kamberi...? Që të dy bashkërisht, ose shumë e shumë të tjerë...? Nuk e di...

Dikur kishte thënë:

- Di vetëm që nuk di...

- Është mrekullia e krijimtarisë ajo që me marrje-dhënie, që janë të natyrshme, dhe me ato zhvendosjet që bën, ndryshon edhe gjendjet, edhe pamjet, e edhe të gjitha, sa t’i shfaqë në një dritë të re, në një dritë që, në të vërtetë, duhet ta kenë, por që prej saj privohen dhunshëm, ndonëse kjo kurrë nuk mund të mbetet fjalë e fundit...

Ai kishte heshtur dhe ende kishte pasur përshtypjen se kthimi i mallkimit në betim ishte më shumë se një shndërrim krijues. Ishte diçka që më vonë kishte hetuar se lidhej me ato të fshehtat e brendshme, të cilat mund të hapen dhe mund të veprojnë edhe vetvetiu, madje edhe njëanshëm vetëm përballë gjendjeve të jashtëzakonshme...

X

Fuqisë së të fshehtave të brendshme, të cilat veprojnë edhe vetvetiu dhe njëanshëm përballë gjendjeve të jashtëzakonshme dhe shpesh duket sikur në to marrin pjesë edhe të tjerë, të njohur dhe të panjohur (siç hetonte praninë e frymës së Gjyshit të Madh, e së voni edhe të poeteshës dhe këngëtares së talentuar Shpresa Kamberi, a të ndonjë tjetri), i ishte nënshtruar, jo vetëm në lartësitë e rrënojave të Puerto - Bravos në Meksikë, kur ishte mrekulluar nga

rrjedhja e atij shpirti krijues me aso fuqie të përhershme, por atyre u ishte dhënë edhe kur për disa muaj kishin kaluar në Amerikën Latine, në pjesën e Andeve, në kërkim të përjetimit të mbetjeve të qytetërimit të Inkëve dhe prej andej pastaj ishin përgatitur që përfundimisht të ktheheshin në Egjipt, pranë piramidave dhe grishjes së tyre të përhershme, që të hulumtonte edhe madhështinë e Aleksandrisë, që e kishte nga Aleksandri i Madh, të cilin i ati e merrte se i takonte botës pellazge, nga i kishte rrënjët edhe Dardania antike dhe lashtësia e saj, që ai e kishte kthyer në projekt jetësor të kujtesës historike dhe që atje t'u kuptohet e fshehta e kohës dhe përpëlitjet që kishin kushtëzuar atë ngritje dhe në njëfarë mënyre kishte paraqitur moton e asaj që do t'i kthehet në përkushtim të përmbushjes së dosjes *“Në kërkim të perandorisë së më të mirës”*.

Disa vjet më vonë – gjithnjë nën tryshninë e vazhdueshëm të Helgës, që si tërësi t'i jepeshin opinionit botëror kundrimet e brendshme të atyre thyerjeve të mëdha, nëpër të cilat ishte kaluar dhe shumë prej tyre nuk ishin përballuar pikërisht prej atyre që nuk kishin qenë në gjendje t'i pajtonin të papajtueshmet, të cilat shfaqeshin si pasoja të kohëve me përshtatje të vazhdueshme dhe me të tjera pasoja të këtilla që shquajnë çdo ndryshim dhe lëvizje të madhe kudo qoftë - e kishte botuar dhe kishte pasur jehonë të madhe, saqë e kishte detyruar ta vazhdonte edhe më tutje atë që e kishte quajtur *“Rikthim i përhershëm nga largësia e afërsisë...”*

Në rrafshnaltat e Andeve, përballë mrekullisë së shpirtit krijues të Inkëve, kur kishte medituarr rreth të madhërishtes që mbetet frymëzim i amshuar, kishte parë edhe mjerimin e rrënuesve, që, ndonëse shfaqej si dhunë dhe qëllon vlerat më të mira, megjithatë nuk është në gjendje të arrijë qëllimin përfundimtar dhe kjo kishte bërë që t'i nënshtrohej vlerësimit nga këndvështrimi i ndërtimit, pra i krijimit si fuqi absolute, me çka edhe projekti jetësor për Dardanië si kujtesë poetike, me ato nëntëdhjetë e nëntë poemat me mijëra e mijëra vargje me gjashtëmbëdhjetë rrokje, do t'i shfaqet thujse i ndryshueshëm dhe me këtë edhe i papërfunduar, nga shkaku se edhe ato që vërshimi i frymëzimit i ngjyrote si rënie, si dështime, si fatkeqësi dhe tragjedi, madje, siç ishte tragjedia e fundit që ishte kërcënuar me shfarosje - çuditërisht i rishfaqeshin si ngadhënjime dhe aty hetonte se ishte një ndërhyrje e ngjashme me atë të kujtesës historike, që mund t'i vinte nga ai kodi i hapur i të atit, i cili vepronte diku i pandalshëm edhe atëherë kur ai ndodhej përballë rrëtimeve të brendshme...

- Ka diçka që përherë ngre lart, bile edhe atëherë kur rënia duket e përhershme. Kjo ndërhyrje duket e pashpjegueshme, por çuditërisht vepron...

Kështu i kishte thënë holandezja Helga Krojf, me çka atij i ishte krijuar bindja se edhe ato që kishin paraqitur “ndërhyrje” krijuese (të shumtën kishte menduar që i vinin nga poetja dhe këngëtarja e talentuar Shpresa Kamberi, që ishte vlarë të nesërmen e asaj dite që ishin shfaqur rusët në Prishtinë), flisnin për një të vërtetë të pamohueshme dhe për atë dramën e madhe të shpirtit, me kundërshti të pandalshme, që ruante qenien dhe themelet e saj, madje edhe atëherë kur e përkohshmja kërkonte të kthehej në gjendje të përhershme të shkapërderdhjeve të brendshme, siç mund të thuhej edhe për ato krijesat e përkohshme dhe të dhunshme nëpër të cilat ishte kaluar, që nga Gjyshi i Madh, gjyshi, i ati dhe ai, (Serbia e Londrës, pastaj e ashtuquajtura Mbretëri Serbo-Kroate-Slllovene, Jugosllavia e Versajës dhe ajo e Jaltës me ato fytyrat që kishte: të hegjemonizmit serb, të lidhjes serbo-kroate-slllovene nën Karagjorgjeviqët dhe së fundi, ajo e socializmit vetëqeverisës të Titos), që ishin shfaqur pas tërmetejeve të fuqishme që kishin shembur perandori të mëdha të kohës, atë Osmane dhe Austro-hungareze, që, si të dhunshme dhe pa ardhmëri, nuk kishin qenë në gjendje t'u bënin ballë kthesave të kohës.

Madje, krijesë e ngjashme, pjesë e të përkohshmes që nuk duhej të kthehej kurrë në diçka të përhershme, kishte qenë edhe vetë ajo që, si Shqipëri e përgjysmuar ishte shfaqur në fundin e nëntorit të një mijë e nëntëqind e dymbëdhjetës në Vlorë, e që një vit më vonë ishte njohur edhe nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, por që qëllimisht e gjymtuar (Kosova dhe pjesë të tjera të etnisë që i ishin shkëputur dhunshëm dhe u ishin dhënë vendeve

përreth) asnjëherë nuk kishte qenë në gjendje të bëhej e tërë dhe të ndjehej e qëndrueshme, e kjo ishte vërtetuar edhe me ato pushtimet e kohëpaskohshme që i kishin ardhur herë nga Serbia, herë nga Greqia dhe së fundi edhe nga Italia fashiste, kur përkohësisht, si shtet, do të shkrihej për t'u rishfaqur, por tash nën kthetrat e ideologjisë komuniste, që nuk kishte paraqitur tjetër veçse një lodër që ishte përplasur sa në gjirin e Beogradit, sa të Moskës, e edhe të Peknit, në mënyrë që së fundi të mbyllet në atë fortesë iluzore, të "kështjellës së kuqe", që nga ai vetëmashtrim i madh dhe shkatërrues do ta shpëtojë rënia e ideologjisë së cilës i ishte dhënë me aq përkushtim...

Ndonëse krijesat e përkohshme, që kërkonin të ktheheshin në të përhershme, i ndërhyenin kudo, edhe aty ku bënte çmos t'u mbyllte derën, megjithatë ishte një lloj udhëzimi për shpëtimin prej tyre, i cili duhej të kërkohej te perandoria e më të mirës dhe vendosja e saj, qoftë si iluzion, i cili sikur i vinte nga ato ndërhyrjet e jashtme, që nuk i ndaheshin dhe që ia priste mendja se i kishte nga Gjyshi i Madh, i cili kërkonte t'u mbetej besnik hapësirave dhe hapjes, ngritjes dhe ngjitjes, edhe atëherë kur kjo pengohej nga të gjitha anët dhe me të gjitha mjetet, porosi këto, të cilat sikur i kishte që nga ato të Aleksandrit të Madh e tutje...

Bon, janar-qershor 2007

(Fundi i librit)

...

Shënime për autorin

Jusuf Buxhovi ka lindur më 4 gusht të vitit 1946 në Pejë. Fëmijërinë e kaloi në Gjakovë, ku edhe kreu shkollimin e mesëm. Në vitin 1968 u diplomua në Universitetin e Prishtinës (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe), ndërsa në vitin 1979, me temën „Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet gjermane“ magjistroi në Degën e Historisë të Universitetit të Prishtinës.

Nga viti 1967 e deri në vitin 1999 punoi si gazetar dhe redaktor në gazetën „Rilindja“. Gjatë viteve 1976-1980 dhe 1995-1999 ishte korrespondent i përhershëm i kësaj gazete, i akredituar në Bon të Gjermanisë, ku edhe më tutje punon si analist i pavarur.

Deri më tash ka botuar këto vepra:

1. „**Cirku**“, tregime - „Rilindja“ - 1972
2. „**Pioni**“, tregime - „Rilindja“ - 1975
3. „**Matankrena**“, roman - „Rilindja“ - 1976
4. „**Çaste**“, vështrime letrare – „Rilindja“ – 1978
5. „**Dinosauri**“, dramë – „Rilindja“ – 1979
6. „**Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit**“, roman – „Rilindja“ – 1982
7. „**Ura e Fshejit**“, novela – „Rilindja“ – 1983
8. „**Pranvera e zhveshur**“, dy drama – „Rilindja“ – 1984
9. „**Nata e shekujve**“, roman – „Rilindja“ – 1985. (Fitoi çmimin vjetor të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës)
10. „**Galeria e të vdekurve**“, roman – „Rilindja“ – 1987
11. „**Libri i të mallkuarve**“, roman triptik – „Rilindja“ – 1989. (Fitoi çmimin letrar „Hivzi Sulejmani“)
12. „**Prapë vdekja**“ - (libri i parë) , roman trilogji, „Rilindja“ – 1991 (Fitoi çmimin vjetor të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës)

13. **“Prapë vdekja “** - (libri i dytë) , roman trilogji, **“Rilindja“** –1993
 14. **“Prapë vdekja “** - (libri i tretë) , roman trilogji, **“Rilindja“** – 1995
 15. **“Qyteti i dënuar me vdekje“**, roman, „Faik Konica“ – 2000
 16. **“Letrat për Kryeprincin“**, roman, „Faik Konica“ – 2003
 17. **“Vdekja e Kolonelit“**, roman, „Faik Konica“ – 2004
 18. **“Vera e fundit e Gjin Bardhit“**, roman, „Faik Konica“ – 2004
 19. **”Kujtimet e zonjës Von Braun”**, roman, „Faik Konica“ – 2005
 20. **“Kodi i dashurisë“**, roman, **“Faik Konica“** – 2006. (U nderua me çmimin kombëtar „Azem Shkreli“ si vepra më e mirë e vitit)
 21. **„Udhëtimi i Mendim Drinit“**, roman, **“Faik Konica“** – 2006.
 22. **“Libri i Bllacës – 1 Shënime nga psikiatria“**,trilogji,”Faik Konica”,2007.
 23. **”Libri i Bllacës – 2 Bota e përmbysur e Uraku”**,trilogji,”Faik Konica”,2007.
-